

L I G J
Nr.7889, datë 14.12.1994

PËR STATUSIN E INVALIDIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Statusin i invalidit e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Shoqëria dhe shteti marrin në mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, t’u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t’u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese.

Neni 3

Shteti mbron invalidët nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes.

Neni 4

Invalidët pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 5

Asnjë organ nuk ka të drejtë të japë të dhëna për gjendjen e invaliditetit të një personi pa pëlqimin e tij.

Neni 6

Statusi i invalidit vazhdon edhe pas mbushjes së moshës për pension pleqërie.

Neni 7

7.1. Invalidëve që kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet ose institucionet shtetërore dhe ish-kooperativat bujqësore e që janë me sëmundje profesionale ose të aksidentuar në punë, u jepet nga buxheti i shtetit një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit si përfitim paaftësie.

7.2. Përfitim paaftësie mbi pensionin e invaliditetit përfitojnë gjithashtu paraplegjikët, të paralizuarit dhe të gjithë ata që kanë nevojë për shërbim.

Kriteret e marrjes së përfitimit të paaftësisë dhe masa e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

8.1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pajisjen e invalidëve me:

- a) mjete lëvizëse dhe pajisje të ndryshme ortopedike;
- b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;
- c) me mjete ndihmëse kardiake etj.

Kriteret përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

8.2. Invalidët nuk paguajnë taksa doganore për mjetet lëvizëse dhe ndihmëse të përcaktuara në pikat a,b dhe c të pikës 8.1 të nenit 8.

Neni 9

Shteti cakton për invalidët sipërfaqe të caktuara në shtëpi pushimi bregdetare, malore, balneare, ku bëhen përshtatjet e duhura për mënjanimin e barrierave arkitektonike për paaftësitë e kategorive të ndryshme. Ato shërbejnë për pushimin dhe riaftësimin e invalidëve.

Kriteret e gëzimit të kësaj të drejte përcaktohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 10

Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk lëvizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 11

11.1. Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas.

11.2. Udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqytetas bëhet me 50 për qind të vlerës së biletës.

11.3. Të gjitha mjetet e udhëtimit qytetas dhe ndërqytetas rezervojnë vende të veçanta për invalidët.

Ministria që mbulon transportin dhe komunikacionin nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 12

Hyrja e invalidëve në shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive bëhet me 50 për qind të çmimit të biletës.

Ministria që mbulon kulturën, rininë e sportet nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 13

13.1. Mjediset e institucioneve shëndetësore, të përkujdesjes shoqërore dhe ato publike përshtaten për përdorimin e tyre nga të verbrit dhe paraplegjikët.

Procedura dhe fazat e përshtatjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

13.2. Të gjitha ndërtimet e reja publike që realizohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të ofrojnë mundësi përdorimi nga kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

Ministria që mbulon ndërtimin, strehimin dhe rregullimin e territorit nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 14

Invalidët punësohen dhe ripunësohen në ndërmarrje shtetërore dhe private në procese pune të përshtatshme që rekomandohen nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë.

Rregullat për punësimin dhe ripunësimin e invalidëve caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Invalidët favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit e të rikualifikimit profesional, si dhe ndjekjen e shkollave të larta.

Neni 16

16.1. Invalidët përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta të parashikuara në ligjin nr.7680, datë 3.3.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë".

16.2. Kur invalidi ushtron veprimtari private, nuk përjashtohet nga taksat.

Neni 17

Gjatë përgatitjes së akteve ligjore e nënligjore dhe të programeve qeveritare mbahen parasysh interesat e nevojat e invalidëve.

Shoqatat që mbrojnë interesat e invalidëve, marrin pjesë në mbledhjet për diskutimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore që prekin drejtpërdrejt a tërthorazi interesat e invalidëve.

Neni 18

18.1. Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së Invalidëve të Punës sipas mundësive dhe burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim.

18.2. Mjediset që shteti vë në dispozicion të Shoqatës së Invalidëve të Punës për të zhvilluar veprimtarinë e saj, jepen në përdorim pa shpërblim.

Neni 19

19.1. Të drejtat që gëzojnë invalidët sipas statusit të tyre, afishohen në vende të dukshme në mjediset publike.

19.2. Për shkelje të të drejtave që sanksionohen nga ky ligj, invalidi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Neni 20

20.1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe e ish të Përmdekurve Politikë.

20.2. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse nxjerrin aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1000, datë 28.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

L I G J
Nr.8098, datë 28.3.1996

PËR STATUSIN E TË VERBËRIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore ushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësore janë të paaftë për punë në kushte normale.

Neni 2

Shteti dhe shoqëria marrin në mbrojtje personat e verbër dhe krijojnë të gjitha kushtet për integrimin e tyre në jetën normale. Me integrim kuptohet pjesëmarrja aktive duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a) krijimin e kushteve të përshtatshme për banim, të sipërfaqes së banimit dhe të pajisjeve të zakonshme dhe speciale;
- b) punësimin në kushte të favorshme e me përparësi, duke përcaktuar profesionet e mbrojtura me ligj;
- c) risistemimi në punë i atyre të verbërve që për arsye të ndryshme janë pushuar ose kanë humbur punën dhe gjatë kësaj kohe marrin një shpërblim të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;
- ç) përcaktimin e fondeve për depistimin dhe ridiagnostikimin nga klinikat okulistike të sistemit të shërbimit shëndetësor shtetëror nën mbikëqyrjen dhe me ndihmën e specialistëve të huaj të klinikave të përparuara perëndimore, si dhe krijon kushte të favorshme për mjekimin e syve dhe sëmundjeve të tjera të lindura apo të fituara.

Neni 3

Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë veprë penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta.

Neni 4

Të verbërit përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë veprimtari private si persona juridikë.

Neni 5

Pavarësisht nga të ardhurat e tjera që përfitojnë nga shteti, të verbërit marrin një shtesë për shkak të verbërisë së tyre në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave e cila nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekt varfërie. Po në këtë masë pagesën e përfiton edhe kujdestari i tyre, të cilin e zgjedhin vetë.

Neni 6

Personat juridikë shtetërorë apo privatë që punësojnë të verbërit, përveç kriterëve të

përcaktuara në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, përfitojnë ulje në tatimin mbi fitimin të barabartë me përqindjen e fuqisë punëtore të verbër.

Neni 7

Këshillat e Rregullimit të Territorit dhe organet e urbanistikës nuk miratojnë asnjë projekt për rrugët e mjediset publike, në qoftë se në to nuk janë mbajtur parasysh përshtatjet e nevojshme dhe të mundshme të tyre për të verbërit.

Shteti kujdeset për strehimin e të verbërve, duke siguruar veçanërisht për të verbërit e grupit të parë, ose që barazohen me ta, një dhomë mbi kubaturën normale dhe përshtatjen e saj në raport me kushtet fizike.

Enti Kombëtar i Banesave përballon shpenzimet për blerjen dhe përshtatjen e banesës që përfitojnë të verbërit.

Neni 8

Arsimimi i të verbërve në sistemin shtetëror bëhet falas, kurse pranimi i tyre në arsimin e zakonshëm bëhet me kritere të veçanta të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Gjatë kohës së studimit në arsimin e mesëm, universitar ose pasuniversitar, si dhe gjatë periudhës së kualifikimit, të verbërit përfitojnë pagesën e vendosur nga Këshilli i Ministrave. Ata me gradë shkencore këtë pagesë e përfitojnë në mënyrë të përhershme.

Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e të verbërve.

Neni 9

Shteti bën sigurimin shëndetësor të të verbërve falas , si dhe përfitimin e ilaçeve dhe pajisjeve ndihmëse mjekësore falas, deri në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit përcakton listën e pajisjeve ndihmëse.

Neni 10

Këshilli i Ministrave merr masat dhe përcakton fondet për ndërtimin e dy qendrave të pushimit bregdetare dhe malore me kapacitet të mjaftueshëm për numrin e të verbërve në Shqipëri. Administrimi i tyre bëhet nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë dhe subvencionohet nga shteti në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Në funksion të çlodhjes dhe argëtimit shteti përkrah veprimtarinë kulturore të të verbërve, si dhe u siguron falas hyrjen në mjediset kulturore.

Neni 11

Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat.

Neni 12

Të gjithë të verbërit, të paafte për të lëvizur pa shoqërues, në kushte fizike të invaliditetit të grupit të parë, pajisen me telefon. Ata paguajnë tarifë telefonike të nivelit të parë të favorizuar për popullsinë, e përcaktuar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke u përjashtuar nga tarifat e tjera, diferencat paguhen nga shteti.

Të gjithë personat e verbër, sipas nenit 1 të këtij ligji, paguajnë 20 për qind të vlerës së konsumit mujor të energjisë elektrike, diferencat paguhen nga shteti.

Neni 13

Shteti mbron dhe përkrah Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë.

Ai i njeh asaj rolin aktiv në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve, duke e trajtuar si palë konsultative në hartimin e ligjeve e akteve nënligjore, si dhe zgjidhjen e problemeve të të verbërve.

Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim.

Shteti vë në dispozicion të Shoqatës së të Verbërve mjedise pune në qendër dhe në rrethe, të cilat ua jep në përdorim.

Neni 14

Asnjë organ nuk ka të drejtë të japë të dhëna për gjendjen e invaliditetit të një personi pa pëlqimin e këtij të fundit.

Neni 15

Personat e verbër të përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji përfitojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligjin nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statutin e invalidit”.

Neni 16

Paditë e ngritura në gjykatë për mozbatimin e këtij ligji shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar. Shpenzimet përballohen nga shteti.

Neni 17

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministritë përkatëse të nxjerrin akte nënligjore në zbatimin e këtij ligji.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1458, datë 9.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

L I G J
Nr.8153, datë 31.10.1996

PËR STATUSIN E JETIMIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Përfitojnë statusin e jetimit personat me moshë nga 0-25 vjeç, që kanë kaluar ose jo nëpër institucione shtetërore a private të përkujdesit shoqëror dhe që plotësojnë këto kritere:

- a) të lindurit jashtë martese;
- b) që nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit;
- c) të cilëve me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njerin prind dhe prindi tjetër nuk jeton;
- d) që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre.

Neni 2

Personat që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 1, përfitojnë nga ky status edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, nëse nuk janë trajtuar nga shteti me strehim dhe janë në kushte të vështira jetese.

Kriteret për trajtimin e tyre dhe afatet kohore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Vendosja e fëmijëve jetimë në institucionet shtetërore ose private të përkujdesit shoqëror bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Institucionet që trajtojnë jetimë, duke përfshirë dhe ato arsimore, janë të detyruara që me mbarimin e vitit të parafundit të shkollës të dërgojnë statistika të sakta pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe pranë zyrave të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror në bashki e komuna, me qëllim që të merren masa për sistemimin e tyre me punë dhe strehim sipas rregullave të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

1. Jetimët në institucionet shtetërore ose private të përkujdesit shoqëror mbahen deri në moshën 14 vjeç. Në rastet kur fëmija brenda kësaj moshe nuk ka mundur të kryejë shkollën 8-vjeçare mbahet deri në moshën 17 vjeç. Pas kësaj moshe zbatohet neni 6 për ata që fitojnë statusin e jetimit.

2. Me mbarimin e shkollës 8-vjeçare drejtorja e institucionit të përkujdesit shoqëror, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe organet e pushtetit lokal, planifikon për jetimin të drejtë studimi sipas pritjeve dhe aftësive. Këtyre personave u jepet bursë e plotë nga shteti, sipas kriterëve që përcaktohen me akte nënligjore.

Neni 6

Bursa dhe trajtimi me veshmbathje për vitet e shkollës së mesme dhe të lartë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Për jetimët që mbarojnë shkollën e mesme ose të lartë dhe që jetojnë në konvikte, shpenzimet e ushqimit përballohen nga zyrat e ndihmës dhe të përkudësimit shoqëror në bashki e komuna, deri në zënie e tyre me punë.

Neni 8

Jetimët që vazhdojnë shkollat e mesme a të larta, për periudhën e pushimeve verore, trajtohen me një pagesë suplementare që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 9

Shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet për jetimët, të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, sigurohen falas nga shteti. Për këtë Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 10

Udhëtimi me mjetet e transportit shtetëror e privat qytetas, si dhe ndërqytetas i jetimëve që s'janë në marrëdhënie pune bëhet falas.

Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë nxjerr për këtë aktet nënligjore përkatëse.

Neni 11

Për jetimët e vendosur në institucionet e përkujdesimit shoqëror sigurohet hyrja në shfaqje, spektakle, veprimtari sportive etj., me 50 për qind të vlefës së biletës.

Për këtë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 12

Punësimi i jetimëve bëhet me përparësi nga zyrat e punës e përkujdesjes sociale.

Neni 13

Jetimët e punësuar trajtohen me përparësi nga punëdhënësi, duke krijuar mundësi për mbajtjen në punë gjatë procesit të shkurtimit të veprimtarisë.

Neni 14

Jetimët trajtohen me përparësi në emigracionin e organizuar nga shteti. Në këto raste përjashtohen nga taksat.

Neni 15

Personave që fitojnë këtë status dhe shkojnë për të kryer shërbimin e detyruar ushtarak, u jepet nga shteti një kuotë suplementare që caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Djemtë jetimë që mbarojnë shërbimin ushtarak sistemohen me strehim e punë nga bashkitë e komunat në bazë të kërkesës së bërë 6 muaj më parë nga kryesia e shoqatës. Në rast të kundërt, sistemohen në konvikte. Shpenzimet e ushqimit përballohen nga zyrat e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror deri në zënien e tyre në punë.

Neni 17

Strehimi i personave që përfitojnë nga ky status bëhet me përparësi dhe me kredi afatgjata nga shteti, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, si dhe aktet nënligjore përkatëse. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 18

1. Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së Jetimëve Shqiptarë sipas mundësive financiare të planifikuara për këtë qëllim.

2. Të gjitha ndihmat humanitare, si me fonde ashtu edhe me materiale për jetimët, livrohen nëpërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim edhe me Shoqatën e Jetimëve.

3. Mjediset që shteti vë në dispozicion të Shoqatës së Jetimëve për të zhvilluar veprimtarinë e saj, jepen në përdorim pa shpërblim.

Neni 19

Pranë Komitetit Shqiptar të Birësimeve merr pjesë dhe një përfaqësues i Shoqatës së Jetimëve.

Neni 20

Këshilli i Ministrave ngarkon ministrinë përkatëse për zbatimin e këtij ligji, në bashkëpunim me komisionin qendror që do të ngrihet pranë kësaj ministrie.

Mënyra e krijimit dhe e funksionimit të komisionit qendror rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1634, datë 11.11.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

L I G J
Nr.9143, datë 16.10.2003

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7889, DATË 14.12.1994 "PËR STATUSIN E
INVALIDËVE", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidëve", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshon si më poshtë:
"PËR STATUSIN E INVALIDËVE TË PUNËS".

Neni 2

Neni 1 riformulohet si më poshtë:

"Neni 1

Statusin e invalidit e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme, që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", i ndryshuar dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar."

Neni 3

Neni 7 riformulohet si më poshtë:

"Neni 7

Invalidët e punës, që kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet, institucionet shtetërore, ish-kooperativat bujqësore, repartet ushtarake, si dhe ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, që vuajnë nga sëmundje profesionale, të aksidentuar në punë dhe me sëmundje të ndryshme, që marrin pension invaliditeti, në mbështetje të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", i ndryshuar dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, nga Buxheti i Shtetit.

Kriteret e marrjes së përfitimit të paaftësisë dhe masa e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3999, datë 6.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.9233, datë 13.5.2004

PËR NJË SHITESË TË LIGJIT NR.8153, DATË 31.10.1996 “PËR STATUSIN E JETIMIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, pas nenit 18 shtohet neni 18/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1

Data 20 maj shpallet Dita Kombëtare në Ndihmë të Jetimëve”,

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4240, datë 8.6.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9355, datë 10.3.2005

PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim:

1. Të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

2. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

Neni 2

Ky ligj rregullon marrëdhëniet e financimit e të ofrimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në Shqipëri.

Neni 3

Parimet bazë, mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore, janë:

- a) respekti dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit;
- b) universaliteti;
- c) barazia e mundësive;
- ç) e drejta për të përfituar;
- d) partneriteti;
- dh) transparenca dhe paanshmëria;
- e) decentralizimi;
- ë) pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit;
- f) mosdiskriminimi;
- g) karakteri subvencionues;

Neni 4

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Ndhmë ekonomike” është mbështetja, në para e natyrë, e individëve me status të veçantë dhe e familjeve në nevojë.

2. “Pagesë për personat me aftësi të kufizuar” është pagesa mujore, në lekë, që u jepet personave me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimit të këtij ligji.

3. “Person me aftësi të kufizuar” është individi, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko-mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente,

sëmundje të përkohshme ose të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.

4. “Invalid pune” është individ i cili është deklaruar i tillë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfiton nga ligji nr. 7889, datë 14. 12. 1994 “Për statusin e invalidëve”, i ndryshuar.

5. “Shërbime shoqërore” është tërësia e shërbimeve që u ofrohet individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë, me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente ose kronike.

6. “Njësi e pushtetit vendor” është bashkia ose komuna, ku subjektet përfituese, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar kompensimin e të ardhurave materiale ose/dhe monetare, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe për shërbime shoqërore.

7. “Administrator shoqëror” është nëpunësi civil i organeve të pushtetit vendor, i cili administron shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët në nevojë.

8. “Familje” është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën strehë.

9. “Familje kujdestare” është një familje alternative, sipas përkufizimit të dhënë në nenin 266 të ligjit nr. 9062, datë 8. 5. 2003 “Kodi i Familjes”.

10. “Kryetar i familjes” është personi, sipas kësaj renditjeje: babai, nëna, anëtari më i madh i familjes, në grup-moshën aktive 18-65 vjeç, anëtari më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç, dhe kujdestari, kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç.

11. “Familje në nevojë” është familja, që nuk ka të ardhura materiale ose/dhe monetare apo i ka të pamjaftueshme, nga veprimtaria ekonomike, programe të tjera të mbrojtjes shoqërore dhe kapitali.

12. “Familje bujqësore” është familja, që ka në pronësi tokë të punueshme, pavarësisht nga vendndodhja e familjes ose e tokës.

13. “Të ardhura të familjes” janë të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes nga çdo lloj burimi, duke përfshirë dhe ata që përkohësisht jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin pjesëtarët e familjes me aftësi të kufizuar mendore ose fizike, të verbërit, paraplegjikët e tetraplegjikët, përfitimet e invalidëve sipas Statusit të Invalidit të Punës, si dhe pagesat për fëmijët e lindur si trinjakë a më shumë.

14. “Jetim” është fëmija pa prindër, deri në moshën 25 vjeç, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” .

15. “Shërbime shoqërore në komunitet” janë të gjitha llojet e shërbimeve shoqërore, publike dhe jopublike, që kryhen në nivel vendor në territorin nën juridiksionin e bashkisë ose komunës.

16. “Person i moshuar” është personi, që ka arritur moshën e pensionit të pleqërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

17. “Vendbanim” është vendi ku familja ose personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë ose të realizimit të interesave të vet, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

18. “Vendqëndrim” është vendi ku banohet për një kohë të caktuar për arsye pune, studimi, trajtimi mjekësor, pushimi, shërbimi të detyruar ushtarak apo vuajtjeje dënimi, si dhe raste të tjera të kësaj natyre.

19. “Burime jetese” janë të gjitha mjetet monetare ose të ardhurat në natyrë, të cilat bëjnë të mundur jetesën.

20. “Veprimtari ekonomike” është çdo veprimtari, në formën e punësimit, të vetëpunësimit, të punës që kryhet pa pagesë pranë një anëtari të vetëpunësuar të familjes, si dhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme, që sjell të ardhura për individët dhe familjet e tyre.

21. “Kapital” është çdo lloj prone ose pasurie që mund të sjellë të ardhura.

22. “Veprim i qëllimshëm” është çdo veprim që synon të shmangë punësimin e shpërblyer, kualifikimin për punësim dhe për mundësi punësimi, trajtimin mjekësor në rastet e përdoruesit të drogës ose të përdoruesit me tepri të alkoolit, mospërdorimin e kapitalit atje ku është mundësia për të siguruar mjetet e domosdoshme të jetesës, dhënies reale të të ardhurave, si dhe çdo veprim që nxit ndarjen e familjeve, që vërtetohet se kanë të njëjtën strehë, për përfitim nga ndihma ekonomike.

KREU II PËRFITUESIT E NDIHMËS DHE TË SHËRBIMIT SHOQËROR

Neni 5

Përfitues të ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet në nevojë.
2. Jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari.
3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.

Neni 6

Përfituesit e shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, gratë, vajzat në nevojë, si dhe të gjithë ata që janë në rrezik të bëjnë pjesë në grupet në nevojë.

Neni 7

Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

1. Të verbrit, me mungesë të plotë ose të pjesshme të shikimit, të lindur ose të fituar, të cilët janë deklaruar të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë.
2. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha.
3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.
4. Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës.

Neni 8

Personat përfitues që përcaktohen në pikat 1, 2, 3 të nenit 7 të këtij ligji, të cilët me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë.

Neni 9

Nga ky ligj nuk përfitojnë:

1. Shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit si emigrantë, me përjashtim të personave dhe të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë.
2. Azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilit.
3. Shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe e luftërave.

KREU III LLOJET E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Neni 10

Ndihma ekonomike jepet në formën e një kësti mujor, në lekë, ose përfitimi mujor, në natyrë,

për kategoritë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Masa mujore e ndihmës ekonomike në vlerë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

1. Pagesa për personat me aftësi të kufizuar jepet në formën e një kësti mujor, në lekë. Masa e pagesës për këta individë dhe për kujdestarët e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Përfituesit e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, të klasifikuar me vendim të komisioneve mjekësore të aftësisë në grupet e dyta të paaftësisë, humbasin të drejtën e pagesës së aftësisë së kufizuar në çastin e punësimit të tyre.

Neni 12

Shërbimet shoqërore, sipas natyrës, ndahen në:

- a) shërbime të përkujdesit shoqëror;
- b) shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor.

Neni 13

1. Shërbimet e përkujdesit shoqëror përfshijnë shërbimet që u ofrohen individëve, familjeve, grupeve në nevojë, komuniteteve, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, për plotësimin e nevojave të tyre jetësore.

2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror-mjekësor ofrohen nga personeli i specializuar në qendra riintegruese dhe rehabilituese rezidenciale, në qendra ditore ose në familje, për individët, të cilët nuk janë në gjendje të jetojnë normalisht, për shkak të përkeqësimeve të përkohshme apo të përhershme fizike, psikike dhe mendore.

Neni 14

Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së organizimit dhe të funksionimit, janë:

- a) shërbime të përkujdesit rezidencial;
- b) shërbime të përkujdesit komunitar.

Neni 15

1. Shërbimi në institucionet rezidenciale ofrohet për individë, për të cilët përkujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosja e tyre në qendrat e përkujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e personit, pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të tij.

2. Shërbimet e përkujdesit komunitar ofrohen në qendra ditore, në shtëpitë e individëve ose në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të grupeve përfituese.

Neni 16

Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe në shërbime private.

Neni 17

1. Shërbimet e përkujdesit shoqëror publik përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror, që ofrohen në institucionet rezidenciale, ditore ose në shtëpi, për grupet në nevojë.

Këto shërbime financohen nga buxheti qendror dhe nga buxhetet e pavarura të organeve të qeverisjes vendore.

Bashkitë ose komunat administrojnë të gjitha shërbimet shoqërore për individë, që janë banorë të atij qyteti apo komune.

Qarku administron shërbime kur ato ofrohen për individë, që u përkasin disa njësi vendore në atë qark.

2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror privat përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror, që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi, të financuara privatisht.

Neni 18

1. Personat juridikë publikë dhe personat juridikë privatë, që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, licencohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Kriteret dhe procedurat për licencimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror publik, që financohen me fondet e buxhetit qendror apo vendor prokurohen nga organet e pushtetit vendor tek ofruesit privatë të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

3. Organet e pushtetit vendor lidhin kontratë me personat juridikë privatë fitues, për shërbimet që ato ofrojnë në juridiksionin e territorit të tyre.

4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale harton standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe kontrollon zbatimin e tyre. Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

KRITERET E PËRFITIMIT DHE PROCEDURA E DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Neni 19

Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet në nevojë, është e plotë ose e pjesshme.

1. Ndhimë ekonomike të plotë përfitojnë familjet ose individët, që nuk kanë të ardhura nga:

a) veprimtaria ekonomike;
b) programet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore ose ndonjë sistem tjetër i mbrojtjes shoqërore;

c) kapitali;

ç) pjesëtarët e familjes që janë në emigracion.

2. Ndhimja ekonomike është e pjesshme kur familja pretenduese ka të ardhura të pamjaftueshme nga:

a) toka;

b) bagëtia, shpendët, bletët, vreshtaria e kopshtaria;

c) pensionet dhe të ardhura të tjera.

3. Vlerësimi në koeficient i të ardhurave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni, për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike të plotë ose të pjesshme, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

1. Ndhimja ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuar shpërndahen një herë në muaj me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

2. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga kryetari i familjes dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët madhorë të saj. Aplikuesit paraqesin dokumentacionin e nevojshëm tek administratori shoqëror pranë njësisë së pushtetit vendor. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar pagesë për personat me aftësi të kufizuar paraqiten tek administratori shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore. Kriteret për përfitimin e pagesës

për personat me aftësi të kufizuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror paraqiten tek administratori shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore. Kriteret e pranimit në institucionet e përkujdesit shoqëror dhe për shërbimet në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Këshilli i bashkisë ose komunës ka të drejtë të miratojë kritere specifike për të dhënë ndihmë ekonomike ose për të ofruar shërbime të përkujdesit, me fondet e buxhetit vendor, për familjet me shumë pjesëtarë apo familjet në nevojë.

Neni 22

Personat, që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, pranoen në institucionet rezidenciale publike pa pagesë, nëse familjet e tyre nuk kanë asnjë të ardhur. Shpenzimet e tyre mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 23

1. Personat, që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror dhe kanë të ardhura personale, pranoen në institucionet publike të përkujdesit, kundrejt një pagese në raport me të ardhurat e tyre mujore ose të ardhurat e individëve të tjerë përgjegjës. Masa e kontributit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pagesa e personave me aftësi të kufizuar, sipas nenit 7 të këtij ligji, nuk përfshihet në llogaritjen e të ardhurave personale të personave, që vendosen në institucionet publike të përkujdesit shoqëror.

3. Përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, që vendosen në institucionet e përkujdesit, u jepet në dorë një shumë në lekë për shpenzime personale. Kjo shumë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare miratohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. Nivelet e kuotave të shpenzimeve në institucionet private nuk mund të jenë më të ulëta se ato në institucionet publike.

Neni 25

Aplikuesi, të cilit i refuzohet kërkesa për përfitim të ndihmës ekonomike, pagesës për aftësinë e kufizuar ose të shërbimit shoqëror me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, ka të drejtë për ankimim në gjykatë.

KREU V

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SKEMËS SË NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Neni 26

1. Shërbimi Social Shtetëror është institucion publik, në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. Statuti i Shërbimit Social Shtetëror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Shërbimi Social Shtetëror administrohet dhe drejtohet nga Këshilli Administrativ, i cili është organi më i lartë vendimmarrës.

4. Funkcionet dhe anëtarësia e Këshillit Administrativ përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Shërbimi Social Shtetëror përgjigjet për zbatimin e politikave të Ministrisë së Punës dhe

Çështjeve Sociale në fushën e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për:

- a) programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror;
- b) hartimin e standardeve të shërbimeve dhe propozimin për miratim të shërbimeve të reja;
- c) përcaktimin e dokumentacionit unik të nevojshëm për aplikuesit dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore, sipas këtij ligji.

Neni 27

1. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të legjislacionit, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standardeve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore, në sektorin publik dhe privat.

2. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale ngre Inspektoratin e Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili kontrollon veprimtarinë dhe zbatimin e legjislacionit në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe seksionet e ndihmës ekonomike në bashki ose komuna, si dhe miraton dokumentacionin e përcaktuar në nenin 26 pika 5 shkronja "c" të këtij ligji.

3. Procedura e kryerjes së kontrollit nga ky Inspektorat përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale grumbullon informacione, statistika dhe raporte nga njësitë e pushtetit vendor, me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave, arritjen e standardeve për ndihmën ekonomike, kryerjen e pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror. Përmbajtja, periodiciteti dhe treguesit statistikore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale harton dhe paraqet pranë Ministrisë së Financave nevojat për fonde nga buxheti për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror.

Neni 29

Këshilli i bashkisë ose komunës ka këto përgjegjësi:

1. Miraton fondin dhe numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.
2. Miraton fondin për pagesën e personave me aftësi të kufizuar.
3. Miraton fondin për shërbimet e përkujdesit shoqëror.
4. Harton planin për zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, bazuar në burimet, nevojat dhe përparësitë vendore.
5. Miraton dhe mbështet zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit në bazë të vlerësimit të nevojave e përparësive vendore.
6. Merr vendime për personat, familjet, llojet e shërbimeve shoqërore që do të ofrohen bazuar në:

- a) vlerësimin e nevojave të individëve dhe familjeve, të kryera nga administratori shoqëror;
- b) mundësitë financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve.

7. Vendos, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të drejtën dhe masën e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjen, si dhe ofrimin e përfitimeve të veçanta, të parashikuara me ligj.

8. Autorizon strukturat e njësisë së qeverisjes vendore të kontraktjnë me ofrues shërbimesh shoqërore private të licencuara edhe në rastet kur këto shërbime ofrohen nga shërbime shoqërore publike.

9. Me fondet e veta, në bazë të kriterëve specifike, mbështet me ndihmë ekonomike ose forma të tjera ndihme të menjëhershme familjet në nevojë.

10. Miraton programet për kushtëzimin e ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet. Kriteret për kushtëzimin e ndihmës me punë e shërbime në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

11. Miraton strukturat e institucioneve në varësi të tij, që merren me shpërndarjen e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe realizimin e shërbimeve të përkujdesit nën juridiksionin e tij.

12. Miraton programe bashkëpunimi me OJF-të, institucionet e kultit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, në përputhje me nevojat dhe planet kombëtare e rajonale të ndihmës dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Neni 30

Për administrimin e skemës së ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, pranë qarqeve, bashkive ose komunave ngrihen strukturat përkatëse. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave, në zbatim të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 31

Administratorët shoqërorë në bashki ose komuna kanë për detyrë:

a) të identifikojnë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe nevojat e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror;

b) të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike;

c) të propozojnë në këshillin e bashkisë ose komunës familjet në nevojë, për të përfituar ndihmë ekonomike;

ç) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror;

d) të marrin pjesë në procesin e hartimit të projektvendimit për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, të listës së personave me aftësi të kufizuar dhe personave që do të trajtohen me shërbime të përkujdesit shoqëror;

dh) të llogarisin dhe të propozojnë për miratim në seksionin e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror të bashkisë ose komunës masën e ndihmës ekonomike;

e) të hartojnë kërkesën për bllok-ndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për njësinë e qeverisjes vendore;

ë) të bashkëpunojnë për hartimin e planeve vendore dhe rajonale në mbështetje të personave në nevojë;

f) të vlerësojnë nevojat e individëve ose familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore, në përputhje me përparësitë kombëtare dhe vendore, mundësitë financiare për mbulimin e këtyre shërbimeve, të përgatisin dokumentacionin dhe propozimet për miratim në këshillin e bashkisë ose komunës;

g) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror;

gj) të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e bashkisë ose komunës.

KREU VI

FINANCIMI I NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Neni 32

Shteti ofron shërbime të përkujdesit shoqëror dhe forma të tjera të mbështetjes për personat në nevojë, sipas mundësive të Buxhetit të Shtetit.

Neni 33

Financimi i programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe buxhetet e qeverisjes vendore.

Neni 34

Burimet e financimit të ndihmës dhe pagesës së personave me aftësi të kufizuar përbëhen nga:

- a) fondet e Buxhetit qendror të Shtetit;
- b) fondet nga taksat dhe tarifatat vendore.

Neni 35

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale programon fondet për bllok-ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar, në përputhje me vlerësimin e kërkesave të ardhura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe një herë në dy muaj i transferon ato në bashki ose komunë.

Kriteret dhe treguesit që përdoren për programimin e bllok-ndihmës propozohen nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale delegon një herë në 4 muaj fondin e bllok-ndihmës ekonomike në bashki ose komuna, të cilat dhënie e ndihmës ekonomike e kushtëzojnë me punë e shërbime të përkujdesit shoqëror në komunitet.

Teprica e fondeve të ndihmës ekonomike, e krijuar si rezultat i menaxhimit më të mirë të bllok-ndihmës, pas miratimit nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, i mbetet njësisive vendore. Këto fonde shërbejnë për të mbështetur programe, që zbatohen për punë ose shërbime në komunitet brenda vitit.

Neni 37

Burimet e financimit për shërbimet e përkujdesit shoqëror, që realizohen nga institucionet publike dhe jopublike në nivel qarku, bashkie ose komune, në institucionet rezidenciale, në qendrat ditore, në familje ose shërbime të lëvizshme në komunitet përbëhen nga:

- a) fondet e deleguara nga Buxheti qendror i Shtetit;
- b) fondet e caktuara nga taksat dhe tarifatat vendore;
- c) të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe veprimtari të tjera të bashkisë ose komunës;
- ç) kontributet e përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji;
- d) dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë të tjerë, që nuk përfshihen në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni.

Neni 38

Fondet nga Buxheti Qendror për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror delegohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në bashki, komunë ose qark që në fillim të vitit, në përputhje me vlerësimin e nevojave dhe me mundësitë e Buxhetit të Shtetit. Metodologjia e llogaritjes dhe e shpërndarjes së këtyre fondeve përcaktohet nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Për mbështetjen e shërbimeve të reja të përkujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale krijon Fondin Shoqëror, i cili përbëhet nga:

- a) një pjesë e fondeve të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror;
- b) financime jashtëbuxhetore nga organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë të tjerë;

c) të ardhurat e tjera, që sigurohen nga zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, që Republika e Shqipërisë lidh me shtetet e tjera;
ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Rregullat e përdorimit të Fondit Shoqëror përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 40

Kontrolli për përdorimin e fondeve të ndihmës, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror bëhet nga organet e specializuara të kontrollit, në përputhje me ligjin nr. 9009, datë 13. 2. 2003 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

KREU VII

Neni 41

Sanksionet

Çdo shkelje e këtij ligji dhe e akteve nënligjore në zbatim të tij quhet kundërvajtje administrative, në mbështetje të ligjit nr. 7697, datë 7. 4. 1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 42

Dispozita kalimtare

1. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale harton programin e kalimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në varësi të pushtetit vendor.

2. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale harton dhe ndjek procedurat e transferimit të shërbimeve shoqërore dhe kalimin e institucioneve në varësi të qeverisjes vendore, duke filluar nga viti 2005 deri në vitin 2007.

3. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale merr masat për transferimin e fondeve për të gjitha institucionet që transferohen në varësi të qeverisjes vendore.

4. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale krijon Inspektoratin e Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore brenda vitit 2005.

5. Qarqet, bashkitë ose komunat ngarkohen të krijojnë e të plotësojnë strukturat për administrimin e skemës së ndihmës ekonomike, pagesës për aftësinë e kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, sipas nevojave, brenda vitit 2006.

Neni 43

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 10, 11, 18, 19, 20, 23, 26, 27, 29, 30, 35, 38 dhe 39 të këtij ligji.

Neni 44

Ligji nr. 7710, datë 18. 5. 1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", i ndryshuar,

vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij dhe neni 2 i ligjit nr. 8626, datë 22. 6. 2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” shfuqizohen.

Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4520, datë 25.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.9669, datë 18.12.2006

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20 mijë zgjedhësve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Neni 2
Objekti

Ky ligj ka si objekt:

- a) krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- b) orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- c) fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
- ç) sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. “Dhunë” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.
2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.
3. “Pjesëtarë të familjes” janë:
 - a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish–bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues;
 - b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
 - c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën “b”;
 - ç) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es

ose bashkëjetuesit/es;

d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit;

dh) fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

4. “Viktimë“ është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

5. “Dhunues/e” është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.

6. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykatë, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.

7. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykatë, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykatë.

Neni 4 Subjektet

Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjithë personat e cilësuar në nenin 3 pika 3 të këtij ligji.

KREU II ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5 Autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:

a) njësitë e qeverisjes vendore;

b) Ministria e Brendshme;

c) Ministria e Shëndetësisë;

ç) Ministria e Drejtësisë.

Neni 6 Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:

a) hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

b) financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, si dhe të gjithë infrastrukturës së nevojshme, që shërben për një mbështetje dhe plotësim të të gjitha nevojave për personat e dhunuar në marrëdhëniet familjare, përfshi këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore dhe sociale, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) organizimin e kurseve të trajnimit rreth dhunës në familje me punonjësit e shërbimeve sociale, që janë të atashuar pranë çdo njësie vendore, strukturat e Policisë së Rendit dhe me punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale;

d) mbajtjen e të dhënave statistikore për nivelin e dhunës në familje;

dh) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje;

e) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;

ë) licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit.

Neni 7

Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës

1. Ministria e Brendshme ka këto detyra:
 - a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;
 - b) trajnimin e efektivave e policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje.
2. Ministria e Shëndetësisë ka për detyrë të krijojë kapacitetet e duhura për të ofruar ndihmë mjekësore për dhunën në familje në shërbimet e urgjencës dhe në qendrat shëndetësore në bashki dhe komuna:
 - a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje;
 - b) për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;
 - c) për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;
 - ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;
 - d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.
3. Ministria e Drejtësisë ka këto detyra:
 - a) të trajtojë ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;
 - b) të trajtojë përmbaruesit në detyrën e tyre për të ekzekutuar urdhrat e mbrojtjes në mënyrë të menjëhershme, të sigurojë përmbushjen e tyre në përputhje me nenin 23 pika 6, si dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura;
 - c) të financojë mbrojtje ligjore falas, sipas parashikimeve në ligj dhe të sigurojë një numër të caktuar avokatësh të trajnuar, që mund të japin një asistencë të tillë.
4. Njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë, komunat) kanë këto detyra:
 - a) angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje;
 - b) instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre;
 - c) ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

Neni 8

Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Përmbushja e këtij detyrimi mbikëqyret nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
2. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrat të mbrojtjes apo urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj.
3. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të:
 - a) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet;
 - b) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimin në qendrat dhe institucionet përkatëse;
 - c) sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale;

ç) vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.

4. Nëse ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje apo ka thyer urdhrat e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, organet e policisë do të bëjnë konstatimet e menjëhershme.

5. Personat të cilët marrin dijëni për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të Kodit Penal.

6. Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktima vihet në dijeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.

Neni 9

Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse

1. Në rast të dhunës në familje, viktimë mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë postës së policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme.

2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarë masat e nevojshme.

KREU III

MASAT MBROJTËSE

Neni 10

Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje

1. Mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, do të sigurohet me këto mënyra:

a) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj paditësit/es (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

b) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

c) duke larguar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;

ç) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

d) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm ose të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimë, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

dh) duke vendosur menjëherë viktimën/at dhe të miturit në strehime të përkohshme, duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;

e) duke kufizuar ose duke ndaluar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

ë) duke i ndaluar të paditurit/ës (dhunuesit/es) hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;

f) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbaues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin/ën (dhunuesin/en) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;

g) duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të konfiskojnë çdo armë që i përket dhunuesit

gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij;

gj) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktimë dhe dhunuesi/ja ose ndonjë pjesë të saj;

h) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;

i) për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;

j) duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore të paditurit/ës (dhunuesit/es);

k) duke vendosur dhe duke urdhëruar sipas rastit (në kompetencë të gjykatës) ndërhyrjen e shërbimeve sociale, publike apo private të vendbanimit ose pranë organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje;

l) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët, për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën, gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;

ll) duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;

m) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të marrë pjesë në programe rehabilitimi; nëse i/e padituri/a (dhunuesi/ja) urdhërohet të shkojë në një program rehabilitimi, përgjegjësve të programit u kërkohet të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi e ndjek apo merr pjesë në të. Nëse i/e padituri/a (dhunuesi/ja) nuk merr pjesë, atëherë, me kërkesë të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, gjykata e thërret këtë përpara saj dhe zbaton dispozitat përkatëse të Kodit Penal, për pengimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës.

2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendimin e gjykatës, mund të parashikohen disa nga masat e parashikuara në shkronjat “a” deri në “g” të këtij neni.

4. Në rastin e zbatimit të shkronjës “g” të këtij neni, gjykata mban parasysh:

a) nëse arma është konfiskuar, ajo mund të kthehet vetëm pas mbarimit të urdhrin të mbrojtjes dhe marrjes së një urdhri nga gjykata;

b) nëse arma është konfiskuar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, gjykata njofton autoritetin përkatës administrativ, ose pezullon lejen e armës derisa të mbarojë urdhri mbrojtës.

Neni 11

Efektet e urdhrin të mbrojtjes

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e mësipërme do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i nxjerrë me vendim gjykate, apo përfundimi i efekteve të tij nuk cenon në mënyrë të përhershme të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

KREU IV

GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDRIT TË MBROJTJES

Neni 12

Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje

1. Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e rrethit gjyqësor, seksioni familjar.

Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, gjykata lëshon urdhra mbrojtjeje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.

2. Pala e interesuar mund t'i kërkojë gjykatës, sipas rastit, konform dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

3. Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës, siç parashikohet në këtë ligj. Urdhri mbrojtës përkatës shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 13

Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes

1. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:
 - a) vetë viktimja;
 - b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
 - c) policia / prokuroria.
2. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:
 - a) prindi ose kujdestari i të miturit;
 - b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
 - c) të afërmit;
 - ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimja, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
 - d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
3. Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:
 - a) vetë viktimja;
 - b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
 - c) policia/prokuroria;
 - ç) personi me të cilin viktimja ka marrëdhënie familjare;
 - d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimja, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
 - dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
4. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 14

Forma e kërkesë-padisë

1. Kërkesë-padia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes duhet të përmbajë edhe:
 - a) të dhëna personale rreth familjes ose marrëdhëniet farefisnore mes viktimës dhe dhunuesit;
 - b) përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cenimin e sigurisë, të shëndetit apo të mirëqenies së viktimës nga i/e padituri/a (dhunuesi/ja) të parashikuara në nenin 3 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji;
 - c) masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen;
 - ç) nënshkrimin e kërkuesit.
2. Kërkesë-padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin "Për Policinë e Shtetit".
3. Për hartimin e kërkesë-padisë, përgatitjen e akteve dhe paraqitjen e tyre në gjykatë kërkuesi asistohet nga një avokat falas.
4. Kërkuesi shkarkohet nga taksat e gjykatës. Me daljen e urdhrin të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje. Në rast të kundërt, shpenzimet gjyqësore

i ngarkohen kërkesit.

5. Kërkesë-padia regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj.

Neni 15

Provat në procesin gjyqësor

1. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njërive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.

2. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisaritet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkesi ose të vetë gjykatës. Në rast të moslëshimit të dokumentit të mësipërm, personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.

3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.

Neni 16

Gjykimi për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës.

2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:

- a) viktimën, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;
- b) të paditurin/ën (dhunuesin/en), përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij/saj;
- c) prokurorin, nëse ky ka paraqitur kërkesën;
- ç) përfaqësuesit e policisë;

d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur, kur kërkesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;

dh) punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;

- e) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

3. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 17

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdhër mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesë-padi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse vërteton se:

a) ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje;

b) lëshimi i urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave, urdhër në të cilin, përveç kërkesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë, me të cilët kërkesi ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, i cili, përveçse përmbush kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

- a) masën e caktuar nga gjykata;
- b) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;
- c) njoftimin se shkelja e urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;
- ç) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, brenda 15 ditëve nga shpallja apo marrja dijeni e tij.

4. Urdhri i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile. Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njëri prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrin ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

- a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;
- b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;
- c) zyrës së shërbimeve sociale të njësisë vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
- ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

Neni 18

Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.

2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhrë të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjohen personat në vijim:

- a) viktima, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj;
- b) dhunuesi/ja, përfaqësuesi apo avokati i tij/saj;
- c) prokurori, nëse merr pjesë;
- ç) kërkuesit e tjerë, të parashikuar në nenin 13 të këtij ligji;
- d) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Neni 19

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse konstaton se:

- a) ekzistojnë bazat për të besuar se i/e padituri/a (dhunuesi/ja) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje; ose
- b) i/e padituri/a (dhunuesi/ja) paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës; ose
- c) lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, që mbrohen me anë të urdhrit të mbrojtjes.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

- a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;

c) njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën veprë penale, në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

ç) njoftimin për të drejtën e ankimit kundër vendimit brenda 5 ditëve nga shpallja apo marrja dijani e tij;

d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.

4. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile.

Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njëren prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjkata, brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) kërkuesve në kuptim të nenit 13 të këtij ligji;

c) zyrës së shërbimeve sociale të njësisve vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisaritit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga zyra e përmbarrimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510/e, 516/c e vijues).

Neni 20

Gjykimi për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes

Pas përfundimit të seancës gjyqësore për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata vazhdon seancën për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes mbi bazën e kërkesës, në zbatim të nenit 16 të këtij ligji. Në përfundim të procesit gjyqësor gjykata:

a) vendos anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;

b) refuzon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate;

c) lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate.

Neni 21

Ankimi

1. Kundër vendimit përkatës të gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankimi i veçantë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

2. Kundër vendimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose kundër vendimit për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate mund të bëhet ankimi brenda afateve dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

3. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrin të mbrojtjes.

Neni 22

Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, viktimi (përfaqësuesi i saj), dhunuesi/ja ose prokurori, nëse ka marrë pjesë në proces, mund të paraqesë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes.

2. Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes, gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

a) lënien në fuqi të urdhrin të mbrojtjes;

b) ndryshimin e urdhrin të mbrojtjes nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht; ose

c) ndërprerjen e tij, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 10 pika1 të këtij ligji nuk vlejné më, për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.

3. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes.

4. Viktimi ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, mund të parashtrijë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrihet kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij.

5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

a) vërtetimin e ndërprerjes së urdhrin të mbrojtjes në datën e përfundimit të efekteve të tij; ose

b) vazhdimin e efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, nëse vlejné kriteret e përcaktuara në nenin 17 pika1 të këtij ligji.

Neni 23

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor

1. Vendimi gjyqësor, i cili përmban urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv që në momentin që shpallet (ose u njoftohet palëve). Gjkata lëshon një urdhër ekzekutimi në të njëjtën kohë që lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.

2. Vendimi gjyqësor, që përmban urdhrin e mbrojtjes, përbën titull ekzekutiv pasi të marrë formën e prerë dhe ekzekutohet menjëherë nga përmbaruesit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, komisariatet e policisë dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki, komuna) apo edhe vetë dhunuesi vullnetarisht. Gjkata lëshon urdhrin e ekzekutimit në të njëjtën kohë që lëshon dhe urdhrin e mbrojtjes.

3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.

4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e licencuara për ofrim shërbimesh zbatojné masat e parashikura në vendimin gjyqësor dhe koordinojné punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.

5. Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të gjykatës bëhet nga zyrat e shërbimit përmbarimor, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510 e vijues).

6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga organet zbatuese të vendimit të gjykatës, siç përshkruhet në pikat 2 dhe 4 të këtij neni, përfshirë dhe të paditurin/ën, të cilëve u komunikohet vendimi, ndiqet ekzekutimi i detyruar në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këto raste, ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës zbatohen sanksionet përkatëse të parashikura në nenet 320 e 320/a të Kodit Penal, si edhe sanksionet e parashikuara në nenin 606/3 të Kodit të Procedurës Civile.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Procedimi penal

Lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procesin penal, për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve

që përbëjnë figura të veprave penale.

Neni 25
Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 26
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

Shpallur me dekretin nr.5182, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr. 26/2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8098, DATË 28.3.1996 “PËR STATUSIN
E TË VERBRIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Të verbrit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Të gjithë personat e verbër, sipas nenit 1 të këtij ligji, përfitojnë kompensim të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës telefonike fikse. Masa, kriteret dhe procedurat e përfitimit të këtij kompensimi financiar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 15.3.2012

Shpallur me dekretin nr. 7370, datë 5.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr. 121/2016

PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj përcakton:

- a) llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërkimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- b) rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Shërbime të kujdesit shoqëror” është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

2. “Shërbime rezidenciale” janë shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike.

3. “Shërbime komunitare” janë shërbime që ofrohen në qendra komunitare lokale ose në mjedise të tjera, si shërbimet e kujdesit ditor apo të zëvendësimit të përkohshëm të kujdestarit për të gjitha kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

4. “Shërbime parashoqërore” janë shërbime që përfshijnë informimin e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ofruesit e shërbimeve, ndihmën për përfituesit në përcaktimin e nevojave të tyre, vlerësimin fillestar, mbështetjen dhe ndihmën për zgjedhjen që u përshtatet nevojave të përfituesit në sistemin e shërbimeve shoqërore.

5. “Shërbime në familje” janë shërbime të kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për kategoritë në nevojë, që e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare, ditore dhe rezidenciale.

6. “Shërbime të specializuara” janë shërbimet e ofruara nga profesionistë të profilizuar në specialitete të ndryshme. Këto shërbime ofrohen në nivel qarku/rajonat dhe bashkie për fëmijët me çrregulime pervazive të zhvillimit, prapambetje mendore, çrregullime në komunikim, në nevojë për aftësim fizik, fëmijët e abuzuar seksualisht, fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe gratë e vajzat e abuzuara, të dhunuara apo të trafikuar, si dhe të gjitha kategoritë që kanë nevojë për shërbime të tilla.

7. “Shërbimi i këshillimit me telefon ose *on-line*” është shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve, sipas protokollove të hartuara dhe të miratuara.

8. “Përfitues i shërbimeve të kujdesit shoqëror” është subjekti, individi ose familja që përmbush kushtet për të përfutur të drejtat nga shërbimi shoqëror.

9. “Fëmijë” është çdo individ deri në moshën 18 vjeç.

10. “Fëmijë në nevojë për mbrojtje të veçantë” është individ deri në moshën 18 vjeç, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, trafikimit, diskriminimit, dhunës, braktisjes apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ nën 18 vjeç, i cili ka kryer ose akuzohet se ka kryer një veprë penale.

11. “Person me aftësi të kufizuara” është individ, fëmijë ose i rritur, me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

12. “Viktima të dhunës” janë të gjithë individët, grupet e individëve apo familjet, të cilat janë viktima dhe/ose viktima të mundshme të dhunës, përfshirë dhunën në familje ose abuzimet, sipas legjislacionit në fuqi.

13. “Viktimë e trafikimit” është personi fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përkufizimit të shkronjës “e”, të nenit 4, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore””.

14. “Situatë emergjence” është një situatë kritike, e përkohshme ose jo, e shkaktuar nga faktorë shoqërorë, që sjellin apo mund të sjellin dëme të menjëhershme, të rënda ose që dëmtojnë seriozisht jetën, shëndetin apo mirëqenien e individit në rast se nuk merren masa urgjente dhe ndaluese.

15. “Procedurë administrative”, “Akt administrativ”, “Kompetenca administrative”, “Organ publik”, “Palë” kanë kuptimin e dhënë në Kodin e Procedurave Administrative.

16. “Kujdestar” është individ që ofron shërbime kujdestarie për të miturit sipas përcaktimeve në Kodin e Familjes.

17. “Familje kujdestare” është një familje alternative, e vendosur nga gjykata për t’i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirëritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.

18. “Ndhmës personal” është individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

19. “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predis-pozicione gjenetike, aftësinë e kufizuara, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

20. “Person i vetëm” është individ i cili nuk ka një familje ose që jeton i vetëm.

21. “Prind i vetëm” është prindi i/e cili/a nuk është martuar ose që kujdeset i/e vetëm/me për fëmijën/ët e tij/saj.

22. “Person mbi moshë pune” është individ që, në çastin e vlerësimit të kriterëve për përfitim të

shërbimit shoqëror, është mbi moshën e përcaktuar të punës për atë vit, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

23. “Njësi të qeverisjes vendore” janë bashkitë dhe qarqet, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore.

24. “Punonjës social i njësisë së qeverisjes vendore” është profesionisti, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, që do të jetë përgjegjës për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve.

25. “Menaxhim i rastit” është sigurimi dhe bashkërendimi i referimit të individëve në nevojë për kujdes shoqëror në të gjithë procesin e ofrimit të shërbimit, sa herë që të jetë e nevojshme, deri në integrimin e plotë të tyre.

26. “Subjekt jopublik, ofruer i shërbimeve shoqërore” është çdo ofruer jopublik i licencuar për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, nga autoriteti përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin.

27. “Regjistri Elektronik Kombëtar” është baza elektronike e të dhënave të përfituesve, subjekteve ofruese, institucioneve përgjegjëse, llojit dhe kohëzgjatjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror.

28. “Punonjës i shërbimeve sociale” është i punësuar në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si pjesë e sistemit publik dhe jopublik të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

29. “Tarifat e shërbimeve të kujdesit shoqëror” janë tarifat që vendosen me vendim të këshillit bashkiak në përputhje me kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas llojit të shërbimit dhe mënyrës së përcaktimit të tyre.

KREU II PARIME TË VEÇANTA

Neni 4 **Parimet**

Shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

a) Parimi i universalitetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë krijuar, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një sistem rregullash ligjore që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t’u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.

b) Parimi i drejtësisë sociale. Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t’i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

c) Parimi i subsidiaritetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.

ç) Parimi i mbështetjes shoqërore. Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

d) Parimi i deinstitutionalizimit. Shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.

dh) Parimi i partneritetit. Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

e) Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.

ë) Parimi i mosdiskriminimit. Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

f) Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, subjekt të këtij ligji, për të cilat ka marrë dënimin si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

PJESA E DYTË KATEGORITË E SUBJEKTEVE PËR FITUESE DHE LLOJET E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

KREU I SUBJEKTET QË GËZOJNË TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Neni 5

Kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale.

2. Shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren nga shtetasit shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë.

3. Shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren edhe nga shtetasit e huaj, personat pa shtetësi dhe refugjatët, por me banim në Republikën e Shqipërisë.

4. Personat, të cilët kanë fituar statusin e refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të drejtën e kujdesit shoqëror njësoj si shtetasit shqiptarë, bazuar në dokumentacionin përkatës, të përgatitur për këtë qëllim nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, sipas legjislacionit në fuqi për azilin.

Neni 6

Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore:

a) familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin;

b) personat me aftësi të kufizuara;

c) të rriturit, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;

ç) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare;

d) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë;

dh) të moshuarit në nevojë.

2. Individit, i cili nuk përfshihet te përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas pikës 1, të këtij neni, ka të drejtë, kundrejt tarifave përkatëse, të kërkojë sistemim të përkohshëm në institucionet e ofrimit të shërbimit, qofshin këto rezidenciale apo komunitare, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, deri në mbarimin e rrethanave të veçanta për të cilat ka kërkuar shërbimin.

Neni 7

Kategoritë që nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror

Nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror kategoritë e mëposhtme:

a) shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit;

b) azilkërkuarit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilit;

c) shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe luftërave;

ç) personat që vuajnë dënim me heqje lirie, me vendim të formës së prerë të gjykatës.

KREU II

SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR DHE MËNYRAT E OFRIMIT TË TYRE

Neni 8

Llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuar të përfituesve.

2. Llojet e shërbimeve shoqërore janë si më poshtë:

a) shërbimet parashoqërore;

b) shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit;

c) shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat;

ç) shërbimet shoqërore në situatë emergjente;

d) shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror;

dh) shërbimet e specializuara;

e) shërbimi i këshillimit me telefon ose *on-line*.

3. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë shërbime rezidenciale kur është i pashmangshëm dhe i papërshtatshëm ofrimi i tyre në familje apo komunitet.

4. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përdorur shërbime të kujdesit shoqëror paraqiten te punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore, pjesë e strukturave të vlerësimit të nevojave dhe referimit në njësitë e qeverisjes vendore.

5. Kriteret dhe procedurat e pranimit në qendrat rezidenciale dhe për përdorimin e shërbimeve në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Klasifikimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.

2. Në shërbimet shoqërore publike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore.

3. Shërbimet jopublike klasifikohen në shërbime fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Shërbimet shoqërore fitimprurëse nuk mund të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit dhe ai i bashkive. Shërbimet shoqërore jofitimprurëse gëzojnë të drejtën të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit apo ai i bashkive, vetëm nëse kanë lidhur kontratë me subjektin që ka përgjegjësi për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror.

4. Shërbimet shoqërore të specializuara janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe nga njësitë e qeverisjes vendore në nivel qarku.

5. Në shërbimet shoqërore jopublike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi nga subjekte jopublike.

Neni 10

Shërbimet parashoqërore

1. Shërbimet parashoqërore konsiderohen si shërbime komunitare dhe përbëhen nga:

- a) informimi dhe këshillimi;
- b) shërbimi në familje;
- c) mbështetja psiko-sociale;
- ç) ndërhyrja e hershme.

2. Shërbimet parashoqërore sigurohen nga profesionistë të caktuar nga struktura të vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë njësite të qeverisjes vendore.

Neni 11

Informimi dhe këshillimi

Informimi dhe këshillimi janë shërbime që synojnë përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij, në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 12

Shërbimi në familje

1. Shërbimi në familje është shërbim ndaj individit, person i vetëm, që jepet në shtëpi ose në familjen kujdestare.

2. Shërbimi në familje u njihet fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari.

3. Shërbimi në familje është një kombinim shërbimesh të kujdesit ditor që përfshin:

- a) furnizimin dhe shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi;
- b) furnizim të barnave apo furnizime të tjera;
- c) mbajtjen e higjienës personale;
- ç) përmbushjen e nevojave të tjera të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti;
- d) mbështetjen psiko-sociale.

Neni 13

Mbështetja psiko-sociale

1. Mbështetja psiko-sociale ofrohet individualisht ose në grup dhe synon inkurajimin, rehabilitimin, zhvillimin e aftësive njohëse, funksionale, komunikuese apo shoqërore të përfituesve.
2. Kur vlerësohet e nevojshme nga strukturat e vlerësimit të nevojave dhe referimit, mbështetja psiko-sociale mund të jepet edhe si pjesë e shërbimeve të specializuara.

Neni 14

Ndërhyrja e hershme

1. Ndërhyrja e hershme është një shërbim shoqëror individual që ofrohet në familje, në qendra sociale për ofrimin e shërbimeve në komunitet ose institucionet e arsimit të detyrueshëm dhe konsiston në ndihmë profesionale dhe stimuluese për fëmijët deri në 8 vjeç, asistencë këshilluese për prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes me lidhje gjaku ose për familjen kujdestare, me qëllim riintegrimin në shoqëri të fëmijës.
2. Ndërhyrja e hershme përfshin referimin e rastit të fëmijës të një qendër e shërbimeve shoqërore e specializuar, institucion i arsimit të detyrueshëm apo institucion mjekësor, sipas karakteristikave të veçanta të fëmijës.

Neni 15

Shërbimet komunitare

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror, të ofruara kryesisht në qendra komunitare, ofrohen si shërbime të plota ditore ose gjysmëditore.
2. Qëndrimi i plotë ditor zgjat nga gjashtë deri në tetë orë në ditë, ndërsa qëndrimi gjysmëditor nuk mund të jetë më shumë se gjashtë orë në ditë.
3. Gjatë kohës së qëndrimit në qendrën komunitare garantohet siguria fizike, jepen shërbime për higjienën personale, kujdesin shëndetësor, edukimin, rehabilitimin psiko-social, kalimin e kohës së lirë në komunitet, fuqizimin e individit/familjes, si dhe çdo shërbim tjetër i nevojshëm, sipas nevojave të identifikuar të përfituesit.
4. Shërbimet e plota ditore mund të përdoren një ose disa ditë në javë ose gjatë të gjitha ditëve të punës.
5. Kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Shërbimet në qendrat e zhvillimit

1. Shërbimet në qendrat e zhvillimit janë shërbime komunitare që synojnë sigurimin dhe përmirësimin e statusit dhe cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç.
2. Llojet e shërbimeve, që ofrohen në qendrat e zhvillimit janë si më poshtë:
 - a) terapi intensive psiko-sociale për aftësimin mendor dhe rehabilitimin social me qëllim integrimin në komunitet;
 - b) shërbim psikomotor për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë dhe të motorikës fine e globale;
 - c) aftësim i parametrave fizikë;
 - ç) shërbime të specializuara ortofonie për aftësimin e individëve me çrregullime të spektrit autik apo aftësisë për të komunikuar;
 - d) terapi riaftësimi për punë;
 - dh) terapi zhvillimi.

Neni 17
Strehëzat

1. Shërbimi në strehëza është shërbim i kujdesit shoqëror rezidencial i ofruar në mënyrë të përkohshme, që përfshin shërbimin e specializuar, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psiko-social, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit.

2. Përfituesit e shërbimit në streha janë:

- a) fëmija, i cili gjendet i pambikëqyrur nga prindërit, në rrezik, apo në situatë rruge;
- b) fëmija në nevojë të mbrojtjes së veçantë;
- c) i rrituri, ose i moshuari, i cili nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten;
- ç) gratë dhe vajzat shtatzëna ose prindi i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç;
- d) fëmijët dhe të rriturit, viktimat të dhunës në familje, abuzimit, viktimat të trafikimit apo viktimat të mundshme të trafikimit ose në rrezik potencial për jetën;
- dh) fëmijët dhe të rriturit në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësive nga droga ose alkooli apo përjashtimi social.

3. Ky shërbim mund të ofrohet gjatë të gjitha ditëve të javës dhe përfshin edhe referimin në një shërbim tjetër shoqëror.

Neni 18
Strehimi i përkohshëm

1. Strehimi i përkohshëm është një shërbim i ofruar ndaj individëve që ndodhen në rrethana të vështira dhe emergjente, deri në referimin e tyre të një shërbim tjetër shoqëror.

2. Përfituesit e këtij shërbimi nuk kalojnë në procesin e zakonshëm të vlerësimit të rastit, por vetëm referohen nëpërmjet punonjësit social.

3. Pas kalimit të situatës së emergjencës, struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe referimin bën vlerësimin e mëtejshëm të rastit për personin në nevojë.

4. Ky shërbim strehimi mund të jepet edhe në familjen me lidhje gjaku ose familjen kujdestare.

5. Strehimi i përkohshëm zgjat deri në gjashtë muaj, por mund të zgjatë deri në një vit, rast pas rasti.

Neni 19
Trajtimi i fëmijës në situatat e emergjencës

1. Në rast se një punonjës social i njësisë së qeverisjes vendore informohet ose beson në mënyrë të arsyeshme se fëmija ndodhet në situatë emergjente, ndërmerret veprimet e mëposhtme:

- a) largon fëmijën nga vendndodhja aktuale dhe e strehon atë në strehën e përkohshme më të afërt;
- b) ndihmon fëmijën duke e dërguar në spital ose informon menjëherë policinë në rast se situata e kërkon;
- c) komunikon me fëmijën për të kuptuar situatën e tij;
 - ç) informon fëmijën mbi hapat që duhen ndjekur sipas këtij neni.
 - d) referon fëmijën në njësinë e mbrojtjes së fëmijës.

2. Menjëherë pas dërgimit të fëmijës në strehën e përkohshme, punonjësi social informon prindërit ose përfaqësuesin ligjor të fëmijës.

3. Strehja e përkohshme ku është strehuar fëmija bën kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje në gjykatën kompetente, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e fëmijës, duke legjitimuar qëndrimin e tij në qendrat e kujdesit shoqëror.

4. Në rast se gjykata lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, fëmija qëndron në qendrat e

kujdesit shoqëror, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë ligj.

5. Pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, institucioni i kujdesit shoqëror, në rast se e diktojnë rrethanat, paraqet përpara gjykatës një kërkesë për vendosjen ose zëvendësimin e kujdestarisë.

6. Në rast se gjykata nuk e gjykon të arsyeshëm lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore monitoron mirëqenien e fëmijës pranë familjes.

Neni 20

Trajtimi i fëmijëve të shfrytëzuar ose të trafikuar

Institucionet, të cilat me ligj janë përgjegjëse për trajtimin e fëmijëve të shfrytëzuar ose të trafikuar, janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet specifike për të ndihmuar dhe mbështetur fëmijët, viktimat të shfrytëzimit ose trafikimit, deri në shërimin e tyre fizik dhe psiko-social, pas një vlerësimi të veçantë të rrethanave të secilit fëmijë, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme, sipas ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore””.

Neni 21

Shërbimet në qendrat rezidenciale

1. Shërbime në qendrat rezidenciale konsiderohen shërbimet e strehimit afatgjatë dhe të organizuar që u ofrohet kategorive në nevojë, për të cilat kujdesi në shtëpi nuk është i mundur.

2. Vendosja e kategorive në nevojë në qendrat e kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e individit ose përfaqësuesit të tij ligjor pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të individit.

Neni 22

Strehimi afatgjatë

1. Strehimi afatgjatë u sigurohet individëve që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore, kur ky kujdes nuk u sigurohet dot në familje apo familje kujdestare.

2. Personat që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm janë:

a) personat me aftësi të kufizuara, sipas moshës, llojit dhe shkallës së dëmtimit, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje, duke i dhënë format e duhura institucionale të kujdesit;

b) të moshuarit dhe të sëmurët rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore.

Neni 23

Strehimi i organizuar

1. Strehimi i organizuar është një shërbim i kujdesit shoqëror në nivel vendor, i cili ofrohet për 24 orë në ditë në qendrat rezidenciale për të përmbushur nevojat themelore sociale, kulturore, arsimore, rekreative dhe përfituesve nga subjekte publike ose jopublike.

2. Strehimi i organizuar u ofrohet të moshuarve, jetimëve, fëmijëve pa kujdes prindëror ose pa kujdestari, personave me aftësi të kufizuara, duke u dhënë format e duhura rezidenciale të kujdesit, kur janë shteruar të gjitha mundësitë për të siguruar kujdesin në familje, familje kujdestare apo qendra komunitare.

3. Përfituesve të shërbimeve të strehimit të organizuar u jepet një shumë në lekë për shpenzime personale. Kjo shumë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Personat, që kanë dëshirë të përdorin shërbimin e strehimit të organizuar dhe kanë të ardhura personale, mund të pranohen në institucionet publike të strehimit të organizuar, kundrejt një tarife.

5. Në çdo rast, përparësi për t'u pranuar në shërbimin e strehimit të organizuar do të kenë kategoritë e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 24

Shërbimet e përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror

1. Fëmijës së privuar në mënyrë të përkohshme/të përhershme nga mjedisi familjar ose kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis i sigurohet një përkujdesje alternative.

2. Përkujdesja alternative mund të jetë:

a) vendosja në një familje alternative ose në një institucion të përkujdesjes për fëmijë;

b) vendosja në një familje birësuese.

3. Shërbimet e përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror ofrohen në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të fëmijës, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

4. Procedura e evidentimit të familjes kujdestare organizohet dhe mbikëqyret nga strukturat e shërbimeve shoqërore të organeve të njësisë të qeverisjes vendore, të cilat ngrenë pranë tyre komisionet multidisiplinare për vlerësimin e rasteve. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

5. Kriteret, dokumentacioni dhe procedura që do të ndiqet nga strukturat e shërbimeve shoqërore të organeve të njësisë të qeverisjes vendore, për evidentimin e familjeve kujdestare, si dhe masa e financimit për shpenzimet e fëmijës të vendosur në familje kujdestare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve.

Neni 25

Shërbimet publike

1. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfitojnë shërbimet publike, si arsimimi dhe shëndetësia. Shpenzimet e tyre mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

2. Përfituesit e shërbimeve shoqërore, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor. Kontributi në fondin e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore për këto kategori paguhet nga Buxheti i Shtetit.

PJESA E TRETË

ADMINISTRIMI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

KREU I

Neni 26

Kriteret e përgjithshme të funksionimit dhe bashkërendimit

1. Sistemi i shërbimeve të kujdesit shoqëror ofron shërbime, falas ose kundrejt tarifave, sipas rasteve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Në çdo rast, metodologjia e përcaktimit të tarifave dhe nivelit të tyre do të bëhet me udhëzim të

përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave.

3. Koordinimi dhe mbështetja e përgjithshme e shërbimeve të kujdesit shoqëror bëhet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Neni 27

Subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen nga personat juridikë publikë apo jopublikë, të licencuar për këtë qëllim. Licencimi i veprimtarive të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe subjekteve të ofrimit të tyre, të përcaktuara në këtë ligj, bëhet nga autoriteti përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për licencat.

2. Shërbimet e kujdesit shoqëror të financuara privatisht ofrohen nga subjekte jopublike, por sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, në çdo rast, bëhet në përputhje me standardet e hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Neni 28

Pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror fillon me kërkesë të individit në nevojë, përfaqësuesit të tij, psikologut, por mund të fillojë edhe kryesisht nga punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore kur konstatohet situata e nevojës për shërbime.

2. Kërkesa për të përfituar shërbime të kujdesit shoqëror paraqitet te punonjësi social i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit në strukturën e posaçme për shërbimet shoqërore të njësisë së qeverisjes vendore.

3. Këshilli bashkiak vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës për pranimin në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Vendimet e keshillit bashkiak mund të ankimohen në rrugë gjyqësore.

4. Në rast se shërbimi i kujdesit shoqëror për individin nuk ofrohet nga ajo njësi e qeverisjes vendore, kryetari i bashkisë referon rastin te një njësi tjetër e qeverisjes vendore, vetë ose nëpërmjet drejtorisë rajone të Shërbimit Social Shtetëror. Vendimet e kryetarit të bashkisë mund të ankimohen në rrugë gjyqësore.

Neni 29

Regjistri Elektronik Kombëtar

1. Regjistri Elektronik Kombëtar administrohet në nivel qendror nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe aksesohet nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

2. Çdo njësi e qeverisjes vendore ka detyrimin për të hedhur në regjister të dhënat që disponon dhe për të raportuar periodikisht në Shërbimin Social Shtetëror.

3. Të dhënat e hedhura në regjister grumbullohen nga Shërbimi Social Shtetëror dhe i raportohen në mënyrë periodike ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

4. Regjistri Elektronik Kombëtar ngrihet dhe administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazën e të dhënave shtetërore.

5. Rregullat specifike të funksionimit e të administrimit të Regjistrimit Elektronik Kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

Përgjegjësia për zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Zbatimi i sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, që financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore, është përgjegjësi e organeve publike të ngarkuara me këtë detyrë, në nivel qendror dhe vendor.

2. Institucionet kryesore përgjegjëse për administrimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë si më poshtë:

- a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe institucionet e saj të varësisë;
- b) qarku;
- c) bashkia.

Neni 31

Roli i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale organizon dhe administron sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me kërkesat dhe standardet e ofrimit të tyre.

2. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ka këto role dhe funksione kryesore:

a) harton dokumentet e politikave të reformimit e të modernizimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me synim rritjen e efektivitetit dhe ofrimin e tyre;

b) harton dhe përditëson standardet minimale të ofrimit të shërbimeve;

c) harton dhe/ose propozon akte ligjore e nënligjore për plotësimin e kuadrit rregullator të funksionimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;

ç) përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;

d) harton dhe ndërmerr fushata ndërgjegjësimi që inkurajojnë ndihmën, punën vullnetare dhe format e tjera të mbështetjes në favor të individëve dhe familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;

dh) harton dokumente bashkëpunimi mes aktorëve të përfshirë në zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me qëllim koordinimin e bashkëpunimit në mënyrë efektive;

e) programon, si zë më vete në buxhet, fondet për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që u delegohet bashkive si transfertë në fondin social;

ë) harton dhe miraton manuale trajnimi e edukimi për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ana e subjekteve ofruese, me qëllim zbatimin me uniformitet të ligjit;

f) këshillon dhe udhëzon njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me strukturat që duhet të ngrihen prej tyre për zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mënyrat e planifikimit e të ofrimit të shërbimeve;

g) harton dhe paraqet për miratim nevojat për financim nga Buxheti i Shtetit për aktivitetet e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 32

Shërbimi Social Shtetëror

1. Shërbimi Social Shtetëror është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

2. Statuti i Shërbimit Social Shtetëror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika e Shërbimit Social Shtetëror miratohet me urdhër të Kryeministrit.

Neni 33

Roli i Shërbimit Social Shtetëror

1. Shërbimi Social Shtetëror monitoron zbatimin e legjislacionit të shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin, nëpërmjet strukturave të njësisë qendrore dhe drejtorive rajonale.

2. Shërbimi Social Shtetëror ka këto role dhe funksione kryesore:

a) harton dokumentacionin tip për përfituesit e shërbimeve shoqërore;

- b) kryen vlerësimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- c) mbledh, analizon dhe përpunon informacionin mbi ecurinë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale;
- ç) harton raportin vjetor të vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror dhe kapaciteteve të shërbimeve publike e jopublike;
- d) trajnon personelin e njëjësive të qeverisjes vendore që mbulon aspektet e shërbimeve shoqërore;
- dh) bashkërendon procesin e hartimit të planeve sociale, duke siguruar që këto plane të përputhen me strategjitë kombëtare;
- e) përditëson dhe mirëmban Regjistrin Elektronik Kombëtar me të dhënat për përfituesit dhe subjektet kërkuese të kujdesit shoqëror;
- ë) i dërgon ministrisë statistikën sociale të lidhura me shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pagesat sociale.

Neni 34

Roli i Inspektoratit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror

1. Inspektorati, që mbulon fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në vijim Inspektorati, është personi juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.
2. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror ka përgjegjësi të kontrollojë dhe të verifikojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
3. Inspektorati funksionon sipas këtij ligji dhe ligjit që rregullon inspektimin në Republikën e Shqipërisë.
4. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë së Inspektoratit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Struktura dhe organika e Inspektoratit miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 35

Funksionet dhe kompetencat e Inspektoratit

1. Inspektorati, në zbatim të këtij ligji, kryen këto funksione:
 - a) kontrollon zbatimin e kritereve e të kushteve nga subjektet publike dhe jopublike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore, sipas këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;
 - b) inspekton standardet e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - c) bashkëpunon dhe u jep informacion organeve të tjera shtetërore për rastet që janë në kompetencë të tyre, në lidhje me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
 - ç) ushtron kontroll në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat kanë detyrimin të lejojnë dhe të vënë në dispozicion të Inspektoratit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për inspektim;
 - d) vendos gjoha dhe masa të tjera administrative ndaj subjekteve publike dhe jopublike, kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji;
 - dh) i propozon ministrit përgjegjës për çështjet sociale heqjen e licencës së ofruesit të shërbimit shoqëror, i cili, brenda dhjetë ditëve, merr vendimin përfundimtar mbi propozimin e marrë;
 - e) raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale mbi rezultatet e inspektimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
2. Inspektorati shqyrton ankesat ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore, të marra drejtpërdrejt ose të përcjella nga çdo institucion tjetër apo individ.
3. Inspektorati merr vendim, pas shqyrtimit të ankesave, në përputhje me Kodin e Procedurave

Administrative dhe në përputhje me kompetencat e dhëna me këtë ligj.

4. Rregullorja e shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 36

Roli i bashkisë

1. Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj:

a) duke identifikuar nevojat;

b) duke vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit;

c) duke hartuar planin social vendor;

ç) duke programuar buxhetet vendore;

d) duke planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;

dh) duke kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;

e) duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.

2. Për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror.

3. Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësi e vlerësimit të nevojave dhe referimit.

4. Bashkia cakton nga një punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë.

5. Bashkitë, me numër popullsie më pak se gjashtë mijë banorë, orientohen dhe mbështeten në funksionet e tyre nga zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Neni 37

Roli i punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore

Punonjësit socialë në njësinë e qeverisjes vendore janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe kanë për detyrë:

a) të verifikojnë gjendjen shoqërore dhe ekonomike të individëve e të familjeve që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror nëpërmjet identifikimit të rasteve;

b) të ndihmojnë në përgatitjen e dokume-ntacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimit dhe referimit në shërbimet sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar;

c) të marrin pjesë në procesin e hartimit të planeve të kujdesit për personat që do të trajtohen apo të cilëve u refuzohen shërbimet e kujdesit shoqëror nëpërmjet vlerësimit, ndjekjes, monitorimit dhe mbylljes së rastit;

ç) të përgatitin dokumentacionin dhe propozimet për miratim nga këshilli bashkiak;

d) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për personat që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;

dh) të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë.

Neni 38

Roli i qarkut

1. Këshilli i qarkut harton planin social rajonal të bashkërenduar me planet sociale të njësisë të qeverisjes vendore dhe ia paraqet ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

2. Kryetari i qarkut vendos ofrimin e shërbimeve të specializuara në bashkërendim rajonal të rasteve për shërbimet e kujdesit shoqëror të vendosura në nivel rajonal.

3. Kryetari i qarkut krijon komitetin e planifikimit të nevojave “*ad hoc*”, të përbërë nga përfaqësues të të gjitha strukturave vendore /rajonale dhe shoqërisë civile, me pjesëmarrje vullnetare.

KREU II AKREDITIMI DHE EDUKIMI I VAZHUESHËM

Neni 39

Akreditimi

1. Të gjitha subjektet publike/jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe vendase, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të licencuara për ofrimin e trajnimeve e të kualifikimeve, akreditohen nga ministria përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror, në mënyrë periodike, për të vlerësuar shkallën e plotësimit nga ana e tyre të standardeve të paracaktuara për to nga Këshilli i Ministrave.

2. Rregullat dhe mënyra e realizimit të procesit të akreditimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 40

Profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Regjistrimi i profesionistëve është një proces i detyrueshëm, i cili bëhet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

2. Ministri përgjegjës për çështjet sociale miraton, me urdhër, rregulloren për procedurat e regjistrimit dhe reregjistrimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 41

Urdhrat e profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror regjistrohen pranë urdhrave profesionistë përkatës dhe janë subjekt i detyrave dhe përfitimeve korresponduese.

2. Funksionimi i urdhrave të profesionistëve rregullohet me ligje të veçanta.

Neni 42

Edukimi i vazhdueshëm profesional

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale krijon një program të detyrueshëm për edukimin e vazhdueshëm profesional, i quajtur “Programi i certifikimit për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, program i cili është sistem i bazuar në cikle periodike, brenda të cilave profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit të vazhdueshëm profesional, bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Certifikimi është procesi që profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror përfundon me përbushjen e kriterëve të secilit cikël të programit të certifikimit dhe lidhet me ecjen në karrierë të profesionistit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.

2. Profesionistët e ndihmës e të shërbimeve shoqërore janë të detyruar që t’i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rritin cilësinë e shërbimeve.

3. Punësimi ose kontratat në institucionet e kujdesit shoqëror, publike dhe jopublike, pezullohen nëse profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror nuk merr asnjë kredit të edukimit të vazhdueshëm. Rifitimi i së drejtës për punësim ose lidhja e kontratave të punës me institucionet bëhet pasi profesionisti t'i jetë nënshtruar provimit të certifikimit. Nëse profesionisti i shërbimeve të kujdesit shoqëror mbledh kredite të edukimit të vazhdueshëm, por më pak se limiti i kërkuar, ai duhet t'i nënshtrohet provimit të certifikimit brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit. Nëse dështon në provim, punësimi ose kontratat në institucionet e tjera pezullohen. Rifitimi i së drejtës për punësim ose kontrata me institucionet e kujdesit shoqëror, publike dhe jopublike, bëhet pasi profesionisti të ketë kaluar me sukses provimin e certifikimit. Institucionet publike dhe jopublike të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë të detyruara të hartojnë dhe të zbatojnë programe të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e tyre.

4. Institucionet, që merren me shërbimet e kujdesit shoqëror, u nënshtrohen sanksioneve, në rast se ato punësojnë specialistë të cilët nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë nen.

5. Institucionet, që merren me shërbimet e kujdesit shoqëror, lehtësojnë edukimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve të kujdesit shoqëror.

Neni 43

Sigurimi i cilësisë së aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, akreditimi

1. Akreditimi është procesi i miratimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm ose/dhe i ofruesit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, bazuar në procedurat, standardet dhe kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ofrues të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të gjitha strukturat publike ose jopublike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe të vendit, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, sipas kriterëve të miratuara.

3. Ofruesit e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të detyruar të sigurojnë cilësinë e aktiviteteve që zhvillojnë, përmes respektimit të kriterëve të cilësisë e akreditimit dhe standardeve të edukimit të vazhdueshëm profesional.

4. Kriteret, standardet dhe procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, si dhe të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 44

Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore funksionon Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për ndihmën dhe shërbimet shoqërore dhe ka në përbërje një përfaqësues nga:

- a) Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim;
- b) Shërbimi Social Shtetëror;
- c) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- ç) Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve;
- d) Urdhri i Infermierëve;
- dh) Urdhri i Punonjësit Social;
- e) Urdhri i Psikologut.

2. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm është organi më i lartë vendimmarrës në sistemin e certifikimit dhe ricertifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe të akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm. Ky bord mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe, për raste të veçanta, kur është e nevojshme, kryetari mund ta mbledhë atë edhe më shpesh. Mbledhjet e bordit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimmarrja në Bordin e

Edukimit të Vazhdueshëm bëhet me shumicë të thjeshtë.

3. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm kryen këto funksione kryesore:

a) harton kriteret, standardet e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm e të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, si dhe kriteret e procedurat e procesit të certifikimit dhe/ose ricertifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror;

b) miraton tarifat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm;

c) miraton listën e ekspertëve të pavarur për secilën fushë ekspertize, të cilët do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve, si pjesë e procesit të akreditimit, dhe masën e pagesës së tyre, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) shqyrton ankesat e bëra nga profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror për procedurat e njohjes e të regjistrimit të krediteve përkatëse;

d) shqyrton ankesat e bëra nga ofruesit e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për procesin e vlerësimit të jashtëm, të cilat nuk janë zgjidhur nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim;

dh) ndërmer masat e nevojshme për realizimin e provimit të ricertifikimit për të gjithë profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror që nuk përmbushin kërkesat e programit të certifikimit;

e) monitoron zbatimin e programit të certifikimit për të siguruar përmbushjen e detyrave të institucioneve përgjegjëse.

4. Anëtarët e Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm shpërblehen sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të bordeve, këshillave ose komisioneve.

KREU III

FINANCIMI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Neni 45

Burimet e financimit

Burimet e financimit për shërbimet e kujdesit shoqëror, që realizohen nga institucionet publike dhe jopublike, përbëhen nga:

a) fondet e deleguara nga Buxheti i Shtetit, përfshirë fondin social;

b) fondet nga buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore;

c) të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe veprimtari të tjera të bashkisë;

ç) tarifat e shërbimit për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Neni 46

Mekanizmat e financimit

1. Njësia e qeverisjes vendore planifikon, ndërton, administron dhe mirëmban rregullisht shërbimet e kujdesit shoqëror, të ofruara brenda territorit të saj nëpërmjet buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore.

2. Ministri përgjegjës për çështjet sociale udhëzon njësitë e qeverisjes vendore për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen kundrejt pagesës së tarifave zbatojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe bëhen pjesë e paketës fiskale dhe buxhetit vjetor të bashkisë. Në parim, tarifat paguhen nga përfituesi i shërbimit të kujdesit shoqëror dhe synojnë të mbulojnë një pjesë të shpenzimeve korrente për njësitë e shërbimit në fjalë.

3. Tarifat e shërbimeve publike të financuara nga Buxheti i Shtetit caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të Ministrit të Financave, si më poshtë:

a) kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji;

b) dhurimet, sponsorizimet, donacionet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë.

Neni 47
Fondi social

1. Bashkia, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondin social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale. Ndalohet përdorimi i fondit social për financimin e qëllimeve të tjera nga ato të përcaktuara në këtë pikë.

2. Fondi social përbëhet nga:

- a) të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit;
- b) financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë;
- c) të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror;
- ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- d) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia.

3. Mjetet financiare në fondin social, të papërdorura në vitin fiskal ushtrimor, mbarten në buxhetin e vitit pasardhës si pjesë e fondit social.

4. Procedurat e krijimit e të funksionimit të fondit social rregullohen dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 48
Fondet e financimit

1. Në lidhje me financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nga Buxheti i Shtetit, ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e vet fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat u transferohen njësisive të qeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime të kujdesit shoqëror. Në këtë rast, ministri përgjegjës për çështjet sociale shpërndan dhe transferon në fillim të vitit, në buxhetin e njësisive të qeverisjes vendore, fondin social dhe transferta të tjera për çdo shërbim të kujdesit shoqëror, duke marrë parasysh kriterin e nevojës më të madhe dhe prioritetet e çdo njësie të qeverisjes vendore në ofrimin e këtyre shërbimeve.

2. Metodologjia e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror përcaktohet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Fondet nga Buxheti i Shtetit për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror përcaktohen në përputhje me vlerësimin e nevojave dhe me mundësitë e Buxhetit të Shtetit.

KREU IV

Neni 49
Sanksionet

1. Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 25, 27, pika 2, 35, 37 e 38, të këtij ligji, dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe:

- a) dënohen me gjobë, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative;
- b) ndëshkohen me masë disiplinore.

2. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, me qëllim zbatimin e legjislacionit për shërbimet e kujdesit shoqëror, vendos këto sanksione:

- a) kur konstaton kundërvajtje administrative për rastet e shkeljeve të detyrimeve të përcaktuara në nenin 25, të këtij ligji, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, vendos ndaj subjekteve ofruese të shërbimeve të kujdesit shoqëror gjoba nga 50 mijë lekë deri në 100 mijë lekë dhe pezullimin e licencës së subjekteve

jopublike në rast të parregullsive të rënda ose në rast përsëritjeje;

b) për shkeljet nga ana e punonjësve të institucioneve publike zbatuese të këtij ligji të detyrimeve të përcaktuara në nenet 27, pika 2, dhe 35, të tij, nis procedimin disiplinor dhe merr masa, në përputhje me rregullat e Kodit të Punës ose ligjin e nëpunësit civil, sipas përkatësisë së punonjësit;

c) për shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 37 dhe 38, të këtij ligji, zbaton dispozitat e kundërvajtjeve administrative të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;

ç) shpërblimin e dëmit, nëse është shkaktuar një i tillë.

3. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror kryen gjithashtu inspektime në bazë të shkeljeve të konstatuara nga monitorimet e kryera nga Shërbimi Social Shtetëror.

4. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, kur vlerëson se janë konsumuar elementet e veprës penale nga personat përgjegjës, bën kallëzimin penal pranë autoriteteve kompetente.

5. Çdo shkelje e menaxhimit të fondeve buxhetore, që programohen dhe përdoren për shërbimet e kujdesit shoqëror, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas përcaktimeve të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

6. Për çdo masë të marrë nga Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, mund të bëhet ankimi në rrugë gjyqësore.

7. Të gjitha të ardhurat nga gjokat e vendosura, sipas këtij neni, derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit.

Neni 50

Ankimi

1. Kërkuesi/përfituesi i shërbimeve shoqërore, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund të paraqesë ankesë me shkrim pranë njësisë së qeverisjes vendore/Shërbimit Social Shtetëror brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së ankesës.

2. Kërkuesi/përfituesi i shërbimeve shoqërore ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë Inspektoratit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së përgjigjes nga njësia e qeverisjes vendore/Shërbimi Social Shtetëror, pas ezaurimit të ankimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e qeverisjes vendore/Shërbimin Social Shtetëror brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së ankesës.

4. Kërkuesi/përfituesi i shërbimeve shoqërore, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 51

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, pika 29; 8, pika 5; 15, pika 5; 23, pika 3; 24, pika 5; 29, pika 5; 32, pika 2; 34, pika 4; 39, pikat 1 dhe 2; 42, pika 1; 43, pika 4; 46, pika 2; 47, pika 4; dhe 48, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 32, pika 3; dhe 34, pika 5, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 24, pikat 4 dhe 6; 26, pika 2; 27 pika 3; 35, pika 4; 40, pika 2; dhe 46, pika 3, të këtij ligji.

Neni 52

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha qendrat rezidenciale dhe ofrimi i shërbimeve rezidenciale u transferohen njësisë të qeverisjes vendore.

2. Dispozitat apo pjesët e dispozitave të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, që trajtojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, shfuqizohen.

3. Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Neni 53

Shfuqizime

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, bëhen këto shfuqizime:

1. Neni 4, pikat 5, 15 dhe 16, nenet 6, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, pika 4, 22, 23 dhe 24.

2. Në pikën 1, të nenit 26, fjalët “dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standardeve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore, në sektorin publik dhe privat”.

3. Neni 27, pika 5, shkronjat “b” e “c”, pikat 6 dhe 7.

4. Neni 29, pikat 3, 4, 5, 6, 8 dhe 12.

5. Neni 31, shkronja “a”, fjalët “dhe nevojat e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror”, shkronja “c”, fjalët “dhe personat që do të trajtohen me shërbime të përkujdesjes shoqërore”, shkronjat “ë”, “p”, shkronja “g”, fjalët “dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesjes shoqërore”, dhe shkronja “gj”, të këtij neni.

6. Neni 32, neni 33, fjalët “dhe shërbimeve shoqërore”, dhe nenet 37, 38, 39, 42/4.

7. Kudo në ligj, fjalët “dhe shërbimet” dhe “shërbimet e përkujdesjes shoqërore” shfuqizohen.

Neni 54

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.11.2016

Shpallur me dekretin nr. 9886, datë 6.12.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 18/2017

PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN
E FËMIJËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;

b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;

ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;

d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;

dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;

e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia” nënkupton Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
2. “Autoritetet përgjegjës” është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror a vendor, i cili/të cilat, brenda fushës së veprimtarisë së tij/tyre, harton/jnë politika dhe ushtron/jnë përgjegjësitë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, kryen/jnë dhe mbulon/jnë shërbime të specializuara e profesionale për fëmijën.
3. “Dhunë ndaj fëmijës” është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.
4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.
5. “Fëmijë i pashoqëruar” është fëmija që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji.
6. “Fëmijë në nevojë për mbrojtje” është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ i nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.
7. “Këshilli” nënkupton Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
8. “Mbrojtje e fëmijës” është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimet, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.
9. “Ndëshkimi trupor” është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim të fëmija, nga çdo person ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja, shtytja, djegia, goditja, pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, tërheqja e flokëve, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, si dhe çdo veprim i ngjashëm me të.
10. “Neglizhimi i fëmijës” është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.
11. “Përmbajtje të dëmshme për fëmijën” janë çdo pamje, imazh dhe çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cenon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës.
12. “Përfaqësues procedural” është personi i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar/viktimë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.
13. “Pjesëmarrje e fëmijës” është një proces i vazhdueshëm i përfshirjes aktive të fëmijës dhe i respektimit të së drejtës së tij për t’u shprehur e për t’u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje që lidhen me të.
14. “Prind” është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martesë.
15. “Sistemi i integruar i mbrojtjes” është tërësia e akteve ligjore, politike dhe e shërbimeve të nevojshme, në të gjitha fushat, veçanërisht në ato të mirëqenies sociale, edukimit, shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve që shfaqen gjatë zbatimit të tyre. Institucionet përgjegjëse marrin masa konkrete, me qëllim bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësisë dhe koordinimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si

elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.

16. “Shërbimi psiko-social shkollor” është shërbimi që u ofron mbështetje nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore për identifikimin dhe trajtimin e problematikave të ndryshme, sipas nevojave psiko-sociale të komunitetit shkollor, i cili sigurohet nga njësitë arsimore vendore.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

- a) fëmijën me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) fëmijën me shtetësi shqiptare, i cili ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Parime të përgjithshme

Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.
2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.
3. Barazia dhe mosdiskriminimi.
4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.
5. Ndarja e përgjegjësive ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.
6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.
7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj.
8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.
9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.
10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

Neni 6

Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

- a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;
- b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirëritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

KREU II TË DREJTAT E FËMIJËS

Neni 7

E drejta e jetës

1. Mbrojtja e jetës së fëmijës është e garantuar me ligj. Fëmija gëzon standardet më të larta të mundshme të shëndetit, trajtimit e rehabilitimit.

2. E drejta e aksesit të fëmijës tek institucionet e kujdesit shëndetësor garantohet pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, racës, etnisë dhe aftësisë ose situatës ekonomike, sociale e ligjore të prindërve apo kujdestarit.

3. Çdo fëmijë që ka nevojë për shërbim shëndetësor ose trajtim mjekësor apo rehabilitues në situata emergjence, vetë ose nëpërmjet prindërve apo kujdestarit, ka të drejtë t'iu drejtohet institucioneve të kujdesit shëndetësor ose social për këtë qëllim. Personi ose autoriteti përgjegjës, brenda fushës së kompetencave që ka, i ofron fëmijës ndihmën e menjëhershme dhe e referon atë në institucionin e kujdesit shëndetësor ose rehabilitues më të përshtatshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prindit ose kujdestarit.

4. Në raste përjashtimore, kur jeta e fëmijës rrezikohet ose ka një rrezik për pasoja serioze në jetën dhe shëndetin e fëmijës, mjeku ka të drejtë të kryejë ekzaminimin dhe të japë ndihmën mjekësore, si nevojë imediate për të shpëtuar jetën e fëmijës, edhe nëse prindërit ose kujdestari nuk japin pëlqimin.

Neni 8

E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajtur identitetin

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë:

a) të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

b) të ketë një emër;

c) të fitojë shtetësinë;

ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur.

2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.

3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihma mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:

a) gjetjen e prindërve;

b) gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkuës, me qëllim bashkimin familjar;

c) regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.

4. Regjistrimi dhe vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në përputhje me kriteret, rregullat dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.

5. Nëse nuk është i mundur përcaktimi i identitetit të një fëmije të gjetur ose të braktisur në mjediset e institucioneve të kujdesit shëndetësor ose identiteti i prindërve të fëmijës, punonjësi i strukturës së mbrojtjes së fëmijës, kryesisht ose pas marrjes së mendimit të strukturave përgjegjëse të shërbimeve sociale, cakton menjëherë një ose disa punonjës të institucionit ku është gjetur ose braktisur fëmija, për t'u kujdesur për fëmijën deri në marrjen e masave të nevojshme, sipas këtij ligji.

6. Kur fëmija braktiset nga nëna në maternitetet ose institucione të tjera të kujdesit shëndetësor, personeli social dhe mjekësor i tyre, brenda 24 orëve nga zhdukja e nënës, njofton me telefon dhe me shkrim njësinë e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor dhe policinë, në të njëjtën kohë e mënyrë. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor, në bashkëpunim me punonjësin e policisë, përgatit raportin me shkrim mbi faktin e braktisjes së fëmijës, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Nëse gjendja shëndetësore e fëmijës është e mirë, bazuar në raportin e hartuar, njësia e mbrojtjes së fëmijës, pranë pushtetit vendor, merr masa për vendosjen e fëmijës, përkujdesje alternative, sipas nenit 57 të këtij ligji.

7. Në rast se identifikohet njëri nga prindërit, njësia e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor ofron këshillim, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e fëmijës pranë familjes biologjike dhe lëshimin e certifikatës së lindjes. Nëse nëna nuk identifikohet pas hetimit të policisë, punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ka lindur fëmija, përgatit dosjen që përmban aktin e lindjes, raportin e përgatitur, sipas pikës 6, të këtij neni, vendimin për masën e mbrojtjes së fëmijës dhe informacionin e dërguar nga policia për rezultatin e hetimeve të kryera.

8. Institucionet e kujdesit shëndetësor, të shërbimit social, shërbimet rezidenciale, si dhe të gjithë personat juridikë e fizikë që identifikojnë gra shtatzëna ose fëmijë që nuk kanë dokumente identifikimi, njoftojnë me shkrim punonjësin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ushtrojnë aktivitetin, i cili, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të pushtetit vendor, ndërmer veprime konkrete për përcaktimin e identitetit të gruas shtatzënë ose të fëmijës.

9. Rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor, parashikohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 9

E drejta për të qëndruar me prindërit

1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës. Pamundësia ekonomike nuk është shkak i mjaftueshëm që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton, apo të heqjes së përgjegjësisë prindërore.

2. Fëmija, në çdo rast, ka të drejtë të dëgjohet dhe t'i merret mendimi ose pëlqimi nga gjykata, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

3. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kalojë kohë ose të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.

4. Prindi ose kujdestari nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.

5. Në rastet kur ka mosmarrëveshje ndërmjet prindërve, lidhur me mënyrat e ushtrimit të të drejtave të tyre për të mbajtur kontakte me fëmijën, gjykata vendos një ditar të përcaktuar me orare, sipas moshës së fëmijës, intensitetit të lidhjes emocionale që fëmija ka me prindin, me të cilin nuk bashkëjeton, sjelljen e këtij të fundit, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme për vendimmarrjen e gjykatës në secilin rast. Ky kriter ndiqet nga gjykata edhe në përcaktimin e kontakteve të fëmijës me persona të tjerë të afërt me të.

6. Për qëllime të këtij ligji, marrëdhëniet personale mund të ndërtohen nëpërmjet:

a) takimeve ndërmjet fëmijës dhe prindit ose një personi tjetër, i cili, sipas ligjit, ka të drejtë të mbajë kontakte me fëmijën;

b) vizitave të fëmijës në mjedisin e banimit;

c) banimit të përkohshëm të fëmijës te një i afërm ose person, i cili nuk jeton rregullisht me fëmijën;

ç) korrespondencës ose çdo forme tjetër komunikimi me fëmijën;

d) dërgimit të informacionit fëmijës, lidhur me prindërit e tij ose personat e tjerë që, sipas ligjit, kanë të drejtë të mbajnë marrëdhënie personale me fëmijën;

dh) transmetimit, nga personi që jeton me fëmijën, të informacionit lidhur me të, duke përfshirë foto të fundit të tij, raporte mjekësore ose psikologjike tek i afërmi tjetër që ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;

e) takimeve të fëmijës me të afërmit e tij ose me persona të tjerë, me të cilët fëmija është i lidhur emocionalisht, në një mjedis neutral për fëmijën, me ose pa mbikëqyrje, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.

7. Për të siguruar mbarëvajtjen e marrëdhënieve personale të fëmijës me prindërit ose me persona të tjerë, me të cilët ai gëzon një jetë familjare, si dhe me qëllim kthimin e fëmijës në banesën e tij pas përfundimit të vizitës ose lejimit të fëmijës për t'u takuar me prindin tjetër, sipas vendimit të gjykatës, kjo e fundit, me kërkesë të prindit të interesuar ose të personit të ngarkuar me mirërritjen e fëmijës, mund të vendosë marrjen e këtyre masave ose garancive:

a) gjobë për vonesë ndaj personit që refuzon të zbatojë orarin e caktuar për mbajtjen e kontakteve me fëmijën;

b) garanci pasurore ndaj prindit që nuk respekton vendimin e gjykatës, kur është e mundur, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

8. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kërkojë të dhëna të hollësishme për vendin ku ndodhet prindi ose anëtar i familjes, në rastet kur ata janë të ndaluar, arrestuar, burgosur, internuar, dëbuar ose kur ata kanë vdekur, për çfarëdo shkak, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e tij.

9. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna lidhur me vendqëndrimin e një fëmije, i cili është ndarë nga prindërit për shkak të ndalimit, burgimit, largimit nga vendi apo të vdekjes gjatë privimit të lirisë, me përjashtim të rastit kur një gjë e tillë dëmton mirëqenien e fëmijës. Në rast të mosdhënies së informacionit, prindi ose anëtarë të tjerë të familjes kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, e cila vendos nëse mosdhënia e informacionit është e bazuar.

10. Në rast se prindërit nuk bien dakord për vendbanimin e fëmijës, gjykata vendos për vendbanimin e tij, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, si dhe mban në konsideratë:

a) vullnetin e secilit prind për të përfshirë prindin tjetër në vendime që lidhen me fëmijën dhe të mbikëqyrë të drejtat prindërore të tjetrit;

b) historikun e marrëdhënieve ndërmjet fëmijës dhe secilit prind, duke përfshirë masën dhe mënyrën se si i kanë plotësuar detyrimet prindërore secili prej tyre kundrejt fëmijës;

c) vullnetin e secilit prind për të lejuar tjetrin të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;

ç) statusin e banesës të secilit prind në 3 vitet e fundit;

d) historikun e veprimeve të dhunshme ndaj fëmijës ose ndaj personave të tjerë;
dh) distancën ndërmjet banesës së secilit prind dhe institucioneve të edukimit që ndjek fëmija;

e) mendimin e fëmijës;

ë) vendbanimin e motrave dhe vëllezërve të fëmijës.

11. Këto aspekte mbahen parasysh edhe në rastet kur vendbanimi i fëmijës caktohet pranë institucioneve të tjera të rritjes dhe edukimit ose në rast të mbrojtjes që i ofrohet fëmijës në nevojë për mbrojtje.

Neni 10

E drejta për ribashkim familjar

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të hyrë ose për t'u larguar nga Republika e Shqipërisë për arsye të ribashkimit familjar me prindërit e tij. Kjo kërkesë trajtohet në një frymë pozitive, njerëzore e të shpejtë dhe refuzohet vetëm në rastin kur ka arsye për të dyshuar se hyrja ose largimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

2. Në rast se prindërit janë migrantë të paligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe fëmija ka fituar shtetësinë shqiptare, prindërit lejohen të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë e të mos largohen nga vendi.

Neni 11

E drejta për t'u zhvendosur nga vendbanimi ose për të siguruar kthimin në vendin e origjinës

1. Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve ose, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, me vendim gjyqate, pasi të jetë marrë mendimi ose pëlqimi i fëmijës.

2. Mendimi ose pëlqimi i fëmijës merret në konsideratë për çështje që lidhen me kthimin e tij në vendin e origjinës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Me qëllim që fëmija të shprehë mendimin e tij, atij i ofrohet informacion i plotë lidhur me situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që mund t'i ofrohen në vendin e origjinës.

3. Fëmija i pashoqëruar nga prindi ose kujdestari ka të drejtën e kthimit, në një kohë sa më të shpejtë pranë tyre. Kthimi në vendin e origjinës bëhet vetëm nëse është në interesin më të lartë të fëmijës, parim, i cili mbahet parasysh gjatë të gjithë procesit. Në këto raste vlerësohen aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integritimin e tij në vendin ku do të kthehet, si dhe mundësitë e tij për të ruajtur identitetin, kombësinë, emrin dhe lidhjet familjare, duke marrë parasysh mendimin ose pëlqimin e fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

4. Prindi, kujdestari i fëmijës, ose çdo person që merr dizeni për humbjen e tij, duhet të njoftojë, brenda 24 orëve, autoritetin shtetëror përgjegjës për të bërë të mundur kthimin e shpejtë dhe të sigurt të fëmijës.

5. Për rastet që përfshijnë fëmijët e pashoqëruar, shërbimi diplomatik i Republikës së Shqipërisë jashtë vendit njofton ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, ndërsa, për rastet që përfshijnë fëmijët e shoqëruar vetëm nga njëri prind dhe pa pëlqimin e prindit tjetër, njoftohet Ministria e Drejtësisë. Këto organe marrin masa të menjëhershme për kthimin e fëmijës në Shqipëri, sipas rregullave të ligjit nr. 9446, datë 24.11.2005, "Për ratifikimin e Konventës mbi Aspekte Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës".

6. Procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhësimin e fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 12

Liria e shprehjes

1. Fëmija ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të drejtpërsëdrejti ose me familjen e tij apo komunitetin, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

2. Fëmija ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe të përcjellë informacione e ide të çdo lloji, në çdo formë ose me çdo mjet të zgjedhur nga ai, me përjashtim të rasteve kur cenohet një interes publik, siguria kombëtare ose nderi e dinjiteti apo të drejtat e të tjerëve.

Neni 13

E drejta për t'u dëgjuar

1. Fëmijës i garantohet e drejta për t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim. Nëse autoritetet refuzojnë të marrin mendimin e fëmijës, në çdo rast duhet dhënë vendim i arsyetuar për shkaqet e refuzimit.

2. E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar respektohet nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendimmarrëse që lidhen me hartimin e zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

3. Fëmija, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, ka të drejtë të ankohet vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit të tij kundër vendimeve apo masave të marra nga autoritetet shtetërore lidhur me të, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kur fëmija e ushtron vetë këtë të drejtë, punonjësit e administratës së shërbimit civil ose të administratës gjyqësore kanë detyrimin t'i japin këshillimin e nevojshëm.

Neni 14

E drejta e informimit

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë ose të marrë çdo lloj informacioni në lidhje me mirëqenien, edukimin dhe zhvillimin e tij fizik e psikologjik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Fëmija ka akses në të gjithë regjistrat ku mbahen të dhëna për të.

Neni 15

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Fëmijës i garantohet liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.

2. Prindi ose kujdestari i fëmijës e drejton atë në ushtrimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, në zgjedhjen e një besimi fetar, pasi ka marrë në konsideratë mendimin e tij dhe pa ushtruar forcë në zgjedhjen e fëmijës, në përputhje me zhvillimin e aftësitë e tij.

3. Nëse fëmija ndodhet në kushtet e mbrojtjes, personat që janë ligjërisht përgjegjës për të ndalohen të marrin masa të tilla, që ndikojnë në besimin fetar të fëmijës.

Neni 16

Liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore

1. Fëmijës i garantohet liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore. Ndalohet detyrimi i fëmijës për tubim në kundërshtim me vullnetin e tij.

2. Ushtrimi i kësaj lirie bëhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

3. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore dhe çdo institucion tjetër publik apo privat mbikëqyrin nëse kjo e drejtë garantohet nga institucionet përgjegjëse, sipas këtij ligji dhe, në rast mosrespektimi, njoftojnë organet e policisë për

marrjen e masave konkrete, sipas legjislacionit në fuqi, duke mbajtur në vëmendje sigurinë e fëmijës gjatë ushtrimit të kësaj të drejte.

4. Mosrespektimi i detyrimit të parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.

Neni 17

Liria e jetës private

1. Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.

2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institucioneve të kujdesit shëndetësor, shoqëror e të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.

3. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.

4. Pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 14 vjeç në debate publike, si dhe në programe audiovizive bëhet vetëm me miratimin e prindit ose kujdestarit të fëmijës.

5. Fëmijët nuk mund të përdoren apo të ekspozohen nga prindi, kujdestari, institucionet publike apo private për qëllime të përfitimit personal apo për të ndikuar vendimet e autoriteteve publike.

6. Mosrespektimi i këtij ndalimi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.

7. Transmetuesit audiovizivë mbajnë përgjegjësi për rastet e mosrespektimit të lirive dhe të drejtave të fëmijës gjatë transmetimit të programeve të tyre, në përputhje me këtë ligj, si dhe me legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.

8. Rastet përjashtimore nga mbrojtja e privatësisë bëhen vetëm nëse i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 18

E drejta për arsimim

1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimimit të detyrueshëm.

2. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që:

a) të mundësojnë aksesin e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm falas për të gjithë fëmijët, edhe në rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë;

b) të zhvillojnë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, programe edukimi për prindërit, përfshirë programe për parandalimin e dhunës në familje;

c) të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijën që nuk arrin nivelet e duhura që synon programi mësimor, me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;

ç) të organizojnë plane mësimore të veçanta edukimi për fëmijët që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, ose pranë

institucioneve joshkollore, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit;

d) të mbikëqyrin të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;

dh) të marrin masa konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale brenda mjediseve të shkollës, si ushqim, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;

e) të krijojnë kushtet e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimimit, nëpërmjet kurrikulave, mjeteve mësimore, infrastrukturës së përshtatshme, si dhe të vlerësimit periodik të personelit mësimor;

ë) të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës;

f) të ndërmarrin veprime konkrete për të garantuar të drejtën e arsimimit të fëmijës që i përket grupeve ose rajoneve me mangësi të konsiderueshme edukimi ose që është në situata të vështira sociale, ekonomike ose gjendje fizike apo mendore të veçantë, ose që lidhen me aspekte të gjinisë, besimit fetar ose praktikave kulturore, ose që janë pjesë e një grupi kulturor etnik ose vijnë nga një situatë migratore;

g) të ngrenë mekanizma efikasë për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bulizmi);

gj) të parashikojnë dhe zbatojnë sanksione të përshtatshme për personelin arsimor, në rastet kur ai lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme ose ngacmimi të fëmijës në institucionet e edukimit, sipas këtij ligji.

h) të marrin masa për identifikimin e fëmijës në rrezik për të braktisur shkollën ose të atij që e ka braktisur atë, duke koordinuar veprimet me autoritetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim mbajtjen ose kthimin e tij në shkollë.

4. Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mosregjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, pranë pushtetit vendor merr masa të menjëhershme për regjistrimin të fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji. Ndëshkimi trupor i fëmijës si dhe çdo formë tjetër e dhunës gjatë procesit të edukimit janë të ndaluara.

6. Fëmija ka të drejtë të ankohet ndaj vlerësimeve të dijeve të tij, sipas kriterëve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar.

Neni 19

E drejta për pushim dhe argëtime kulturore e sportive

1. Fëmija ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore, artistike e sportive, në përshtatje me moshën e tij.

2. Autoritetet publike qendrore e vendore, brenda kompetencave të tyre, marrin masa konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe mundësive të barabarta për ushtrimin e aktiviteteve kulturore, artistike e çlodhëse për të gjithë fëmijët. Ato krijojnë hapësira të nevojshme, brenda mundësive, për lojërat e fëmijës. Këto masa përfshijnë:

a) miratimin e kuadrit rregullues urbanistik, si dhe të akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore për të garantuar hapësira urbane të përshtatshme dhe aksesin e sigurt në mjedise sportive, kënde lojërash ose mjedise të tjera çlodhëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve sociale ekonomike;

b) vendosjen e standardeve të sigurisë dhe aksesimit për të gjitha mjediset çlodhëse e këndet e lojërave, me qëllim mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimet e mundshme të shëndetit;

c) krijimin e hapësirave të përshtatshme për të mundësuar ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive sportive, kulturore e defryese në mjediset shkollore dhe komunitare;

ç) hartimin e kurrikulave shkollore, të cilat krijojnë mundësi që fëmijët të kenë kohë të mjaftueshme për lojëra, çlodhje dhe veprimtari sportive.

Neni 20

E drejta për nivel jetese të përshtatshëm

1. Fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

2. Prindi ose kujdestari kanë detyrimin dhe përgjegjësinë parësore për t'i siguruar, brenda aftësive dhe mundësive financiare që ata kanë, kushtet më të mira të jetesës, të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

3. Çdo fëmijë gëzon të drejtën e aksesit në programe për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, duke përfshirë aksesin në çerdhe, kopshte ose programe të tjera zhvillimi, si dhe të drejtën e ushqimit gjatë ndjekjes së këtyre programeve, sipas standardeve të parashikuara në akte nënligjore.

4. Organet e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet përgjegjëse në varësi të tyre marrin masat e nevojshme për të ndihmuar prindin ose kujdestarin të ushtrojë këtë të drejtë, në rast se ka nevojë për asistencë materiale ose programe mbështetëse.

Neni 21

E drejta për kujdes shëndetësor

1. Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor falas dhe e standardit më të lartë, si dhe përfitimi nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet, pavarësisht nëse fëmija është i regjistruar ose jo në regjistrin e gjendjes civile ose nëse prindërit e fëmijës kanë paguar ose jo taksat.

2. Garantimi i kësaj të drejte bëhet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, e cila merr masa:

a) për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;

b) për t'u siguruar të gjithë fëmijëve kujdesin shëndetësor falas e cilësor, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;

c) për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të sigurimit, ndër të tjera, të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe të ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

ç) për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;

d) për të mundësuar, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, që të gjitha grupet shoqërore dhe, në veçanti, prindërit dhe fëmijët, të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi e të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe përmirësimin e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;

dh) për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues dhe për të nxitur jetesën e shëndetshme të fëmijët, këshillimin e prindërve dhe fëmijës, edukimin dhe shërbimet në fushën e shëndetit riprodhues për prindërit dhe fëmijët, në varësi të moshës dhe aftësisë së tyre për të kuptuar;

e) për verifikimin periodik të trajtimit që i bëhet fëmijës së vendosur në institucione të kujdesit shëndetësor ose në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme, me vendim të gjykatës;

ë) për ruajtjen e konfidencialitetit gjatë dhe pas ekzaminimit mjekësor të fëmijës, ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur rrezikohet shëndeti ose jeta e fëmijës, sipas nenit 67 të këtij ligji;

f) për ofrimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor për fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim riaftësimin dhe përfshirjen sociale të tyre, si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë si

të gjithë fëmijët.

3. E drejta e fëmijës për të pasur akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe të rehabilitimit, si dhe marrja e mjekimit të përshtatshëm për sëmundjen që ka garantohet nga shteti dhe shpenzimet mbulohen nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Prindërit kanë detyrimin të kërkojnë kujdes mjekësor, me qëllim që fëmija të gëzojë standardin më të lartë shëndetësor, si dhe për të parandaluar situata që mund të jenë të rrezikshme për jetën, rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

5. Vizitat periodike të punonjësve të konsultores së nënës dhe fëmijës në banesën e gruas shtatzënë dhe fëmijës deri në moshën 1 vjeç janë të detyrueshme. Ato kryhen sipas paketës bazë të shërbimeve të kujdesit parësor e protokolleve standarde për këto shërbime dhe bëhen me qëllim mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës, duke përfshirë këshillimin për mirërritjen e fëmijës, parandalimin dhe shmangien e braktisjes së fëmijës, abuzimin, shfrytëzimin dhe neglizhimin ose çdo lloj tjetër dhune ndaj fëmijës.

Neni 22

E drejta për të përfituar nga shërbimi i kujdesit shoqëror

1. Fëmija ka të drejtë të përfitojë nga shërbimi i kujdesit shoqëror, drejtpërdrejt apo nëpërmjet prindit ose kujdestarit të tij, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.

2. Në rast se prindi/prindërit ose personi/ personat që kujdesen për fëmijën nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, për shkak që nuk varen prej vullnetit të tyre, nevojat minimale të fëmijës për strehim, ushqim, veshmbathje dhe edukim, ofrohen nga shteti, kur kjo kërkohet prej tyre, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.

3. Çdo institucion publik ose jopublik që ushtron aktivitet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës ka detyrimin t'u japë prindërve të gjithë informacionin e nevojshëm për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23

Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës

1. Fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Fëmija mbrohet edhe nga të gjitha format e migracionit të paligjshëm, sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

2. Prindërit e fëmijës ose kujdestari, në bashkëpunim me institucionet e kujdesit shëndetësor, të edukimit, strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur rehabilitimin fizik, psikologjik e emocional, si dhe integrimin social të fëmijës viktimë e dhunës, neglizhimit, shfrytëzimit ose abuzimit, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Subjektet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme, me qëllim integrimin e fëmijës në një jetë normale dhe duke respektuar dinjitetin e vetëvendosjen e fëmijës, në përputhje me moshën e tij.

4. Ndalohet ndëshkimi trupor ose i ndonjë forme tjetër, që sjell pasoja në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.

Neni 24

Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik

1. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, sipas parashikimeve të Kodit Penal, që përfshin kryerjen e çdo pune që:

- a) paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor;
- b) cenon edukimin;
- c) është e detyruar.

2. Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës.

3. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune të detyruar brenda familjes së tij, në shkollë, institucione të rehabilitimit dhe dënimit, ose në aktivitete kulturore, artistike, sportive, modelimi ose për qëllime reklamuese, që paraqet rrezik, cenon edukimin, dëmton shëndetin ose zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

4. Ndalohet çdo praktikë, nëpërmjet së cilës fëmija detyrohet të kryejë veprime të përmendura në pikat 2 e 3, të këtij neni, pavarësisht dijenisë ose jo të prindit ose kujdestarit, si dhe pavarësisht faktit nëse është apo jo kundrejt shpërblimit.

5. Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimiti i detyrueshëm, shmang arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara, sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë.

Neni 25

Mbrojtja nga përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope

1. Fëmija mbrohet nga:

- a) përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope;
- b) prodhimi dhe trafiku i paligjshëm i këtyre substancave.

2. Ndalohet shitja e përzierësve ose tretësve për prodhimin ose përdorimin e substancave narkotike e psikotrope, duhanit, si dhe pijeve alkoolike të fëmijët.

3. Policia e Shtetit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, brenda kompetencave, marrin masa, me qëllim:

- a) parandalimin e përfshirjes së fëmijës në prodhimin, shpërndarjen dhe trafikimin e substancave narkotike;
- b) rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe të fëmijës për këtë çështje, përfshirë edhe hartimin e kurrikulave të nevojshme për këtë qëllim;
- c) përkrahjen e fëmijës dhe familjeve të tyre nëpërmjet këshillimit;
- ç) hartimin e politikave, strategjive dhe shërbimeve që garantojnë rehabilitimin fizik, mendor dhe social të fëmijës që përdor alkool, duhan ose substanca narkotike e psikotrope.

4. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësinë e qeverisjes vendore mbështesin fëmijën dhe familjen nëpërmjet referimit të çështjes të shërbimit e specializuara për këtë qëllim.

Neni 26

Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual

Fëmija mbrohet nga trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë veprimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzimi seksual me fëmijë, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe akteve të tjera në fuqi.

Neni 27

Mbrojtja e fëmijës nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet

1. Prindi, kujdestari ose çdo person tjetër, i cili është në kontakt me fëmijën është përgjegjës për të mbrojtur fëmijën nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet.
2. Qendrat e ofrimit të internetit, institucionet e edukimit, si dhe çdo institucion tjetër publik ose privat, i cili ofron akses në internet, aplikojnë instrumente teknike dhe masa të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe ose të dëmshme, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, kur konstaton se në rrjetet kompjuterike ose ato të informacionit, në faqet e internetit apo në mjedise ku ka fëmijë, qarkullojnë materiale me përmbajtje të dëmshme për fëmijën, sipas këtij ligji dhe ligjit për sigurinë kibernetike, i kërkon autoritetit përgjegjës të marrë masat për bllokimin e aksesit në këto rrjete ose faqe.
4. Masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Mbrojtja nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe në situata të emergjencave civile

1. Fëmija nuk lejohet të përfshihet drejtpërdrejt dhe tërthorazi në një konflikt të armatosur.
2. Në rast konflikti të armatosur ose në situata emergjence civile, fëmijës i garantohet një respekt i veçantë dhe mbrojtje nga çdo formë sulmi të paligjshëm. Gjatë konfliktit fëmijës i sigurohet kujdes e ndihmë e veçantë, në përputhje me moshën dhe për çdo arsye tjetër.
3. Nëse fëmija arrestohet ose ndalohet për arsye që lidhen me konfliktin e armatosur, ai mbahet në mjedise të veçanta nga të rriturit, përveç rasteve kur është ndaluar me familjen e tij.
4. Njësia e mbrojtjes së fëmijës në çdo njësi të qeverisjes vendore, brenda 24 orëve nga nisja e një konflikti të armatosur ose emergjence civile, harton një listë me të gjithë fëmijët që ndodhen në territorin e njësisë përkatëse administrative dhe ia dërgon atë Drejtorisë për Emergjencat Civile, me qëllim mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e posaçme të tyre gjatë konfliktit.
5. Në raste të evakuimit të popullsisë gjatë një konflikti të armatosur ose emergjence civile, fëmijës i jepet prioritet. Drejtoria për Emergjencat Civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës marrin masat e nevojshme për evakuimin e sigurt të fëmijës. Në çdo rast, fëmija nuk ndahet nga prindërit ose familja e tij.

Neni 29

E drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi administrativ ose gjyqësor

1. Fëmijës, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij.
2. Ndihma juridike dhe psikologjike i ofrohet fëmijës drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës.
3. Ndihma juridike ndaj fëmijës përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, gjatë të gjithë procesit administrativ ose gjyqësor.
4. Ndihma psikologjike përfshin të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.
5. Fëmija, vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit të tij, bën kërkesë për ndihmë

juridike tek institucionet përgjegjëse, të cilat informojnë fëmijën, kujdestarin ose përfaqësuesin e tij për procedurat sipas legjislacionit në fuqi.

6. Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike.

Neni 30

Ushtrimi i kujdesit prindëror

1. Prindi ose kujdestari ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.

2. Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për të ndihmuar prindin në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës. Në rast se edhe pas ndihmës së dhënë rezulton se qëndrimi i mëtejshëm i fëmijës me prindin nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për largimin e përkohshëm të fëmijës nga prindi dhe e vendos fëmijën në kujdes të përkohshëm alternativ, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes dhe në këtë ligj.

3. Prindërit e fëmijës, pavarësisht faktit se cili prej tyre ushtron përgjegjësinë prindërore, kanë të drejtë të marrin informacion dhe asistencën e nevojshme për mirërritjen, kujdesin dhe edukimin e fëmijës, të marrin informacion për fëmijën nga shkolla, njësitë e shërbimit shëndetësor ose çdo institucion tjetër në kontakt me fëmijën.

4. Në rast se të dy prindërit ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, por nuk bashkëjetojnë me njëri-tjetrin, vendimet lidhur me zgjedhjen e edukimit ose trajnimit profesional, trajtimet mjekësore komplekse ose ndërhyrjet kirurgjikale, vendbanimin e fëmijës ose administrimin e pasurisë së tij, merren me pëlqimin e të dy prindërve.

5. Në rast se njëri nga prindërit nuk jep pëlqimin e tij për të marrë vendim, lidhur me çështjet e parashikuara në pikën 4, të këtij neni, ose kur ai nuk mund të kontaktohet për shkak të vendndodhjes së panjohur ose për shkak të nevojës urgjente për të marrë vendim lidhur me fëmijën, vendimet merren nga prindi që jeton me fëmijën, përveç rasteve kur vendimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

6. Në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet prindërve lidhur me ushtrimin e të drejtave prindërore dhe realizimin e detyrimeve të tyre ndaj fëmijës, cilido prej tyre mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente. Pasi të jenë dëgjuar të dy prindërit, si dhe të jetë marrë mendimi i fëmijës, gjykata vendos në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 31

Përkujdesja alternative

1. Fëmija i privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar, për shkak se prindërit kanë vdekur ose mbi bazë të një vendimi gjyqësor apo kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis për shkak të një mase mbrojtjeje, vendoset në përkujdesje alternative. Në zbatimin e kësaj mase i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar, sipas interesit më të lartë të fëmijës.

2. Përkujdesja alternative mund të jetë:

a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës;

b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën;

c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të

shkurtër kohe.

3. Fëmija në nevojë për mbrojtje mund të vendoset në një nga format e mësipërme të përkujdesjes alternative për shkak të një mase mbrojtjeje, sipas nenit 55 të këtij ligji.

4. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e njëres prej alternativave të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes.

Neni 32

Fëmija me aftësi të kufizuar

1. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj në mënyrë të plotë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë.

2. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për të përfituar nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit ose kujdestarit.

3. Prindi ose kujdestari ka detyrimin të ndjekë procedurat e detyrueshme, sipas këtij ligji, për t'i siguruar fëmijës aksesin në të gjitha shërbimet nga të cilat përfiton sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, prindi ose kujdestari asistohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve sipas nevojës.

4. Fëmijës me aftësi të kufizuara mund t'i ofrohet shërbimi edukativ, shëndetësor apo rehabilitues, në përputhje me nevojat specifike, në një njësi të qeverisjes vendore të ndryshme nga ajo ku jeton dhe që përmbush kriteret për këtë qëllim. Shpenzimet, në këtë rast, mbulohen nga buxheti i të dyja njësisë të qeverisjes vendore. Rregullat dhe procedurat për mbulimin e këtyre shpenzimeve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, ministrit përgjegjës për shëndetësisë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

5. Autoritetet përgjegjëse, sipas këtij ligji, eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive, që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

6. Autoritetet përgjegjëse garantojnë përshtatjen e arsyeshme rast pas rasti.

7. Autoritetet përgjegjëse garantojnë pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e politikëbërjes dhe legjislacionit përmes informacionit të përshtatur, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, moshës dhe aftësisë së fëmijët për të kuptuar.

Neni 33

Fëmija që i përket pakicave kombëtare

1. Fëmija që i përket një pakice etnike, fetare ose gjuhësore ka të drejtë të ushtrojë jetën e tij kulturore, të deklarojë përkatësinë e tij etnike e fetare, të ushtrojë besimin e tij fetar, si dhe të përdorë gjuhën e tij me anëtarët e tjerë të komunitetit, të cilit i përket.

2. Fëmija që i përket një pakice kombëtare ka të drejtë të shprehet në gjuhën e tij amtare gjatë procedurave që lidhen me çështjet e tij.

3. Mënyrat e ushtrimit të të drejtave të parashikuara në këtë nen garantohen duke mbajtur parasysh respektimin edhe të të drejtave të fëmijëve të tjerë.

KREU III

MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Neni 34

Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat

për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

1. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.

2. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë:

- a) Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror;
- b) grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative në nivel vendor.

3. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror janë:

- a) ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;
- b) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- c) çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon, në lidhje me të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen

e tyre.

4. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:

- a) bashkia;
- b) struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
- c) njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
- ç) njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësite administrative;
- d) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

5. Mekanizmat dhe strukturat në nivel qendror e vendor bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit e të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Këta mekanizma dhe struktura bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Avokati i Popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Neni 35

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

1. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

2. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës.

3. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe përbëhet nga 9 anëtarë, përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore dhe 5 përfaqësues nga shoqëria civile. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverive të nxënësve, organizatave, forumeve apo çdo grupimi tjetër fëmijësh.

4. Përfaqësuesit nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës duhet të jenë shtetas shqiptarë, të cilët të kenë njohuri dhe të kenë marrë pjesë në veprimtari të

shquara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Përfaqësuesit nga shoqëria civile zgjidhen nga Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile.

5. Mandati i anëtarëve të Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Në çdo rast, riperteritja e të gjithë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë ndalohet.

6. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka të drejtë të ngrrejë komitete teknike këshilluese për çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe të përcaktojë përbërjen e rregulloret e tyre.

7. Zgjedhja e përfaqësuesve të fëmijës dhe të shoqërisë civile realizohet sipas udhëzimeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

8. Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen në rregulloren e këtij këshilli, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Detyrat e Këshillit Kombëtar në lidhje me të drejtat e fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në lidhje me të drejtat e fëmijës, ka këto detyra:

a) vlerëson gjendjen konkrete të respektimit të të drejtave të fëmijës në Shqipëri, duke marrë në konsideratë angazhimet shtetërore, në kuadër të Konventës së të Drejtave të Fëmijës dhe traktateve të tjera në fushën e të drejtave të njeriut;

b) vlerëson planifikimin e buxhetit nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve;

c) jep rekomandime të posaçme për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;

ç) bën propozime dhe jep rekomandime për Këshillin e Ministrave, për përmirësimin e legjislacionit në fushat përkatëse të zbatimit të të drejtave të fëmijës.

Neni 37

Detyrat e Këshillit Kombëtar në lidhje me mbrojtjen e fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, ka këto detyra:

a) vlerëson dhe analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për mbrojtjen e fëmijës;

b) i propozon ministrit përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës programet kryesore shtetërore për mbrojtjen e fëmijës dhe drejtimin e politikave shtetërore për përmirësimin e gjendjes së trajtimit të tyre;

c) rekomandon shërbime dhe programe të orientuara për fëmijët dhe familjet e tyre;

ç) rekomandon shërbime dhe programe parandaluese ndërsektorale për mbrojtjen e fëmijës;

d) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Neni 38

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës, i cili, nëpërmjet strukturës politikëbërëse realizon këto detyra:

1. Në lidhje me orientimin e monitorimin e politikave shtetërore dhe situatës së të drejtave të fëmijës:

a) koordinon dhe monitoron zhvillimin e zbatimin e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit për fëmijët si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe përgatit raportet përkatëse;

b) kontrollon veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe miraton raportin vjetor të saj për ecurinë e realizimit të të drejtave e të mbrojtjes së fëmijës;

c) orienton mbështetjen e donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të strategjisë kombëtare për fëmijët;

ç) ofron mbështetje për organizatat jofitim-prurëse në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile;

d) bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

dh) analizon të dhënat e raporteve statistikore e të raporteve të tjera dhe koordinon me ministrat e tjerë, me qëllim që të përshtatë në mënyrë dinamike politikat e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

2. Në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, realizon këto detyra:

a) merr masa, në bashkëpunim me ministrat e tjerë, për ngritjen dhe mirëfunksionimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase për mbrojtjen e tyre, nëpërmjet shërbimeve shumëdisiplinore, ndërsektoriale, të koordinuara, me në qendër fëmijën.

b) harton politika, programe shtetërore dhe strategji në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe shërbimeve për fëmijët, si dhe planifikon shpërndarjen e buxhetit për arritjen e tyre;

c) i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera për garantimin e të drejtave të tyre, kryesisht dhe në bazë të rekomandimeve të propozuara nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

ç) nxjerr udhëzime metodologjike për veprimtarinë e strukturave të mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore;

d) bashkërendon punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës;

dh) siguron ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, sipas këtij ligji dhe standardeve për mbrojtjen e fëmijës;

e) siguron ngritjen e një sistemi për akreditimin, kontrollin e cilësisë dhe ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës;

ë) është përgjegjës për ngritjen e një regjistri elektronik kombëtar për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe merr masa për miratimin e akteve nënligjore për ta bërë të detyrueshëm përdorimin e këtij regjistri.

3. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për bashkëpunim me ministrin që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

4. Mënyra e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Detyrat e ministrave

Ministrat, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore, nëpërmjet strukturave të tyre politikëbërëse, kanë për detyrë:

a) të sigurojnë zbatimin e plotë të këtij ligji dhe realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës, të njohura nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

b) të hartojnë politika sektoriale, aktet ligjore e nënligjore të nevojshme për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe programeve ndërsektoriale, duke siguruar edhe marrjen e mendimit të fëmijës;

c) të shoqërojnë çdo projektligj apo projektakt normativ që hartojnë me një analizë të ndikimit të tij te fëmijët, djem dhe vajza;

ç) të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të fëmijës dhe për mbrojtjen e fëmijës;

d) të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për të siguruar që punonjësit dhe strukturat në varësi të tyre, që merren me mbrojtjen e fëmijës, të përgatiten me njohuritë e duhura dhe të specializohen në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Neni 40

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është person juridik në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, financuar nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe burime të tjera, sipas ligjit.

2. Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil.

3. Struktura dhe organika e agjencisë miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

4. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen në rregulloren e agjencisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 41

Detyra e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në lidhje me ngritjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës

1. Agjencia është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

2. Agjencia ka për detyrë t'u ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, në lidhje me:

a) koordinimin me agjenci të tjera shtetërore dhe private;

b) zhvillimin e aktiviteteve profesionale, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës;

c) asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të caktuara të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si edhe supervizimin, në raste të caktuara; bashkërendim të punës për raste ndërshtetërore të mbrojtjes së fëmijës;

ç) këshillimin e agjencive shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të punonjësve që punojnë në institucione publike e private për ndihmën e fëmijës në rrezik apo në nevojë për mbrojtje, për të cilën agjencia nxjerr një urdhër të brendshëm për mënyrën e funksionimit.

3. Agjencia ka për detyrë gjithashtu:

a) të mbledhë të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe të menaxhojë regjistrin elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje;

b) të analizojë nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe të mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë të parandalimi;

- c) të kontrollojë cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes;
- ç) të koordinojë dhe të organizojë trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje;
- d) në zbatim të nenit 11, pika 6, e këtij ligji, të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për realizimin e procesit të mbrojtjes dhe marrjes së masave për menaxhimin e rasteve të fëmijës në situatë migrimi, në situatë ndërkuftare dhe në nevojë për mbrojtje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të fëmijës së pashoqëruar.

Neni 42

Detyrat e agjencisë në lidhje me bashkërendimin e punës me ministrin përgjegjës për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës i paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës.
2. Përgatit dhe i propozon ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës udhëzime metodologjike për strukturat e mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore dhe koordinimin ndërsektorial në fushën e mbrojtjes së fëmijës.
3. Bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
4. I paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe për rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Neni 43

Detyrat e agjencisë në lidhje me politikat dhe veprimtaritë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin Europian, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.
2. Ndërton dhe realizon vetë apo në bashkëpunim me institucione të tjera veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit të drejtësisë.
3. Koordinon ose realizon fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete konkrete për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijës në të gjitha fushat.
4. Inicion dhe zbaton projekte pilot, në bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe u jep mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
5. Organizon dhe bashkërendon kërkime shkencore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
6. Realizon mbledhjen, analizën e të dhënave dhe raportimin e zbatimit të dokumenteve strategjike me fokus fëmijët, si dhe të situatës së të drejtave të fëmijës.
7. Zhvillon dhe mirëmban një sistem informacioni me fokus institucionet e specializuara për fëmijët, organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të dhëna të tjera, që lidhen me mbrojtjen e fëmijës.
8. Bashkërendon veprimtarinë e saj me agjencitë homologe në vendet e tjera.

Neni 44

Mbështetja e agjencisë nga autoritetet shtetërore

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me agjencinë, për realizimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave të nevojshme, në kuadër të ngritjes dhe zbatimit të standardeve për një sistem funksional të integruar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të dhënave të tjera, të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

2. Llojet, mënyra e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga agjencia pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 45

Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe ata që punojnë me fëmijët

1. Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, si dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, nuk mund të punësohen dhe, kur janë të punësuar, përfundojnë marrëdhënien e punës në rast se:

a) janë dënuar me dënim të formës së prerë për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje;

b) ndaj tyre është marrë, me vendim gjykate, një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje.

2. Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, si dhe punonjësit që punojnë me fëmijët pezullohen nga detyra kur ndaj tyre fillon një procedim penal për vepra penale të kryera ndaj të miturve ose kur ata akuzohen për kryerjen e një vepre penale në bashkëpunim me të mitur.

3. Kriteret për punësimin e punonjësit të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 46

Roli i bashkisë

Bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative në varësi të tyre të strukturave përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në zbatim të standardeve dhe, nëpërmjet tyre, të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, duke siguruar, ndërmjet të tjerash:

a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në planet e zhvillimit vendor, në programet dhe projektet, në përputhje me politikat kombëtare;

b) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës;

c) zhvillimin e programeve dhe projekteve për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës;

ç) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera vendore, për situatën e të drejtave të fëmijës dhe familjeve, me qëllim hartimin e programeve që krijojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin optimal të fëmijës;

d) zbatimin e politikave kombëtare të mbrojtjes së fëmijës dhe masave të mbrojtjes, siç parashi-kohen në këtë ligj;

dh) ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijës, sipas këtij ligji, duke krijuar kushtet për funksionimin e tyre, në përmbushje të funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, përfshirë edhe shpërndarjen e fondeve përkatëse, në mënyrë që strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor të funksionojnë në mënyrë efikase;

e) zbatimin e procedurës për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si dhe për ngritjen e koordinimin e sistemit të referimit, raportimit, të marrjes në mbrojtje dhe të ndjekjes së rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje nëpërmjet strukturave të saj;

ë) organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje, shërbimeve me bazë komunitare për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe shërbimeve mbështetëse për familjet e shërbime të përkujdesjes alternative për fëmijët;

f) ngritjen e programeve dhe të shërbimeve rehabilituese e riintegruese për fëmijët në nevojë për mbrojtje, me një fokus të veçantë për fëmijët viktime të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit dhe fëmijët që dyshohen apo kanë kryer vepra penale, të cilët janë nën moshën për përgjegjësi penale;

g) kontributin për ngritjen dhe menaxhimin e sistemit kombëtar të informacionit për mbrojtjen e fëmijës, brenda kompetencave të tyre;

g) financimin e shpenzimeve për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe të Planit për Aftësim Prindëror.

Neni 47

Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki

1. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore pranë bashkisë është përgjegjëse edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi. Ajo, nëpërmjet strukturave në varësi të saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, me mekanizmat vendorë të mbrojtjes dhe institucionet e tjera vendore, merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë.

2. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore i raporton kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak për ecurinë e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.

3. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore ngre grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie dhe, kur është e nevojshme, në nivel njësie administrative, si dhe koordinon e mbikëqyr punën dhe aktivitetin e tij, sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 48

Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore

1. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore është përgjegjës për:

a) marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në propozimin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe të grupit teknik ndërsektorial;

b) miratimin dhe koordinimin e veprimeve ndërsektoriale me institucionet shtetërore për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes;

c) marrjen e masave për koordinimin me njësitë përkatëse brenda bashkisë për realizimin e prokurimit të shërbimeve të nevojshme për realizimin e Planit Individual të Mbrojtjes, kur ato nuk mbulohen dot nga strukturat shtetërore;

ç) marrjen e masave për organizimin dhe planifikimin e një shërbimi mbrojtjeje emergjente 24-orësh, i cili i njoftohet edhe strukturave të Policisë së Shtetit;

d) monitorimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve për mbrojtjen e garantimin e aksesit në të drejtat e fëmijës në territorin e bashkisë;

dh) raportimin për ecurinë e veprimtarisë së njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në bashki dhe për situatën e fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.

2. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës miraton, me udhëzim, mënyrën e vendosjes, në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën, ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje.

Neni 49

Njësia për mbrojtjen e fëmijës

1. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.

2. Punonjësit e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë.

3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, përveç detyrave të parashikuara në nenin 51, të këtij ligji, është përgjegjës dhe ka për detyrë:

a) të mbështesë punonjësin për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje;

b) të hedhë informacionin për fëmijët në nevojë për mbrojtje, masat e mbrojtjes dhe planet individuale të mbrojtjes në bazën e të dhënave përkatëse, të miratuar nga ministri përgjegjës që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në nivel bashkie dhe njësie administrative;

c) të mbikëqyrë mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkive, për të cilin është marrë masë mbrojtjeje ose është hartuar Plan Individual Mbrojtjeje;

ç) t'i raportojë, periodikisht, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësie administrative përkatëse;

d) të identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore;

dh) të koordinojë funksionimin e grupit ndërsektorial në nivel bashkie dhe/ose njësie administrative, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimin e ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve për masat e mbrojtjes dhe të dhunës në familje;

e) të ndërgjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/ komunës;

ë) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen apo të referohen te shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë.

4. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki harton dhe përshtat, një herë në vit, listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal dhe ia dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve proceduralë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe Ministrin të Drejtësisë.

5. Njësia për mbrojtjen e fëmijës ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 50

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të bashkisë

1. Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të bashkive janë pjesë e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe kryejnë vetëm detyra që lidhen me mbrojtjen e fëmijës.

2. Çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka, minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësisë së

vlerësimin të nevojave dhe referimit. Në rastet kur njësi administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, i cili ka të përcaktuar në përshkrimin e punës funksionin si punonjës për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 51

Detyrat e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre.

2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë:

a) të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët;

b) të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje;

c) të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;

ç) të informojë drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe t'i propozojë drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masave të mbrojtjes mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe të koordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan;

d) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës;

dh) të monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të masës së mbrojtjes, progresin e zhvillimit të fëmijës, për të cilin është vendosur masa e mbrojtjes. Profesionistët e tjerë, të përfshirë në zbatimin e masës së mbrojtjes apo të Planit Individual të Mbrojtjes, janë të detyruar ta mbajnë të informuar punonjësin e mbrojtjes së fëmijës në lidhje me progresin, sfidat dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit të tyre;

e) të propozojë ndryshimin apo heqjen e masës së mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes nëse nuk ekzistojnë më kushtet, për shkak të të cilave është vendosur masa dhe plani, apo kur një gjë e tillë i shërben fëmijës dhe/ose është në interesin më të lartë të tij;

ë) të lehtësojë dhe të mbështesë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në përmbushjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes;

f) të marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në planet individuale të mbrojtjes së fëmijës, për të cilët ai është menaxher rasti;

g) t'i drejtohet prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e vënë atë në dijeni për prindërit që tregojnë pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose kur, me veprimet e tyre, prindërit ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.

gj) të ndihmojë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse.

Neni 52

Grupi teknik ndërsektorial

1. Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet *ad-hoc*, grupi teknik ndërsektorial i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje.

2. Grupi teknik ndërsektorial thirret nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, në nivel bashkie, ose nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në nivel njësie administrative.

3. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial.

4. Në takimet e grupit teknik ndërsektorial thirren të marrin pjesë:

- a) anëtarët e nevojshëm për menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik;
- b) prindërit apo anëtarët e familjes ose kujdestarët e fëmijës;
- c) fëmija, bazuar në moshën dhe në aftësinë e tij për të kuptuar dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij.

5. Grupi teknik ndërsektorial mbështet punonjësën e mbrojtjes së fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për vlerësimin e rastit, hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, lehtëson referimin e tij, si dhe zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes.

6. Funkcionimi i grupit teknik ndërsektorial rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV MASAT E MBROJTJES SË FËMIJËS

Neni 53

Mbrojtja e fëmijës

Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose duke e vendosur atë në përkujdesje alternative, kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të përhershme nga përkujdesja e mbrojtja e prindërve ose kur, për shkak të interesit të tij më të lartë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve.

Neni 54

Plani Individual i Mbrojtjes

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me njësitë e vlerësimit dhe të Referimit të Rasteve dhe grupin teknik ndërsektorial, që funksionon në nivel bashkie ose pranë njësisë administrative të bashkisë, duhet të hartojë një Plan Individual Mbrojtjeje, i cili përmban edhe propozimin për masën e mbrojtjes, kur është e nevojshme.

2. Plani Individual i Mbrojtjes përmban, përveç masave të mbrojtjes, edhe ndërhyrjet e tjera të nevojshme, që realizojnë respektimin dhe lehtësojnë aksesin e fëmijës në të drejtat e tij, si dhe shërbimet shoqërore apo shërbime të tjera të nevojshme, sipas nevojave që janë identifikuar gjatë vlerësimit të rastit.

3. Plani Individual i Mbrojtjes përmban, sipas rastit, masat për hetimin dhe ndërhyrjen e menjëhershme në rastet kur fëmija është në rrezik për abuzim, dhunë, neglizhim e shfrytëzim dhe ndihmën mjekësore, shërbimin psikologjik, ligjor, shoqëror apo çdo shërbim tjetër të nevojshëm rehabilitues apo riintegruar, sipas nevojave që janë identifikuar gjatë vlerësimit të rastit, si edhe aktivitete edukative, mësimore e argëtuese për fëmijën, masat për riaftësim prindëror, programet e mbështetjes dhe ndihmës për prindërit, kujdestarin dhe anëtarët e familjes së gjerë.

4. Të gjitha ndërhyrjet dhe shërbimet e parashikuara në Planin Individual të Mbrojtjes ofrohen falas.

5. Procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimi e përmbajtja e Planit Individual të Mbrojtjes, financimi i shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimi i masave të mbrojtjes rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 55

Masat e mbrojtjes

1. Masat e mbrojtjes janë:

a) masa emergjente e mbrojtjes, e cila është një masë e përkohshme mbrojtjeje për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative;

b) masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative;

c) masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar.

2. Masat e mbrojtjes vendosen për fëmijën:

a) prindërit e të cilit kanë vdekur ose janë shpallur të vdekur nga gjykata, janë të panjohur, u është hequr përgjegjësia prindërore dhe janë në kushte nevojë për mbrojtje;

b) prindi ose kujdestari ligjor i të cilit është shoqëruar, ndaluar, arrestuar ose dënuar me heqje lirie dhe fëmija është në nevojë emergjente mbrojtjeje;

c) kur, në interesin e tij më të lartë, nuk mund të lihet në kujdesin prindëror, për shkak se rrezikohet integriteti i tij fizik, moral, psikologjik e emocional;

ç) i cili është abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar ose neglizhuar;

d) i cili është braktisur nga prindërit që në lindje ose është nën moshën 16 vjeç dhe askush nuk është duke u kujdesur për të;

dh) i cili ka kryer një vepër penale dhe, për shkak të moshës, nuk ka përgjegjësi penale;

e) i cili ka, dyshohet ose akuzohet ose është dënuar se ka kryer një vepër penale, është në gjendje të lirë dhe ka nevojë për mbrojtje.

Neni 56

Masa emergjente e mbrojtjes

1. Masa emergjente e mbrojtjes për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen e tij në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje, e cila vendoset për fëmijën që ndodhet në situatat e mëposhtme:

a) kur fëmija vlerësohet të jetë në situatë rreziku të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo formë dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku fëmija qëndron nuk është e sigurt për fëmijën;

b) është braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;

c) është pa përkujdes prindëror, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situata të tilla, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

2. Gjatë kohës së vlefshmërisë së një mase emergjente mbrojtjeje, dhënë nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, apo të vendimit të gjykatës për konfirmimin e saj, prindërit nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

3. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

Neni 57

Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative

1. Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje për fëmijën pa përkujdesje prindërore dhe kur për mbrojtjen e tij është e nevojshme strehimi apo vendosja e tij në përkujdesje alternative, duke ndjekur këtë radhë:

a) pranë një të afërmi të fëmijës;

b) pranë një familjeje kujdestare;

c) në një institucion rezidencial të përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga alternativat e mësipërme.

2. Marrja e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative merr parasysh mosndarjen e motrave dhe vëllezërve.

3. Vendimi për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata për konfirmimin ose jo të saj dhe ka të njëjtat efekte si vendimi i gjyqësor për kujdestarinë.

4. Personat apo institucioni, pranë të cilit vendoset fëmija në përkujdesje alternative, ka të njëjtat detyra, përgjegjësi dhe të drejta si ato të kujdestarit, të parashikuara në Kodin e Familjes, ndërsa prindërit e fëmijës, gjatë kohës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes, nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

5. Gjatë zbatimit të kësaj mase mbrojtëse, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek me përparësi këto çështje:

a) trajtimin dhe gjendjen psiko-emocionale të fëmijës së vendosur në përkujdesje alternative;

b) ndihmën dhe krijimin e mundësive për prindërit për të mbajtur kontakte e marrëdhënie personale me fëmijët e tyre;

c) përgatitjen e dokumenteve përkatëse, të kërkuara nga gjykata në procesin gjyqësor, të konfirmimit ose jo të masës së mbrojtjes dhe të vendosjes së fëmijës në kujdestari;

ç) nevojën për ndryshimin apo heqjen e masës mbrojtëse, në varësi të progresit, kushteve dhe rrethanave të rastit.

6. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës së mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

Neni 58

Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar

1. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

2. Kjo masë vendoset edhe në rastet kur fëmija mund të qëndrojë me njërin nga prindërit, i cili ka aftësitë dhe mundësitë për t'u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë nga veprimet e prindit tjetër, i cili dyshohet ose provohet se ka abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar apo neglizhuar fëmijën dhe i cili nuk banon apo i cili, për shkak të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje apo një urdhri mbrojtjeje nuk lejohet të frekuentojë të njëjtën banesë apo mjedis familjar me atë ku ndodhet fëmija në nevojë për mbrojtje.

3. Plani Individual i Mbrojtjes, i cili përmban edhe masën e mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar, hartohet në bashkëpunim me prindërit ose njërin nga prindërit. Në rast se prindërit nuk bashkëpunojnë apo nuk japin miratimin e tyre për ndjekjen e fëmijës me këtë masë mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes së fëmijës vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes.

Neni 59

Vendimmarrja për masat e mbrojtjes

1. Masat e mbrojtjes, ndërhyrjet për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe shërbimet e nevojshme për fëmijën vendosen dhe zbatohen bazuar në Planin Individual të Mbrojtjes.

2. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie apo njësie administrative ose drejtori i njësisë së mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie i dërgon Planin Individual të Mbrojtjes, së bashku me propozimin për masën e mbrojtjes, drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie, i cili merr vendimin e masës së mbrojtjes brenda 24 orëve. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij. Në rastin e masave emergjente të mbrojtjes apo masave të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative vendimi ka fuqi deri në marrjen e vendimit gjyqësor përkatës. Vendimi për dhënien e masës së mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar ka fuqi deri në shfuqizimin e masës nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, bazuar në propozimin e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës, dhe nuk dërgohet për shqyrtim gjyqësor.

3. Masat e mbrojtjes për fëmijët mbi moshën 14 vjeç vendosen vetëm pasi është marrë pëlqimi i fëmijës. Në rast se fëmija nuk jep pëlqimin, atëherë marrja e masës së mbrojtjes merret nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, vendim, i cili është i vlefshëm deri në marrjen e një vendimi gjyqësor nga gjykata për lënien në fuqi, kur për këtë masë përkatëse parashikohet shqyrtimi gjyqësor, sipas këtij ligji.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, e cila përmban edhe kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes duke shqyrtuar edhe ankimet përkatëse të paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo vazhdon gjykimin edhe për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Vendimi i gjykatës për dhënien e masës emergjente të mbrojtjes apo të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi. Gjykata vlerëson si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës dhe vendosjen e tyre në kujdestari.

6. Gjykata vendos për heqjen e masës së mbrojtjes mbi bazën e kërkesës së punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, kur gjatë shqyrtimit gjyqësor verifikohet se kanë pushuar shkaqet që kanë çuar në vendosjen e saj.

7. Gjykata kompetente në lidhje me masat e mbrojtjes dhe vendosjen në kujdestari për shkak të këtij ligji është gjykata e rrethit gjyqësor.

8. Veprimtaria e punonjësve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, në lidhje me marrjen dhe zbatimin e masave të mbrojtjes dhe planeve individuale të mbrojtjes është objekt kontrolli nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore.

Neni 60

Monitorimi i masave të mbrojtjes

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është përgjegjës për monitorimin e masave të mbrojtjes së fëmijës. Ai duhet të raportojë te drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, të paktën një herë në muaj, për mbarëvajtjen, progresin e masës dhe/ose për nevojën e ndryshimit apo heqjen e saj.

2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës i dërgon propozimin për heqjen e masës së mbrojtjes dhe kthimin e fëmijës në familjen e tij drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, duke e shoqëruar atë edhe me dokumentacionin përkatës, që vërteton se prindërit janë në gjendje të kujdesen për fëmijën dhe kthimi i fëmijës në familje nuk do ta ekspozojë atë në ndonjë rrezik të mundshëm për jetën dhe integritetin e tij fizik, psikologjik moral apo emocional.

3. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, nëse e miraton propozimin për heqjen

e masës mbrojtëse, autorizon punonjësën për mbrojtjen e fëmijës për të paraqitur kërkesën për heqjen e masës mbrojtëse, nëse ajo është konfirmuar nga gjykata kompetente.

4. Në rast se, në kuadër të Planit Individual të Mbrojtjes, prindërit kanë qenë të detyruar të ndjekin kurse prindërimi apo të kryejnë ndonjë veprim tjetër, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës verifikon përfundimin me sukses të këtyre detyrimeve për prindërit dhe përfshin informacionin përkatës në propozimin për heqjen e masës mbrojtëse.

Neni 61

Masat për aftësim prindëror

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë ose me njësinë për vlerësimin dhe referimin e rastit në nivel njësie administrative, ka për detyrë të vlerësojë situatën familjare të çdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe të synojnë në çdo rast, me përparësi, realizimin e mbrojtjes së tij pranë familjes.

2. Në rastet kur për fëmijën merren masa mbrojtëse të vendosjes në përkujdesje alternative, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, kur është e mundur, harton një plan për aftësim prindëror, i cili është pjesë e Planit Individual të Mbrojtjes së fëmijës dhe synon të përgatisë prindërit për rikthimin e fëmijës në familje pas përfundimit të masës mbrojtëse.

3. Planit për aftësim prindëror mund të përmbajë masa për detyrimin e prindërve për të ndjekur kurse për aftësim prindëror, këshillim psikologjik, për menaxhimin e zemërimit, trajtim mjekësor kundër alkoolizimit apo përdorimit të substancave narkotike e psikotrope, trajtim të shëndetit mendor, si dhe ndërhyrje për mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendje civile, në skemën e ndihmës ekonomike, në shërbimet e punësimit, pranë shërbimit shëndetësor, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, e cila do të përmirësonte situatën familjare dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.

4. Zbatimi i planit për aftësimin prindëror ndiqet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me punonjësit e njësisë së vlerësimit dhe referimit të rasteve.

KREU V

MBROJTJA E POSAÇME PËR KATEGORI TË CAKTUARA FËMIJËSH

Neni 62

Mbrojtja e fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës janë përgjegjëse për të verifikuar dhe trajtuar, duke ofruar mbrojtjen e nevojshme për çdo rast të identifikuar apo raportuar të fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe dhunuar. Këto struktura, në bashkëpunim me strukturat dhe autoritetet e tjera përgjegjëse vendore, duhet të realizojnë zbatimin e masave të mbrojtjes, ndërhyrjeve dhe shërbimeve të nevojshme të specializuara për të përmbushur të gjitha nevojat e fëmijës viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në interesin më të lartë të tij, kanë të drejtë të kenë akses në banesën e prindit apo të personit fizik, si dhe në rezidencën e personit juridik, të cilët janë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, me qëllim që të verifikojnë situatën e fëmijës së identifikuar apo të raportuar si viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës. Kur, në bazë të rrethanave dhe fakteve është e nevojshme, strukturat e mbrojtjes së fëmijës kërkojnë mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit.

3. Prindi, personi ligjërisht përgjegjës, qoftë person fizik apo juridik, ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe t'u ofrojë atyre informacionin e nevojshëm për adresimin e situatës apo të rastit. Në rast se personat e mësipërm refuzojnë të bashkëpunojnë apo ndalojnë strukturat e mbrojtjes të bëjnë verifikimet e nevojshme, atëherë verifikimi bëhet forcërisht, me mbështetjen e organeve të Policisë së Shtetit. Mosbashkëpunimi ose ndalimi i strukturave të mbrojtjes së

fëmijës për verifikim, kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

4. Në rast se strukturat e mbrojtjes së fëmijës, pas vlerësimeve të bëra, arrijnë në konkluzionin se ka arsye të qenësishme, të cilat mbështesin ekzistencën e një situatë të rrezikut të lartë/të menjëhershëm për fëmijën, atëherë ato kanë të drejtë të marrin masën emergjente të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative.

5. Në rast se nga vlerësimi i rastit të fëmijës rezulton se abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi apo dhunimi është kryer nga persona ligjërisht përgjegjës për përkujdesjen e fëmijës, si punonjës të institucioneve publike apo private të përkujdesjes, kujdestare, familje kujdestare, të afërm, tek të cilët është vendosur fëmija për shkak të një mase mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes marrin masa të menjëhershme për veçimin e fëmijës nga këta persona dhe njoftojnë menjëherë organet e policisë dhe të prokurorisë.

6. Në rastet e dhunës në familje, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, i cili shërben edhe si menaxher rasti, përveç kërkesës për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes, sipas nenit 59, të këtij ligji, mund të iniciojë procesin për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes pranë gjykatës kompetente. Në këtë rast, të dyja kërkimet gjykohen nga i njëjti gjyqtar.

7. Në çdo rast, pas vlerësimeve të mësipërmeve, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës, i cili përmban masën e mbrojtjes përkatëse, ndërhyrjet e nevojshme dhe shërbimet për të cilat ka nevojë fëmija, me qëllim trajtimin e tij në aspektin shëndetësor e psiko-emocional, si dhe rehabilitimin e riintegrimin e tij. Po kështu, kur është i mundur qëndrimi i fëmijës pranë familjes apo kur fëmija presupozohet se do të kthehet pranë familjes, pavarësisht marrjes së masës së mbrojtjes për vendosje në përkujdesje alternative, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton dhe merr masa për zbatimin e një plani për aftësim prindëror.

8. Të dhënat në lidhje me vlerësimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës së abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar, dhunuar mbahen konfidenciale, përveç rastit kur ato përdoren përpara organeve të drejtësisë.

9. Fëmija shoqërohet, në çdo rast, nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ose një psikolog i caktuar nga ky i fundit, sipas Planit Individual të Mbrojtjes, në çdo procedurë përpara organeve të policisë, të prokurorisë apo gjykatës.

10. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr masa për monitorimin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes.

Neni 63

Deklarata e fëmijës

1. Gjatë procesit të verifikimit të situatës së fëmijës nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, deklarata e dhënë nga fëmija mund të administrohet *ex-officio* si një provë. Deklarata e fëmijës do të konsiderohet e vlefshme pavarësisht mënyrës së regjistrimit të saj, me shkrim apo me mjete audio-vizive, gjithmonë në prani të një psikologu dhe me pëlqimin e fëmijës mbi 10 vjeç.

2. Gjyqtari konsideron si provë deklaratën e dhënë nga fëmija gjatë procesit gjyqësor për vlefshmërinë dhe dhënien e masës emergjente të mbrojtjes apo të masës së mbrojtjes për vendosje të fëmijës në përkujdesje alternative. Në rast se fëmija kërkon të dëgjohet, gjykata merr parasysh kërkesën e tij, e cila mund të rrëzohet veçse për shkaqe të rënda dhe me një vendim të motivuar.

Neni 64

Mbrojtja e fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës kanë për të detyrë të identifikojnë në mënyrë aktive dhe të trajtojnë me përparësi çdo rast të raportuar të fëmijës së shfrytëzuar, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Këto struktura janë përgjegjëse dhe kanë të drejtë të ndër marrin veprime konkrete, me mbështetjen e

organeve të Policisë së Shtetit, për largimin e fëmijës nga situata e shfrytëzimit ekonomik apo situata e rrugës. Procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pas vlerësimit të secilit rast, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin teknik ndërsektorial përfshin në Planin Individual të Mbrojtjes, por pa u kufizuar në to:

- a) marrjen e njëres nga masat e mbrojtjes së parashikuara në këtë ligj;
- b) regjistrimin e fëmijës në shkollë dhe/ose ndjekjen e rregullt të programit mësimor;
- c) mbështetje mësimore, nëpërmjet mësuesve të posaçëm apo klasave të integruara;
- ç) mosfrekuentimin e vendeve të caktuara;
- d) këshillim psikologjik;
- dh) trajtim shëndetësor, nëse është i nevojshëm.

3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në situatën familjare të fëmijës, mund të raportojë prindërit tek organet e policisë dhe të prokurorisë ose të përcaktojë një plan për aftësimin prindëror të prindërve të fëmijës, i cili përmban, por nuk kufizohet në:

- a) ndjekjen e kurseve për aftësim prindëror;
- b) ndjekjen e kurseve kundër alkoolizmit apo programeve kundër lëndëve narkotike e psikotrope;
- c) mbështetjen për t'u regjistruar në njësinë vendore përkatëse dhe regjistrimin e gjithë anëtarëve të familjes në gjendjen civile;
- ç) ndihmën për t'u integruar në skemën e ndihmës ekonomike;
- d) ndihmën për aksesimin e tregut të punës;
- dh) çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme, e cila ndihmon në përmirësimin e situatës familjare, duke krijuar premisa për mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e mbarëvajtjes së Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës, si dhe për ndryshimin e tij, duke përshtatur ose hequr çdo masë apo ndërhyrje nëse situata që ka çuar në vendosjen e tyre ka ndryshuar. Në çdo rast, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës vë në dijeni drejtorin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në lidhje me zbatimin apo nevojën për ndryshimin e Planit Individual të Mbrojtjes.

Neni 65

Mbrojtja e fëmijës nën moshën për përgjegjësi penale

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës marrin masa të menjëhershme për vlerësimin e rastit të fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, duke angazhuar njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin shumëdisiplinor për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, i cili përmban një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në këtë ligj, si dhe ndërhyrjet e shërbimet e tjera të nevojshme për riintegrimin e tij, duke marrë në konsideratë:

- a) kushtet, të cilat lehtësuan përfshirjen e fëmijës në krim;
- b) nivelin e rrezikshmërisë shoqërore dhe veprën e kryer;
- c) mjedisin, në të cilin është rritur dhe ka jetuar fëmija;
- ç) rrezikun apo mundësinë që fëmija të kryejë një vepër tjetër penale;
- d) çdo faktor tjetër, i cili mund të ndihmojë për të kuptuar situatën e fëmijës.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës mund të përhijnë në Planin Individual të Mbrojtjes edhe seanca këshillimi për prindërit e fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, të cilët nuk janë subjekt i një procedimi penal apo nuk janë dënuar penalisht për këtë gjë.

3. Veprimtaria e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 66

Masa e mbikëqyrjes së specializuar për fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale

1. Masa e mbikëqyrjes së specializuar për fëmijën që dyshohet ose ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, zbatohet duke lejuar qëndrimin e fëmijës pranë familjes, me kusht që të mbikëqyren aktivitetet e mëposhtme:

- a) shkuarja në shkollë në mënyrë të rregullt;
- b) pjesëmarrja në aktivitete të shërbimeve parashoqërore;
- c) ndjekja e një trajtimi mjekësor apo këshillimi psikologjik;
- ç) ndalimet për të shkuar apo frekuentuar vende të caktuara.

2. Në rast se është e pamundur që fëmija të lihet pranë familjes ose kur fëmija nuk përmbush kushtet e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes, strukturat e mbrojtjes së fëmijës mund të propozojnë dhe të vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes, përfshirë edhe vendosjen e fëmijës te një nga të afërmit dhe duke i kërkuar fëmijës, në çdo rast, të respektojë kushtet e vendosura në Planin Individual të Mbrojtjes.

KREU VI

RAPORTIMI I RASTEVE TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

Neni 67

Detyrimi për raportim

1. Çdo person fizik ose juridik që ka informacion, ose vetë fëmija, duhet të njoftojë për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës institucionet qendrore dhe strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës ose Policinë e Shtetit.

2. Çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

3. Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Njësia arsimore vendore, në çdo rast, kur merr dijeni për fëmijë në nevojë për mbrojtje, bën raportimin te strukturat për mbrojtjen e fëmijës.

4. Punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private, kanë për detyrë të raportojnë menjëherë te drejtori i institucionit, organet e Policisë së Shtetit, strukturat për mbrojtjen e fëmijës çdo rast të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes, neglizhimit apo dhunës te fëmijët.

5. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës marrin masa për vendosjen e njoftimeve me informacionin e kontaktit në të gjitha institucionet publike apo private të përkujdesjes së fëmijës, të arsimit e të shëndetësisë, për të lehtësuar raportimin.

6. Të gjithë personat, të cilët kanë detyrim për raportim, sipas këtij ligji, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Procedurat për raportimin e rasteve rregullohen me udhëzim të përbashkët të minis-trave përkatës.

Neni 68

Linja e telefonit për fëmijë

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me

organizatat jofitimprurëse, vendos në dispozicion një linjë telefoni pa pagesë, me numër të publikuar gjerësisht, e cila është e detyruar të verifikojë dhe të referojë pranë njësive për mbrojtjen e fëmijës apo strukturave të tjera kompetente çdo rast të raportuar.

KREU VII SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 69

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e të drejtave të parashikuara në nenet 8, 9, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 32 e 33, të këtij ligji, kur nuk përbëjnë veprë penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

- a) personi fizik, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;
- b) personi juridik, nga 60 000 deri në 100 000 lekë;
- c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkeljen, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;
- ç) personi, i cili ushtron funksion publik, nga 60 000 deri në 80 000 lekë.

2. Çdo mospërbushje e detyrimeve ligjore nga strukturat e përcaktuara dhe punonjësit përkatës konsiderohet kundërvajtje administrative, sipas neneve 38, 39, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 54, 57, 59, 60, 62, 64, 65, 66 e 67 të këtij ligji.

3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organi, i cili konstaton kundërvajtjen administrative, vendos dhe ekzekuton sanksionet administrative.

4. Vendimi i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është titull ekzekutiv. Procedura për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimin e gjobave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundër-vajtjet administrative.

5. Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 70

Ankimi

Kundër vendimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, sipas neni 69, të këtij ligji, mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 71

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 6; 27, pika 4; 34, pikat 5 e 6; 35, pika 8; 38, pika 4; 40, pika 4; 44, pika 2; 45, pika 3; 52, pika 6; 54, pika 5; 64, pika 1; 65, pika 3; dhe 69, pika 5, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të neni 40, pika 3, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministrat përgjegjës që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim neneve 8, pika 9; 32, pika 4; 48, pika 2; 49, pika 4; dhe 67, pika 7, të këtij ligji.

Neni 72

Shfuqizime

Ligji nr. 10 347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 73

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10060, datë 6.3.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 22/2018

PËR STREHIMIN SOCIAL

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aftësi paguese” është tërësia e mjeteve financiare që një familje mund të përdorë për pagesën e qirave ose të kësteve të kredive, në raport me të ardhurat familjare, në masën e përcaktuar në këtë ligj.
2. “Administrator shoqëror” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.
3. “Azilkërkues” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin për azilin në Republikën e Shqipërisë.
4. “Banesë” është bashkësia e mjediseve ose mjedisi i vetëm që ka hyrje të pavarur (derë) dhe dalje në rrugën publike.
5. “Banesë sociale” është tërësia e banesave të përfituara sipas programeve sociale të parashikuara nga ky ligj.
6. “Banesë sociale me qira” është banesa që jepet me qira, në pronësi publike, nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë e mbeten në pronësi të subjekteve private, por që vihen në dispozicion të programit të banesave sociale me qira, me pëlqimin e pronarit privat.
7. “Banesë me kosto të ulët” është banesa që ndërtohet në përputhje me të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi dhe që vihet në dispozicion të njërit prej programeve të strehimit të parashikuara nga ky ligj.
8. “Banesë e përkohshme” është banesa e destinuar për strehim të përkohshëm, në kushtet e emergjencës së strehimit të individëve të pastrehë ose që kanë nevojë për strehim të menjëhershëm dhe me afat të shkurtër, sipas parashikimeve të këtij ligji, derisa t’u zgjidhet mundësia për strehim të qëndrueshëm.

9. “Banesë e specializuar” është banesa me infrastrukturë të përshtatur dhe të aksesueshme për të plotësuar nevojat funksionale, shëndetësore dhe të sigurisë fizike, për grupet në nevojë.

10. “Çmim mesatar i banesave në treg” është mesatarja e çmimeve të shitjes së banesave në treg gjatë një viti, e cila llogaritet sipas metodologjisë që miratohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

11. “Dëbim” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale, informale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, pa një proces të rregullt ligjor, në mungesë të konsultimit dhe ofrimit të strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe pa siguruar një mbrojtje ligjore efektive.

12. “Ent menaxhues” është një ent publik ose një person fizik/juridik privat, që ushtron veprimtarinë vetëm pas regjistrimit në një regjister të posaçëm në njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe është përgjegjës për administrimin dhe mbikëqyrjen e banesave sociale.

13. “Emigrantë të rikthyer” janë kategoritë e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi.

14. “Familjet e punonjësve të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë” janë të gjitha kategoritë që përfshihen në ligjin nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye ose për shkak të detyrës.

15. “Familje njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë” është nëna apo babai i vetëm që kanë në ngarkim fëmijë.

16. “Fondi publik i banesave sociale” është tërësia e banesave sociale në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore, që krijohet nëpërmjet blerjeve në treg të lirë, investimeve për ndërtime të reja, kalimit të pronësisë nga partneritete publike private ose nëpërmjet përfitimit nga mënyrat e tjera, që vijnë nga ndërtimet private, si dhe nga burime të tjera, të parashikuara në këtë ligj.

17. “Grant i menjëhershëm” është mbështetje financiare e menjëhershme, që përfitojnë pa të drejtë kthimi disa kategori të specifikuar, në masën e përcaktuar sipas parashikimeve në këtë ligj.

18. “Grante konkurruese” janë fonde të kushtëzuara që përdoren nga ministria përgjegjëse për strehimin, për financimin e plotë ose të pjesshëm të projekteve që propozohen dhe zbatohen nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për qëllime të këtij ligji.

19. “Institucion që menaxhon kredinë” është banka ose institucioni financiar, i cili ka nënshkruar një kontratë me institucionin investues për menaxhimin e një programi kreditimi me kushte lehtësuese në sektorin e strehimit.

20. “I pastrehë” është çdo individ/familje që nuk ka banesë, i cili/e cila banon në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, dhe nuk ka mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë.

21. “Kalim i pronësisë mbi banesat sociale” është transferimi i pronësisë nga pronari ekzistues te një pronar i ri, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil.

22. “Kontratë qiraje sociale” është një kontratë qiraje, niveli i qirasë së të cilës kontrollohet dhe/ose mund të subvencionohet nga institucionet shtetërore.

23. “Kredi hipotekore” është huaja që jepet për strehim, e cila sigurohet nëpërmjet hipotekës mbi një pasuri të paluajtshme, me afat të gjatë maturimi dhe interes më të ulët se kreditë tregtare.

24. “Kredi me kushte lehtësuese” është kredia/huaja, interesat e së cilës subvencionohen nga institucionet shtetërore.

25. “Kushte emergjence për strehim” janë kushtet në të cilat ndodhen individët/familjet që banojnë në banesa në rrezik shembjeje, në banesa që nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe në banesat që prishen për shkak të ndërtimeve të veprave publike, të cilët nuk përfitojnë kompensim financiar nga procedurat e shpronësimit.

26. “Normë e strehimit” është koeficienti që shpreh sipërfaqen minimale të banimit që duhet të ketë një individ në banesë. Ky koeficient shprehet në sipërfaqe, në metër katror për individ.

27. “Individ/familje në nevojë për strehim” është individi/familja që ka banesë, por e ka nën normën e strehimit, që nuk ka të ardhura që të sigurojë pagesën për një qira të përballueshme në tregun e lirë.

28. “Persona me aftësi të kufizuara (në vijim PAK)” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

29. “Programe sociale strehimi” janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve që nuk kanë banesë dhe banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, që nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë, si dhe ato familje/individë, banesa e të cilëve është nën normën ligjore të strehimit dhe që nuk kanë të ardhura që të sigurojnë pagesën për një qira minimale në tregun e lirë.

30. “Pronar social” është çdo subjekt publik, përveç njësite të vetëqeverisjes vendore, si edhe çdo subjekt privat, që investon në banesa sociale me qira ose që disponon banesa për t’i dhënë me qira, për familjet në nevojë për strehim.

31. “Punëtor emigrant” janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9555, datë 8.6.2006, “Për ratifikimin e konventës evropiane “Për statusin ligjor të punëtorëve emigrantë”” dhe në legjislacionin në fuqi për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi.

32. “Punonjës të Policisë së Shtetit” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për Policinë e Shtetit.

33. “Qiramarrës” është individi ose familja që banon me kontratë qiraje sociale.

34. “Qira e përballueshme” është ajo pjesë e qirasë, të cilën familja/individ arrin ta paguajë me të ardhurat e veta dhe që zë jo më shumë se:

- a) 25 për qind të të ardhurave të një familjeje me të ardhura mesatare;
- b) 20 për qind të të ardhurave të një familjeje me të ardhura të ulëta;
- c) 15 për qind të të ardhurave të një familjeje me të ardhura shumë të ulëta.

35. “Qira reale” është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banese të caktuar në tregun e lirë.

36. “Qira mesatare” është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë.

37. “Qira sociale” është qiraja me të cilën jepen banesat sociale me qira dhe që llogaritet, në çdo rast, me një kosto më të ulët sesa qiraja reale.

38. “Refugjat” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

39. “Strukturë përgjegjëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore” është një drejtori, sektor ose njësi e qëndrueshme dhe e trajnuar, që mbulon çështjet e strehimit.

40. “Strehim” është tërësia e elementeve financiare, sociale dhe institucionale të procesit të sigurimit të banesës.

41. “Subjekte private” janë personat fizikë dhe juridikë privatë, sipas përcaktimit të dhënë nga Kodi Civil.

42. “Subvencion i qirasë” është shuma e të hollave që jepet nga institucionet shtetërore për llogari të përfituesit, me qëllim mbulimin e pjesës së qirasë, e cila nuk përballohet me të ardhurat e përfituesit.

43. “Subvencion i interesave të kredisë” është shuma në të holla që përfiton individi/familja nga institucionet shtetërore, me qëllim mbulimin e interesave të kredisë, të marrë me kushte lehtësuese për blerjen e banesave me kosto të ulët.

44. “Të ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuara, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme.

Në këto të ardhura nuk përfshihen të ardhura nga ndihma ekonomike, pagesat e papunësisë, përfitimet e personave me aftësi të kufizuara, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, nga ndihma ekonomike për shkak të aftësisë së kufizuara, e parashikuar në ligjin nr. 9355 datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe

shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8098 datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 8626 datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik”; nga rimbursimi i shpenzimeve për energji elektrike; nga rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe nga paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

45. “Të ardhura mesatare” është niveli mesatar i konsumit familjar, sipas nivelit më të ulët territorial të disagregimit të të dhënave nga INSTAT-i dhe që publikohet në mënyrë periodike. Për efekt të llogaritjes së nivelit të të ardhurave mesatare, familjet grupohen si më poshtë:

a) familje me të ardhura mesatare, që janë familjet me të ardhura mujore midis 100 dhe 120 për qind e të ardhurave mesatare;

b) familje me të ardhura të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore midis 70 dhe 100 për qind e të ardhurave mesatare;

c) familje me të ardhura shumë të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 70 për qind e të ardhurave mesatare;

ç) familje pa të ardhura, që janë familje me ndihmë ekonomike, si dhe ato që përveç ndihmës ekonomike përfitojnë pagesat sipas paragrafit të dytë të pikës 44 të këtij neni.

46. “Viktimitë e dhunës në familje” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në ligjin nr. 104/2012, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje””.

47. “Viktimitë trafikimi” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

48. “Viktimitë e mundshme e trafikimit” është personi, për të cilin agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar gjykojnë se mund të jetë trafikuar dhe ka të njëjtin kuptim, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 27.7.2011, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”.

49. “Vajzat nëna” janë vajzat që bëhen ose janë në pritje për t’u bërë nëna, të vetme, pavarësisht nga mosha e tyre, të cilat marrin përsipër të gjitha përgjegjësitë për të lindur dhe rritur fëmijën e tyre pa ndihmë financiare.

50. “Zhvendosje” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, me ose kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtime formale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, mbështetur në konsultim me subjektet e prekura, në ofrimin e strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe në garantimin e mbrojtjes ligjore efektive.

51. “Komisioni i strehimit” është Komisioni që ngrihet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ka në përbërje përfaqësues të komuniteteve të interesuara.

KREU II

PARIMET E POLITIKAVE TË STREHIMIT

Neni 3

Parimi i përballueshmërisë së strehimit

1. Strehimi konsiderohet i përballueshëm nëse familja me të ardhura:

a) mesatare nuk shpenzon më shumë se 25 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm;

b) të ulëta nuk shpenzon më shumë se 20 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm;

c) shumë të ulëta nuk shpenzon më shumë se 15 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm.

2. Në shpenzimet për strehimin nuk përfshihen shpenzimet për shërbime të furnizimit me ujë dhe me energji elektrike.

3. Strehimi i familjeve pa të ardhura sigurohet nga institucionet shtetërore, nëpërmjet njërit prej programeve të strehimit social të parashikuara nga ky ligj.

Neni 4

Parimi i strehimit të përshtatshëm

1. Strehimi konsiderohet i përshtatshëm për një individ dhe/ose familje atëherë kur garanton privatësinë, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet.

2. Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson:

a) hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

b) shërbime bazë, brenda mjedisit të banimit;

c) qëndrueshmëri dhe siguri nga rreziqe që burojnë nga veprimet ose mosveprimet njerëzore, faktorët natyrorë e klimaterikë;

ç) qasje në shërbimet publike, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve;

d) akses në shërbimet e punësimit, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social, në arsim dhe në shërbime të tjera komunitare;

dh) qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët, duke lehtësuar shkallën e plotësimit të nevojave të veçanta të banimit për ta.

3. Strehimi nuk duhet të çojë drejt veçimit të një grupi përfituesish nga grupet e tjera.

Neni 5

Parimi i sigurisë së qëndrimit

1. Qëndrimi në një vendbanim, strehim të përkohshëm ose të përhershëm është i pacenueshëm, përveç rasteve që janë në kundërshtim me parimet Kushtetuese, si dhe ato të parashikuara me ligj.

2. Ndalohet dëbimi i individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre.

3. Zhvendosja e individëve/familjeve në rastet e parashikuara në ligj kryhet në përputhje me parimet e njoftimit, konsultimit dhe strehimit të përshtatshëm, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 6

Procedura e zhvendosjes

1. Në rast se qëndrimi në një vendbanim ose strehim bëhet i pamundur, për shkak të investimeve me interes publik, prishje të objektit për shkak të përjashtimit nga procesi i legalizimit ose raste të tjera, të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera, njësia e vetëqeverisjes vendore kryen procedurën e mëposhtme:

a) njofton me shkrim individin/familjen për arsyet e zhvendosjes 30 ditë përpara nxjerrjes së aktit administrativ për zhvendosjen nga banesa;

b) informon individin/familjen për mundësitë alternative të strehimit;

c) nxjerr aktin administrativ për zhvendosjen nga banesa 45 ditë përpara zhvendosjes, duke njoftuar edhe formën e miratuar për strehim alternativ.

2. Zhvendosja, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk zbatohet pa siguruar më parë sistemimin me strehim të përshtatshëm të individëve/familjeve që zhvendosen dhe nuk përfitojnë shpronësim.

3. Kundër vendimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për zhvendosje nga banesa, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

4. Individët/familjet që preken nga zhvendosja përfitojnë ndihmë juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

5. Procedurat e zhvendosjes dhe të bashkëpunimit institucional përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Parimi i respektimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në planifikimin e zonave të banimit e të programeve të strehimit, respektojnë traditat dhe kulturat e ndryshme të komuniteteve.

2. Ndërtimi i banesave duhet të mundësojë shprehjen e identitetit kulturor dhe diversitetin e komuniteteve, pa cenuar standardet e nevojshme të cilësisë së strehimit.

Neni 8

Parimi i pjesëmarrjes

Çdo subjekt që zbaton një program social strehimi përfshin në proces konsultimi komunitetin që preket dhe/ose atë që përfiton nga programi, në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Neni 9

Parimi i transparencës dhe i informimit të publikut

Organet e njërive të vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë:

a) informacion të plotë, të lehtë për t’u gjetur, të kuptueshëm dhe të lexueshëm për çdo individ/ familje. Informacioni duhet të përmbajë:

- i) llojin e programit social të strehimit që zbatohet në atë njësi të vetëqeverisjes vendore;
- ii) kushtet që duhet të plotësojnë subjektet e interesuara për t’u përfshirë në programin specifik të strehimit;
- iii) dokumentacionin që kërkohet për verifikimin e të dhënave që deklaron subjekti i interesuar;
- iv) procedurën që do të ndiqet nga njësi e vetëqeverisjes vendore për miratimin e përfituesve;
- v) organin ankimor, të cilit duhet t’i drejtohet subjekti që nuk është përzgjedhur si fitues, afatet kohore dhe formatin e ankimit;

b) transparencë në procesin e përzgjedhjes e të publikimit, si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës për të interesuarit;

c) ndihmë për plotësimin e formularëve të aplikimit për strehim, për individët me aftësi të kufizuar në të parë dhe në të folur, nëpërmjet interpretuesit të gjuhës së shenjave ose lehtësuesit të komunikimit, të moshuarit, për personat që nuk kuptojnë gjuhën shqipe ose ata që nuk dinë shkrim e këndim, si dhe të sigurojnë që çdo individ /familje, të cilët kanë vështirësi komunikimi për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore ose sociale, të marrin informacionin dhe ndihmën e nevojshme për këtë qëllim.

Neni 10

Parimi i mosdiskriminimit

1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja

diskriminuere.

2. Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t'i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë.

KREU III PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT

Neni 11

Llojet e programeve sociale të strehimit

1. Në programet sociale të strehimit përfshihen:

- a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;
- b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;
- c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;
- ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;
- d) programi për krijimin e banesave të përkohshme;
- dh) programi i banesave të specializuara.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kujdesen që familjet dhe individët, të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore.

3. Individit/familja nuk mund të përfitojë njëkohësisht nga më shumë se një program strehimi social në të njëjtën kohë.

Neni 12

Ndërthurja e programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale

1. Programet sociale të strehimit ndërthuren me programe të tjera të shërbimeve sociale, kryesisht ato të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor.

2. Ministria përgjegjëse për strehimin dhe ministria e linjës, sipas llojit të shërbimit, hartojnë udhëzime të përbashkët për të caktuar mënyrën e ndërveprimit të këtyre programeve.

Neni 13

Kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit

1. Statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:

- i) i fatkeqësive natyrore;
- ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;
- iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;

iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;

c) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani

rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.

2. Përfitojnë nga programet e strehimit social të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”.

3. Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen vetëm për ato individë/familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji.

4. Të drejtën për të përfituar nga programi i banesave sociale të specializuara e kanë edhe të miturit nën moshën 18 vjeç, pas lirimit ose përfundimit të programit të masës alternative të shmangies, në rastin kur bazuar në një vendim gjyqësor ose një akt administrativ, mbeten të pastrehë, për arsye se nuk duhet të jetojnë me prindërit, kujdestarin ligjor ose me familjen e tyre.

Neni 14

Rregulla të përgjithshme për aplikimin në programet sociale të strehimit

1. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit/ vendqëndrimit të aplikantit.

2. Individu/familja pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta ose të ulëta, që aplikon, paraqet vetëm kërkesën për programin social të strehimit, sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë.

3. Dokumentacioni për të përfituar strehim, sipas çdo programi, afatet dhe procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Rregulla të përzgjedhjes përmes sistemit të pikëzimit

1. Përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike përpara fillimit të procesit të aplikimit.

2. Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

4. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojë listat e përfituesve brenda një afati dymujor, nga data e njoftimit nga ana e subjektit publik ose privat që ofron dhe realizon një nga programet sociale të strehimit, kur ky subjekt nuk është vetë njësia e vetëqeverisjes vendore. Marrëdhënia e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit që financon projektin përcaktohet me marrëveshje të posaçme.

5. Hartimi i listës së përfituesve kryhet nga zyra përgjegjëse ose struktura e ngarkuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve dhe dokumentacioni përkatës vlerësohet nga komisioni i strehimit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 16

Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve

Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përzgjedhjen e individëve/familjeve përfituese, për hartimin dhe miratimin e sistemit të pikëzimit bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:
 - i) nuk disponojnë banesë në pronësi;

- ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;
 - iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;
 - iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
 - v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;
 - vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.
- b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
- i) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
 - ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;
 - iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;
 - iv) bashkëshortët, moshën e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrijnë deri në 60 vjeç.
- c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
- i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - ii) individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;
 - iii) familjet e mbetura të pastreha për shkak të liritimit të banesave ish-pronarëve;
 - iv) emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit;
 - v) familjet e policëve të rënë në detyrë;
 - vi) punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH);
 - vii) punonjësit e reparatit RENEA;
 - viii) punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
 - ix) viktimat e dhunës në familje;
 - x) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
 - xi) anëtarët e komunitetit rom;
 - xii) anëtarë të komunitetit egjiptian;
 - xiii) të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;
 - xiv) vajzat nëna;
 - xv) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individit nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.
- ç) Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave përcaktohen familjet, sipas grupeve të të ardhurave, të përcaktuara në këtë ligj.

KREU IV PROGRAMI I BANESAVE SOCIALE ME QIRA

Neni 17

Kuptimi i programit të banesave sociale me qira (BSQ)

1. Programi i banesave sociale me qira është programi, me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social.
2. Banesat sociale me qira përfshijnë:

- a) banesat sociale që ndërtohen ose blihen nga tregu i lirë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim që të jepen me kontratë qiraje sociale;
- b) banesat ekzistuese në treg, në pronësi të pronarit social;
- c) objektet e dala jashtë funksionit, si rezultat i mbylljes së një veprimtarie, të cilat kanë kaluar në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe, në përputhje me planin e përgjithshëm vendor, janë miratuar për t'u kaluar në fond banesash sociale me qira, që subvencionohen.

Neni 18

Fondi publik i banesave sociale

1. Fondi publik i banesave sociale është në pronësi të pushtetit vendor ose qendror dhe krijohet nga fonde të pushtetit vendor dhe/ose qendror, të subjekteve private fitimprurëse ose jofitimprurëse, donacione, si dhe:

- a) ndërtime të reja;
 - b) blerje të banesave në treg të lirë ose pas ankandit të parë të banesave që shiten sipas parashikimeve të nenit 557 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastet e blerjes së banesave pas ankandit të parë, në kontratën e shitjes parashikohet marrëveshja kufizuese që ndalon tjetërsimin e pasurisë ose ndryshimin e destinacionit të saj për përdorim si banesë sociale për të paktën 10 vjet nga data e blerjes;
 - c) përshtatje të objekteve të dala jashtë funksionit;
 - ç) kalimi i pronësisë mbi pronat e konfiskuara, si pasuri të vëna me aktivitet të paligjshëm.
2. Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njërive të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, në territorin nën juridiksionin e saj, në përputhje edhe me planet vendore, duhet të parashikojë sipërfaqen e truallit për ndërtimin e një numri të mjaftueshëm banesash sociale, bazuar në nevojat për strehim.

Neni 19

Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik

1. Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2. Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor dhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund t'i akordohet shtesa në intensitet përkundrejt përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimi në favor të bashkisë, për strehim social, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 20

Përcaktimi i kufijve të të ardhurave të individëve/familjeve që përfitojnë nga banesat sociale me qira

1. Nga fondi i banesave sociale me qira, jo më pak se 80 për qind e familjeve që përzgjidhen të trajtohen në banesa sociale me qira duhet të kenë të ardhura nga 0 deri 100 për qind të të ardhurave mesatare familjare

të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.

2. Pjesa tjetër, jo më shumë se 20 për qind e familjeve mund të përzgjidhet brenda intervalit 100–120 për qind të nivelit të të ardhurave mesatare.

Neni 21

Blerja e banesave sociale në treg

1. Blerja e banesave sociale në treg, që i shtohen fondit të banesave sociale me qira, si rregull, realizohet në ato raste kur ndërtimi i banesave të reja kushton më shumë sesa vlera e banesave në treg.

2. Banesa sociale mund të blihet nga tregu, përjashtimisht, kur vlera e banesës në treg është më e lartë se kostoja e ndërtimit, vetëm kur:

a) vërtetohen kushte emergjente për strehim;

b) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk disponon truall për ndërtim banesash të reja.

3. Kushtet, normat dhe standardet që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira dhe procedura e blerjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Pronësia e banesave sociale me qira

1. Banesat sociale me qira regjistrohen në pronësi të subjektit që e ka financuar.

2. Kur banesat sociale me qira financohen tërësisht nga buxheti i shtetit ose bashkërisht nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ato regjistrohen në zyrën vendore të regjistrimit të pronave, në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të institucionit publik të parashikuar në nenin 72, shkronja “g”, me shënimin përkatës për marrëveshjen kufizuese që ndalon tjetërsimin e pasurisë.

Neni 23

Statusi i pronarit social

1. Çdo subjekt publik, përveç njësisë së vetëqeverisjes vendore, si edhe çdo subjekt privat, që investon në banesa sociale me qira ose që disponon banesa për t’i dhënë me qira, për familjet në nevojë për strehim, regjistrohet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore me statusin e “pronarit social” nëse plotëson kushtet dhe kriteret e këtij neni.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore, brenda muajit janar të çdo viti, publikon thirrjet për aplikimet për çdo subjekt të interesuar, i cili kërkon të regjistrohet si pronar social. Thirrja për aplikim përmban, veç të tjerave, kushtet për përfitimin e statusit “pronar social” dhe lehtësitë fiskale që miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

3. Struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore, pasi verifikon kushtet e banesës dhe përshtatshmërinë e saj me normat e strehimit, përgatit raportin e vlerësimit dhe ia drejton për miratim titullarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në rast vlerësimi negativ, njoftohet subjekti i interesuar.

4. Subjektit publik ose privat i jepet statusi “pronar social” kur:

a) banesa e tij plotëson kushtet teknike dhe normat e strehimit në fuqi, referuar raportit të strukturës së njësisë së vetëqeverisjes vendore;

b) qiraja me të cilën ofrohet banesa me qira nuk është më e lartë sesa qiraja mesatare në tregun e lirë;

c) nënshkruan një kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku bien dakord për mënyrën e menaxhimit të banesës së tij;

ç) nënshkruan deklaratën se nuk do të refuzojë qiramarrësin për arsye që përbëjnë diskriminim.

Neni 24

Marrëveshja ndërmjet pronarit social dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pronari social dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nënshkruajnë një marrëveshje. Kjo marrëveshje parashikon:

- a) afatin e marrëveshjes, që nuk mund të jetë më pak se 3 vjet;
- b) masën e qirasë mujore dhe mënyrën e shlyerjes së saj;
- c) mënyrën e administrimit të pronës dhe të marrëdhënieve me qiramarrësin.

Neni 25

Mbështetja e pronarit social

Pronari social mbështetet nëpërmjet financimeve për subvencionin e qirasë për familjet përfituese.

Neni 26

Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave sociale me qira

1. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton mënyrën e administrimit dhe të mirëmbajtjes së fondit publik të banesave sociale me qira. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të ngarkojnë strukturat përgjegjëse të tyre për të kryer funksionet menaxhuese për administrimin, në rastin kur kjo detyrë nuk i është ngarkuar një enti menaxhues.

2. Me administrim kuptohen të gjitha veprimet dhe vendimet që merren për pronën, ndër të tjera:

- a) mbledhja e qirasë;
- b) evidenca e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- c) planifikimi financiar;
- ç) mbajtja e bilancit;
- d) ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të detyrimeve e të drejtave të palëve kontraktuese.

3. Me mirëmbajtje kuptohet tërësia e veprimeve dhe investimet e nevojshme për punime, ndreqje të nevojshme dhe riparime kapitale për përmirësimin e pronës.

4. Banesat sociale me qira, të cilat vihen në dispozicion të programit nga subjektet private, si pronarë socialë, administrohen dhe mirëmbahen në bazë të një kontrate që vetë këto subjekte lidhin me entet menaxhuese publike ose private. Një kopje e kësaj marrëveshjeje depozitohet pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore që kujdeset për strehimin.

Neni 27

Enti menaxhues

1. Pronari social ka të drejtë të regjistrohet si ent menaxhues. Në rastin kur nuk regjistrohet si ent menaxhues dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nuk kryen funksionet e entit menaxhues, atëherë pronari social dhe njësia e vetëqeverisjes vendore përzgjedhin një nga administratorët/shoqëritë administruese, të regjistruara në librin e bashkisë, sipas ligjit nr. 10 112, datë 9.4.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.

2. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren për mënyrën e funksionimit të entit menaxhues, si dhe për kontrollin e mbikëqyrjen e këtij të fundit.

Neni 28

Kushtet e menaxhimit të banesave sociale me qira

Çdo subjekt që ka në pronësi dhe/ose administron banesa sociale me qira duhet të sigurohet që të

plotësohen:

- a) Kushtet dhe standardet e banimit, nëpërmjet:
 - i) plotësimin të kushteve të përshtatshme të banimit, në përputhje me standardet e ndërtimit;
 - ii) mirëmbajtjes së banesave, në mënyrë të tillë që të sigurojë, së paku, standardet, në bazë të të cilave ajo është ndërtuar ose blerë;
 - iii) plotësimin të të gjitha standardeve për sigurinë dhe kushtet higjieno-sanitare e shëndetësore të banesave.
- b) Kushtet e informimit dhe barazisë, nëpërmjet:
 - i) trajtimit të gjithë qiramarrësve në mënyrë të barabartë;
 - ii) informimit të duhur për qiramarrësit për llojin dhe standardin e shërbimeve që ata mund të presin nga enti menaxhues, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me menaxhimin e banesave;
 - iii) formave të qarta e të thjeshta për paraqitjen e ankesave dhe që sigurojnë zgjidhjen e shpejtë, të drejtë e të kujdesshme të tyre;
 - iv) mundësive të ndryshme për qiramarrësit që të angazhohen në menaxhimin e banesave të tyre;
 - v) formave dhe mënyrave që qiramarrësit të kontrollojnë e të sigurojnë zbatimin e standardeve të menaxhimit.
- c) Fqinjësia e mirë, nëpërmjet:
 - i) dhënies së informacionit të nevojshëm për qiramarrësit, për të drejtat dhe detyrimet e tyre për marrëdhëniet e fqinjësisë, respektimin e privatësisë, ruajtjen e qetësisë e të pastërtisë, shmangien e sjelljeve e të veprimeve ofenduese, keqdashëse dhe/ose kriminale;
 - ii) reagimit të menjëhershëm ndaj veprimeve që shqetësojnë ose vënë në rrezik shëndetin dhe sigurinë e banorëve.
- ç) Qëndrueshmëria dhe transparenca financiare, duke siguruar, ndër të tjera:
 - i) transparencën në përcaktimin e qirasë për çdo qiramarrës;
 - ii) mbledhjen e qirave në kohë dhe evidentimin e çdo shkeljeje të këtij afati;
 - iii) menaxhimin e rasteve të debitorëve, duke evidentuar shkaqet dhe duke propozuar zgjidhjet e duhura;
 - iv) auditin e brendshëm dhe kontrollin financiar nga strukturat përkatëse shtetërore dhe vendore.
- d) Mirëmbajtja e rrjeteve, sistemeve dhe pajisjeve, duke siguruar vendosjen në një vend të dukshëm të raportit vjetor të kontrollit të rrjeteve, sistemeve dhe pajisjeve, ku, sipas rastit, përfshihen:
 - i) sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe i largimit të ujërave të ndotura;
 - ii) sistemi dhe pajisjet elektrike;
 - iii) sistemi i përqendruar i furnizimit me gaz;
 - iv) pajisjet individuale të gazit, që përdoren nga qiramarrësit;
 - v) ashensori.
- dh) Lidhja e kontratës së qirasë, ku përcaktohet afati kohor, masa e qirasë dhe kushtet e shfrytëzimit të banesës, si dhe të drejtat e detyrimet që burojnë nga standardet e menaxhimit të banesave me qira, të përcaktuara në këtë nen.

Neni 29

Lidhja e kontratës së qirasë

1. Kontrata e qirasë lidhet ndërmjet pronarit ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij dhe, sipas rastit, individit përfitues ose, në rastin e familjeve, prej bashkëshortëve ose bashkëjetuesve, në bazë të dispozitave të Kodit Civil.

2. Kontrata e qirasë lidhet me të drejtë ripërtëritje çdo vit, bazuar në dokumentimin zyrtar që vërteton të ardhurat e çdo individit të familjes.

3. Vërtetimi i të ardhurave, sipas rastit, merret nga qendra e punës ose personi juridik apo fizik që e ka punësuar, ose zyra përkatëse e ndihmës sociale pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, apo Instituti i

Sigurimeve Shoqërore. Në rastin e individëve pa të ardhura apo me të ardhura të ulëta, shpenzimet për lidhjen e kontratës së qirasë përballohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Çdo pjesëtar madhor i familjes vetëdeklarohet të ardhurat e veta, sipas pikës 44, të nenit 2, të këtij ligji.

5. Nëse familja siguron një banesë tjetër, kryefamiljari detyrohet të bëjë njoftimin e menjëhershëm pranë entit menaxhues, nga i cili ka përfituar banesën me kontratë qiraje sociale. Afati i njoftimit për lirimin e banesës përcaktohet në dispozitat e kontratës.

6. Me lidhjen e kontratës, qiramarrësi është i detyruar të paguajë një paradhënie, në formë garancie, në vlerën e një qiraje mujore. Vlera e garancisë zbritet nga qiraja e muajit të fundit të afatit të qirasë, përveç rasteve kur ajo duhet të përdoret për riparimet e nevojshme të banesës, të diktuar nga dëmtimi i saj nga qiramarrësi ose përveç rasteve kur palët në kontratën e qirasë kanë parashikuar ndryshe. Për familjet pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulëta, paradhënia paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, e cila kryen subvencionimin e qirasë për këto kategori.

Neni 30

Përcaktimi i qirasë

1. Kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore, ose kombinimi i të dyjave, masa e qirasë, e shprehur në lekë/m² sipërfaqe ndërtimi llogaritet nga struktura përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, brenda kufirit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Masa e qirasë miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas metodikës për llogaritjen, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Masa e qirasë vjetore nuk duhet të jetë më e madhe se 3 për qind e kostos së ndërtimit të banesës nga institucionet shtetërore, për banesat e reja, ose 3 për qind e vlerës së banesës së blerë në treg, përveç rastit të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni.

4. Për objektet e dala jashtë funksionimit dhe ato të kthyer në fond banesash sociale me qira, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji, masa e qirasë përcaktohet nga këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 2, të këtij neni, bazuar në vlerën kapitale të transferuar dhe kostot e ndërhyrjes për përshtatjen e tyre.

5. Kur banesat sociale me qira financohen sipas përcaktimeve në shkronjat “b” e “c”, të nenit 69, të këtij ligji, masa e qirasë përcaktohet nga subjektet që e kanë financuar dhe njësia e vetëqeverisjes vendore dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku zbatohet projekti.

6. Masa e qirasë, e shprehur në lekë për metër katror, duhet të mbulojë kostot për administrim, mirëmbajtje, kosto operationale dhe kosto të investimit ose të shlyerjes së borxhit. Niveli i qirasë sociale nuk duhet të jetë më i lartë se niveli mesatar i qirasë në tregun e lirë.

7. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren për shfrytëzimin e banesave sociale me qira nga qiramarrësit, ku përcaktohen me hollësi të drejtat dhe detyrat e qiramarrësit dhe të entit menaxhues.

Neni 31

Zgjidhja e kontratës së qirasë nga qiradhënësi para afatit

1. Kontrata e qiramarrjes zgjidhet nga qiradhënësi, në mënyrë të njëanshme, para përfundimit të afatit të kontratës, nëse:

- a) qiramarrësi bën deklaram të rremë për të ardhurat;
- b) qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër;
- c) qiramarrësi ia ka lënë me qira një të treti;
- ç) qiramarrësi, pa arsye të justifikuar, nuk ka paguar qiranë për 3 muaj rresht;
- d) të ardhurat e qiramarrësit tejkalojnë ato të përcaktuara në pikën 1, të nenit 19, të këtij ligji.

2. Qiradhënësi duhet të njoftojë me shkrim qiramarrësin para zgjidhjes së kontratës, sipas kushteve dhe në adresën e përcaktuar në kontratën e qirasë.

3. Pas zgjidhjes së kontratës, qiramarrësi është i detyruar të bëjë lirim të banesës dhe t'ia dorëzojë pronarit në gjendjen dhe me inventarin që e ka marrë në dorëzim.

4. Në rast se qiramarrësi nuk përmbush detyrimet sipas shkronjës “ç”, pikës 1, të këtij neni, për shkaqe të tilla si: shpenzime të arsyeshme shëndetësore, papunësi e menjëhershme ose humbje e një pjesëtari të familjes, që siguronte të ardhurat dhe këto arsye nuk ndryshojnë me kalimin e tre muajve, qiramarrësi kalon në një nga programet e tjera të strehimit social. Detyrimet e pashlyera për tre muajt e fundit mbulohen nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

Neni 32

Zgjidhja e kontratës së qirasë nga qiramarrësi para afatit

1. Qiramarrësi duhet të njoftojë me shkrim pronarin e banesës për zgjidhjen e kontratës përpara afatit, brenda 3 muajve para zgjidhjes së saj, në adresën e përcaktuar në kontratën e qirasë. Pronari, nëpërmjet entit menaxhues, bën verifikimin e kushteve të banesës. Në rastet kur vërehen dëmtime të banesës dhe/ose pajisjeve që janë në pronësi të pronarit të BSQ-së, pronari mund të mbajë garancinë për kundërvlerën e dëmtimeve.

2. Në rastin e zgjidhjes së kontratës së qirasë para afatit, me kërkesën e qiramarrësit, garancia e paguar si paradhënie kthehet, me përjashtim të rastit kur qiramarrësi nuk ka përmbushur detyrimet sipas kontratës.

KREU V

SUBVENCIONI I QIRASË

Neni 33

Masa e subvencionit të qirasë

1. Subvencionimi i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale.

2. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencionimi mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira.

Neni 34

Rregullat e përgjithshme mbi subvencionimin e qirasë

1. Subvencionimi i qirasë si rregull kryhet nga të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Subvencionimi i qirasë mund të bëhet edhe nga pushteti qendror, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 35, të këtij ligji.

2. Aplikimi i individit/familjes për të përfituar nga subvencionimi i qirasë do të bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve për subvencionimin e qirasë miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndërtohet banesa. Kur subvencionimi i qirasë financohet pjesërisht ose plotësisht nga qeverisja qendrore, lista e përfituesve, e miratuar nga bashkia, i përcillet ministrisë përgjegjëse për strehimin, e shoqëruar me kërkesën për financim.

3. Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme:

- a) individët me statusin e jetimit;
- b) personat me aftësi të kufizuara;

- c) të moshuarit;
 - ç) invalidët e punës;
 - d) familjet e policëve të rënë në detyrë;
 - dh) emigrantët e rikthyer;
 - e) punëtori emigrant;
 - ë) azilkërkuessit;
 - f) familjet e komunitetit rom;
 - g) familjet e komunitetit egjiptian;
 - gj) Viktimat e dhunës në familje;
 - h) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
 - i) prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë;
 - j) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individit nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji;
 - k) të miturit, 14–18 vjeç, dhe të rinjtë, 18–21 vjeç, në konflikt me ligjin, kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë, sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më të mirë në shoqëri;
 - l) vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara;
 - ll) familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012.
- Radha e përparësisë së këtyre kategorive përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 35

Administrimi i kërkesave për planifikimin e fondeve nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë

1. Brenda muajit nëntor të çdo viti rishikohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikimet dhe dokumentacioni i nevojshëm, i përditësuar, për risubvencionim për vitin pasardhës nga përfituesit ekzistues dhe i përcillen ministrisë përgjegjëse për strehimin.
2. Kërkesat e aplikuesve të rinj, për përfitimin e subvencionimit, mund të paraqiten në çdo kohë gjatë vitit, por jo më vonë se muaji nëntor për vitin pasardhës.
3. Rregullat për administrimin e kërkesave të njësisë së vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit mbi subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Subvencionimi i qirasë për banesat në pronësi të pronarit social

1. Subvencionimi i qirasë për banesat bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me miratimin e këshillave të njësisë së vetëqeverisjes vendore të veta, kur nuk kanë fond të lirë banesash sociale me qira, si rregull kur:
 - a) nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg;
 - b) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave;
 - c) familja është në kushtet e emergjencës për strehim dhe kur nuk përfiton nga një program tjetër.

2. Bëjnë përjashtim nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë se:

a) familja që kërkon të strehohet në banesa sociale me qira banon në një banesë me qira, e cila ndodhet pranë vendit të punës, shkollës së fëmijëve, qendrave shëndetësore ose pranë shërbimeve të tjera;

b) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraja është sipas pikës 5, të nenit 30, të këtij ligji.

Neni 37

Administrimi i subvencionit të qirasë në pronësi të pronarit social

1. Subvencioni paguhet drejtpërdrejt në llogari të pronarit, ndërsa qiramarrësi përfiton vetëm të drejtën për të përdorur banesën me qira.

Subvencioni i qirasë jepet me miratimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me buxhetin që jepet çdo vit për subvencionimin e qirave, sipas nenit 33, të këtij ligji, dhe bazuar në kriteret që duhet të plotësojë familja për të përfituar subvencionimin e qirasë sipas këtij ligji.

2. Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategori të përcaktuara në pikën 3, të nenit 34, të këtij ligji, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyra e llogaritjes së subvencionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 38

Përcaktimi i vlerës së subvencionit të qirasë në tregun e lirë

1. Vlera e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100 për qind e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku jepet ky subvencion. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit, bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm, dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Pagesa që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionimit të qirasë nuk duhet t'i kalojë 25 për qind të të ardhurave të familjes.

3. Mënyra e llogaritjes së vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Procedura e subvencionit të qirasë së banesave në pronësi të pronarit social

1. Brenda një muaji nga data e miratimit nga komisioni i strehimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore të listës së individëve/familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë së banesave në treg të lirë, subjekti përfitues depoziton pranë komisionit të strehimit kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet tij dhe pronarit social.

2. Në rastet kur subjekti përfitues nuk e depoziton kontratën brenda afatit 1-mujor, komisioni shtyn afatin me 30 ditë. Nëse edhe pas këtij afati shtesë subjekti përfitues nuk depoziton kontratën, ai humbet të drejtën për të vijuar procedurën. Subjekti ka të drejtë të aplikojë përsëri në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

3. Pas depozitimit të kontratave të qirave të subjekteve përfituese, komisioni i strehimit i përcjell këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore listën dhe kontratat e qirasë, me qëllim që ai të vendosë miratimin e vlerave konkrete të subvencionit të qirasë për çdo përfitues. Mbledhja e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore zhvillohet jo më vonë se një muaj nga data kur mbërrijnë listat e miratuara nga komisioni i strehimit.

4. Subvencioni i qirasë do t'i jepet përfituesit që nga data e lidhjes së kontratës, pavarësisht nga data e miratimit të vlerës së subvencionit për përfituesin konkret.

5. Subvencioni i qirasë rinovohet çdo vit, sipas kontratës së qirasë dhe të ardhurave të deklaruara të familjes, sipas përcaktimeve në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 29, të këtij ligji.

6. Subvencioni i qirasë e humbet vlefshmërinë kur kontrata zgjidhet sipas përcaktimit të nenit 32 të këtij ligji.

KREU VI PROGRAMI PËR PËRSHTATJEN E PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË OBJEKTEVE DHE BANESAVE

Neni 40

Kuptimi dhe qëllimi

1. Programi për përshtatjen e objekteve, pronë shtetërore, nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njërive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit, për t'i kthyer ato në banesa, me qëllim strehimin. Procesi i kthimit të këtyre objekteve në fond banese miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private ose pronë shtetërore nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njërive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit për këtë qëllim.

3. Me përmirësim të kushteve të banesave ekzistuese dhe, nëse është e nevojshme, deri në ndërtim të ri, kuptohet tërësia e punimeve që duhet të kryhen, me qëllim që banesa të shndërrohet në një strehim të përshtatshëm, sipas kushteve të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 41

Objektet/banesat që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve

1. Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve ose i përmirësimit të kushteve deri në ndërtim të ri, janë:

a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;

b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

2. Administrimi i kërkesave dhe identifikimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të objekteve/banesave ekzistuese duhet të bëhet nga struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 42

Instrumentet e programit të kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese

1. Programi për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për:

a) përmirësimin e kushteve të banimit e jetesës, deri në ndërtim të ri, për banesat në rrezik shembjeje;

b) përmirësimin e kushteve të banimit në banesat e amortizuara;

c) rregullimin e banesave individuale ose strukturave, të cilat nuk klasifikohen si banesë, nga vetë familjet që nuk sigurojnë të ardhurat e nevojshme për ta kryer vetë përmirësimin.

2. Kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 43

Përfituesit nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit

1. Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.

2. Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:
- a) personat me aftësi të kufizuara;
 - b) individët me statusin e jetimit;
 - c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
 - ç) të moshuarit;
 - d) komuniteti rom;
 - dh) komuniteti egjiptian;
 - e) komunitetet e zonave rurale;
 - ë) prindërit e vetëm;
 - f) viktimat të trafikimit /viktimat të mundshme të trafikimit;
 - g) viktimat të dhunës në familje.

KREU VII
PROGRAMI I BANESAVE ME KOSTO TË ULËT (BKU)

Neni 44

Kuptimi i banesave me kosto të ulët

1. Banesë me kosto të ulët (BKU) konsiderohet banesa që plotëson të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi, që është e paracaktuar për t'u disponuar në pronësi nga përfituesi, nëpërmjet formave të ndryshme të lehtësimit nga institucionet shtetërore.

2. Banesat me kosto të ulët që sigurohen nëpërmjet ndërtimit, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku vlerat e tregut janë me të larta se kostojat e ndërtimit, shiten me çmim nën vlerën e tregut, por jo nën vlerën e kostos së ndërtimit.

3. Në rastet kur vlera e banesës në tregun e lirë është më e ulët se kostojat e ndërtimit, këto banesa blihen dhe përfshihen në programin e BKU-së, nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 45

Format e sigurimit dhe burimet e financimit

1. Banesat me kosto të ulët sigurohen nga subjekte publike ose private, nëpërmjet ndërtimit ose blerjes nga tregu.

2. Banesat me kosto të ulët mund të financohen me fondet e buxhetit të shtetit, me fondet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, fondet e institucioneve publike, nëpërmjet donacioneve e kredive dhe nëpërmjet nxitjes së nismës private. Forma dhe procedurat e nxitjes së nismës private dhe të bashkëpunimit me sektorin privat rregullohen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar.

3. Normat dhe standardet e banesave me kosto të ulët, procedurat e blerjes nga tregu, procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët konkrete në varësi të nivelit të të ardhurave të tyre, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për lehtësimin e blerjes së BKU-së nga përfituesi përdoren instrumentet financiare të mëposhtme:

- a) granti i menjëhershëm; dhe/ose
- b) subvencioni i interesave të kredive.

Neni 46

Granti i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët

1. Përfitojnë grant të menjëhershëm familjet të cilat kanë në përbërje:

- a) një person me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra në nënndarjen "i", të shkronjës

“c”, të nenit 16, të këtij ligji, për këto kategori;

b) një individ me statusin e jetimit, i cili, në momentin e aplikimit nuk ka mbushur moshën 30 vjeç;

c) kryefamiljarin e vetëm, në rastin kur ka në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç;

ç) familjet e komunitetit rom dhe egjiptian.

2. Shuma e grantit të menjëhershëm, që përfiton individi, është në masën 10 për qind të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.

3. Granti i menjëhershëm për kategoritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, akordohet nga buxheti i shtetit, sipas procedurave, kriterëve dhe përparësive që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 47

Subvencionimi i interesave të kredive

1. Familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore me kushte lehtësuese nga një institucion financiar, që ka lidhur marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për strehimin, ministrinë përgjegjëse për financën ose me njësinë e vetëqeverisjes vendore.

2. Financimi nga buxheti i shtetit dhe/ose i njësisë të vetëqeverisjes vendore jepet në formën e subvencionimit të interesave të kredisë për ato familje, të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë dot pagesat e kredisë për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhe se mesatarja e vlerave të tregut në atë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit. Masa e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurat e dhënies së saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kushtet e dhënies së kredisë për familjet përfituese përcaktohen me marrëveshje të përbashkët të institucionit financiar dhe ministrit përgjegjës për strehimin ose, sipas rastit, të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucionit që jep e menaxhon kredinë.

4. Masa e subvencionit, që rezulton në fund të periudhës së maturimit të kredisë, nuk duhet të kalojë më shumë se 100 për qind të vlerës së banesës. Në rast se nga llogaritjet rezulton një subvencion më i madh për përballimin e kësteve të kredisë, ose kur kësti i kredisë edhe pas subvencionit të interesave të kredisë është i papërballueshëm, sipas kuptimit të nenit 3, të këtij ligji, familja përzgjidhet për t'u trajtuar në njërin nga programet e tjera sociale të strehimit.

Neni 48

Përfituesit nga programi i banesave me kosto të ulët

1. Përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët familjet me të ardhura mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, sipas përcaktimit të nenit 2, pika 45, shkronja “a”, e këtij ligji, të cilat, në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore:

a) vërtetojnë se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekje apo sëmundje e rëndë) ose force madhore;

b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;

c) janë të zhvendosura nga banesat, sipas parashikimeve në nenin 6 të këtij ligji.

2. Kur përfitues është një familje që ka siguruar banesë nëpërmjet programeve sociale nga procesi i privatizimit ose nëpërmjet blerjes në tregun e lirë dhe sipërfaqja e banimit është nën normat e strehimit, bëhet shkëmbimi i banesës nën normë për të marrë një banesë në normat e nevojshme të strehimit, duke u llogaritur diferenca ndërmjet vlerës së banesës ekzistuese me vlerën e banesës me kosto të ulët që merr. Banesa ekzistuese nën normë bëhet pjesë e fondit publik të banesave dhe vihet në dispozicion të programit të banesave me kosto të ulët.

3. Normat e strehimit, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, edhe procedura e shkëmbimit të

banesës me kosto të ulët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Administrimi i kërkesave për këto banesa bëhet nga strukturat përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 49

Kufizimet

1. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t'i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë te një individ tjetër ose ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë.

2. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët dhe e ka shlyer kredinë, duke u bërë pronare e saj, në rast tjetërsimi të banesës humbet të drejtën për të përfituar nga programet e strehimit për një periudhë 10-vjeçare, me përjashtim kur e tjetërson banesën për arsye madhore, si vdekje apo sëmundje e rëndë.

3. Nëse, për arsye madhore, si vdekje apo sëmundje e rëndë, familja që ka përfituar banesë me kosto të ulët e tjetërson atë, i lind e drejta për të aplikuar në një nga programet e strehimit.

KREU VIII

PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E ZONËS ME QËLLIM STREHIMI

Neni 50

Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bazë të përcaktimit të zonave të banimit, dokumenteve të planifikimit qendror e vendor, vlerësimit të nevojave për strehim social dhe kërkesave për ndërtim banesash sociale, planifikojnë sipërfaqet e nevojshme të truallit për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin.

2. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin bëhet për ndërtimin e banesave sociale, në bazë të dokumenteve të planifikimit qendror e vendor.

3. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin përfshin hartimin dhe miratimin e projektit të ndërtimit, deri në përfundimin e tij.

4. Zhvillimi i zonës, sipas pikës 3, të këtij neni, bëhet me investimet nga buxheti i shteti, buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore dhe/ose në bashkëpunim me sektorin privat, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Programi i zhvillimit të zonës me qëllim strehimin realizohet në troje që janë pronë e shtetit ose private.

6. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin mund të zbatohet edhe në zonat:

a) me ndërtime të palegalizuara, që nuk mund të legalizohen;

b) me ndërtime të papërfunduara, të identifikuar si të tilla nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

c) e vjetra industriale, jofunksionale, të zëna nga individë të pastrehë, pa autorizime përkatëse për strehim.

7. Trualli i pajisur me infrastrukturë, pjesë e zhvillimit të një zone me qëllim strehimin, mund t'u ofrohet për ndërtim, pa shpërblim, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, edhe familjeve përfituese që marrin përsipër të ndërtojnë banesën mbi të me shpenzimet e tyre, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 51

Përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi

1. Përparësi në përfitimin nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin kanë familjet/individët e pastrehë, të cilët, në zonën përkatëse, e kanë siguruar strehimin në:

a) ndërtime të palegalizuara, që nuk mund të legalizohen;

b) zonat e vjetra industriale, jofunksionale, të zëna nga individë të pastrehë, pa autorizime përkatëse për

strehim.

2. Kriteret për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, mënyra e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, forma e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, me qëllim strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 52

Partneriteti publik-privat për ndërtime në zona të zhvilluara me qëllim strehimin

1. Ndërtimi i banesave në kuadrin e partneritetit publik-privat bazohet, por pa u kufizuar, në parimet e mëposhtme:

a) parimin e kthimit të investimit subjektiv privat dhe një fitim të arsyeshëm për një periudhë kohore të caktuar;

b) alokimin e risqeve, sipas parimit se pala, e cila do të mbajë riskun, është ajo e cila është në pozitë më të mirë për të përballuar riskun dhe/ose për të minimizuar pasojat e tij;

c) vlerësimin e drejtë të përfitimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në favor të realizimit të programeve sociale të strehimit, nëpërmjet përcaktimit të vlerës më të mirë për para.

2. Marrëveshja për ndërtimin e banesave, që kryhet nga subjekte private, nëpërmjet partneritetit publik-privat, bazohet në një nga format e mëposhtme:

a) financimi i ndërtimit nga subjekti privat në truallin ose truallin e pajisur me infrastrukturë në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në këmbim të përfitimit nga njësi vendore të një përqindjeje të caktuar sipërfaqe ndërtimi, të përshtatur në apartamente, sipas normave të strehimit, si kundërvlerë e vlerës së truallit të pajisur me infrastrukturë. Vlera e truallit që do të shkëmbehet me sipërfaqe ndërtimi, vlerësohet me vlerat e tregut nga ekspertë të licencuar;

b) financimi i ndërtimit nga subjekti privat dhe shfrytëzimi si banesa sociale me qira për një periudhë kohe të përcaktuar në marrëveshje midis financuesit dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në përfundim të afatit të marrëveshjes, çështjet mbi pronësinë e banesave sociale rregullohen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjes së partneritetit publik-privat;

c) bashkëfinancim i ndërtimit nga subjekti privat dhe njësi e vetëqeverisjes vendore nga buxheti i vet dhe/ose me mbështetje të buxhetit të shtetit, përkundrejt përfitimit të një numri banesash sociale dhe ose me kosto të ulët.

3. Procedura e përzgjedhjes, mënyra e kontraktimit, forma dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas formës së përcaktuar në pikën 2, shkronjat “a” dhe “c”, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas formës të përcaktuar në pikën 2, shkronja “b”, të këtij neni, kushtet e përgjithshme të marrëveshjes midis palës publike dhe asaj private, përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet /partneritetin publik privat. Referuar kësaj pike, projektet propozohen vetëm në formën e propozimeve të kërkuara.

Neni 53

Administrimi i programit të zhvillimit të zonës me qëllim strehimi

1. Ministria përgjegjëse për strehimin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë për përcaktimin e standardeve dhe të modaliteteve të realizimit të programit të zhvillimit të zonës me qëllim strehimin me pronarin e truallit, kur ofrohet nga privati.

2. Njësi e vetëqeverisjes vendore ka kompetencën për të rregulluar përdorimin e tokës në juridiksionin e saj, me qëllim zhvillimin e zonës, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, në

bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për strehimin.

KREU IX PROGRAMI I STREHËVE TË PËRKOHSHME

Neni 54

Strehët e përkohshme dhe rastet e përdorimit

1. Strehët e përkohshme janë objekte ose pajisje që montohen dhe çmontohen lehtë dhe që shërbejnë për strehim të përkohshëm. Me strehim të përkohshëm kuptohet strehimi për një afat deri në dy vjet. Menjëherë me strehimin në strehët e përkohshme, përfituesit e këtij programi duhet të aplikojnë në programet e tjera sociale të strehimit.

2. Strehët e përkohshme shërbejnë për strehimin e:

- a) refugjatëve;
- b) individëve që zhvendosen nga vendbanimi për shkak të fatkeqësive natyrore a njerëzore;
- c) individëve që zhvendosen për shkak të investimeve publike ose private dhe nuk përfitojnë kompensim, vetëm në ato raste kur njësia e vetëqeverisjes vendore dëshmon se nuk disponon asnjë alternativë tjetër strehimi në kuadër të programeve të tjera të strehimit social;
- ç) emigrantëve të rikthyer;
- d) personave të pastrehë, që banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim.

Neni 55

Kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme

1. Strehët e përkohshme vendosen në vende të përshtatshme, të pastra e të sigurta nga përmytjet dhe rreziqe të tjera.

2. Strehët e përkohshme sigurojnë mbrojtjen e duhur nga kushtet atmosferike. Zonat në të cilat instalohen strehët e përkohshme duhet të jenë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme, tualete dhe dushe.

3. Kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për strehimin.

Neni 56

Burimet e financimit të strehëve të përkohshme

1. Strehët e përkohshme financohen me fondet e buxhetit të shtetit, me fondet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet donacioneve e kredive të institucioneve publike ose private, vendase apo të huaja.

2. Sigurimi i strehëve të përkohshme bëhet nga institucionet publike ose private, nëpërmjet ndërtimit, instalimit ose blerjes së objekteve apo pajisjeve.

Neni 57

Administrimi dhe mirëmbajtja e strehëve të përkohshme

1. Ndërtimi, instalimi dhe ngritja e strehëve të përkohshme sigurohen nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me subjektet ose institucionet publike apo private që financojnë ngritjen e tyre.

2. Përcaktimi i institucioneve publike që administrojnë strehët, i kritereve, procedurave dhe kapaciteteve të mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Institucionet publike, të ngarkuara për administrimin e strehëve të përkohshme dhe mirëmbajtjen e tyre, mund të lidhin kontrata me subjekte publike ose subjekte private fitimprurëse ose jofitimprurëse.

4. Procedurat që lidhen me administrimin dhe mirëmbajtjen e strehëve të përkohshme, kompetencat e subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU X PROGRAMI I BANESAVE TË SPECIALIZUARA

Neni 58

Kuptimi dhe qëllimi

1. Banesat e specializuara janë banesat në të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore adresojnë një nevojë specifike strehimi, në të cilat përfshihen banesat për:

- a) të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara;
- b) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
- c) viktimat e dhunës në familje;
- ç) fëmijët, të cilët janë pa kujdes prindëror ose janë marrë në mbrojtje nga institucionet shtetërore dhe që përgatiten për të kaluar në jetën e pavarur, të miturit nga 14–18 vjeç ose të rinjtë nga 18–21 vjeç, pas lirimit ose kryerjes së programeve që lidhen me drejtësinë penale;
- d) vajzat nëna.

2. Kushtet dhe normat e projektimit të banesave të specializuara hartohen nga ministria përgjegjëse për strehimin, në bashkëpunim me ministritë e linjës, dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 59

Banesat e specializuara për të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara

1. Banesat e specializuara sociale për të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme, të përshtatur dhe të aksesueshme për lehtësimin e sigurimin e marrjes së ndihmës së shpejtë mjekësore, si dhe të njoftimit, në raste emergjencash.

2. Banesat e specializuara për të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara jepen në uzufukt, me afat sa jetëgjatësia e përfituesve. Kur kjo kategori nuk ka të ardhura familjare /individuale, atëherë dhënia në uzufukt bëhet pa shpërblim.

3. Për banesat e kësaj kategorie parashikohen në katet e para mjedise të nevojshme për fizioterapi, shërbime mjekësore, shërbime sociale, si dhe mjedise të përbashkëta për jetë komunitare.

Neni 60

Banesat e specializuara për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje

1. Banesat e specializuara për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje pajisen me shërbimin e punonjësve të specializuar socialë dhe u garantohet mbrojtje nga punonjësit e Policisë së Shtetit në rastet e rrezikut për jetën dhe shëndetin.

2. Banesat e specializuara për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme për njoftimin e policisë, në raste rreziqesh ose emergjencash.

3. Banesat e specializuara për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje jepen me qira, duke iu nënshtruar respektimit të kushteve, të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga programi i banesave sociale me qira, i parashikuar në këtë ligj. Këto kategori përfitojnë nga programi i banesave të specializuara derisa t'u sigurohet përfitimi nga një prej programeve të tjera sociale

të strehimit.

Neni 61

Banesat e specializuara për të miturit 14–18 vjeç ose të rinjtë 18–21 vjeç, pas lirimit ose kryerjes së programeve rehabilituese

1. Banesat e specializuara për të miturit nga moshë 14 deri në 18 vjeç, pas lirimit ose kryerjes së programeve rehabilituese, përdoren në rastet kur nga organet kompetente vendoset se rikthimi i tyre në familje rrezikon kryerjen e së njëjtës vepre penale apo të një vepre tjetër penale.

2. Banesat e specializuara për të miturit, sipas pikës 1, të këtij neni, pajisen me shërbimin e kujdestarisë për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të tyre për arsimim, shëndetësi, mirërritje, punësim, me qëllim integrimin dhe rishoqërimin në komunitet.

3. Banesat e specializuara për të rinjtë nga 18–21 vjeç jepen me qira, në rastin kur këta nuk kanë banesë ose kur referohet nga shërbimet sociale dhe shërbimi i provës që të jetojnë veçmas nga familjet e tyre. Në rastin kur të rinjtë nuk janë në marrëdhënie pune, banesa jepet në huapërdorje derisa njësi e vetëqeverisjes vendore të mund të sigurojë punësimin e tyre.

4. Në banesat e specializuara për të miturit dhe të rinjtë, të parashikuara nga ky nen, ofrohet shërbimi i psikologut ose punonjësit social, për të siguruar monitorimin e tyre, me qëllim integrimin dhe rishoqërimin në komunitet.

5. Banesat e specializuara sociale për të miturit (14–18 vjeç) dhe të rinjtë (18–21 vjeç) duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme për njoftimin e policisë në raste rreziqesh ose emergjencash.

Neni 62

Banesat e specializuara për vajzat nëna

1. Banesat e specializuara për vajzat nëna sigurojnë sistemimin në to të vajzave nëna gjatë dhe pas shtatzënisë, derisa fëmija të arrijë moshën 5 vjeç, kur ato janë nëna të vetme, nuk kanë mundësi strehimi, për shkak të mospranimit të gjendjes së tyre nga ana e familjarëve të tyre dhe kur nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të siguruar strehimin.

2. Banesat e specializuara për vajzat nëna duhet të pajisen me shërbimin e nevojshëm shëndetësor, të specializuar për kujdesin dhe mbrojtjen e shëndetit të nënës e të fëmijës dhe infrastrukturën përkatëse, si dhe me shërbimin e psikologut e të punonjësit social.

3. Banesat e specializuara për vajzat nëna jepen në huapërdorje ose uzufrukt pa shpërblim, për një afat deri në 5 vjet, kur vajzat nëna nuk kanë të ardhura, ose me qira, për sa kohë janë të identifikuara si të tilla, duke iu nënshtruar respektimit të kushteve, të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga programi i banesave sociale me qira, të parashikuara në këtë ligj.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa për të ndërthurrur programin e banesave të specializuara edhe me programe për sigurimin e mirërritjes së fëmijës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të kujdesen edhe për punësimin e vajzave nëna dhe sistemimin e fëmijëve të tyre në sistemin parashkollor publik.

5. Pasi fëmija arrin moshën 5 vjeç, vajzat nëna kalojnë nga programi i banesave të specializuara në një program tjetër social, që i përgjigjet gjendjes së tyre ekonomike dhe nivelit të të ardhurave që ato sigurojnë.

Neni 63

Mënyrat e financimit të programit të banesave të specializuara

1. Fondi i banesave të specializuara mund të sigurohet nëpërmjet investimit për ndërtim, blerjes në tregun e lirë ose marrjes me qira nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

2. Banesat e specializuara financohen me fondet e buxhetit të shtetit, të njësive të vetëqeverisjes vendore ose me bashkëfinancim, nëpërmjet donacioneve e kredive të institucioneve publike apo private.

3. Të ardhurat e grumbulluara nga qiratë e banesave të specializuara shkojnë në favor të këtij programi, për mirëmbajtjen e tyre.

Neni 64

Administrimi dhe mirëmbajtja

1. Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave të specializuara bëhen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin kontrata për mirëmbajtjen e banesave të specializuara me entet menaxhuese, si dhe me organizatat jofitimprurëse.
3. Mënyra e administrimit dhe e mirëmbajtjes përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrisë përgjegjëse për strehimin dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, veprimtaria e të cilave ndërthuret me kategoritë që përfshihen në këtë program dhe përfitojnë prej tij.

KREU XI

VERIFIKIMI I GJENDJES EKONOMIKE DHE SOCIALE TË FAMILJES

Neni 65

Mënyra e verifikimit

1. Mbështetja nga buxheti i shtetit dhe buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore për përfituesit nga programet sociale të strehimit jepet pas verifikimit të gjendjes ekonomike e financiare të familjes..
2. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes kryhet nga administratorët shoqërorë, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.

Neni 66

Ankimi

1. Pas verifikimit nga administratorët shoqërorë, strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore njoftojnë zyrtarisht familjen për rezultatet e verifikimit të gjendjes ekonomike.
2. Kundër vendimit të administratorëve shoqërorë individi/familja ka të drejtë të ankohet brenda 10 ditëve nga marrja dijeni e vendimit, pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar një rivlerësim të dytë. Vendimi i rivlerësimit merret nga kryetari dhe i njoftohet ankuesit.
3. Vendimi i rivlerësimit të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të ankimohet në gjykatën kompetente, në përputhje me afatet dhe procedurën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU XII

FINANCIMI I PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT

Neni 67

Burimet e financimit të programeve sociale të strehimit

Programet sociale të strehimit financohen nga:

- a) fondet buxhetore, që jepen çdo vit për programe strehimi nga ministria përgjegjëse për strehimin;
- b) fonde nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- c) kontribute dhe investime nga sektori privat ;
- ç) kontributet nga donatorë të ndryshëm, vendas ose të huaj;

Neni 68

Programet 5-vjeçare të strehimit

1. Strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë programe 5-vjeçare strehimi për popullsinë nën juridiksionin e tyre, duke u mbështetur në analizën e nevojave për strehim dhe në përputhje me strategjinë e strehimit social, sipas parashikimeve të këtij ligji. Ky program miratohet nga këshillat e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Programet 5-vjeçare të strehimit përmbajnë:

a) burimet e financimit, që përfshijnë fonde nga buxheti i shtetit, fondet e siguruar nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe fonde nga burime të tjera, duke përcaktuar origjinën e tyre;

b) nevojat për strehim, sipas parashikimeve të këtij ligji, duke përcaktuar grupet e familjeve sipas të ardhurave dhe gjendjes së tyre sociale;

c) lidhjet e këtij programi me programe të tjera të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe mënyrën e ndikimit të tyre te njëra-tjetra;

ç) masën e rritjes së fondit publik të banesave, brenda një viti financiar, me ndërtesa që do të jepen me qira, uzufrukt ose huapërdorje, si dhe numrin dhe kategoritë e familjeve që do të përfitojnë banesa sociale me qira, uzufrukt ose huapërdorje;

d) numrin e familjeve që do të përfitojnë banesa me kosto të ulët dhe mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;

dh) masën e subvencionimeve nga buxheti i shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në ndihmë të përfituesve për shlyerjen e qirave ose interesave të kredive me kushte lehtësuese;

e) numrin dhe sipërfaqet e trojeve të pajisura me plan zhvillimi, infrastrukturë për ndërtim banesash, numrin dhe llojin e banesave që do të ndërtohen, familjet që do të përfitojnë, formën e bashkëpunimit me sektorin privat, si dhe masën e përqindjen e kontribuesve;

ë) numrin e strehëve të përkohshme dhe të banesave të specializuara që do të ndërtohen ose do të vihen në dispozicion të përfituesve;

f) numrin e banesave ekzistuese ose të reja, që do të përfitojnë nga programi i granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit;

g) numrin e banesave që do të përfitohen si rezultat i zbatimit të programit për zhvillimin e zonave me qëllim strehimit, për banesa sociale;

gj) numrin, vendndodhjen dhe profilin e familjeve që jetojnë në banesa që nuk mund të legalizohen dhe që preken nga investime publike ose private, sipas planeve rregulluese.

Neni 69

Kushtet për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore përfiton nga fondet e investimeve të buxhetit të shtetit për ndërtimin e banesave sociale dhe/ose atyre me kosto të ulët kur:

a) ka vlerësuar nevojat për strehim;

b) ka ngritur strukturën përgjegjëse për menaxhimin e strehimit ose ka përcaktuar përgjegjësitë në një nga strukturat;

c) ka hartuar programin 5-vjeçar të strehimit;

ç) ka parashikuar zonat e ndërtimit të banesave në instrumentin vendor të planifikimit urban;

d) ka dërguar informacionin vjetor me të dhënat, sipas shkronjës “dh”, të pikës 2, të nenit 73, të këtij ligji.

2. Mënyra e aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit miratohen me udhëzim të ministrit të linjës, që ka në dispozicion fondet.

Neni 70

Mënyra e planifikimit

Fondet e buxhetit të shtetit dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për çdo program, ndahen në:

- a) grante konkurruese për investime në ndërtim dhe/ose blerje trualli;
- b) kredi afatgjata për investime në ndërtim dhe/ose blerje trualli;
- c) subvencione për individë ose familje;
- ç) fond për asistencë teknike;
- d) fond për studime në fushën e projektimit e të ndërtimit për programe sociale strehimi.

KREU XIII

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL DHE AFATET E NGRITJES SË KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN E KËTIJ LIGJI

Neni 71

Këshilli Kombëtar për Strehimin

1. Këshilli Kombëtar për Strehimin (KKS) është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për strehimin.

2. Këshilli Kombëtar për Strehimin kryesohet nga ministri përgjegjës për strehimin dhe në përbërje të tij ka 7 anëtarë, prej të cilëve 2 janë anëtarë të ministrisë përgjegjëse për strehimin, 1 anëtar nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, 1 anëtar nga ministria përgjegjëse për çështjet vendore, 1 anëtar përfaqësues nga grupet e interesit dhe shoqëria civile dhe 1 anëtar nga shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Strehimin është 4 vjet, me të drejtë riemërimi.

4. Këshilli Kombëtar për Strehimin mbledhet, të paktën, dy herë në vit dhe në ushtrimin e detyrave të tij mbështetet nga sekretariati teknik pranë ministrisë përgjegjëse për strehimin.

5. Rregulla të hollësishme për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit, si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Këshilli Kombëtar për Strehimin, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për strehimin, këshillon për:

a) linjat kryesore të ndërhyrjes në sektorin e strehimit, sipas objektivave të përcaktuar nga politika e strehimit dhe programet ekonomike kombëtare;

b) plotësimin e nevojave parësore për strehim;

c) kriteret e ndarjes së burimeve të financimit për programet sociale të strehimit, sipas këtij ligji;

ç) këshillon për programet kombëtare 5-vjeçare të strehimit dhe për rishikimin eventual të tyre. Programet kombëtare 5-vjeçare të strehimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 72

Funksionet e ministrisë përgjegjëse për çështjet e strehimit

Në zbatim të këtij ligji, ministria përgjegjëse për strehimin, nëpërmjet strukturës përkatëse:

a) harton strategjinë kombëtare 10-vjeçare të strehimit, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave;

b) përditëson planin e veprimit të strategjisë kombëtare 10-vjeçare të strehimit, në bazë të programeve 5-vjeçare të njësisë të vetëqeverisjes vendore për strehimin;

c) planifikon fondet e buxhetit të shtetit për mbështetjen e realizimit të programeve vjetore të strehimit, bazuar edhe në kërkesat e njësisë të vetëqeverisjes vendore;

ç) informohet për administrimin e kërkesave për strehim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

d) krijon bazën e të dhënave në nivel kombëtar, që përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës

për strehimin, për:

- i) nevojat për strehim, me programe sociale strehimi;
- ii) inventarin e banesave sociale me qira, pronë publike;
- iii) kushtet fizike dhe teknike të banesave sociale me qira;
- iv) numrin e familjeve të strehuara me programet sociale të strehimit;
- v) sipërfaqen e nevojshme të truallit që duhet pajisur me plan zhvillimi dhe infrastrukturë për ndërtim banesash;
- vi) sipërfaqet e trojeve, të pajisura me infrastrukturë për ndërtim banesash;
- dh) përcakton koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave, në kuadër të programeve të këtij ligji, e cila miratohet çdo vit me udhëzim të Këshillit të Ministrave;
- e) përcakton, çdo vit, shpërndarjen e fondeve që financohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera financimi;
- ë) në përputhje me strategjinë 10-vjeçare të strehimit dhe planin e veprimit, drejton dhe ndjek mbështetjen e njësisë të vetëqeverisjes vendore për asistencën teknike, si dhe për studime e kërkime shkencore në fushën e projektimit dhe të ndërtimit për programe sociale strehimi;
- f) mbikëqyr realizimin e investimeve në programet sociale të strehimit me financime ose bashkëfinancime nga buxheti i shtetit;
- g) zbaton programe, sipas këtij ligji, nëpërmjet institucionit publik që themelohet, organizohet dhe funksionon me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 73

Funksionet e njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për zbatimin e politikave të strehimit, sipas programit të parashikuar në këtë ligj.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e programeve të strehimit, sipas këtij ligji, kryen funksionet e mëposhtme:

a) Identifikon nevojat për strehim dhe miraton listat e përfituesve brenda një afati 2-mujor nga data e njoftimit nga ana e subjektit publik ose privat që ofron dhe realizon një nga programet sociale të strehimit, kur ky subjekt nuk është vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji.

b) Harton programe 5-vjeçare për strehimin, bazuar në burimet financiare që zotëron.

c) Planifikon fonde vjetore nga buxheti i saj për mbështetjen e realizimit të secilit program të strehimit, bazuar në kërkesat e qytetarëve.

ç) Evidenton sheshet e ndërtimit dhe përgatit listën e tyre, në zbatim të programeve të strehimit, të hartuara në bazë të këtij ligji.

d) Evidenton banesat në rrezik shembjeje dhe përgatit listën e tyre.

dh) Brenda muajit janar të çdo viti, paraqet pranë ministrit përgjegjës për strehimin kërkesën për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji, nga fondet e buxhetit të vitit korrent, shoqëruar me informacionin, i cili përmban:

i) numrin e familjeve të regjistruara për t'u trajtuar me programet sociale të strehimit;

ii) numrin e familjeve që janë trajtuar brenda një viti;

iii) të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore, që do të përdoren për programet sociale të strehimit në vitin pasardhës, dhe sasinë e fondeve që kërkohet nga buxheti i shtetit, në bazë të programit 5-vjeçar të strehimit;

iv) sipërfaqet e trojeve, të miratuara për programet sociale të strehimit;

v) nivelin e qirasë së miratuar me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

e) Krijon bazën e të dhënave, në nivel vendor, për aplikimet e bëra për programet sociale të strehimit,

sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për strehimin.

ë) Krijon dhe administron, në nivel vendor, bazën e të dhënave për familjet që përfitojnë strehim, sipas këtij ligji.

f) Përcakton kostot maksimale të lejueshme, brenda kufijve të përcaktuar nga ministri përgjegjës për strehimin, për ndërtimin e banesave, sipas këtij ligji.

g) Siguron ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira.

gj) Organizon fushata të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë që ofrohen nga programet sociale të strehimit.

h) Merr masa për publicitetin dhe transparencën e organizimit të procedurave që lidhen me zbatimin e programeve të banesave sociale.

i) Njofton, çdo vit, ministrin përgjegjës për strehimin për ecurinë e programeve të strehimit, sipas këtij ligji.

j) Kryen të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në këtë ligj.

3. Organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë planin e veprimit dhe projektbuxhetin përkatës për zbatimin e programeve afatgjata të strehimit.

4. Kryetari dhe këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të kryejnë, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, detyrimet dhe të përmbushin kompetencat e tyre.

5. Në rastet kur programi i strehimit financohet plotësisht ose pjesërisht me fondet e buxhetit të shtetit dhe njësi e vetëqeverisjes vendore nuk përmbush detyrimin e dakordësuar në marrëveshjen e posaçme, zbatimi i programeve të strehimit për afatin e marrëveshjes i kalon ministrisë përgjegjëse për strehimin.

6. Procedurat për zbatimin e pikës 5, të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

Neni 74

Ngritja e kapaciteteve dhe afatet

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve në këtë ligj, krijon strukturën përgjegjëse dhe të qëndrueshme për zbatimin e këtij ligji, bazuar në burimet financiare e njerëzore në dispozicion të saj.

2. Ministria përgjegjëse për strehimin, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, harton dhe miraton programet e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore, në zbatim të këtij ligji.

3. Ministria përgjegjëse, sipas pikës 2, të këtij neni, në bashkëpunim me institucionet vendase e të huaja dhe në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Strehimit, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, realizojnë fazën e parë të trajnimit për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, pas 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, plotësojnë detyrimet sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 73, të këtij ligji.

KREU XIV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 75

Rimbursimi në rastin e përfitimit të padrejtë

1. Individit/familja që ka përfituar nga programet e strehimit, duke paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, ose në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në këtë ligj, detyrohet të rimbursojë shumën e përfituar padrejtësisht. Pavarësisht nga rimbursimi i kësaj shume, njësi e vetëqeverisjes vendore bën kallëzim penal, kur konstaton se ka elemente të veprës penale.

2. Rimbursimi i shumës së përfituar padrejtësisht, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet sipas kërkesës së njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në rast të mosekzekutimit vullnetar, njësi e vetëqeverisjes vendore paraqet kërkesëpadi në gjykatën kompetente, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin

në fuqi.

Neni 76

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, 13, 14, 16, 21, 30, 35, 37, 45, 46, 48, 51, 52, 57, 58, 71, 73 dhe 77 të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për strehimin, ministri përgjegjës për çështjet vendore dhe ministri përgjegjës për çështjet sociale për nxjerrjen e akteve përkatëse nënligjore, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 77

Dispozita kalimtare

1. Privatizimi i banesave apo objekteve të kthyera në fond banese bëhet bazuar në sipërfaqet e banimit, të përcaktuara për normat e strehimit. Çdo sipërfaqe e përfituar mbi atë të normave të strehimit do të llogaritet me çmim tregu. Këtu përfshihen:

a) banesat, që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", si dhe i ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore", të cilat nuk janë regjistruar në ZVRPP;

b) objektet që kanë mbetur të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura. Përfshihen për ushtarakët dhe ish-ushtarakët e Forcave të Armatosura, sipërfaqja mbi normat e strehimit trajtohet njëjloj si sipërfaqja brenda normave të strehimit.

Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të këtyre objekteve për privatizim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) banesat dhe objektet e kthyera në fond banese me vendime të organeve të vetëqeverisjes vendore, ato që kanë kaluar në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore, si dhe ato që figurojnë ende në pronësi të shtetit, ku, me autorizime të dhëna nga organet kompetente, janë sistemuar me strehim banorët përpara vitit 2004;

ç) banesat dhe objektet e kthyera në fond banese me vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat i kanë kaluar në administrim Entit Kombëtar të Banesave me qëllim privatizimin e tyre.

2. Banesat e ndërtuara me fonde publike nga Enti Kombëtar i Banesave, të cilat deri në fund të vitit 2007 rezultojnë me kontrata të palidhura dhe kanë kaluar në pronësi të organeve të vetëqeverisjes vendore ku ato ndodhen, do të përdoren në funksion të njërit prej programeve sociale të strehimit ose për privatizim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kur këto banesa nuk kanë kaluar në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore, ato mbeten në pronësi të EKB-së dhe do të përdoren në funksion të njërit prej programeve sociale të strehimit ose për privatizim.

3. Rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit, sipas pikave 1 e 2, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Banesat e ndërtuara për familjet e shpërngulura për shkak të ndërtimit të veprave publike, të tilla si Hidrocentrali i Banjës, Hidrocentrali i Fierzës, të cilat ende figurojnë të paprivatizuara, privatizohen falas, me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe sipas listës emërore që kanë trashëguar.

5. Familjeve të shpërngulura për shkak të ndërtimit të veprave publike dhe në pamundësi financiare, të cilat kanë përfituar kredi nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, u falen detyrimet monetare, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

6. Për objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës, kalimi i së drejtës së pronësisë mbi objektin dhe truallin realizohet pa pagesë nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat dhe afatet që ndiqen nga ALUIZNI për kalimin e së drejtës së pronësisë.

7. Banesat e ndërtuara me fonde publike nga Enti Kombëtar i Banesave ose të transferuara nga të tretët tek enti, të cilat nuk janë pajisur me dokument pronësie, trajtohen sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, nga ALUIZNI, dhe regjistrohen në emër të EKB-së. Pas regjistrimit, EKB-ja mund të ndjekë procedurat e privatizimit ose mund t’i përdorë në funksion të programeve sociale të strehimit.

8. Familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, që nuk përfitojnë kredi me interes 0 për qind, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012, trajtohen me prioritet, me një nga programet e strehimit social, të parashikuara në këtë ligj.

9. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe deri në dy vjet pas hyrjes së tij në fuqi, parashikojnë që në programet sociale të strehimit jo më pak se 5 për qind e vendeve nga çdo program, për çdo vit brenda kësaj periudhe, të plotësohen nga familje të komuniteteve rome e egjiptiane. Familjet e komuniteteve rome dhe egjiptiane konsiderohen si kategori prioritare për trajtim nga programet sociale të strehimit për të gjitha kriteret e parashikuara në ligj, si dhe për përparësitë ose pikëzimet e vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zbatim të këtij ligji, deri në dy vjet nga hyrja në fuqi e tij. Me përfundimin e afatit të përcaktuar, ai do të rivlerësohet në përputhje me politikat qeveritare të përfshirjes sociale ndaj këtyre komuniteteve.

10. Programet që janë në proces në zbatim të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, si dhe ato që do të zbatohen me fondet e planifikuara për vitin 2018 dhe 2019, do të trajtohen sipas dispozitave të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 78 **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 79 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 3.5.2018

LIGJ
Nr. 47/2018

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9669, DATË 18.12.2006, “PËR
MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme.

2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar, si dhe të çdo individ, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3, të tij, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje.”.

Neni 2

Në nenin 2, pika 1, shkronja “c”, fjala “gjqësor” zëvendësohet me shprehjen “sistemit gjyqësor”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3
Përkufizimet

Në këtë ligj, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dhunë” është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7, të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

3. “Dhunues/e” është personi i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.

4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Termi “i mitur”, i përdorur në këtë ligj, ka të

njëtin kuptim.

5. “Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

6. “Njësi shtëpiake” është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes.

7. “Pjesëtarë të familjes” janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues;
b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake;

c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit;

ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshttrin/ thjeshtren, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi;

d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit /es ose bashkëjetuesit/es;

dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es;

e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;

ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje;

f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuara dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes.”.

8. “Marrëdhënie intime” është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional.

9. “Viktimë“ është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

10. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit.

11. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

12. “Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme” është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1, të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.”.

Neni 4

Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Legjislacioni i zbatueshëm

1. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

3. Masat e veçanta mbrojtëse, të parashikuara në nenin 10 dhe në nenin 13/1, të këtij ligji, që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kriterëve të parashikuar në këtë ligj.”.

Neni 5

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4
Subjektet

1. Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji, që janë shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekte që mbrohen nga ky ligj janë edhe shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë, dhe të huajt me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt, që përfshihen në kategorinë e subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji.”.

Neni 6

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5
Autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:

- a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- b) ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;
- c) ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
- ç) ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;
- d) ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
- dh) ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit;
- e) ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional;
- ë) njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Lista e autoriteteve të tjera përgjegjëse të linjës, të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, ndryshon nëse njëri prej tyre merr rolin e autoritetit kryesor përgjegjës. Në këtë rast, ky autoritet ka edhe rol kryesor përgjegjës dhe mbulon çështjet në fushën përkatëse.”.

Neni 7

Në nenin 6 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronjat “c”, “ç” dhe “d” ndryshohen si më poshtë:

“c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”, që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore,

strukturat e Policisë së Shtetit, stafit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Trajnimet mund të organizohen në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me Shkollën e Magjistraturës, me Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social ose me organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematika që lidhen me çështje të dhunës në marrëdhëniet familjare, për të gjitha autoritetet përgjegjëse administrative, ligjzbatuese dhe gjyqësore;

d) bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nën-komisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.

Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave për rastet e dhunës në familje bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Botimi i tyre bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për statistikatat zyrtare.

2. Shkronjat “g” dhe “gj” ndryshohen si më poshtë:

“g) harton politikat dhe mbikëqyr marrjen e masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, nëpërmjet vendosjes në përkujdesje alternative ose dhënies së masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

gj) ofrimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në Qendrën Kombëtare të Përkujdesjes Shoqërore për viktimat e dhunës në familje.”.

3. Pas shkronjës “gj” shtohen shkronjat “h” dhe “i” me këtë përmbajtje:

“h) hartimin, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve ose protokolleve, lidhur me vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

i) koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.”.

Neni 8

Në nenin 7 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalja hyrëse e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ka këto detyra:”.

b) Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje, me qëllim rritjen e kapaciteteve në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit dhe me aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj;”.

c) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) miratimin, me udhëzim të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje;”.

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron ndihmën mjekësore në familje, në shërbimet e urgjencës, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.”.

b) Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje;”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë kryen edhe këto detyra:

a) organizon trajnime dhe specializime për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve sociale në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha, në bashkëpunim me urdhrat e ngritur sipas legjislacionit në fuqi;

b) monitoron përbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj, nga ana e personelit mjekësor;

c) parashikon ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave, që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku viktimat trajtohet. Standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”.

4. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalja hyrëse e pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ministria përgjegjëse për drejtësinë ka këto detyra:”

b) Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) merr masa për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbartësve gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;”.

c) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje;”.

ç) Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) mbikëqyr funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;”.

d) Pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç”, “d”, e “dh” me këtë përmbajtje:

“ç) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve;

d) harton formularë të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe publikon këto të dhëna në vjetarin statistikor;

dh) nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë, siguron zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.”.

5. Në pikën 3/1 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja hyrëse e pikës 3/1 ndryshohet si më poshtë:

“3/1. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë, kanë këto detyra:”.

b) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) parashikon programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktimë, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.”.

6. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, kanë këto detyra:

a) angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;

c) ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;

ç) marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;

d) marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës;

dh) bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.”

7. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit, mbështet me financime njësitë e vetëqeverisjes vendore për sigurimin e banesave të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.”

Neni 9

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Garancia për mbrojtjen

1. Çdo organ ose autoritet, që është përgjegjës për të trajtuar dhunën në familje, pranë të cilit drejtohet viktimë, garanton mbrojtje sipas këtij ligji, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës.

2. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.”

Neni 10

Në nenin 8, pika 3, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) hartimit nga punonjësi social për çështjet e dhunës në familje pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe njësisë së vlerësimit të nevojave e referimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të një plani individual të ndërhyrjes që përmban masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës dhe të një raporti për shëndetin mendor e gjendjen psikosociale të viktimës.”

Neni 11

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, shkronjat “j”, “k” dhe “m” ndryshohen si më poshtë:

“j) duke i hequr dhunuesit, përkohësisht, përgjegjësinë prindërore ose, nëse është rasti, kujdestarinë mbi të miturin, kujdestarinë për personin me aftësi të kufizuara, ose për personin që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Kur gjykata vendos të heqë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga të dy prindërit ose nga prindi i vetëm, ajo cakton kujdestarinë e përkohshme mbi fëmijët, duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin e Familjes dhe legjislacionin procedural në fuqi;

k) duke urdhëruar organet kompetente, shërbimet sociale të njëjësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe/ose organizatat që ofrojnë shërbime, që, sipas rastit, të mbështesin me ndihmë psikosociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar në familje, si dhe të monitorojnë respektimin e urdhrave të mbrojtjes nga palët, duke paraqitur raportet përkatëse përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;

m) duke urdhëruar dhunuesin/en, nëse është rasti, të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të aftësimit prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit raportojnë përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij, në mënyrë periodike si dhe në përfundim të programit, në të cilin të përfshihen rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit. Nëse dhunuesi/ja nuk merr pjesë në program, atëherë, me kërkesë të mbledhjes *ad-hoc* të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje ose të subjekteve të parashikuara nga neni 13, i këtij ligji, zbatohen dispozitat e Kodit Penal, për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për urdhrat e mbrojtjes.”

2. Pas shkronjës “m” shtohet shkronja “m/1” me këtë përmbajtje:

“m/1) duke urdhëruar të paditurin ose dhunuesin/en, nëse është rasti, të marrë pjesë në programe rehabilitimi, pranë qendrave spitalore, qendrave ambulatorë ose qendrave komunitare, që japin shërbime të shëndetit mendor, shërbime të alkoologjisë ose shërbime të toksikologjisë. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit vënë në dijeni koordinatorin vendor pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje për pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij.”

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me këtë përmbajtje:

“3/1 Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj.

3/2 Vendimi për zgjidhjen e martesës, i shpallur nga gjykata gjatë kohës së zbatimit të UMM/UM-së për pasojat e njëkohshme, fillon të zbatohet nga dita e përfundimit të UMM/UM-së. Në rast se gjykata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët.”

Neni 12

Në nenin 11, pika 1, fjalët “përmban masat e mësipërme”, zëvendësohen me fjalët “përmban masat e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji”.

Neni 13

Në nenin 12, pika 1, fjalët “gjykata e rrethit gjyqësor, seksion familjar”, zëvendësohen me fjalët “gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë”.

Neni 14

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 13/1

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

1. Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake të mbrojtjes së viktimës/ave dhe për ndalimin e dhunës.

2. Në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohen një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) urdhërimi i dhunuesin/es që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;

b) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;

c) ndalimi menjëherë i dhunuesin/es, që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;

d) urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës “ç”, të kësaj pike;

dh) urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;

e) bllokimi i çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo sekuestrimi i çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

3. Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna sipas procedurës dhe modelit, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

Një kopje e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme i njoftohet menjëherë koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

4. Në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

5. Brenda 48 orëve nga marrja e masave, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

6. Të drejtën për të kërkuar vlerësimin e urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme përpara gjykatës e ka edhe viktimat dhe subjektet e parashikuara nga neni 13, pika 3, e këtij ligji, brenda 48 orëve, nga dita e lëshimit të tij.

7. Gjykata, 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos:

a) vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) anulimin e urdhrimit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar.

8. Gjykata, për nevoja të gjykimit, mund të thërrasë përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatorin vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime.”.

Neni 15

Në nenin 14 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pikat 3, 4 e 5 ndryshohen si më poshtë:

“3. Për hartimin e kërkesëpadisë, përgatitjen e akteve dhe përfaqësimin në procesin gjyqësor, kërkuesi asistohet nga një avokat që ofron ndihmën juridike detyësore, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

4. Kërkuesi i UMM/UM-së dhe mbajtësi i UPMM-së përjashtohen nga:

a) pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

b) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

c) pagimi i akteve të ekspertimit psikosocial, të interpretimit të gjuhës së shenjave, të ekspertimit mjeko-ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje ose të ndonjë akti ekspertimi tjetër.

Pas lëshimit të UMM/UM-së, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.

5. Kërkesëpadia regjistrohet në një regjistër të veçantë, protokollohet ditën e dorëzimit të saj dhe hidhet në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.”.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Gjykata, në vendimin e lëshimit të urdhrimit të mbrojtjes, vendos edhe për rastet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni.”.

Neni 16

Në nenin 15 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjalja e fundit e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të parashikuar në këtë pikë, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të viktimës, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës publike, që e disponojnë atë.”.

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1 Moslëshimi i dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personit përgjegjës, bazuar në dispozitat e legjislacionit të posaçëm.”.

Neni 17

Në nenin 16, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Gjykata vendos për lëshimin e urdhrimit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.”.

Neni 18

Në nenin 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1 Gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me pajtim ose ndërmjetësim.”.

2. Në pikën 3, shkronja “ç” shfuqizohet.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbarrimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim.”.

Neni 19

Në nenin 20, fjalia hyrëse e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Gjykata kryen seancën, sipas nenit 16, të këtij ligji, jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata.”.

Neni 20

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes dhe vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankimi. Ankimi paraqitet brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose nga dita e marrjes dijeni. Gjykata e apelit vendos brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Kundër vendimit të gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nuk lejohet ankimi nga viktimat.”.

Neni 21

Në nenin 23 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. Së bashku me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit të tij. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përmbarrimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1 Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrin të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji dhe/ose në vendimin e gjykatës, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me

vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes.”.

4. Pikat 2 dhe 5 shfuqizohen.

Neni 22

Kudo në ligj, fjalët “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB)” zëvendësohen me fjalët “ministra përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje”.

Neni 23

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për shëndetësinë që, brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7, pika 2/1, shkronja “c”, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike dhe ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje që, brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 1, shkronja “b/1” dhe nenit 13/1, pika 3, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për drejtësinë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor që, brenda katër muajve nga krijimi i këtij të fundit, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim nenit 7, pika 3, shkronja “ç”, të këtij ligji.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10851, datë 31.7.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 57/2019

PËR ASISTENCËN SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore;
- b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre;
- c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura;
- ç) mirorganizimin dhe mirëfunktionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale, me përjashtim të kufizimeve të vendosura në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 4
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Administrator shoqëror”, është nëpunësi i organeve të vetëqeverisjes vendore, i cili vlerëson, verifikon dhe administron procesin dhe dokumentacionin për aplikimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe përfitimeve të tjera;

b) “Azilkërkues”, është çdo i huaj apo person pa shtetësi, që shpreh, në çfarëdo mënyre, se nuk dëshiron të kthehet në vendin e tij, si dhe çdo i huaj apo person pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë;

c) “Bashki/njësi administrative”, është institucioni nën juridiksionin e të cilit personat përfitues, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar mbështetje me të ardhura monetare ose/dhe në natyrë, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe për të kërkuar mbështetje për adresimin e situatës së tyre social-ekonomike drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore, të punësimit, strehimit;

ç) “Burime jetese”, janë të gjitha mjetet monetare, asetet ose të ardhurat në natyrë që bëjnë të mundur jetesën;

d) “Familje”, është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, marrëdhënie prindër-fëmijë, marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, të cilët jetojnë në të njëjtën strehë;

dh) “Familje kujdestare”, është një familje alternative, sipas përkufizimit të dhënë në Kodin e Familjes;

e) “Fëmijë”, është çdo person nën moshën 18 vjeç dhe, në rastin kur moshja e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;

ë) “Formula e unifikuar e pikëzimit”, është një formulë e pranueshmërisë së individëve, familjeve për ndihmë ekonomike, që përdor koeficientë dhe ndryshore të përcaktuara qartë, të cilët dalin nga lidhjet reciproke, objektive, me statusin ekonomik dhe me varfërinë;

f) “Invalid pune”, është individ, i cili është deklaruar i tillë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfiton nga ligji për Statusin e Invalidëve;

g) “Individ në nevojë”, është personi fizik që është jetim, viktimë e trafikimit, viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare;

gj) “Jetim”, është fëmija deri në moshën 25 vjeç, sipas përcaktimit të bërë në ligjin për Statusin e Jetimit;

h) “Kryefamiljar”, është personi i parë sipas renditjes në certifikatën familjare;

i) “Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar”, është një ekip i përzgjedhur, i përbërë nga një mjek dhe një punonjës social, të cilët janë të punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit bio-psiko-social të aplikuesve për përfitimet në para dhe/ose në natyrë për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura nga institucionet shëndetësore, informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara, verifikimin dhe shkëmbimin e informacionit me institucione të tjera sociale, arsimore, shëndetësore, të punësimit e formimit profesional;

j) “Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale”, është ministria që, ndër të tjera, ka në fushën e veprimtarisë së vet çështjet e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar;

k) “Ndihma ekonomike”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;

l) “Ndihmësi personal”, është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme;

ll) “Përfitime në natyrë”, është mbështetja me mallra ushqimore dhe të përdorimit të përditshëm e në veshmbathje, që u jepen familjeve dhe individëve në nevojë sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;

m) “Pagesë për personat me aftësi të kufizuar”, është pagesa mujore në lekë që u jepet personave me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimit të këtij ligji;

n) “Person me aftësi të kufizuar”, janë individët, të cilët kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime, që, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore e të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të tyre në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët, siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar;

nj) “Person paraplegjik”, është çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme;

o) “Person mbi moshë pune”, është një person fizik, i cili, në çastin e vlerësimit të kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike, është mbi moshën e përcaktuar për atë vit për të drejtën e pensionit, sipas ligjit për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

p) “Riintegrimi social”, është tërësia e veprimtarive të integruara në pagesa dhe shërbime, që synojnë fuqizimin ekonomik e social të përfituesve të ndihmës ekonomike nëpërmjet punësimit;

q) “Refugjat”, është i huaji apo personi pa shtetësi, sipas përcaktimeve në legjislacionin për azilin në Republikën e Shqipërisë;

r) “Regjistri elektronik kombëtar i ndihmës ekonomike”, është bashkësia e të dhënave të përfituara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të ndihmës ekonomike gjatë procesit të aplikimit të familjeve/individëve në nevojë për përfitim të ndihmës ekonomike;

rr) “Regjistri elektronik kombëtar i aftësisë së kufizuar”, është bashkësia e të dhënave të përfituara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të aftësisë së kufizuar gjatë procesit të aplikimit për vlerësim dhe përfitim të aftësisë së kufizuar;

s) “Status i refugjatit”, është njohja nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë i shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi si refugjat, sipas përcaktimeve në ligjin për azilin në Republikën e Shqipërisë;

sh) “Të ardhura të familjes”, janë të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes, nga çdolloj burimi, përfshirë dhe të ardhurat nga remitancat. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin anëtarët e familjes me aftësi të kufizuar dhe invalidë pune;

t) “Person tetraplegjik”, është çdo person që vuan nga paraliza e katër anësive;

th) “Vendbanim”, është vendi ku familja ose personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë ose të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose në më të shumtën e kohës;

u) “Vendqëndrim”, është vendi ku banohet për një kohë të caktuar, për arsye pune, studimi, trajtimi mjekësor, pushimi, shërbimi të detyruar ushtarak apo vuajtjeje dënimi, si dhe raste të tjera të kësaj natyre;

v) “Veprim i qëllimshëm”, është çdo veprim që synon të shmangë punësimin e shpërblyer, kualifikimin për punësim dhe mundësi punësimi, shërbimet rehabilituese shëndetësore dhe/ose sociale, mospërdorimin e kapitalit atje ku është mundësia për të siguruar mjetet e domosdoshme të jetesës, deklarin real të të ardhurave si dhe çdo veprim që nxit ndarjen e familjeve, që vërtetohet se kanë të njëjtën strehë, për përfitim nga ndihma ekonomike;

x) “Viktimitë e trafikimit”, është personi fizik, që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore;

xh) “Viktimitë e dhunës në marrëdhëniet familjare”, është çdo person, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, për të cilin është lëshuar urdhër mbrojtjeje ose urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje me vendim të gjykatës;

y) “Vlerësimi bio-psiko-social”, është një proces vlerësimi i faktorëve të ndryshëm e të ndërvarur, që përcaktojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët. Këta faktorë janë: struktura trupore, funksionet trupore e psikologjike si dhe faktorë personale, shoqërore, ekonomike e kulturore.

z) “Remitancë”, janë transfertat neto pa kundërshtëpërblim nga jashtë vendit.

Neni 5 Parime të përgjithshme

Parimet bazë, në bazë të të cilave funksionojnë programet e asistencës sociale janë:

a) universaliteti është parimi që përcakton se asistenca sociale është krijuar, funksionon dhe mbikëqyret bazuar në një sistem rregullash ligjore, që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit, të cilët ndodhen në të njëjtat kushte;

b) drejtësia sociale është parimi që përcakton se çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë, dhe çdokush ka detyrimin të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë, që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre;

c) mbështetja sociale është parimi që përcakton se individët/familjet, të cilët përmbushin kushtet për të përfituar, kanë të drejtën e përfitimit në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për atë kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë;

ç) respektimi i të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit, është parimi që përcakton ofrimin i shërbimeve të asistencës sociale që bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, të integritetit të individit, besimit fetar dhe formimit të gjithanshëm të tij;

d) mosdiskriminimi është parimi që përcakton të drejtat që burojnë nga ky ligj pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër;

dh) konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale është parimi që përcakton se të dhënat personale të individit janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

e) barazia është parimi që përcakton se mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara etj.;

ë) partneriteti është parimi që siguron koordinimin e strukturave qendrore, qeverisjes rajonale e vendore si dhe me partnerë të tjerë në komunitet.

KREU II PËR FITUESIT E ASISTENCËS SOCIALE

Neni 6 Asistenca sociale

Asistenca sociale përfshin, por nuk kufizohet në, ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe përfitime të tjera, që garantohen nga ky ligj.

Neni 7 Përfituesit e ndihmës ekonomike

Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;

b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;

c) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;

d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Neni 8

Përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar

Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshja;

b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;

ç) personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës.

Neni 9

Përfitues i ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi i bebes)

1. Përfitues të ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi i bebes) për foshnjën e porsalindur janë prindi/prindërit e fëmijës.

2. Masa dhe procedura e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të shërbimit spitalor dhe atyre të gjendjes civile përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Përfitues të ndihmës personal

Personat përfitues, që përcaktohen në gerrat a, b, dhe c, të nenit 8, të këtij ligji, të cilët, me vendim të komisioneve të vlerësimit, të parashikuar nga ky ligj, përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një ndihmë personal me pagesë.

Neni 11

Personat jopërfitues

Nga ky ligj nuk përfitojnë:

a) shtetasit shqiptarë, që banojnë jashtë vendit si emigrantë, me përjashtim të përfituesve sipas pikës 1 të nenit 9, të këtij ligji;

b) azilkërkuessit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilantit, dhe refugjatët, të cilët nuk kanë marrë statusin e refugjatit;

c) shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe e luftërave, në përputhje me ligjin për të huajt;

ç) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe e luftërave, për përfitim të ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar;

d) personat, që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuajnë dënimin me heqje lirie, dhe personat, që trajtohen me mjekim të detyruar me vendim gjykate në institucione mjekësore të posaçme, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;

dh) personat që trajtohen në institucionet e përkujdesjes rezidenciale publike, të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit, për masën e ndihmës ekonomike apo pagesën për aftësinë e kufizuar.

KREU III LLOJET E PËRFITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS SOCIALE

Neni 12

Pagesa e ndihmës ekonomike

1. Ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike bëhet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndihmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe individët e përcaktuar në nenin 7, të këtij ligji.

3. Familjet dhe individët në nevojë kanë të drejtë të marrin përfitime në natyrë. Mënyra e përfitimeve në natyrë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Fëmijët e familjes në nevojë, të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe jetimët, të cilët nuk janë në institucione që ndjekin arsimin e detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, marrin një pagesë shtesë, deri në mbarimin e arsimit të detyrueshëm, në masën e përcaktuar me vendim nga Këshilli i Ministrave.

5. Fëmijët e familjes në nevojë, si dhe jetimët, që nuk janë në institucione, të cilët janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinimit, marrin një pagesë shtesë, për çdo vaksinë të kryer, në masën e përcaktuar me vendim nga Këshilli i Ministrave.

6. Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuar, invalid pune apo individ përfitues i ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve në nenin 7, të këtij ligji, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

7. Anëtarit të familjes në nevojë, që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuan dënimin me heqje lirie ose që trajtohet me mjekim të detyruar me vendim gjykate, në institucionet mjekësore të posaçme, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

8. Procedura, dokumentacioni dhe masa mujore e përfitimit të ndihmës ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Masa e ndihmës ekonomike, për familjet në nevojë, përcaktohet sipas strukturës së familjes dhe shkon deri në 150 për qind e masës së pensionit social dhe e indeksuar.

9. Ministri përgjegjës për Çështjet Sociale nxjerr udhëzim për mënyrën e përlllogaritjes së masës së ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.

Neni 13

Pagesa e aftësisë së kufizuar

Pagesa për personat me aftësi të kufizuar jepet çdo muaj për këta individë dhe për ndihmësit personalë të tyre, në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Pagesa për ndihmën e menjëhershme financiare

Pagesa që jepet për nënat me foshnja të porsalindura si ndihmë e menjëhershme financiare, për të garantuar asistencë sociale, jepet vetëm një herë, në masën dhe sipas procedurës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

KRITERET DHE PROCEDURA E PËRFITIMIT NGA PROGRAMET E ASISTENCËS SOCIALE

Neni 15

Përrjashtimi nga ndihma ekonomike

1. Përrjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm, që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes që jetojnë në të njëjtën strehë, kur nuk krijohet një kurorë e re, me përrjashtim të rastit vajzë-nënë;

b) nuk tërheq ndihmën ekonomike brenda afateve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me përrjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si shëndetësore apo fatkeqësi;

c) refuzon verifikimin e situatës social-ekonomike në familje;

ç) fsheh informacionin apo kryen deklaram të rremë;

d) nuk paraqiten për deklaram dhe/ose nuk deklarojnë ndryshimet e situatës social-ekonomike çdo tre muaj pranë administratorit shoqëror, me përrjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si shëndetësore apo fatkeqësi, dhe të anëtarëve të familjes, të cilët janë persona me aftësi të kufizuar, invalidë pune ose të moshuar, të cilët janë në pamundësi lëvizjeje;

dh) refuzojnë përrfshirjen në kurset e formimit profesional për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

e) kanë anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përrjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim dhe banojnë në fshat;

ë) anëtarët në moshë aktive pune, të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përrjashtim të familjeve që kanë anëtarë, që ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, por jo më shumë se deri në moshën 25 vjeç.

2. Përrjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë njëvjeçare familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre qoftë edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) është në moshë aktive pune dhe refuzon ofertat e përrshtatshme për punë të zyrave të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

b) punësohen dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, me përrjashtim të rasteve kur zgjidhja e kontratës bëhet nga ana e punëdhënësit;

c) ka kryer më shumë se një deklaram të rremë;

ç) ato familje, të cilat rezultojnë me të ardhura dhe kushte të mira social-ekonomike.

Neni 16

Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike

1. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet nga:

a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e;

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë;

c) nga vetë individi, sipas përcaktimeve në shkronjat “b”, “ç” e “d”, të nenit 7.

2. Aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin.

Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe masa e përfitimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet formulës së pikëzuar, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj nga bashkia nëpërmjet shërbimit bankar dhe/ose shërbimit postar, bazuar në vendimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

5. Të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike për familjet në nevojë e ka bashkëshortja e kryefamiljarit. Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, të drejtën e tërheqjes e ka kryetari i familjes.

Neni 17

Përfitimi i pagesës nga personat me aftësi të kufizuar

1. Përfitimi i pagesës nga personat me aftësi të kufizuar bëhet në bazë të vendimit të komisioneve të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji, të cilat vlerësojnë aftësitë e kufizuara sipas kompetencës së tyre. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. PAGESA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR shpërndahet një herë në muaj nga bashkia, nëpërmjet shërbimit bankar dhe/ose shërbimit postar, bazuar në vërtetimin për vendimin e marrë nga komisioni që ka kryer vlerësimin e aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve për çdo kategori të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.

3. Përfitimi i pagesës nga personat me aftësi të kufizuar ndërpritet kur:

a) personi refuzon të kryejë ekzaminimet e kërkuara;

b) dokumentacioni për rivlerësim nuk paraqitet sipas afateve të përcaktuara në rregulloret e organizimit, të drejtave, detyrave dhe funksionimit të komisioneve të vlerësimit;

c) personi nuk paraqitet në komision epror dy herë radhazi dhe refuzon të kryejë ekzaminimet e kërkuara/mjekimin e rekomanduar/marrjen e shërbimit të rekomanduar;

ç) vërtetohet që personi nuk është rezident në Shqipëri;

d) personi ka qëndruar për më shumë se tre muaj jashtë Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për arsye shëndetësore.

Neni 18

Përfitimi nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor

Përfituesit e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

KREU V
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË ASISTENCËS SOCIALE

Neni 19

Roli i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale

1. Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të programeve dhe legjislacionit, programimin e fondeve për programet e asistencës sociale, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore.

2. Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale propozon mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, për të siguruar riintegrimin social të tyre, nëpërmjet një programi daljeje nga skema e ndihmës ekonomike, e cila përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale grumbullon të dhëna statistikore, me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të asistencës sociale. Përmbajtja, që do të kenë treguesit statistikorë të vlerësimit e monitorimit, që do të mbledhen, dhe periodiciteti i mbledhjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale harton dhe paraqet nevojat për fonde për programet e asistencës sociale pranë Ministrisë përgjegjëse për Financat.

Neni 20

Roli i Shërbimit Social Shtetëror

1. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror e rajonal, është institucion publik në varësi të Ministrisë përgjegjëse për Çështjet Sociale.

2. Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit Social Shtetëror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror e rajonal, përgjigjet për zbatimin e politikave të asistencës sociale të Ministrisë përgjegjëse për Çështjet sociale, si më poshtë:

a) programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për asistencën sociale;

b) administrimin dhe përdorimin e të dhënave të Regjistrit Elektronik Kombëtar, i cili përfshin aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar;

c) kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale, në kuptim të këtij ligji, në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. Procedura e kryerjes së kontrollit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) grumbullimin dhe përpunimin e informacioneve dhe të statistikave;

d) bashkëpunimin e vazhdueshëm me Shërbimin Kombëtar të Punësimit për riintegrimin social të anëtarëve të familjeve në nevojë, të cilët janë në moshë aktive pune.

4. Shërbimi Social Shtetëror në nivel rajonal, për realizimin e procesit të vendimmarrjes për përfituesit e ndihmës ekonomike, ka këto përgjegjësi:

a) verifikon të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë në Regjistrin Kombëtar Elektronik dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse;

b) merr vendim për caktimin e familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, masën e përfitimit të tyre si edhe refuzimin e kërkesës për dhënie të përfitimit të ndihmës ekonomike të shoqëruar me arsyet e refuzimit;

c) i dërgon vendimin kryetarit të bashkisë:

- i) për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;
- ii) për të kryer veprimet financiare për pagesën për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Neni 21

Roli i këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Familjet në nevojë trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, duke përfshirë ose jo edhe fonde të buxhetit vendor. Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Roli i strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, për efekt të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, kryen këto detyra:

a) dërgon nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë nën juridiksionin e bashkisë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për trajtim me ndihmë ekonomike;

b) përgatit listën e plotë dhe masat e përfitimit për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar për ekzekutimin e tyre;

c) harton kërkesën për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës për ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuar.

ç) grumbullon dhe përgatit informacione e statistika, të cilat i dërgon pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, mban regjistrin e përfituesve dhe ndjek shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar;

d) monitoron punën e administratorit shoqëror, për të shmangur veprime të kryera nga ana e tij në kundërshtim me këtë ligj;

dh) bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me zyrat vendore të punësimit për riintegrimin social të anëtarëve të familjeve në nevojë, të cilët janë në moshë aktive pune.

Neni 23

Roli i administratorit shoqëror të njësisë administrative

Administratorët shoqërorë në njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë:

a) të identifikojnë familjet dhe individët në nevojë dhe t'i ftojnë e t'i informojnë për aplikim për ndihmë ekonomike;

b) të plotësojnë aplikimin për familjet dhe individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar;

c) të verifikojnë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren gjendjen social-ekonomike për familjet që aplikojnë për herë të parë dhe, dy herë në vit, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike. Verifikimi për familjet që aplikojnë për herë të parë kryhet brenda muajit të aplikimit. Të dhënat e verifikuara nëpërmjet vizitave në familje hidhen në Regjistrin Elektronik Kombëtar;

ç) të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike;

d) të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki listën e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe masat e përfitimit, në bazë të vërtetimeve të

vendimeve të komisioneve të vlerësimit dhe të dokumentacionit për përfitime të tjera shtesë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) të përcjellin dokumentacionin për vlerësimin e aftësisë së kufizuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;

e) të evidentojnë dhe të verifikojnë rastet e personave që përfitojnë në kundërshtim me germën a, të nenit 11, të këtij ligji, të kryejnë verifikime jo më pak se një herë në tre muaj, të informojnë strukturat përgjegjëse të shërbimit social shtetëror për të kryer verifikimet me institucione të tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre, kur kanë dijeni;

ë) të ndërpresin pagesën e aftësisë së kufizuar për personat që përfitojnë në kundërshtim me germën a, të nenit 11, të këtij ligji, në bazë të verifikimit të kryer nga strukturat përgjegjëse të shërbimit social shtetëror në nivel rajonal;

f) të administrojnë dokumentacionin për përfitimin e pagesave të personave me aftësi të kufizuar;

g) të hartojnë kërkesën për bllok-ndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për njësinë e vetëqeverisjes vendore;

gj) të grumbullojnë e të hartojnë informacione dhe statistika për ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe t'i raportojnë ato pranë bashkisë;

h) të bashkërendojnë informacionin lidhur me familjet përfituese me administratorët e tjerë shoqërorë të njësisë të vetëqeverisjes vendore;

i) të informojnë dhe të udhëzojnë komunitetet lidhur me skemën e ndihmës ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuar, me anë të fushatave të ndryshme informuese;

j) të bashkëpunojnë me punonjësit socialë, që janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për kategoritë përfituese të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në nenin 36, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";

k) të adresojnë rastet e individëve/familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore e të punësimit, me qëllim rehabilitimin dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore.

KREU VI FINANCIMI I PROGRAMEVE TË ASISTENCËS SOCIALE

Neni 24

Financimi i programeve të asistencës sociale

Programet e asistencës sociale për ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi i bebes) financohen nga buxheti i shtetit.

Neni 25

Programimi i fondeve

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale programon fondet për ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar në përputhje me vlerësimin e kërkesave të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe i detajon që në fillim të vitit për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore. Planifikimi i fondeve përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për Çështjes Sociale.

2. Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale programon fondet për ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura çdo fillim viti.

Neni 26
Transferimi i fondeve

1. Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale transferon çdo dy muaj fondin e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar në bashki.

2. Transferimi i fondeve për ndihmën e menjëhershme financiare të nënave me foshnja të porsalindura bëhet në bankat e nivelit të dytë.

Neni 27
Kontrolli i fondeve

Kontrolli për përdorimin e fondeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe mbështetjes financiare për foshnjat e porsalindura bëhet nga organet e specializuara të kontrollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

KREU VII

SANKSIONET DHE PROCEDURA E ANKIMIMIT

Neni 28
Sanksionet

1. Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 20, 22 dhe 23, të këtij ligji, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, kur nuk përbëjnë vepër penale,:

a) përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative;

b) ndëshkohen me masë disiplinore, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil ose Kodit të Punës.

2. Struktura përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, për pagesën për personat me aftësi të kufizuara në Shërbimin Social Shtetëror, në nivel qendror dhe/ose rajonal, për shkeljet përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, konstaton kundërvajtjen administrative dhe i propozon, për shkelësit, kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore/Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror vendosjen e:

a) gjobës, nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë;

b) masës disiplinore;

c) shpërblimit të dëmit, nëse është shkaktuar një i tillë.

Neni 29
Ankimi

1. Aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë dhe personi me aftësi të kufizuar, kur gjykon se i është shkelur një e drejtë e garantuar nga ky ligj, mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njësisë administrative brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar, që pretendon se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 30

Vlerësimi bio-psiko-social i aftësisë së kufizuar

Në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat zbatohet modeli bio-psiko-social i vlerësimit të aftësisë së kufizuar me komision vlerësimi shumëdisiplinor për personat që kërkojnë të vlerësohen/rivlerësohen për aftësinë e kufizuar dhe përdoret regjistri elektronik kombëtar, ndiqen këto procedura:

a) kërkesa dhe dokumentacioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar paraqiten pranë zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, e cila hedh të dhënat e aplikuesit në Regjistrin Elektronik Kombëtar, administron dokumentacionin, kryen verifikimin dhe vlerësimin e individëve dhe merr vendimin për aftësinë e kufizuar;

b) drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror pajis me dokumentin përkatës personin me aftësi të kufizuar dhe i dërgon kryetarit të bashkisë vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar me qëllim kryerjen e veprimeve financiare;

c) masa, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për vlerësimin e përfitimin e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmës personal, si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 31

Dispozita kalimtare

1. Përdorimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të të dhënave për aplikuesit e përfituesit të pagesës së aftësisë së kufizuar bëhet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 32

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, pika 2; 12, pikat 1, 3, 4, 5 e 8; 13, pika 1; 14; 15, pika 1, shkronja "b"; 16, pikat 2 e 3; 17, pika 1; 19, pikat 2 e 3; 20, pikat 2 e 3, shkronja "c"; 21; 30, shkronja "c"; dhe 31, pika 1.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për Çështjet Sociale, që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë udhëzimet në zbatim të neneve 12, pika 9, dhe 25, pika 1, të këtij ligji.

Neni 33

Shfuqizime

Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me të shfuqizohet.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 18.7.2019.

Shpallur me dekretin nr.11244, datë 30.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

UDHËZIM
Nr.2365, datë 26.11.2008

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.277, DATË 18.6.1997 “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

1. Personat që plotësojnë kërkesat e ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, duhet të paraqesin kërkesën e tyre për trajtim pranë seksionit të ndihmës ekonomike dhe të perkujdesit shoqëror, në njësinë administrative ku ata janë banorë të regjistruar sipas gjendjes civile.

2. Krahas kërkesës për trajtim, pretenduesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e tjera si më poshtë:

a) Certifikatë personale me fotografi, e cila ripërtërihet çdo fillim viti.

b) Vendimin mjekësor të lëshuar nga KMPV, kur personi është komisionuar pas 1 janarit 2001 apo vendimi mjekësor i lëshuar nga KMCAP para 1 janarit 2001, në të cilin të jetë përcaktuar:

i) Shkalla e paaftësisë (grupi i parë ose i dytë);

ii) Përqindja e shikimit;

iii) Nevoja për kujdestar.

c) Kopjen e librezës së punës të noterizuar ose vërtetimin e arkivit, kur ai ka qenë në marrëdhënie pune me kooperativën bujqësore.

d) Deklaratën noteriale mes të verbrit dhe kujdestarit, si dhe adresën e kujdestarit.

e) Certifikatën familjare, kur kujdestari i të verbrit është pjesëtar i familjes.

f) Certifikatën e kujdestarit me fotografi, kur kujdestari është i zgjedhur jashtë familjes.

3. Si kujdestar i personit të verbër mund të jetë prindi i tij, një pjesëtar tjetër i familjes ose person i zgjedhur nga i verbri, me kusht që kujdestari të ketë zotësi të plotë për të vepruar. Kujdestari duhet të pajiset me raport mjekësor, i cili duhet të përsëritet çdo vit.

4. Nëse personi i verbër nuk ka zotësi të plotë për të vepruar, kujdestari i të verbrit zgjidhet nga prindi ose kujdestari ligjor, në ngarkim të të cilit është i verbëri. Kur prindërit janë të divorcuar kujdestari përcaktohet nga prindi, të cilit, me vendim gjykate, i është dhënë përgjegjësia prindërore ndaj tij.

5. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, sipas përcaktimit të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, (i ndryshuar) është 8700 lekë në muaj. Masa e përfitimit për kujdestarinë është e njëjtë, pra 8700 lekë në muaj.

6. PAGESA E PËRFITIMIT PËR SHKAK TË VERBËRISË, SI DHE AJO E PËRFITIMIT TË KUJDESTARISË BËHET ÇDO MUAJ. Tërheqja e pagesës mund të bëhet nga:

a) vetë i verbri; ose

b) kujdestari me dokument identiteti ose certifikatë me fotografi.

Kur i verbri dhe kujdestari i tij nuk paraqiten në muajin përkatës për të tërhequr pagesën, atëherë pagesa mund të tërhiqet nga një pjesëtar tjetër i familjes i pajisur me prokurë të posaçme për këtë veprim.

7. Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurse kualifikimi, vetëm për një shkollë, përfitojnë dyfishin e pagesës së përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, i ndryshuar, pra në masën 17 400 lekë në muaj.

8. Studentët e verbër të shkollave të larta, ose që përfshihen në studimet pasuniversitare, ose të verbrit që kanë mbrojtur gradën “Doktor i shkencave”, përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 (i ndryshuar), në masën 26 100 lekë në muaj.

9. Për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, të verbrit nxënës, që vazhdojnë shkollat e mesme, të larta dhe studimet pasuniversitare, kanë të drejtë të marrin pagesën e verbërisë deri në përfundimin e ciklit shkollor. Pagesa që përfiton i verbri për gradën “Doktor i shkencave”, është e përhershme.

10. Të verbrit që vazhdojnë shkollën e mesme, të lartë, studimet pasuniversitare, për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, duhet të paraqesin këto dokumente:

a) Vërtetim të firmosur nga titullari dhe sekretari i shkollës, i cili të përmbajë emrin e përfituesit, llojin e arsimit që ndjek, vitin shkollor, nëse është cikël normal me korrespondencë apo i përsëritur.

b) Vërtetim të formosur nga titullari dhe sekretari i shkollës për frekuentimin e shkollës nga përfituesi për çdo 3 muaj, për të verbrit që vazhdojnë shkollën me korrespondencë të paraqitet vërtetim që ka shlyer detyrimet para çdo sezoni.

c) Kopjen e noterizuar të dëftesës së shkollës të çdo viti për shkollën e mesme dhe kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së lartë.

11. Të verbrit që ndjekin kurset e kualifikimit, për përfitimin e pagesës për shkak të verbërisë, duhet të paraqesin këto dokumente:

a) Vërtetim nga institucioni që organizon kursin, ku të jetë përcaktuar emri i kursantit, lloji i kursit dhe kohëzgjatja e tij;

b) Vërtetim për frekuentimin e kursit, kur ai zgjat mbi 6 muaj, vërtetimi paraqitet çdo 3 muaj;

c) Kopja e noterizuar e dëshmisë së kursit në mbarim të tij.

12. Të verbrit që kanë fituar gradën “Doktor i shkencave”, duhet të paraqesin si dokument shtesë origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton dhënien e gradës shkencore.

13. Të gjithë personat e verbër që kanë punuar në ndërmarrje shtetërore ose kooperativa bujqësore para janarit 1991 dhe kanë humbur vendin e punës pas janarit 1991, përfitojnë 150% të vlerës së përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, (i ndryshuar), pra në masën 13 000 lekë në muaj, pasi ta kenë vërtetuar këtë fakt me:

i) paraqitjen e librezës së punës të fotokopjuar dhe të noterizuar; ose

ii) vërtetim nga arkiva, kur të verbrit kanë punuar në kooperativa bujqësore.

Pagesa shtesë, mbi pagesën që përfitojnë të verbrit sipas pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, i ndryshuar, përfitohet deri në momentin që personi:

i) risistemohet në punë;

ii) mbush moshën për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë, pavarësisht nëse i përfiton nga sistemi i sigurimeve shoqërore.

14. Personi i verbër përjashtohet nga skema e përfitimit për shkak të verbërisë, i merret librezë e verbërisë për një periudhë deri në 3 vjet, si dhe u nënshtrohet sanksioneve të përcaktuara në pikën 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997, i ndryshuar, në rastet kur i verbri kryen veprime të qëllimshme për të përfituar pagesën për shkak të verbërisë si:

a) Falsifikim të dokumenteve të verbërisë, dëshmime apo dëftesave;

b) Refuzim të punësimit;

c) Refuzim i kualifikimit;

d) Mosparaqitja e dëshmime pas mbarimit të dy kurseve të kualifikimit.

15. Fondet e pagesave të pensioneve të invaliditetit të atyre personave që përfitojnë nga ligji nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” mbulohen nga sigurimet shoqërore, ndërsa fondet e pagesave të verbërisë dhe të kujdestarisë të personave që përfitojnë nga ky ligj

akordohen nga MPÇSSHB.

16. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dërgon zyrtarisht tek administratori shoqëror dosjen e personit që është komisionuar së bashku me vendimin e KMPV dhe librezën e re të verbërisë, të lëshuar prej saj në modelin e miratuar nga ministri. Dosja shoqërohet me një fletinventari për dokumentet që ndodhen në të, një kopje e së cilës ruhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

17. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, pajis me librezën e re të verbërisë të gjithë personat e verbër, afati i lëshimit të librezës të jetë deri në 3 vjet për personat që janë komisionuar deri në tre vjet dhe përgjithmonë. Për personat të cilët afatin e komisionimit e kanë deri në 1 vit, librezat e re e verbërisë do të përsëritet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror çdo vit.

18. I verbri, për pajisjen për herë të parë me librezën e verbërisë së re, paraqet tek administratori shoqëror, certifikatën personale me fotografi ose kartën e identitetit, si dhe tre fotografi të të njëjtit format me atë të certifikatës. Administratori shoqëror përcjell me shkresë zyrtare certifikatën dhe fotografinë e të verbrit në zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, dhe kjo e fundit i përcjell ato zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, pas plotësimit të librezave për çdo individ, harton listën me emrat sipas librezës, për zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

19. Zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror shpërndajnë në mënyrë zyrtare dhe dorëzojnë me procesverbal librezat e verbërisë tek administratorët shoqërorë të çdo njësie vendore.

20. Të verbrit për rinovimin e librezës së verbërimit të re, paraqesin pranë administratorit shoqëror librezën e verbërisë së cilës i ka mbaruar afati, certifikatën personale me fotografi dhe tri fotografi. Administratori shoqëror i përcjell këto dokumente sipas procedurës së përcaktuar në pikën 18 të këtij udhëzimi.

21. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, deri në nxjerrjen e librezës së re të verbërisë, pajis me vërtetim përfitimi nga statusi i të verbrit, të gjithë personat e përcaktuar në pikat 16 e 17 të këtij udhëzimi.

22. Udhëzimi nr.1766/1, datë 17.9.2003 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Anastas Duro

UDHËZIM
Nr. 8, datë 25.2.2015

PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE PËR NDIHMËN EKONOMIKE

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 35, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe në zbatim të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 6.2.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si edhe udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2 datë 9.1.2015, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015",

UDHËZOJ:

1. Administratori shoqëror në bashki/komunë, në përputhje me kriteret dhe treguesit, programon kërkesat për fonde për ndihmën ekonomike dhe i dërgon në zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Programimi i fondeve për ndihmën ekonomike:

Programimi i fondeve mbështetet në numrin e popullsisë gjithsej, numrin e familjeve, vlerësimin e varfërisë dhe numrin e familjeve në NE, strukturën e anëtarëve të familjes (bashkëshortët, bashkëshorti i vetëm, anëtarët mbi moshë pune, në moshë pune, dhe nën moshë pune); personat që kanë statusin e jetimit; numrin e familjeve që kanë fëmijë të lindur njëherësh, si: trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë, viktimat të trafikimit, viktimat të dhunës në familje, fëmijë në familje kujdestare, fëmijë që ndjekin arsimin e detyrueshëm, numri i vaksinave për fëmijët e vaksinuar të familjeve në NE, etj.

Në bazë të dokumentacionit, vlerësohen edhe të ardhurat që llogariten sipas koeficienteve nga pasuria, toka, blegtoaria, duke përfshirë qarqet Tiranë, Elbasan dhe Durrës.

3. Fondet e nevojshme për ndihmën ekonomike për bashkinë/komunën përlllogariten në bazë të treguesve të mësipërm sipas mod. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Njësitë vendore, kërkesat për fondet e programojnë sipas mod. 1 dhe i dorëzojnë në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, në fund të muajit qershor të vitit në vazhdim.

5. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror vlerësojnë kërkesat në përputhje me kriteret në fuqi dhe hartojnë nevojat për fondet e bllokndihmës ekonomike në nivel qarku dhe së bashku me mod. 1 për secilën bashki/komunë, brenda datës 10 korrik i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

6. Drejtoaria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror vlerëson kërkesat e ardhura nga rajonet dhe programon fondet për projektbuxhetin e vitit pasardhës në nivel kombëtar, të cilat i përcjell në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

7. Në fund të muajit nëntor të vitit në vazhdim bashkitë/komunat përditësojnë kërkesat për fonde sipas mod. 1 dhe i paraqesin në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

8. Drejtoritë rajonale këto kërkesa i përcjellin brenda datës 10 dhjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

9. Shërbimi Social Shtetëror bën detajimin e fondeve të programuara për bllokndihmën sipas ligjit të buxhetit të vitit pasardhës për çdo bashki/komunë dhe i përcjell në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

10. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë bën transferimin e fondeve si grante të kushtëzuara për dymujorin e parë sipas pikës 9 të këtij udhëzimi dhe për vazhdimësinë transferata do të bëhet për çdo dymujor.

11. Drejtoaria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dërgon brenda datës 10 të muajit shkurt, prill, qershor, gusht dhe tetor, në Drejtorinë e Financave të MMRS, sektori i buxhetit, treguesit statistikorë mbi numrin e familjeve, individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe fondin faktik të shpenzuar të çdo 2-mujori, për çdo bashki/komunë, fond ky i cili do të shërbejë për çelje në 2-mujorët pasardhës, konkretisht treguesit statistikorë dhe fondi i shpenzuar të muajit nëntor-dhjetor, do të shërbejë për çeljen e fondeve për periudhën mars-prill, e kështu në vazhdimësi për dymujorët e tjerë.

12. Udhëzimi nr. 4, datë 11.3.2014 i Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Për planifikimin e fondeve për ndihmën ekonomike” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

Moduli 1

QARKU _____
BASHKIA, KOMUNA _____

Programimi i fondeve, për shpërndarjen e ndihmës ekonomike

Nr	Emërtimi	Struktura në numër	Masa e pagesës	Fondi mujore lekë
1	Popullsia gjithsej			
2	Familje gjithsej			
3	% e familjeve në skemë			
-	Familje në skemë, e ndarë kjo			
4	Bashkëshortët			
5	Bashkëshort i vetëm			
6	Anëtarë mbi moshë pune			
7	Anëtarë në moshë pune			
8	Anëtarë nën moshë pune			
9	Jetim 18-25 vjeç			
10	Jetim mbi 25 vjeç			
11	Numri i fëmijëve 3-njakë të familjeve			
12	Numri i fëmijëve 4-njakë të familjeve			
13	Numri i fëmijëve 5-njakë të familjeve			
14	Viktima të dhunës			
15	Viktima të trafikimit			
16	Kompensim energjie për familjet në skemë.			
17	Kompensim energjie për heqjen e fashës deri 300kwh për familjet në NE			
18	Kompensim energjie për personat me PAK			
19	Kompensim energjie për heqjen e fashës deri në 300kwh për personat me PAK			
20	Fëmijë deri në moshën 16 vjeç që ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar (janar-qershor; shtator-dhjetor)			
21	Numri i vaksinave për fëmijët në familjet përfituese të NE			
22	Fëmijë në familje kujdestare			
23	Fëmijë me AK në familje kujdestare			
24	Nr. i fëmijëve në familje kujdestare që përfitojnë shpenzime veshje + indirekte			
25	Nr. i fëmijëve në familje kujdestare që përfitojnë shpenzime shkolle			
A	Fondi sipas strukturës A = (4+5+6+7+8)*1 muaj			
B	Të ardhurat, gjithsej mujore B = (a+b+c+d) *1 muaj			
a	Të ardhurat nga toka			
b	Të ardhurat nga blegtoaria			
c	Të ardhurat nga pensionet			
d	Të ardhurat të tjera			
C	Fondi vjetor C=(A - B) x 12 muaj)			
Ç	Fondi për individë e kompensime {(9+10+11+12+13+14+15+16+17+18+19+22+23) x 12 muaj} + (20*10) +(21*1)+ (24*1) + (25*1)			
D	Fondi gjithsej D= (C + Ç)			

ADMINISTRATORI

KRYETARI

UDHËZIM
Nr. 3, datë 17.2.2017

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 955, DATË 7.12.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE,
DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 43 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe në zbatim të Kreut IV pika 2 të vendimit nr. 955 datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

1. Familjet dhe individët në nevojë, të përcaktuar në kreun I, pika 2 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, aplikojnë për ndihmë ekonomike përmes administratorëve shoqërorë në bashkitë/njësitë administrative në të cilën ata janë të regjistruar brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit. Çdo aplikim i hedhur pas kësaj date, nuk do të ndjekë procedurat për të përfituar ndihmë ekonomike për muajin aktual, por do të mbarten në listën e muajit pasardhës.

2. Aplikojnë për ndihmë ekonomike krye-familjari i familjes/anëtari madhor së bashku me bashkëshorten kur ka bashkëshorte, të cilët plotësojnë dhe nënshkruajnë aplikimin për familjen. Bashkëshortja është përgjegjëse për tërheqjen dhe marrjen në dorëzim të përfitimit të ndihmës ekonomike. Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, të drejtën e tërheqjes së ndihmës ekonomike e ka kryetari i familjes/anëtari madhor.

3. Kryefamiljari dhe bashkëshortja mund të plotësojnë aplikime të veçanta nëse ata janë në proces zgjidhjeje martesë dhe ende nuk ka një vendim gjykatë të formës së prerë.

4. Familjet aplikuese/individët plotësojnë dokumentacionin për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas përcaktimeve në kreun 1, pika 4 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

5. Aplikuesit duhet të shoqërojnë aplikimin e tyre me fotokopje të kartave të identitetit të aplikuesit dhe të anëtarëve të tjerë të familjes në moshë madhore të cilët janë pajisur me kartë identiteti.

6. Administratori, në prani të bashkëshortëve interviston aplikuesin dhe plotëson formularin e aplikimit për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, që përmbledh informacionin mbi: i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; ii) llojin e banesës; iii) pasuritë/asetet familjare; iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera.

7. Aplikuesi e kontrollon aplikimin për të konfirmuar se informacioni është i saktë. Nëse aplikuesi nuk bie dakord me informacionin, kërkon që administratori shoqëror ta ndryshojë informacionin për të cilin ai pretendon se nuk përputhet me deklaratimet e tij/saj. Në përfundim, aplikuesi nënshkruan aplikimin.

8. Nëse ka mungesa në informacion apo dokumentacion, atëherë administratori shoqëror e informon aplikuesin, dhe i jep një listë të informacionit apo dokumentacionit të munguar që duhet të plotësojë.

Administratori shoqëror do ta mbajë aplikimin dhe dokumentet shoqëruese deri në 30 ditë, në mënyrë që aplikuesi të ketë mundësi të plotësojë dokumentacionin. Administratori shoqëror do ta pranohet dhe do të vazhdojë me procesin e aplikimit, për muajin pasardhës. Nëse aplikuesi nuk siguron informacionin apo dokumentacionin e munguar brenda 30 ditëve, administratori shoqëror anulon aplikimin. Nëse aplikuesi

siguron informacionin apo dokumentacionin e munguar brenda 30 ditëve, administratori shoqëror e pranon atë dhe vazhdon me procesin e aplikimit, për muajin pasardhës.

9. Administratori shoqëror ruan dokumentacionin në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e dokumentacionit.

10. Administratori shoqëror verifikon situatën social-ekonomike të familjeve në nevojë brenda 3 muajve kur futen për herë të parë në skemë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, dhe hedh në Regjistrin elektronik të dhënat e marra nga intervistimi dhe verifikimi i situatës social ekonomike sipas shtojcës 2 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

11. Pas hedhjes dhe transferimit të të dhënave nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar, struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, përgatit projektvendimin sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Projektvendimi përgatitet në bazë të të dhënave të gjeneruara nga administratori shoqëror i çdo njësie administrative nën juridiksionin e Bashkisë dhe paraqitet për shqyrtim e miratim në Këshillin Bashkiak. Projektvendimi shoqërohet me një numër protokollit të strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki.

12. Këshilli i Bashkisë shqyrton projekt-vendimin së bashku me listat dhe merr vendim për propozimin e familjeve dhe individëve që duhet të trajtohen me ndihmë ekonomike, sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Këshilli i Bashkisë, nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në lista, por ia përcjell menjëherë në formë elektronike dhe zyrtare drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror së bashku me listën shoqëruese. Në rastet kur anëtarët e këshillit kanë qëndrime të ndryshme, vendimi për propozim shoqërohet me relacion.

13. Drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror, pas verifikimit të të dhënave, cakton familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike ose refuzon familjet/individët që nuk klasifikohen nga sistemi i pikëzimit si familje në nevojë dhe refuzon/përfshaton për një periudhë 6 mujore rastet e parashikuara në kreun II, pika 9 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

14. Regjistri Elektronik Kombëtar do të kontrollojë në mënyrë të kryqëzuar automatikisht me sistemet e tjera të informacionit të dhënat e deklaruara nga aplikuesit/përfituesit e ndihmës ekonomike.

15. Në raste specifike, kur sistemi nuk e bën të mundur këtë kryqëzim informacioni, Drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror do t'i drejtohet zyrtarisht çdo institucion nga i cili kërkon të marrë informacion. Institucionet e mëposhtme duhet të përgjigjen zyrtarisht brenda 10 ditëve:

- a) Zyrat e Punës;
- b) Zyrat e Tatimeve;
- c) Zyrat e Sigurimeve Shoqërore;
- d) Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- e) Zyrat e Regjistrimit të Automjeteve;
- f) Inspektorati i Punës;
- g) Sektori pranë bashkive (urbanistikë, treg i lire, bujqësi);
- h) Gjykatës;
- i) Institucioneve të vuajtjes së dënimit me heqje lirie.

16. Drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror gjeneron vendimin sipas aneksit nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet/individët përfitues dhe masën e përfitimit dhe për familjet/individët jopërfitues edhe arsyen e refuzimit. Vendimi i dërgohet në mënyrë shkresore dhe në formë elektronike nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar, Kryetarit të Bashkisë, për të:

- a) njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;

- b) kryer veprimet financiare, për kryerjen e pagesës, për përfituesit e ndihmës ekonomike;
- c) njoftuar kërkuesit për refuzimin e ndihmës ekonomike me argumentet përkatëse.

17. Përfshihen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë 6-mujore, familjet të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes, kur nuk krijohet një kurorë e re, me përjashtim të rastit vajzë nënë.

b) Nuk tërheq ndihmën ekonomike brenda një afati 10 ditor nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare, për përfituesit e ndihmës ekonomike me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme si shëndetësore dhe fatkeqësi.

c) Refuzon verifikimin e situatës social ekonomike në familje. Refuzimi dokumentohet me procesverbal, sipas shtojcës 4.

ç) Fsheh informacionin apo kryen deklaram të rremë mbi të dhënat e kërkuara në pikën 1, germa “a” të kreut II të këtij vendimi.

d) Nuk deklaron ndryshimet e situatës social ekonomike në deklaratën e paraqitjes çdo tre muaj të familjes.

dh) Refuzojnë përfshirjen në kurset e formimit profesional ose refuzojnë ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit.

e) Anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë, pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve kur rezultojnë taksapagues pranë pushtetit vendor për tokën bujqësore në pronësi/ përdorim.

18. Familjet/individët përfitues për ndihmë ekonomike paraqiten dhe plotësojnë çdo 3 (tre) muaj deklaratën, nga data 1–15 të muajit, sipas shtojcës 3 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

19. Në rastet kur familja/individë ndryshon vendbanimin, krahas ndryshimit të gjendjes civile, bëhet edhe transferimi dokumentacionit të ndihmës ekonomike pranë Bashkisë/Njësisë Administrative të vendbanimit të ri.

20. Të gjitha organet e administratës shtete-rore dhe njësitë e qeverisjes vendore, në të gjithë territorin e RSH-së, marrin të gjitha masat për vënien në funksion të Regjistratit Elektronik në rang Kombëtar, mbështetjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

21. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 maj 2017.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

UDHËZIM
Nr. 4, datë 17.2.2017

PËR PËRLLOGARITJEN E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 10, pika 7 dhe nenit 43, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe kreut IV, pika 2, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

1. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror pas vlerësimit sipas sistemit të pikëzimit për familjarët dhe individët, llogarit masën e ndihmës ekonomike.

2. Pavarësisht nga përbërja e saj, masa maksimale e plotë e ndihmës ekonomike për familjen nuk mund të jetë më e lartë se 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

3. Masa e ndihmës ekonomike, në muaj, për prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh është:

- a) për trinjakë, 3000 (tremijë) lekë për çdo fëmijë;
- b) për katërnjakë, 4000 (katërmijë) lekë për çdo fëmijë;
- c) për pesënjakë, 5000 (pesëmijë) lekë për çdo fëmijë.

Kjo ndihmë ekonomike përfitohet deri në moshën 18 vjeç.

4. Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 3000 (tremijë) lekë në muaj dhe përfitohet pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre.

5. Masa e ndihmës ekonomike për çdo viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore, është 3000 (tremijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet gjatë periudhës së vlefshmërisë të urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

6. Masa e ndihmës ekonomike për çdo jetim është 3000 (tremijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet nga jetimet që nuk janë në institucione deri në çastin e punësimit të tyre.

7. Masa e ndihmës ekonomike për familje llogaritet:

a) 1800 (njëmijë e tetëqind) lekë për anëtarin e parë të familjes sipas renditjes në certifikatën familjare;

b) 1260 (njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë për anëtarët e tjerë të familjes mbi moshën 18 vjeç;

c) 900 (nëntëqind) lekë për anëtarët që janë në dhe nën moshën 18 vjeç.

8. Kur në përbërjen e strukturës së familjes, për efekt të llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike, mbetet vetëm një anëtar, masa e ndihmës ekonomike për këtë të fundit është ajo e llogaritur për këtë anëtar.

9. Për rastet kur familja e përzgjedhur për të përfituar ndihmë ekonomike, është e përbërë vetëm nga një anëtar, i cili është mbi moshë punë masa e ndihmës ekonomike është 2.600 (dymijë e gjashtëqind) lekë.

10. Anëtarët e familjes, fëmijë, për të cilët vërtetohet që ndjekin arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç, marrin një shtesë në masën 300 (treqind) lekë në muaj gjatë vitit shkollor.

11. Anëtarët e familjes, fëmijë, për të cilët vërtetohet që janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinimit marrin një shtesë në masën 100 (njëqind) lekë, për çdo vaksinë të kryer.

12. Për bashkëshortët në proces zgjidhje martesë, kur ende nuk ka një vendim gjykatë të formës së prerë, masa e ndihmës ekonomike për secilin bashkëshort, do të jetë e përllogaritur në bazë të strukturës së familjes.

13. Për anëtarin e familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuar, invalid pune, nuk llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

14. Të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike për familjet në nevojë e ka bashkëshortja. Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon të drejtën e tërheqjes e ka kryetari i familjes.

15. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 maj 2017.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

UDHËZIM
Nr. 5, datë 17.2.2017

MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN
EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të kreut IV, pika 2, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

1. Këshilli i Bashkisë ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, duke përdorur deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

2. Mbi këtë fond mund të shtohen ose jo edhe fonde të buxhetit vendor.

3. Akordimi i fondit deri në 6 për qind do t'i shtohet çeljes faktike të çdo 2-mujori që transferohet për përfituesit e ndihmës ekonomike të përzgjedhura nga sistemi i pikëzimit.

4. Këshilli i Bashkisë miraton në fillim të vitit kriteret për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6 për qind.

5. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet regjistrat elektronik për ndihmë ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit .

6. Familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike do të miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak.

7. Për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social ekonomik në familje nga administratori shoqëror sipas shtojcës 2, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

8. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki harton projektvendimin për familjet në nevojë nën juridiksionin e Bashkisë, në bazë të propozimeve dhe vlerësimeve social ekonomike të ardhura nga njësitë administrative, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 për qind.

9. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki përllogarit fondin për mbulimin e familjeve në nevojë që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri në 6 për qind dhe e dërgon për miratim në Këshillin e Bashkisë.

10. Masa e ndihmës ekonomike për familjet llogaritet sipas strukturës së familjes, përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale “Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”.

11. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki grumbullon dhe përgatit informacione, statistika mbi numrin e familjeve përfituese të trajtuara sipas këtij udhëzimi dhe fondin e realizuar të cilat i dërgojnë pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

12. Nuk mund të trajtohen në bazë të këtij udhëzimi:

a) familjet të cilat nuk kanë aplikuar për ndihmë ekonomike sipas vendimit nr. 955, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”;

b) familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike sipas vendimit nr. 955, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

13. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 maj 2017.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

UDHËZIM
Nr. 8, datë 8.5.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 17.2.2017 “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 955 DATË 7.12.2016 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 43 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe në zbatim të kreut IV pika 2 të vendimit nr. 955 datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

1. Pika 4 e udhëzimit ndryshohet si më poshtë:

“4. Për të përfituar ndihmë ekonomike, plotësohet dokumentacioni i mëposhtëm:

4.1 Për familjet në nevojë, kryetari i familjes/ anëtari madhor, së bashku me bashkëshorten, kur ka një të tillë, kërkojnë të aplikojnë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative, ku kanë vendbanimin duke paraqitur këtë dokumentacion:

a) Kopjen e kartës së identitetit të aplikantëve;

b) Certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme/vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende.

4.1.1 Për rastet që janë në proces zgjidhjeje martese dhe ende nuk ka një vendim gjykate të formës së prerë, dokumentacioni i përcaktuar në pikën 4.1, paraqitet i ndarë nga secili bashkëshort. Krahas këtij dokumentacioni paraqitet edhe vërtetimi i gjykatës që bashkëshortët janë në proces zgjidhjeje martese.

4.1.2 Për familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, krahas dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4.1, paraqesin edhe kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

4.1.3 Për fëmijët e familjeve në nevojë, që ndjekin arsimin bazë, paraqesin edhe vërtetimin për ndjekjen e shkollës të lëshuar nga shkolla, i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor, për të përfituar pagesën shtesë.

4.1.4 Për fëmijët e familjeve në nevojë që vaksinohen paraqesin edhe fotokopje nga libri i shëndetit të fëmijës për vaksinën e kryer sipas kalendarit të detyrueshëm për grup-moshat e fëmijëve, për të përfituar pagesën shtesë.

4.2 Jetimët, të cilët nuk janë në institucione, paraqesin pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative:

a) kopjen e kartës së identitetit;

b) kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për statusin e jetimit, të ndryshuar;

c) për jetimët që ndjekin arsimin bazë, paraqesin edhe vërtetimin për ndjekjen e shkollës, të lëshuar nga shkolla, i cili paraqitet 2 herë brenda vitit akademik, për të përfituar pagesën shtesë;

d) për jetimët që vaksinohen paraqesin edhe fotokopje nga libri i shëndetit të fëmijës për vaksinën e kryer sipas kalendarit të detyrueshëm për grupmoshat e fëmijëve për të përfituar pagesën shtesë;

4.3 Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë:

a) kërkesë për tu trajtuar me ndihmë ekonomike;

b) çertifikatë familjare;

c) verifikimi social-ekonomik i familjes nga administrator shoqëror që është familje në nevojë.

ç) për fëmijët që ndjekin arsimin bazë, paraqesin edhe vërtetimin për ndjekjen e shkollës, të lëshuar nga shkolla, i cili paraqitet 2 herë brenda vitit akademik, për të përfituar pagesën shtesë;

d) për fëmijët që vaksinohen paraqesin edhe fotokopje nga libri i shëndetit të fëmijës për vaksinën e kryer sipas kalendarit të detyrueshëm për grupmoshat e fëmijëve për të përfituar pagesën shtesë;

4.4 Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre, paraqesin:

- a) kopjen e kartës së identitetit;
- b) vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të lëshuar brenda 30 ditëve të fundit.
- 4.5. Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes paraqesin:
- a) kopjen e kartës së identitetit;
- b) urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, për periudhën e vlefshmërisë së tij.”
2. Në pikën 5 togfjalëshi “të cilët janë pajisur me kartë identiteti”, shfuqizohet.
3. Në pikën 7 në fjalinë e fundit shtohet:
 “.....dhe i jepet një kopje e faqes së parë të aplikimit të nënshkruar nga administratori shoqëror dhe aplikuesi.”
4. Në pikën 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
- a) Në fund të paragrafit të parë shtohet togfjalëshi: “....brenda afatit të përcaktuar për aplikim.”.
- b) Paragrafi i dytë shfuqizohet.
5. Në pikën 11, Aneksi nr. 1 dhe Aneksi nr. 2 ndryshohen sipas formatit bashkëngjitur këtij udhëzimi.
6. Në pikën 12 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
- a) Në fjalinë e parë pas togfjalëshit “Këshilli i Bashkisë...” shtohet “brenda datës 20 të muajit”.
- b) Fjalja e fundit shfuqizohet.
7. Në pikën 16, Aneksi nr. 3 ndryshohet sipas formatit bashkëngjitur këtij udhëzimi.
8. Në pikën 17, gërma (b) togfjalëshi “kryerja e pagesave” zëvendësohet me “data e fillimit të kryerjes së pagesave”.
9. Në pikën 18 togfjalëshi “Familjet / individët” zëvendësohet me “Anëtarët madhorë të familjes/individët” dhe togfjalëshi “1-15 të muajit” zëvendësohet me “1-10 të muajit”.
10. Pas pikës 19 shtohen pikat 19/1, 19/2, 19/3 dhe 19/4 me këtë përmbajtje:
 “19/1. Personat e grup-moshës 35-70 vjeç, të cilët janë anëtarë të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike duhet të kryejnë kontrollin mjekësor bazë në një nga ditët e muajit të lindjes.”
 “19/2. Administratori shoqëror në bashkëpunim me mjekun e familjes, merr listën emërore të personave të kësaj grup-moshe, të cilët nuk e kanë kryer kontrollin mjekësor bazë dhe i njofton ata 3 muaj rresht, para muajit të lindjes.”
 “19/3. Personi i njoftuar duhet të kryejë kontrollin mjekësor bazë dhe të dorëzojë pranë administratorit shoqëror, vërtetimin e lëshuar nga qendra shëndetësore që ka kryer kontrollin mjekësor bazë.”
 “19/4. Për koordinimin e këtij procesi, administratori shoqëror bashkëpunon me mjekun e familjes dhe strukturat e Fondit të Sigurimit të Deryrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.”
10. Pika 21 ndryshohet me këtë përmbajtje:
 “Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.9.2017.”

MINISTRI I MIRËQËNIES SOCIALE
 DHE RINISË
Olta Xhaçka

Logo Bashkisë

Prefektura _____
 Bashkia _____

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë _____

**“PËR PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR
 PERIUDHËN _____**

Duke u mbështetur në nenin 30/1 të Ligjit nr. 9355, datë 07.12.2016 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, në pikën 6 të Kreut II të Vendimit Nr. 955, datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki i propozon Këshillit të Bashkisë se janë paraqitur për aplikim _____ familje.

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera konkludojmë dhe propozojmë se:

1. Kanë aplikuar për ndihmë ekonomike _____ familje, lista bashkëlidhur.
2. Individë me statusin e Jetimit _____ persona, lista bashkëlidhur
3. Individë viktime të trafikimit _____ persona, lista bashkëlidhur
4. Individë viktime të dhunës në familje _____, lista bashkëlidhur
5. Individë prindër të fëmijëve të lindur:
 - a) Trinjakë _____ familje,
 - b) Katernjakë _____ familje,
 - c) Pesënjak e më shumë njëherësh _____ familje, lista bashkëlidhur
6. Fëmijë të vendosur në familje kujdestare _____ aplikime, lista bashkëlidhur
7. Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare _____ aplikime, lista bashkëlidhur

Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Personi përgjegjës për ndihmën ekonomike

Drejtori

Emri, Mbiemri firma

Emri, Mbiemri firma

Prefektura _____
Bashkia _____

Lista që i bashkëngjitet projektvendimit në total të familjeve të propozuara në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar.

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Dosje	Nr. anëtarëve

Bashkia _____ |Logo Bashkisë

VENDIM

Nr. ____ datë _____

**“PËR PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR
PERIUdhËN _____**

Duke u mbështetur në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 9355, datë 07.12.2016 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, në pikën 6 të Kreut II të Vendimit Nr. 955, datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, dhe në bazë të projekt-vendimit të paraqitur nga struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, Këshilli i Bashkisë

Vendosi:

Ti propozojë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror _____, të përfitojnë nga aplikimi:

1. Për ndihmë ekonomike _____ familje, lista bashkëlidhur.
2. Individë me statusin e Jetimit _____ persona, lista bashkëlidhur
3. Individë viktime të trafikimit _____ persona, lista bashkëlidhur
4. Individë viktime të dhunës në familje _____, lista bashkëlidhur
5. Individë prindër të fëmijëve të lindur:
 - Trinjakë _____ familje,
 - Katërnjakë _____ familje,
 - Pesënjakë e më shumë njëherësh _____ familje, lista bashkëlidhur
6. Fëmijë të vendosur në familje kujdestare _____ aplikime, lista bashkëlidhur
7. Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare _____ aplikime, lista bashkëlidhur

Shënime¹

Sekretari i Bashkisë

Kryetari i Këshillit Bashkisë

VULA

¹ Këtu mund të shkruhet çdo gjë që kërkohet, sugjerohet, propozohet etj. nga Këshilli i Bashkisë.

Prefektura _____
Bashkia _____

Lista që i bashkëngjitet projektvendimit në total të familjeve të propozuara në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar.

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Dosje	Nr. anëtarëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E MIRËQENIES
 SOCIALE DHE RINISË
 SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
 DREJTORIA RAJONALE _____

VENDIM

Nr. ____ datë _____

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUdhËN _____

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar, në pikën 7 të Kreut II të Vendimit Nr. 955, datë 12.12.2012 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", si dhe në bazë të vendimit për propozim të paraqitur nga **Kryetari i Këshillit të Bashkisë** _____, Drejtoria Rajonale _____.

Vendosi:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike pas aplikimit _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur.
2. Individë me statusin e Jetimit _____ persona, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
3. Individë viktime të trafikimit _____ persona, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
4. Individë viktime të dhunës në familje _____, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
5. Individë prindër të fëmijëve të lindur:
 - a) Trinjakë _____ familje, me një fond _____ lekë
 - b) Katërnjakë _____ familje, me një fond _____ lekë
 - c) Pesënjakë e më shumë njëherësh _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
6. Fëmijë të vendosur në familje kujdestare _____ aplikime, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
7. Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare _____ aplikime, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
8. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike _____ familjet e mëposhtme, për arsyt e renditura përbri.

Emri Atësia Mbiemri i kryefamiljarit

Arsyet e daljes nga skema

1. _____

2. _____

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Drejtori Rajonal i Shërbimit Social Shtetëror VULA

BORDERO E PAGESËS SË NDIHMES EKONOMIKE

Për periudhën ____ / ____ / ____

Nr.	Emri, Atësia, Mbiemri i personit që tërheq NE	Numri ID	Nr. anëtarëve	Shuma NE	nr. Llogarisë bankare	Nënshkrimi ²

² Në rastin kur njësisia vendore dërgon kryerjen e pagesës me shërbimin e Postës Shqiptare

UDHËZIM
Nr. 9, datë 8.5.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 17.2.2017 “PËR
PËRLLOGARITJEN E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 10 pika 7 dhe nenit 43 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe Kreut IV, pika 2 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

1. Pika 15 e udhëzimit nr. 4, datë 17.2.2017 “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.9.2017.

**MINISTRI I MIRËQËNIES SOCIALE
DHE RINISË
Olta Xhaçka**

UDHËZIM
Nr. 9, datë 8.5.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 17.2.2017 “PËR
PËRLLOGARITJEN E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 10 pika 7 dhe nenit 43 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe Kreut IV, pika 2 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

1. Pika 15 e udhëzimit nr. 4, datë 17.2.2017 “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.9.2017.

MINISTRI I MIRËQËNIES SOCIALE
DHE RINISË
Olta Xhaçka

UDHËZIM
Nr. 10, datë 8.5.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 17.2.2017 “MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

Pika 13 e udhëzimit nr. 5 datë 17.2.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.9.2017.

MINISTRI I MIRËQËNIES SOCIALE
DHE RINISË
Olta Xhaçka

UDHËZIM
Nr. 618, datë 27.12.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 17.2.2017, MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 955, DATË 7.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 43, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe në zbatim të kreut IV, pika 2, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 1 të udhëzimit fjalia e fundit shfuqizohet.
2. Pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:
“2. Aplikojnë për ndihmë ekonomike kryefamiljari i familjes/anëtari madhor së bashku me bashkëshorten kur ka bashkëshorte, të cilët plotësojnë dhe nënshkruajnë aplikimin për familjen.”.
3. Në pikën 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
Në pikën 4.1, germa “a”, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “... dhe të anëtarëve të tjerë të familjes në moshë madhore”.
Në pikën 4.1, germa “b”, pas togfjalëshit “nga zyra e kadastrës” shtohet “në bashki/qark”.
Në pikën 4.2, pas germës “c” shtohet germa “ç” me këtë përmbajtje:
“ç) Vërtetim si punëkërkuar i papunë, të lëshuar nga zyra e punës, për jetimët mbi moshën 18 vjeç.”.
Në pikën 4.3, gjerat “a” dhe “b” shfuqizohen.
Pas pikës 4.5 shtohet pika 4.6 me këtë përmbajtje:
“4.6. Pagesa e ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët që përzgjidhen nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar, do të fillojë në muajin që është kryer aplikimi pranë administratorit shoqëror.”.
4. Pika 5 shfuqizohet.
5. Në pikën 7 fjalia e parë riformulohet me këtë përmbajtje:
“7. Administratori shoqëror i konfirmon aplikuesit të dhënat e hedhura në aplikim për të vërtetuar saktësinë e informacionit.”.
6. Pika 9 riformulohet me këtë përmbajtje:
“9. Administratori shoqëror printon formularin e aplikimit i cili nënshkruhet nga administratori dhe aplikuesi dhe ruhet së bashku me dokumentacionin e dorëzuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e dokumentacionit.”.
7. Pika 13 riformulohet me këtë përmbajtje:
“13. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas ardhjes së vendimit për propozim nga Këshilli i Bashkisë, verifikon të dhënat e hedhura në Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse.”.
8. Pika 14 riformulohet me këtë përmbajtje:
“14. Regjistri Elektronik Kombëtar do të kontrollojë në mënyrë të kryqëzuar automatikisht me sistemet e tjera të informacionit të dhënat e deklaruara nga aplikuesit/përfituesit e ndihmës ekonomike. Verifikimi i informacionit do të kryhet me këto institucione:
 - a) Zyrat e punës;
 - b) Zyrat e tatimeve;
 - c) Zyrat e sigurimeve shoqërore;
 - ç) Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

- d) Zyrrat e regjistrimit të automjeteve;
- dh) Inspektorati i punës;
- e) Sektori pranë bashkive (urbanistikë, treg i lirë, bujqësi);
- ë) Gjykatës;
- f) Institucioneve të vuajtjes së dënimit me heqje lirie.”.

9. Pika 15 riformulohet me këtë përmbajtje:

“15. Në raste specifike, kur sistemi nuk e bën të mundur kryqëzimin e informacionit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror do t’i drejtohet zyrtarisht çdo institucioni nga i cili kërkon të marrë informacion. Institucionet e përcaktuara në pikën 14 duhet të përgjigjen zyrtarisht brenda 10 ditëve.”.

10. Pas pikës 15 shtohet pika 15/1 me këtë përmbajtje:

“15/1. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas verifikimit të të dhënave, cakton familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike ose refuzon familjet/individët që nuk klasifikohen nga sistemi i pikëzimit si familje në nevojë dhe refuzon/përjashton për një periudhë 6-mujore rastet e parashikuara në kreun II, pika 9 të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.”.

11. Pika 16 riformulohet me këtë përmbajtje:

“16. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas verifikimit të të dhënave përcakton familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike ose refuzon familjet/individët që nuk klasifikohen nga sistemi i pikëzimit si familje në nevojë, si edhe refuzon/përjashton për një periudhë 6-mujore rastet e parashikuara në kreun II, pika 9, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.”.

12. Pas pikës 16 shtohet pika 16.1 me këtë përmbajtje:

“16.1. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror gjeneron vendimin sipas aneksit nr. 3 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet/individët përfitues, masën e përfitimit dhe për familjet/ individët jopërfitues arsyen e refuzimit. Vendimi i dërgohet në mënyrë shkresore dhe në formë elektronike nëpërmjet Regjistrimit Elektronik Kombëtar, Kryetarit të Bashkisë:

- a) për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;
- b) për të kryer veprimet financiare, për kryerjen e pagesës, për përfituesit e ndihmës ekonomike;
- c) për të njoftuar kërkuesit për refuzimin e ndihmës ekonomike me argumentet përkatëse.”

13. Në pikën 17 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në germën “a”, pas togfjalëshit “të anëtarëve të familjes” shtohet togfjalëshi “që jetojnë në të njëjtën strehë”.

Në germën “b” togfjalëshi “një afati 10-ditor” zëvendësohet me togfjalëshin “10 ditë pune” dhe në fund të fjalisë shtohet “... të vërtetuara me dokumentacionin përkatës”.

Germa “ç” riformulohet me këtë përmbajtje:

“ç) Fsheh informacionin apo kryen deklaram të rremë mbi të dhënat e kërkuara në pikën 1, germa “a”, të kreut II, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2017, të Këshillit të Ministrave.”.

Germa “d” riformulohet me këtë përmbajtje:

“d) Nuk paraqiten anëtarët madhorë të familjes/nuk deklarohen ndryshimet e situatës social-ekonomike në deklaratën e paraqitjes çdo tre muaj të familjes.”.

Germa “e” riformulohet me këtë përmbajtje:

“e) Anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë, pranë zyrrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim.”.

14. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1 me këtë përmbajtje:

“17/1 Bashkëshortja është përgjegjëse për tërheqjen dhe marrjen në dorëzim të përfitimit të ndihmës ekonomike. Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, të drejtën e tërheqjes së ndihmës ekonomike e ka kryetari i familjes/anëtar i madhor.”

15. Pika 18 riformulohet me këtë përmbajtje:

“18. Anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues të ndihmës ekonomike paraqiten dhe plotësojnë çdo 3 (tre) muaj deklaratën lidhur me gjendjen social-ekonomike pranë administratorit shoqëror, nga data 1–10 të muajit. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet social-ekonomike të familjes sipas shtojcës 3, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave.”

16. Në pikën 19 pas togfjalëshit “dokumentacionit të ndihmës ekonomike” shtohet “fizikisht dhe nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar nga administratori shoqëror.”

17. Në pikën 19/3 togfjalëshi “duhet të kryejë kontrollin mjekësor bazë” zëvendësohet me “ka të drejtë të kryejë kontrollin mjekësor bazë”.

18. Pika 19/4 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM
Nr. 593, datë 1.8.2019

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT,
PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.653 (dhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 11.190 (njëmbëdhjetëmijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2019 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Udhëzimi nr. 625, datë 27.8.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2019.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM
Nr. 594, datë 1.8.2019

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT
DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUAR”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së, nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.653 (dhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.653 (dhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 11.190 (njëmbëdhjetëmijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2019 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Udhëzimi nr. 626, datë 27.8.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2019.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

V E N D I M
Nr.31, datë 20.1.2001

PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni mjekësor i caktimit të aftësive për punë (KMCAP), në rreth, shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e interesuar, që përfitojnë nga ligji nr.8626, datë 22.6.2000, pavarësisht nga mosha, nga fakti nëse janë ose jo në marrëdhënie pune, nga koha a vendndodhja e aksidentit apo nga çasti i sigurimit.

Komisioni vendos edhe shkallën e invaliditetit, sipas ndarjes që vijon:

I. Grupi i parë, ku përfshihen:

a) të sëmurët tetraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

b) të sëmurët paraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

II. Grupi i dytë, ku përfshihen të sëmurët paraplegjikë pjesërisht të aftë për punë të përzgjedhur, që janë në gjendje për të vetëshërbyer.

2. KMCAP-ja i lëshon të interesuarit raportin mjekësor, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë dhe nevojën për kujdestar. Invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, duhet të deklarojë para administratorit shtetëror emrin e kujdestarit i cili shënohet në një regjistër të veçantë. Ndërrimi i kujdestarit mund të bëhet sa herë që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, e sheh të arsyeshme, por është i detyruar të njoftojë menjëherë KMCAP-në.

3. Invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

4. Masa e pagesës për invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë është 70 për qind e pagës minimale të punonjësit buxhetor dhe ndryshon sa herë ndryshon kjo pagë. Pagesa përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat e tjera, që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, përfiton nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.

Vendi dhe mënyra e dhënies së këtyre pagesave do të përcaktohet në udhëzimin që do të dalë në zbatim të këtij vendimi.

5. Efektet financiare për këto pagesa të përballohen brenda fondeve të dhëna për vitin 2001, Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, në zërin "Përfitim paaftësie".

6. Personat që do të fitojnë statusin e invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik, para datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë, në zbatim të pikës 4 të këtij vendimi, që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik."

Të gjithë personat e tjerë që do ta fitojnë këtë status pas datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë një muaj pas daljes në KMCAP.

7. Për çdo shpërdorim, personit përgjegjës i merret dëshmia për një periudhë deri në 3 vjet dhe, sipas rastit, zbatohen edhe dispozitat për kundërvajtjet administrative deri në kallëzim për ndjekje penale.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr.869, datë 18.6.2008

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “STATUSI I INVALIDIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin i invalidit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personave përfitues, sipas përcaktimit të nenit 1 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, u jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, në masën:

a) 3300 (tre mijë e treqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga sëmundje të përgjithshme;

b) 2200 (dy mijë e dyqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga sëmundje të përgjithshme;

c) 4000 (katër mijë) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;

ç) 2700 (dy mijë e shtatëqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.

2. Invalidi do ta përfitojë shtesën për paaftësi, sipas përcaktimeve të dhëna në shkronjat “a”, “b”, “c” e “d” të pikës 1 të këtij vendimi, edhe kur del në pension pleqërie.

3. Paga e përfitimit të paaftësisë kryhet nga bashkia/komuna, ku invalidi ka vendbanimin.

4. Efektet financiare shtesë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 97 000 000 (nëntëdhjetë e shtatë milionë) lekë të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2008, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Ngarkohet Ministria e Financave për marrjen e masave për pakësimin e fondeve të parashikuara për 6-mujorin e dytë, në masën 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë, në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për këtë pagesë, dhe për transferimin e këtyre fondeve në njësitë e qeverisjes vendore, ku do të kryhet ngarkesa.

6. Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të nxjerrin udhëzime në zbatim të këtij vendimi, për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimet nr.381, datë 20.5.1996 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”” dhe nr.204, datë 16.4.2004 “Për masën dhe kriteret për përfitim paaftësie nga personat me statusin e invalidit të punës” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1075, datë 23.7.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.869, DATË 18.6.2008 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE "PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 "PËR
STATUSIN E INVALIDIT", TË NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr.869, datë 18.6.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Fondi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë të përballohet nga fondi i kontingjencës dhe të derdhet në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1235, datë 16.12.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.869, DATË 18.6.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN
E INVALIDIT” TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin i invalidit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.869, datë 18.6.2008, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“3. Pagesa e përfitimit të paaftësisë për invalidin bëhet nga shërbimet bankare, që funksionojnë pranë njësisë së qeverisjes vendore, ku ka vendbanimin përfituesi, ose nga shërbimi postar për njësitë e qeverisjes vendore, ku nuk ka një të tillë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.38, datë 19.1.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.869, DATË 18.6.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN E
INVALIDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.869, datë 18.6.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Pagesa e përfitimit të paaftësisë, për invalidin, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 149, datë 13.3.2018

**PËR KRITERET, DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR EVIDENTIMIN E
FAMILJES KUJDESTARE PËR FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR DHE MASËS SË
FINANCIMIT PËR SHPENZIMET E FËMIJËS SË VENDOSUR NË FAMILJE
KUJDESTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton:

a) Kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror;

b) Masën e financimit për fëmijën e vendosur në familje kujdestare.

2. Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare përfshin:

a) Identifikimin e familjes kujdestare;

b) Informimin dhe trajnimin e familjes kujdestare;

c) Vlerësimin e familjes kujdestare, të fëmijës që do të vendoset në familjen kujdestare dhe të familjes së tij biologjike;

ç) Vendimmarrjen për familjen kujdestare dhe vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare;

d) Monitorimin e fëmijës dhe të familjes kujdestare gjatë periudhës që është vendosur në këtë shërbim.

3. Struktura përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijë në familje kujdestare (në vijim “struktura përgjegjëse”) është:

a) Struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë ku banon fëmija;

b) Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë administrative të bashkisë, ku banon fëmija;

c) Subjekti publik ose jopublik, ofrues i shërbimeve të kujdesit shoqëror ku është vendosur përkohësisht fëmija; apo

ç) Organizatat jofitimprurëse që ushtrojnë aktivitetet në fushën e shërbimeve të përkujdesjes alternative për fëmijë.

II. KRITERET, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONI PËR EVIDENTIMIN E FAMILJES KUJDESTARE

4. Bashkia është përgjegjëse për evidentimin e familjeve të gatshme për të qenë familje kujdestare në territorin e bashkisë përkatëse, në zbatim të Kodit të Familjes.

5. Për t'u përcaktuar si familje e gatshme për të qenë familje kujdestare, një familje duhet të plotësojë këto kritere:

a) Të ketë shfaqur interesin për të ofruar shërbimin e përkujdesjes alternative;

b) Anëtarët e familjes të jenë të motivuar për të qenë familje kujdestare;

c) Anëtarët e familjes të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;

ç) Prindërit kujdestarë të kenë aftësi për të kryer detyrën e kujdestarit;

d) Prindërit kujdestarë dhe të gjithë anëtarët e familjes të vërtetojnë me raport mjekësor nga komisioni mjekoligjor që janë të aftë për të ofruar këtë shërbim dhe se nuk mbartin sëmundje të transmetueshme;

dh) Të strehojnë dhe të garantojnë mjedis familjar të sigurt për fëmijën;

e) Anëtarët e familjes të mos kenë qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve, fëmijëve me aftësi të kufizuara apo fëmijëve që i përkasin një minoriteti të caktuar;

ë) Të respektojnë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës/fëmijëve apo të gjitha gjendjet e fëmijës sipas njeriut apo disa prej shkaqeve të parashikuara në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi;

f) Prindërit kujdestarë të kenë kuptim të qartë dhe të jenë të gatshëm të zbatojnë parimin e veprimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;

g) Prindërit kujdestarë të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me familjen biologjike të fëmijës dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ;

gj) Prindërit kujdestarë nuk kanë humbur, nuk u është hequr përgjegjësia prindërore ose nuk u është hequr

detyra e kujdestarit në një rast tjetër;

h) Prindërit kujdestarë të jenë nën moshën 65 vjeç;

i) Prindërit kujdestarë të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në jo më shumë se tre fëmijë.

6. Çdo familje e interesuar për të qenë familje kujdestare duhet të shprehë interesin, duke paraqitur një kërkesë pranë strukturës përgjegjëse. Kërkesa përmban informacion për familjen sipas formularit nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kërkesës i bashkëlidhet/n dokumenti/et e identifikimit të prindërve të familjes.

7. Punonjësi social i strukturës përgjegjëse (në vijim “punonjësi social përgjegjës”) bën vlerësimin paraprak të familjeve të interesuara, në bazë të kriterëve të vlerësimit të parashikuara në pikën 5, të këtij vendimi, dhe fton familjet e përzgjedhura të ndjekin seksionin e informimit mbi shërbimin e kujdestarisë.

8. Seksioni informues konsiston në dhënien e informacionit të hollësishëm për përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e familjes kujdestare.

9. Në përfundim të seksionit informues, punonjësi social përgjegjës fton familjen kujdestare të konfirmojë me shkrim interesin për të vijuar me procedurën e regjistrimit si familje kujdestare.

10. Prindërit kujdestarë të interesuar ftohen nga punonjësi social përgjegjës dhe zhvillojnë një intervistë të strukturuar sipas formularit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Intervista synon të marrë informacion të detajuar mbi kontekstin familjar, edukativ dhe social të familjes aplikuese, si dhe të kushteve e të mundësive që ka familja për të krijuar një mjedis të përshtatshëm familjar për mirëritjen e fëmijës.

11. Familjes së interesuar i kërkohet të paraqesë pranë punonjësit social përgjegjës këto dokumente plotësuese:

a) Raportin mjekoligjor, që vërteton se prindërit e familjes janë të aftë fizikisht dhe mendërisht;

b) Referencat për familjen nga 2 persona (njëri prej të cilëve duhet të jetë një përfaqësues i komunitetit në të cilin jeton familja).

12. Punonjësi social përgjegjës mbledh informacion shtesë të nevojshëm dhe siguron dokumentet e mëposhtme, nëpërmjet portalit unik *e-Albania*, mbi familjen e interesuar:

a) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010;

b) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore për anëtarët e familjes mbi 18 vjeç;

c) Të ardhurat e familjes;

ç) Pasuritë e paluajtshme të familjes;

d) Vërtetim nga strukturat e policisë, nëse ka pasur denoncime për dhunë në familje apo probleme të tjera me komunitetin;

dh) Verifikim social-ekonomik i familjes nga administratori shoqëror i njesisë administrative.

13. Dokumentet e parashikuara në pikën 12 të këtij vendimi mblidhen nga punonjësi social përgjegjës nëpërmjet paraqitjes së kërkesës në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik për llogari të personave fizikë, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Pas plotësimit të dokumentacionit, punonjësi social përgjegjës, në bashkëpunim me psikologun, kryen vlerësimin e mëtejshëm të familjes kujdestare të interesuar. Për kryerjen e vlerësimit, punonjësi social përgjegjës dhe psikologu mbështeten te të dhënat e mbledhura sipas pikave 10, 11 dhe 12 të këtij vendimi, si dhe informacionet që marrin nga:

a) Vizitat në banesën e aplikantit për të verifikuar kushtet e jetesës së familjes kërkuese;

b) Takimet individuale dhe në grup me të gjithë anëtarët e familjes së aplikantit;

c) Intervistat e personave të paraqitur nga aplikanti, si referencë;

ç) Intervistat e specialistëve të tjerë, si: psikologë, punonjës të policisë, përfaqësues të organeve të pushtetit vendor në vendbanimin e familjes kërkuese, punëdhënësin e bashkëshortit/es, përfaqësues të institucioneve arsimore, përfaqësues të komunitetit.

15. Nëse, sipas vlerësimit, gjykohet se familja është e përshtatshme për të qenë familje kujdestare, prindërit kujdestarë të interesuar i nënshtrohen trajnimit për prindër kujdestarë, të organizuar nga struktura përgjegjëse dhe gjatë këtij procesi vlerësohen kapacitetet, aftësitë dhe shprehitë e tyre si prind kujdestar. Kryerja e trajnimit dokumentohet me një procesverbal ose me certifikatën e trajnimit.

16. Pas përfundimit të trajnimit, punonjësi social përgjegjës dhe psikologu përgatisin raportin e vlerësimit të familjes kujdestare.

17. Dokumentet e mbledhura sipas pikave 6, 7, 10, 11, 12, 14, 15 dhe 16 të këtij vendimi sistemohen nga punonjësi social përgjegjës në dosjen e familjes kujdestare të interesuar dhe dërgohen nga struktura përgjegjëse për vendim-marrje në komisionin multidisiplinar në bashkinë përkatëse.

18. Komisioni multidisiplinar mblidhet për të shqyrtuar rastin, bën vlerësimin nëse familja plotëson ose jo kushtet për të ofruar shërbimin e kujdestarisë në familje, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe

merr vendimin për miratimin e familjes kujdestare brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së dosjes, sipas pikës 17 të këtij vendimi.

19. Vendimi i komisionit multidisiplinar i përcillet strukturës përgjegjëse që ka paraqitur dokumentacionin pranë saj, si dhe strukturës së shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë administrative ku banon familja kujdestare.

20. Struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki regjistron familjen në regjistrin e familjeve kujdestare që ngre dhe administron.

III. PROCEDURA E VENDOSJES SË FËMIJËS PA KUJDES PRINDËROR NË FAMILJEN KUJDESTARE

21. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, në rastet e emergjencës, vepron në mënyrë të menjëhershme, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe në ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, duke siguruar shërbim përkujdesjeje të menjëhershme.

22. Pas sigurimit të përkujdesjes së menjëhershme, sipas pikës 21 të këtij vendimi, njësia e mbrojtjes të fëmijëve i referon rastin strukturës përgjegjëse të bashkisë, ku ka vendbanimin fëmija.

23. Struktura përgjegjëse, me marrjen e referimit, sipas pikës 22, të këtij vendimi, mbledh të dhënat për fëmijën pa kujdes prindëror dhe familjen biologjike të tij. Informacioni mbledhet dhe evidentohet, sipas formularit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

24. Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit, punonjësi social përgjegjës harton raportin e vlerësimit të rastit, i cili përfshin vlerësimin e fëmijës pa kujdes prindëror dhe vlerësimin e familjes së tij biologjike dhe përmban këto informacione:

- a) Përbërësit e gjendjes civile individuale dhe familjare të fëmijës;
- b) Marrëdhëniet familjare dhe sociale të fëmijës;
- c) Gjendjen shëndetësore të fëmijës;
- ç) Nivelin e arsimit të fëmijës;
- d) Temperamentin dhe interesat e shfaqur të fëmijës;
- dh) Nevoja të veçanta, probleme të shfaqura të fëmijës;
- e) Arsyet për të cilat fëmija duhet të vendoset në shërbim kujdestaric;
- ë) Moshën e prindërve biologjikë;
- f) Vendbanimin e prindërve biologjikë;
- g) Punësimin dhe të ardhurat financiare të prindërve biologjikë;
- gj) Nivelin e arsimit të pjesëtarëve të familjes biologjike;
- h) Kushtet e strehimit të familjes biologjike;
- i) Gjendjen shëndetësore të anëtarëve të familjes biologjike;
- j) Gjendjen psikosociale dhe ligjore të pjesëtarëve të familjes biologjike;
- k) Deklaratën e prindi/prindërve biologjikë kur prindi/prindërit jetojnë, në të cilën shprehet aprovimi për vendosjen e fëmijës në familje kujdestare, me përjashtim të rasteve kur për fëmijën është marrë një nga masat e mbrojtjes, të parashikuara në nenin 55, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

25. Punonjësi social përgjegjës plotëson dosjen e fëmijës, duke mbledhur informacion shtesë të nevojshëm dhe siguron dokumentet e mëposhtme, nëpërmjet portalit unik *e-Albania*:

- a) certifikatën personale të fëmijës me fotografi;
- b) 4 fotografi të fëmijës;
- c) certifikatën familjare të fëmijës;
- ç) raportin mjekoligjor për gjendjen shëndetësore dhe mendore të fëmijës;
- d) kopjen e fletores së fëmijës për vaksinimet e kryera;
- dh) dëftesën shkollore për fëmijën, nëse fëmija frekuenton një të tillë;
- e) vërtetimin nga institucioni i përkujdesjes shoqërore, nëse fëmija është vendosur në një të tillë.

26. Plotësimi i dosjes, përveç parashikimit në shkronjën “b”, të pikës 25, të këtij vendimi, sigurohet nëpërmjet kërkimit të dokumentacionit në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik, për llogari të personave fizikë, sipas legjislacionit në fuqi.

27. Punonjësi social përgjegjës informon fëmijën për mundësinë e vendosjes në një familje kujdestare, i merr atij mendim mbi preferencat e tij për familjen e ardhshme kujdestare. Mendimi i fëmijës merret:

- a) Në mënyrë verbale, në prani të tij, për fëmijën nga mosha 6–10 vjeç;
 - b) Me shkrim, në prani të tij, për fëmijën mbi 10 vjeç.
28. Dosja e rastit, që përfshin dokumentet e mbledhura sipas pikave 23, 24, 25 dhe 27 të këtij vendimi, i dërgohet, nga struktura përgjegjëse, komisionit multidisiplinar të kujdestarisë në bashkinë që ka bërë referimin, brenda një afati 15-ditor nga momenti i referimit.

29. Komisioni multidisiplinar, brenda një jave nga paraqitja e dosjes, sipas pikës 28 të këtij vendimi, përzgjedh dhe propozon një nga familjet kujdestare nga regjistri i familjeve kujdestare, krijuar sipas pikës 20 të këtij vendimi.

30. Komisioni multidisiplinar përzgjedh familjen kujdestare, sipas pikës 29 të këtij vendimi, duke gjykuar mbi përshtatshmërinë sa më të mirë të nevojave të fëmijës me familjen që propozohet si familje kujdestare. Përshtatshmëria ndërmjet familjes kujdestare dhe fëmijës bazohet në vlerësimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës, në kontekstin familjar edukativ e social dhe vlerësimin e kushteve dhe të përshtatshmërisë së fëmijës me familjen kujdestare të ardhshme, si dhe në kriteret e mëposhtme:

a) Për fëmijën: moshën, temperamentin, interesat, marrëdhëniet me fëmijët e tjerë dhe nevoja të veçanta që mund të ketë;

b) Për familjen biologjike: moshën, temperamentin, profesionin/punësimin, strehimin, interesat, nivelin e edukimit;

c) Për familjen kujdestare: moshën, temperamentin, punësimin/profesionin, aftësitë, interesat, nivelin edukativ, qëndrimet kundrejt kulturave të tjera, statusin ligjor, kompetencat profesionale, preferencat ndaj fëmijëve potencialë për shërbim kujdestarë, gatishmëria, banimi (distanca nga familja biologjike), fëmijët e tjerë të familjes.

31. Me marrjen e njoftimit nga komisioni multidisiplinar, sipas pikës 30 të këtij vendimi, struktura përgjegjëse njofton familjen kujdestare për vendimin që ka marrë për përzgjedhjen si familje kujdestare dhe kjo e fundit i paraqet deklaratën e gatishmërisë për të marrë fëmijën në përkujdesje.

32. Struktura përgjegjëse paraqet kërkesën në gjykatë, sipas nenit 264 të Kodit të Familjes.

33. Gjykata vendos, sipas dispozitave të Kodit të Familjes, për vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare.

34. Struktura përgjegjëse, që ka ndjekur procedurën përkatëse në gjykatë, depoziton një kopje të vendimit të gjykatës pranë njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ku banon familja kujdestare.

35. Me marrjen e vendimit, sipas pikës 34 të këtij vendimi, punonjësi social përgjegjës bën përgatitjen paraprake të fëmijës, që përfshin:

a) Informimin e fëmijës (bazuar në nivelin e të kuptuarit dhe moshën);

b) Përshtatjen graduale të fëmijës me familjen kujdestare, nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta të fëmijës me familjen kujdestare, vizitave dhe takimeve, numri i të cilave përcaktohet dhe realizohet rast pas rasti dhe është i kushtëzuar nga ritmi individual i përshtatjes së çdo fëmije;

c) Sistemimin e fëmijës në familjen kujdestare;

ç) Hartimin e një plani individual për fëmijën;

d) Hartimin e një plani për fuqizimin e familjes biologjike, për mundësimin e rikthimit të fëmijës.

IV. MONITORIMI I FËMIJËS DHE I FAMILJES KUJDESTARE

36. Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ose struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për bashkitë që nuk kanë njësi të vlerësimit dhe referimit të rastit, monitoron në vazhdimësi familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari, nëpërmjet kryerjes së vizitave të monitorimit në shtëpi apo gjatë veprimtarisë normale të familjes.

37. Vizitat e monitorimit, sipas pikës 36 të këtij vendimi, bëhen çdo 2 javë në 3 muajt e parë për familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari dhe, më pas, çdo muaj. Rezultatet e çdo vizite dokumentohen dhe përfshihen në dosjen përkatëse të fëmijës.

38. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror monitorojnë çdo 3 muaj proceset e punës së punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore dhe bëjnë monitorimin e fëmijëve të vendosur në familje kujdestare.

39. Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale inspekton 2 herë në vit familjen kujdestare dhe fëmijën, për të siguruar respektimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë, si dhe për të siguruar mirëqenien e fëmijës, sipas procedurave për zbatimin e standardeve të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

40. Monitorimi nga drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe inspektimi nga inspektorati përgjegjës për shërbimet shoqërore koordinohen dhe realizohen në ditët e monitorimit të familjes nga struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror të bashkisë ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit të njësisë administrative.

41. Në rastet kur punonjësit e strukturave monitoruese apo inspektuese, informohen ose besojnë në mënyrë të arsyeshme se fëmija ndodhet në situatë emergjence, procedojnë menjëherë, duke referuar rastin të njësitë e mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", dhe në ligjin nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

V. MASA E FINANCIMIT PËR SHËRBIMIN

42. Masa e financimit për familjen kujdestare, për shpenzimet ushqimore për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj, ndërsa për shpenzimet e ushqimit të një fëmije me aftësi të kufizuara është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

43. Masa e financimit për familjen kujdestare, për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është si vijon:

a) shpenzime për veshmbathje: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit;

b) shpenzime për shkollimin: 5 000 (pesë mijë) lekë në vit; dhe

c) shpenzime të tjera: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit.

44. Pagesa e familjes kujdestare bëhet një herë në muaj, pranë njësisë administrative, ku ka vendbanimin e përhershëm familja kujdestare.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

45. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale, strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe njësi të vlerësimit të nevojave dhe e referimit të rastit për zbatimin e këtij vendimi.

46. Vendimi nr. 89, datë 26.1.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurave të shërbimit të kujdestarisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

47. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë brenda fondeve të miratuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, planifikuar në programin buxhetor “Përkujdesja sociale”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

FORMULARI NR. 1
MBI TË DHËNAT E APLIKUESIT

I- Të dhëna personale

- 1- Emri _____
- 2- Mbiemri _____
- 3- Moshë _____
- 4- Statusi civil _____
- 5- Adresa _____

II- Cili është burimi juaj i informacionit mbi shërbimin e kujdestarisë?

III- Cili është motivi që ju shtyn për t'u ofruar si prind kujdestar?

IV- Cilat janë marrëdhëniet tuaja me ligjin?

- A ju është mohuar e drejta prindërore në ndonjë periudhë të jetës suaj? Nëse po, kur?
Po Jo

- A keni qenë ndonjëherë i ndjekur penalisht? Nëse po, kur? Po Jo

V- Sa janë të ardhurat mujore të familjes tuaj (përfshi të gjithë anëtarët e familjes)?
_____ lekë

VI- Jepni të dhëna për nivelin e edukimit tuaj.

- I ulët
- I mesëm
- I lartë

VII- A keni pasur ndonjëherë apo keni ndonjë problem shëndetësor?

VIII- Sa është sipërfaqja e banesës suaj? _____ m²

IX- Sa fëmijë keni? Jepni moshën dhe seksin e tyre

Emri	Moshë	Seksi
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

X- A janë dakord të gjithë anëtarët e familjes suaj me vendimin për të qenë familje kujdestare? Po Jo

- Nëse jo, cili nga anëtarët dhe për çfarë arsyeje?
-
-

FORMULAR NR. 2
ME TË DHËNA TË DETAJUARA TË FAMILJES KUJDESTARE

(Ju lutem lexoni udhëzimin për plotësimin e rregullt të formularit)

I- DETAJE KONTAKTI

Institucioni/organizata/agjencia e cila ofron shërbimin e kujdestarisë:

Emri i punonjësit social: _____

Emri i menaxherit/drejtuesit: _____

Adresa: _____

Nr. tel./fax: _____

II- TË DHËNA PËR FAMILJEN KUJDESTARE

1. TË DHËNA PËR PRINDËRIT KUJDESTARË

	Nëna	Babai
Emri	_____	_____
Mbiemri	_____	_____
Mbiemri i mëparshëm	_____	_____
Datëlindja	_____	_____
Shtetësia	_____	_____
Punësimi	_____	_____
Adresa	_____	_____
Nr. tel.	_____	_____

2. MARRËDHËNIET E FAMILJES KUJDESTARE ME LIGJIN

(Lexoni udhëzimin bashkëngjitur formularit)

	Nëna	Babai	
A e gëzoni aktualisht të drejtën prindërore?	PO JO	PO JO	Nëse jo, për çfarë arsyeje?
A ju është mohuar e drejta prindërore në ndonjë periudhë të jetës suaj?	PO JO	PO JO	Nëse po, për çfarë arsyeje?
A keni qenë ndonjëherë i ndjekur penalisht?	PO JO	PO JO	Nëse po, kur dhe për çfarë arsyeje?
A keni ndonjë anëtar të familjes të ndjekur penalisht?	PO JO	PO JO	Nëse po, kur dhe për çfarë arsyeje?

3. STATUSI FINANCIAR

Sa janë të ardhurat mujore të familjes suaj (duke përfshirë të gjithë anëtarët e saj)? _____
lekë

4. EDUKIMI

Jepni të dhëna mbi edukimin tuaj.

	Nëna	Babai
I ulët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
I mesëm	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
I lartë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

5- SHËNDETI

Përkruani shkurtimisht gjendjen tuaj shëndetësore në të kaluarën dhe atë aktuale.

(Për gjendjen aktuale plotësoni formularin bashkëngjitur sipas udhëzimit të dhënë dhe merrni një raport nga mjeku psikiatër.)

6- STATUSI CIVIL

	Nëna	Babai
I /e martuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
I/e divorcuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
I/e ve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Beqar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

7- MOTIVIMI

a- Cilat janë motivet që ju shtyjnë për të qenë familje kujdestare?

b- A janë dakord të gjithë anëtarët e familjes me vendimin për të qenë familje kujdestare?

	Po	Jo
Fëmijët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Anëtarët e tjerë të familjes	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- c- A jeni të gatshëm të pranoni bashkëpunimin midis jush dhe familjes së origjinës në të mirë të fëmijës? Po Jo
- d- A jeni të gatshëm për një bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me agjencinë? Po Jo

8- STREHIMI

- a- Sa është sipërfaqja e banimit të shtëpisë tuaj? _____ m²
- b- Jepni tipin e shtëpisë, sistemin e ujit dhe kanalizimeve.

9- KOMUNITETI

- a- Përshkruani karakteristikat tipike të komunitetit tuaj.

- b- Si janë marrëdhëniet tuaja me fqinjët?

- Shumë të mira
- Normale
- Jo të mira

- c- Çfarë institucionesh edukuese ju ofron komuniteti?

- Çerdhe
- Kopshte
- Shkollë fillore
- Shkollë tetëvjeçare
- Shkollë të mesme

- d- Çfarë institucionesh shëndetësore ju ofron komuniteti?

- Ambulancë
- Klinikë dentare
- Konsultore
- Qendër shëndetësore
- Spital

- e- Çfarë qendrash argëtimi ju ofron komuniteti?

- Sheshe për të luajtur
- Park lojërash
- Bibliotekë
- Kinema

- f- Me çfarë mjetesh realizohet transporti brenda dhe jashtë komunitetit tuaj?

- Autobus
- Fugon
- Tren

III. TË DHËNA PËR FËMIJËT E FAMILJES KUJDESTARE

Emri	Seksi	Datëlindja	Shkolla që frekuenton	Marrëdhënia me prindin
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____

IV. TË DHËNA PËR ANËTARËT E TJERË TË FAMILJES

Emri	Seksi	Datëlindja	Marrëdhënia brenda strukturës familjare
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

V. PËRSHKRIMI I FAMILJES KUJDESTARE

Jepni një përshkrim të jetës suaj familjare (interesat, eksperiencat, si organizohet jeta brenda familjes, pikat e forta dhe të dobëta).

VI. REKOMANDIME

Jepni emrat dhe adresat e dy personave që ju njohin për më shumë se një vit dhe nuk kanë lidhje gjaku me ju.

Emër Mbiemër	Adresa	Nr. tel.
_____	_____	_____
_____	_____	_____

**APLIKANTI
EMËR MBIEMËR**

**PUNONJËSI SOCIAL
EMËR MBIEMËR**

FORMULARI NR. 3
TË DHËNAT E FËMIJËS QË DO TË VENDOSSET NË KUJDESTARI

I- DETAJE KONTAKTI

Institucioni/organizata/agjencia e cila ofron shërbimin e kujdestarisë:

Emri i punonjësit social: _____

Emri i menaxherit/drejtuesit: _____

Adresa: _____

Nr. tel./fax: _____

II- TË DHËNA IDENTIFIKUESE TË FËMIJËS

Emri _____

Mbiemri _____

Gjinia _____

Datëlindja _____

Vendlindja _____

Shtetësia _____

Adresa aktuale _____

Nr. tel. _____

III- STATUSI LIGJOR I FËMIJËS

Nën kujdesin e familjes biologjike

I deklaruar i braktisur

Nën kujdesin e shtetit

Nën kujdesin e familjes kujdestare

Të tjera, specifiko _____

IV- MARRËDHËNIA E FËMIJËS ME FAMILJEN NË TË CILËN JETON AKTUALISHT

Fëmijë nga martesë aktuale

Fëmijë nga martesë e mëparshme

Fëmijë i birësuar

Fëmijë i vendosur nën kujdestari

Tjetër (nëse po, specifiko) _____

V- PËRFITIMET E FËMIJËS NGA:

Trashëgimia

Pension familjar

Pension i paaftësisë

Sistemi i asistencës sociale

Burime të tjera (specifiko) _____

VI- PËRSHKRIM I SHKURTËR I FËMIJËS

1. Zhvillimi psikomotor i fëmijës, emocional dhe social të tij.

2. Rutina ditore e fëmijës.

3. Sjellje të veçanta të fëmijës që mund të shkaktojnë shqetësime.

VII- PËRSHKRIM I SITUATËS SHËNDETËSORE

1. Probleme shëndetësore, aftësi të kufizuara, nëse ka, alergjitë, nevoja për dietë, mjekimet, vizitat mjekësore.

2. Historia mjekësore, imuniteti, sëmundje të së kaluarës, probleme të tjera (urinimi në krevat etj.).

3. Kontaktet me mjekun, dentistin, pediatrin etj.

VIII- EDUKIMI

1. Emri i shkollës _____

2. Adresa e shkollës _____

3. Lloji i shkollës

- Edukim parashkollor
- Shkollë fillore
- Nëntëvjeçare
- Nëntëvjeçare me konvikt
- E mesme
- E mesme me konvikt
- Shkollë për fëmijë me nevoja të veçanta

Renditni më poshtë shkollat e ndjekura më parë nga fëmija (nëse ka):

Emri i shkollës	Adresa	Lloji	Vitet/viti shkollor
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

Kontaktet me edukatorët, mësuesit etj.

IX- VENDBANIMET E FËMIJËS QË NGA LINDJA

Paraqisni një listë të detajuar të të gjitha vendbanimeve të njohura për fëmijën, arsyet e lëvizjes dhe sistemimin aktual të tij. Në fund të listës përshkruani shkurtimisht arsyet e lëvizjes së tij.

<i>Vendbanimet e fëmijës (fam. biologjike, kujdestare, institucione etj.)</i>	<i>Koha e qëndrimit</i>	<i>Mosha e fëmijës gjatë kësaj periudhe</i>	<i>Emrat e prindërve biologjikë, kujdestarëve, punonjësit social</i>	<i>Arsyet e lëvizjes</i>

X- MOTRAT DHE VËLLEZËRIT E FËMIJËS

Emri	Mbiemri	Seksi	Datëlindja	Lidhja e gjakut me fëmijën	Vendbanimi
_____	_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____	_____

(Vendosni shenjën “X” për vëllain/motrën me të cilën fëmija është shumë i lidhur dhe shenjën “XX” për vëllain/motrën me të cilën fëmija kërkon të mbajë kontakte të vazhdueshme në të ardhmen.

- Jepni një përshkrim të shkurtër të takimeve aktuale dhe atyre të planifikuara me motrat dhe vëllezërit (nëse fëmija ka qëndruar më parë në familje kujdestare apo institucion).

XI- FAMILJA BIOLOGJIKE

Nëna e fëmijës

Emri _____

Mbiemri _____

Mbiemri i mëparshëm _____

Datëlindja _____

Vendlindja _____

Emri i bashkëshortit _____

Adresa _____

Emrat e personave të tjerë në familje _____

A e gëzon të drejtën prindërore? Po Jo

- Jepni shkurtimisht një përshkrim të përgjithshëm për nënën e fëmijës.

- Cila është shkalla e lidhjes dhe kontakteve të nënës me fëmijën?

Babai i fëmijës

Emri _____

Mbiemri _____

Datëlindja _____

Vendlindja _____

Emri i bashkëshortes _____

Adresa _____

Emrat e personave të tjerë në familje _____

A e gëzon të drejtën prindërore? Po Jo

- Jepni shkurtimisht një përshkrim të përgjithshëm për babanë e fëmijës.

- Cila është shkalla e lidhjes dhe kontakteve të babait me fëmijën?

	Nëna biologjike	Babai biologjik
Niveli i edukimit	_____	_____
Punësimi aktual	_____	_____
Punësimi i mëparshëm	_____	_____
Statusi civil kur ka lindur fëmija	_____	_____
Statusi civil aktual	_____	_____
Kur e kanë ndërprerë kujdesin për fëmijën?	_____	_____
A ka secili prind përgjegjësi për fëmijën?	_____	_____

Raste të tjera:

a) Njerkë b) Nënë adoptive c) Nënë kujdestare

Emri _____
 Mbiemri _____
 Mbiemri i vajzërisë _____
 Datëlindja _____
 Vendlindja _____
 Emri i bashkëshortit _____
 Adresa _____
 Emrat e personave të tjerë në familje _____
 A e gëzon të drejtën prindërore? Po Jo

- Jepni shkurtimisht një përshkrim të përgjithshëm të saj.

- Cila është shkalla e lidhjes dhe kontakteve të saj me fëmijën?

a) Njerk b) Baba adoptiv c) Baba kujdestar

Emri _____
 Mbiemri _____
 Datëlindja _____
 Vendlindja _____
 Emri i bashkëshortes _____
 Adresa _____
 Emrat e personave të tjerë në familje _____
 A e gëzon të drejtën prindërore? Po Jo

- Jepni shkurtimisht një përshkrim të përgjithshëm për të.

- Cila është shkalla e lidhjes dhe kontakteve të tij me fëmijën?

	Nëna	Babai
Niveli i edukimit	_____	_____
Punësimi aktual	_____	_____
Punësimi i mëparshëm	_____	_____
Statusi civil aktual	_____	_____
Kur e kanë filluar kujdesin për fëmijën?	_____	_____
Kur e kanë ndërprerë përkujdesjen për fëmijën?	_____	_____
A ka secili prind përgjegjësi për fëmijën?	_____	_____

- Jepni të dhëna për kujdestarin ligjor të fëmijës (nëse ka një të tillë).

XII- PRIORITETET QË KA FËMIJA PËR ZGJEDHJEN E FAMILJES KUJDESTARE

(nëse fëmija është mbi 10 vjeç)

- Shëndeti _____
- Edukimi _____
- Mosha _____
- Pozicioni gjeografik _____
- Ndonjë dëshirë tjetër e fëmijës _____

- A ka ndonjë konflikt interesash që duhet marrë parasysh në përzgjedhjen e familjes kujdestare?

Po Jo

Nëse po, shpjegoni

VENDIM
Nr. 518, datë 4.9.2018

**PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR KOMUNITAR E REZIDENCIAL,
KRITERET, PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E TYRE DHE MASËN E SHUMËS PËR
SHPENZIME PERSONALE PËR PËRFITUESIT E SHËRBIMIT TË ORGANIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 8, të pikës 5, të nenit 15, dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. FUSHA E VEPRIMIT

1. Ky vendim përcakton:

a) Kriteret dhe procedurat për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial sipas llojit të shërbimit dhe kategorisë përkatëse të përfituesit;

b) Masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar.

II. SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR KOMUNITAR E REZIDENCIAL

2. Shërbimet e kujdesit shoqëror organizohen në:

a) Shërbime parashoqërore: informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi *on-line*;

b) Shërbime në komunitet: shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditore dhe gjysmëditore, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët.

c) Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.

3. Shërbimet parashoqërore konsiderohen si shërbime komunitare dhe ofrohen nga strukturat e posaçme të shërbimeve shoqërore në kuptim të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror.

4. Shërbimet në familje janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal:

Shërbimi në shtëpi përfshin:

i. shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillim psikologjik e ligjor sipas rasti;

ii. shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi;

iii. dhënien e medikamenteve sipas recetës së mjekut apo shërbime të tjera të kujdesit të shëndetit;

iv. mbajtjen e higjienës personale;

v. përmbushjen e nevojave të tjera të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti.

5. Shërbimi i përkujdesjes alternative siguron zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe i ofrohet fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi. Shërbimi ofrohet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin e Këshillit të Ministrave për shërbimin e kujdestarisë për:

i. fëmijë pa kujdes prindëror;

ii. fëmijë të privuar në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga mjedisi familjar.

6. Shërbimi multifunksional përfshin një shumëllojshmëri shërbimesh multidisiplinare të specializuara dhe u ofrohet të gjitha kategorive në nevojë.

Shërbimi multifunksional siguron:

i. shërbime për rehabilitimin fizik dhe psikosocial;

ii. këshillime ligjore falas, këshillim për prindërimin, punësimin, edukimin shëndetësor, arsimim, argëtim;

iii. fuqizimin e individit/familjes;

iv. çdo shërbim tjetër të nevojshëm të identifikuar nga njësitet e vetëqeverisjes vendore.

7. Qendrat ditore ofrojnë shërbim gjysmëditor ose të plotë ditor, të cilat mund të përdoren një ose disa ditë në javë dhe sigurojnë shërbime specifike sipas kategorisë së përfituesve:

i. fëmijë që jetojnë në situatë rruge dhe fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë shërbime për higjienë personale, ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin;

ii. personat me aftësi të kufizuara - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë terapi zhvillimi, fizioterapi, logopedi, ortofoni, terapi okupacionale, mbështetje psikologjike, përkujdesje fizike, ushqim për qëndrimin ditor;

iii. të moshuarit - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në komunitet dhe ushqim.

8. Shërbimi i emergjencës 72 orë u ofrohet individëve që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. Ky shërbim ngrihet për:

i. viktima të dhunës në familje dhe fëmijët;

ii. fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara;

iii. të moshuarit apo individë të braktisur në situatë rruge.

9. Shërbimi për të pastrehët ofrohet për individë mbi 18 vjeç që nuk kanë strehë banimi dhe janë në vështirësi ekonomike dhe siguron:

i. strehim gjatë natës;

ii. mensë;

iii. mbështetje me këshillim dhe referim për fuqizim dhe riintegrim sa më të shpejtë.

10. Shërbimi i strehimit të mbrojtur u ofrohet viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit dhe personave me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë. Ai organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale, si dhe siguron:

i. strehim, siguri fizike, ushqim, kujdes shëndetësor, trajtim psikologjik dhe emocional, këshillim dhe referim të shërbimit rehabilitues dhe riintegruese në tregun e punës për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, në përputhje me vlerësimin e kryer për nevojat e tyre;

ii. mbështetje për jetesë brenda dhe jashtë ambientit të banimit, terapi rehabilituese, këshillim dhe mbështetje për integrim në tregun e punës për personat me aftësi të kufizuara.

11. Shërbime rezidenciale janë shërbimet që ofrohen në qendrat rezidenciale dhe, në çdo rast, përfshijnë të paktën shërbime të kujdesit 24-orësh dhe afatgjatë për individë në nevojë.

Në këtë shërbim përfshihen:

a) Shërbime në qendrat e zhvillimit, që sigurojnë përmirësimin e statusit dhe të cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç, dhe përfshijnë:

i. terapi intensive psikosociale për aftësimin mendor dhe rehabilitimin social me qëllim integrimin në komunitet;

ii. shërbim psikomotor për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë dhe të motorikës fine e globale;

iii. aftësim i parametrave fizikë;

iv. shërbime specifike ortofonie për aftësimin e individëve me çrregullime të spektrit autik apo të aftësisë për të komunikuar;

v. shërbime riaftësimi për punë;

vi. terapi zhvillimi.

b) Strehimi afatgjatë, i cili u sigurohet individit që ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore. Ky shërbim u ofrohet:

i. personave me aftësi të kufizuara, sipas moshës, llojit dhe shkallës së dëmtimit, kur nuk është e mundur

të sigurohet kujdesi në familje apo në familje kujdestare, duke u dhënë formën e duhur të kujdesit;

ii. të moshuarve dhe të sëmurëve rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje apo familje kujdestare.

c) Shërbimi në strehëza, që u siguron përfituesve shërbim specifik, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psikosocial, terapinë fizike, aktivitete profesionale, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim rezidencial ofrohet në mënyrë të përkohshme:

i. për fëmijën që gjendet i pambikëqyrur nga prindërit, në rrezik apo në situatë rruge;

ii. për fëmijën në nevojë të mbrojtjes së veçantë;

iii. për të rriturin ose të moshuarin që nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten;

iv. për gratë dhe vajzat shtatzëna ose për prindin e vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç;

v. për fëmijën dhe të rriturin, viktimë të dhunës në familje, të abuzimit, viktimë të trafikimit apo viktimë të mundshme të trafikimit ose në rrezik të mundshëm për jetën;

vi. për fëmijën dhe të rriturin në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga ose alkooli apo përjashtimit social;

vii. për fëmijën në konflikt me ligjin.

12. Shërbime të specializuara janë shërbimet që ofrohen në nivel kombëtar, rajonal apo bashkie nga profesionistë të specializuar në fusha të caktuara dhe përfshijnë:

a) Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese publike dhe jopublike që ofrohen në territorin e bashkisë ose në territorin e rajonit për fëmijë:

i. me çrregullime pervazive të zhvillimit;

ii. me prapambetje mendore;

iii. me çrregullime në komunikim;

iv. në nevojë për aftësim fizik.

b) Rehabilitim për viktimat e abuzimit seksual që ofrohet për viktimën e abuzimit seksual. Kur vlerësohet se jeta në familje nuk mund të vijojë pa ndërprerje, shërbimet rehabilituese, terapitë për rehabilitim shëndetësor e psikologjik dhe çdo nevojë tjetër e identifikuar për viktimën e abuzimit seksual ofrohen nga shërbimet ekzistuese komunitare. Shërbimi i specializuar siguron:

i. strehimin;

ii. sigurinë fizike;

iii. ushqimin;

iv. terapinë dhe rehabilitimin psikologjik;

v. kujdesin shëndetësor;

vi. asistencën juridike;

vii. shërbime riintegruese.

c) Strehëza për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, që ofrojnë shërbim në mënyrë të përkohshme, në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit, viktimat e dhunës në familje që kanë marrë urdhër mbrojtjeje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje dhe sigurojnë:

i. strehimin;

ii. sigurinë fizike;

iii. ushqimin;

iv. kujdesin shëndetësor;

v. asistencën juridike;

vi. rehabilitimin psikosocial;

vii. fuqizim për punësim;

viii. shërbime riintegruese;

ç) Qendrën për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit, që ofron shërbim në

mënyrë të përkohshme, duke mundësuar:

- i. strehimin;
- ii. sigurinë fizike;
- iii. ushqimin;
- iv. kujdesin shëndetësor;
- v. asistencën juridike;
- vi. rehabilitimin psikosocial në varësi të nevojave të identifikuar të viktimës së trafikimit.

d) Shërbim rehabilitimi për personat me varësi nga droga/alkooli në nivel komunitar, që ofrohet si shërbim ditor dhe përfshin shërbime rehabilituese sipas nevojave të identifikuar nga njësitë e specializuara mjekësore dhe nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit. Në kushtet rezidenciale shërbimi ofrohet në mënyrë të përkohshme dhe përfshin shërbimet:

- i. rehabilituese;
- ii. strehimin;
- iii. ushqimin;
- iv. kujdesin shëndetësor;
- v. rehabilitimin psikosocial;
- vi. terapinë okupacionale në varësi të nevojave të identifikuar të përfituesve të shërbimit.

III. PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNITARE E REZIDENCIALE

13. Procesi i përfitimit të shërbimeve komunitare dhe rezidenciale fillon me kërkesën e paraqitur nga:

- a) Individit apo familja në nevojë për shërbimin specifik;
- b) Punonjësi i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit;
- c) Organizata joqeveritare dhe ofrues të shërbimeve publike e jopublike;
- ç) Punonjësi i policisë së shtetit;
- d) Punonjësi apo institucionet që janë në kontakt me individin apo familjen në nevojë për shërbim;
- dh) Çdo person tjetër i interesuar.

14. Kërkesa për marrjen e shërbimit në qendra komunitare apo shërbim rezidencial, me përjashtim të shërbimeve të emergjencës, kryhet pranë punonjësit social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit, i cili drejton procesin e përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për përdorimin e shërbimit specifik dhe i siguron dokumentet e nevojshme nëpërmjet kërkesës në institucionet përkatëse ose Regjistrin Elektronik Kombëtar.

15. Vlerësimi i nevojave dhe i riskut, i cili përfshin analizimin e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve, në konsultim me përfituesin, realizohet në mjedisin e tij (në shtëpi, në shkollë), duke përfshirë vlerësimin shumëdisiplinor për rastet komplekse.

16. Punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit informon dhe jep këshilla bazë për të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, informim bazë për pagesat sociale në të holla.

17. Punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit, brenda 10 ditësh nga fillimi i procesit të përfitimit të shërbimit, sipas përcaktimit të pikës 13 të këtij kreu, pasi merr informacionin e plotë nga sistemet e jashtme, e kalon informacionin te komisioni multidisiplinor, i ngritur në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të bërë vlerësimin e plotë të rastit.

18. Komisioni multidisiplinor shqyrton kërkesën e dokumentacionin dhe, pas marrjes së vendimit, përcjell vendimin e dokumentacionin pranë ofruesit të shërbimit ose, në rast refuzimi, pranë njësisë që ka marrë nismën për vendosjen e individit në institucion për kujdesi rezidencial.

19. Punonjësi social në nivel qarku shikon në sistem rastet për trajtim dhe më pas përcakton planin e trajtimit të rastit dhe shikon performancën e punonjësve dhe ecurinë e trajtimit të rastit. Pasi merr vendimin për rivlerësimin e rastit, përcakton hapat e mëtejshëm të trajtimit të tij.

20. Titullari i institucionit të përkuqdesit shoqëror (në vijim "IPSH") shikon në sistem rastet për trajtim.

Përcakton planin e trajtimit të rastit dhe shikon performancën e punonjësve dhe ecurinë e trajtimit të rastit. Merr vendim për rivlerësimin e rastit dhe përcakton hapat e mëtejshëm. Mbyll rastin.

21. Punonjësi në IPSH ndjek detyrat dhe hedh veprimet e ndërmarra dhe dokumentacionin e mbledhur për rastin. Plotëson raportin e vlerësimit periodik dhe raportin e mbylljes së rastit.

22. Bashkërendimi i mbështetjes dhe referimi të shërbimit e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror. Për shërbimet në nivel rajonal dhe qendror vendimi për referimin merret bashkërisht me SHSSH-në.

23. Me përjashtim të viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit dhe të mundshme të trafikimit, për individët dhe familjet në nevojë, vendimi për t'i ofruar shërbimin e kërkuar merret brenda një muaji nga data e kërkesës nga:

a) Këshilli i Bashkisë, në rastin kur shërbimi i kërkuar funksionon në territorin e bashkisë respektive ku banon individi apo familja në nevojë mbi bazën e propozimit të strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkisë;

b) Këshilli i Qarkut, në rastin kur shërbimi i kërkuar përfshihet në territorin e qarkut ku banon kërkuesi i shërbimit, mbi bazën e propozimit të ardhur nga Këshilli i Bashkisë që përfshihet në territorin e qarkut;

c) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, në rastet kur në territorin e bashkisë dhe qarkut ku banon kërkuesi i shërbimit nuk ka shërbim rezidencial për nevojat e individit.

24. Pas marrjes së vendimit sipas përcaktimit të pikës 19 të këtij kreu, dokumentacioni bashkë me vendimin përcillen pranë shërbimit specifik ose i rikthehen individit apo familjes së interesuar në rast se kërkesa nuk është miratuar.

25. Për çdo përfitues të shërbimit rezidencial, çdo 6 muaj rivlerësohen të gjitha kushtet që kanë shkaktuar largimin nga familja apo shërbimi komunitar. Në rast të konstatimit që arsytet e marrjes së shërbimit rezidencial janë shuar, ndiqen procedurat sipas standardit të shërbimit për largimin nga shërbimi rezidencial.

26. Në rastet e emergjencës kur në territorin e bashkisë dhe qarkut respektiv mungojnë shërbime emergjence 72-orëshe, por ofrohet shërbim rezidencial që u përgjigjet nevojave të individit apo familjes në situatë emergjence, kryhet akomodimi i menjëhershëm pa prituri vendimin e autoriteteve vendimmarrëse për akomodimin në shërbimin rezidencial. Pranimi i menjëhershëm në shërbimin rezidencial shoqërohet me procesverbalin e punonjësit të policisë; në rastin e fëmijës procesverbali dorëzohet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, ku përshkruhen rrethanat në të cilën është konstatuar rasti i emergjencës. Brenda 24 orëve nga pranimi në shërbim të rastit emergjent, ofruesi i shërbimit njofton njësinë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë ku ka gjendjen civile individi i akomoduar. Kjo e fundit, brenda 72 orësh, administron rastin, me qëllim vijimin e shërbimit, duke konsideruar me prioritet shërbimet në komunitet.

27. Përpunimi i të dhënave personale, subjekt i rregullimeve të këtij vendimi, kryhet sipas përcaktimit të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

IV. KRITERET E PËRFTIMIT TË SHËRBIMIT DHE PËRMBAJTJA E DOSJES

28. Organet publike në nivel vendor sigurojnë planifikimin në planet sociale dhe realizimin e shportës bazë të shërbimeve komunitare të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në pikat 4–10 të këtij vendimi, në mënyrë uniforme, duke zbatuar kriteret për përfitimin e shërbimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për kualifikimin e individit si përfitues i tij.

29. Formati i planeve sociale miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale.

30. Procedurat e ngritjes, organizimit të shërbimeve, të përcaktuara në pikën 28 të këtij kreu, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale.

31. Shërbimi në shtëpi, sipas përcaktimit të pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kriteret:

a) Të jenë të moshuar ose persona me aftësi të kufizuara që e kanë të pamundur të kujdesen për veten

dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari;

b) Kanë nevojë për një shërbim që nuk ofrohet nga shërbimet komunitare në territorin ku banojnë.

32. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

- a) Epikrizën shëndetësore dhe fotokopje të kartelës mjekësore;
- b) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;
- c) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- ç) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

33. Shërbimi në qendër komunitare multifunksionale, sipas përcaktimit të pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që kanë nevojë për një apo disa shërbime që ofrohen në qendrën komunitare sipas nevojës së identifikuar gjatë procesit të menaxhimit të rastit, të përcaktuar në kreun III të këtij vendimi;

34. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

- a) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;
- b) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- c) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

35. Shërbimi në qendër ditore për fëmijë, sipas përcaktimit të pikës 7/i, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kritere:

- a) Fëmijë të identifikuar në situatë rruge;
- b) Fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike;
- c) Fëmijë në konflikt me ligjin.

36. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- b) Fotografinë e fëmijës (2 copë);
- c) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- ç) Fotokopjen e kartës së identitetit të prindërve;
- d) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;

dh) Raport me të dhëna nga struktura policore të interesuara sipas rastit, dhe/ose komisarati i policisë që mbulon territorin ku banon, në rastin kur fëmija është konstatuar i neglizhuar apo pa kujdes prindëror.

37. Shërbimi në qendër ditore për persona me aftësi të kufizuara, sipas përcaktimit të pikës 7/ii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga persona me aftësi të kufizuara të përcaktuar nga komisioni përgjegjës i vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe që kanë të nevojshme shërbime rehabilituese dhe riintegruese.

38. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- c) Dokumentin që vërteton vendimin e komisionit përgjegjës për përcaktimin e aftësisë së kufizuar;
- ç) Fotografinë e individit (2 copë);

d) Deklaratën me shkrim, të noterizuar, për dhënien e pëlqimit të prindit ose të kujdestarit për pranimin e personit në shërbimin ditor.

39. Shërbimi në qendër ditore për të moshuarit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 7/iii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kritere:

- a) Të jenë të moshuar që kanë mbushur moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi;
- b) Të përfitojnë pension social ose pension minimal në përputhje me legjislacionin përkatës;
- c) Të jenë të vetmuar e të braktisur sipas verifikimeve të kryera nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit.

40. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

- a) Certifikatën e gjendjes civile nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- c) Fotografinë e individit (2 copë);
- ç) Raportin nga komisioni mjekoligjor, që përcakton gjendjen shëndetësore të personit;
- d) Vërtetimin nga sigurimet shoqërore për masën e pensionit që përfiton nga sistemi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- dh) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes.

41. Shërbimi i emergjencës 72 orë, sipas përcaktimit të pikës 8, të kreut II, të këtij vendimi, ofrohet në mënyrë të menjëhershme dhe i vetmi dokumentacion i nevojshëm në momentin e pranimin në këtë shërbim, sipas rastit, është:

- a) Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes - për viktimat të dhunës në familje dhe fëmijët e tyre;
- b) Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes ose procesverbali i policisë - për fëmijë pa kujdes prindëror ose të dhunuar, të shfrytëzuar, të abuzuar, fëmijë me aftësi të kufizuara;
- c) Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes ose procesverbali i policisë - për të moshuar të braktisur në situatë rruge.

42. Brenda 24 orëve nga vendosja në shërbimin e emergjencës, punonjësi social i shërbimit njofton punonjësin social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit për të vijuar me menaxhimin e rastit të përcaktuar në kreun III të këtij vendimi.

43. Shërbimi për të pastrehët, sipas përcaktimit të pikës 9, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kritere:

- a) Të jenë mbi 18 vjeç e të pastrehë;
- b) Të jenë përfitues të ndihmës ekonomike ose në proces aplikimi për ndihmën ekonomike.

44. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;
- b) Fotografinë e individit (2 copë);
- c) Raportin nga komisioni mjekoligjor, që përcakton gjendjen shëndetësore të personit;
- ç) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;
- d) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- dh) Verifikimi i aplikimit për ndihmë ekonomike ose për përfitimin e ndihmës ekonomike;
- e) Informacion mbi pasuritë e paluajtshme nga regjistri i ZRPP-së.

45. Shërbimi i strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje, sipas përcaktimit të pikës 10/i, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që janë viktimat të dhunës në familje, që e kanë të pamundur të jetojnë në mjedisin e mëparshëm familjar apo të pastrehë.

46. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Urdhrit e mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes;
- b) Procesverbalet e referimit nga punonjësi i Policisë së Shtetit;
- c) Raportin e vlerësimit të punonjësit social të sektorit të dhunës në njësitë e qeverisjes vendore;
- ç) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- d) Raportin e komisionit mjekoligjor;
- dh) Vërtetimin nga ZRPP-ja dhe ALUIZNI që nuk zotëron pronë;
- e) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

47. Shërbimi i strehimit të mbrojtur për viktimat e trafikimit ose viktima të mundshme trafikimi, sipas përcaktimit të pikës 10/i, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët, viktima të trafikimit ose viktima të mundshme trafikimi mbi 18 vjeç, që e kanë të pamundur, për arsye të sigurisë apo nevojës për shërbime rehabilituese, të jetojnë në mjedisin e mëparshëm familjar.

48. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Procesverbalet e referimit nga punonjësi i Policisë së Shtetit dhe punonjësi social i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
- b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- c) Raportin e vlerësimit të punonjësit social të Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit mbi rrethanat;
- ç) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;
- d) Raportin e komisionit mjekoligjor;
- dh) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

49. Shërbimi i strehimit të mbrojtur për personat me aftësi të kufizuara, sipas përcaktimit të pikës 10/ii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kritere:

- a) Persona me aftësi të kufizuara të vlerësuar nga komisioni përgjegjës i vlerësimit të aftësisë së kufizuar:
 - i. mendore;
 - ii. fizike;
 - iii. sensore;
- b) Janë të pastrehë dhe/ose familjarë të tyre nuk mund të kujdesen për ta;
- c) Kanë zhvilluar aftësitë për jetesë të pavarur ose gjysmë të pavarur.

50. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- c) Fotografinë e individit (2 copë);
- ç) Vendimin e komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;
- d) Vërtetimin e gjendjes social-ekonomike të familjes, si dhe të të ardhurave personale të personit me aftësi të kufizuar, të lëshuar nga administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore;
- dh) Kërkesën për përfitimin e shërbimit;
- e) Vërtetimin nga ZRPP-ja që vërtetojnë mungesën e strehimit;
- ë) Vërtetimin nga tatimet dhe sigurimet shoqërore, që provojnë nivelin e të ardhurave të deklaruara nga individi, nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

51. Shërbimet rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara, sipas përcaktimit të pikës 11/a, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohen nga individët që plotësojnë këto kritere:

- a) Vendimi i komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar:

- i. mendore;
- ii. fizike;
- iii. sensore;

b) Moshë e përfituesve të këtij shërbimi është nga 0–21 vjeç;

c) Nevoja për terapi zhvillimi për personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund t'i përfitojnë përmes shërbimeve komunitare.

52. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

c) Vendimin e komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;

ç) Fotografinë e individit (2 copë);

d) Verifikimin e gjendjes social-ekonomike të familjes, si dhe të të ardhurave personale të personit me aftësi të kufizuar, të lëshuar nga administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore, sipas formularit të posaçëm të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;

dh) Kërkesën për sistemimin e personit në institucion;

e) Dokumentin e shkollës që ka ndjekur personi;

ë) Deklaratën me shkrim, të noterizuar, për dhënien e pëlqimit të prindit ose të kujdestarit për pranimin e personit në institucion.

53. Strehimi afatgjatë për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, sipas përcaktimit të pikës 11/b, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kriterë:

a) Të jenë persona me aftësi të kufizuara për të cilët është i pamundur të sigurohet kujdesi në familje dhe sipas moshës, llojit dhe shkallës së dëmtimit i jepen format e duhura institucionale të kujdesit;

b) Të jenë të moshuar e të sëmurë rëndë, që vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore.

54. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Certifikatën personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

c) Fotografinë e individit (2 copë);

ç) Raportin mjekoligjor që përcakton gjendjen shëndetësore të personit;

d) Vërtetimin nga sigurimet shoqërore për përfitimin dhe masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë apo ndonjë lloj tjetër pensioni;

dh) Vendimin e komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar që përcakton aftësinë e kufizuar në rastin e personit me aftësi të kufizuar;

e) Verifikimin e gjendjes social-ekonomike të familjes, si dhe të të ardhurave personale të personit me aftësi të kufizuar të lëshuar nga administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore, sipas formularit të posaçëm të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;

ë) Verifikimin nga sistemi bankar të burimeve financiare të individit, i marrë me autorizimin përkatës të individit.

55. Shërbimi në strehëza për fëmijë, sipas përcaktimit të pikës 11/c/i/ii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kriterë:

a) Fëmijë të moshës 0–18 vjeç, që i kanë vdekur prindërit dhe nuk është bërë i mundur në mënyrë të menjëhershme shërbimi i kujdesit në familje kujdestare apo birësimi;

b) Fëmijë i lindur jashtë martesë dhe që, për rrethana të gjendjes ekonomiko-shoqërore, nuk mund ta

rrisë njëri nga prindërit;

- c) Prindërve të fëmijës u është hequr e drejta prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;
- ç) Prindërit e fëmijës janë ndaluar/arrestuar ose dënuar me vendim të formës së prerë me heqje lirie dhe deklarojnë me vullnet të lirë sistemimin e fëmijës në shërbimet e përkujdesjes shoqërore;
- d) Fëmija është deklaruar i braktisur nga gjykata në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;
- dh) Gjykata, me vendim të formës së prerë, ka vendosur sistemimin e fëmijës në institucionet e përkujdesjes shoqërore, pavarësisht nga gjendja familjare;
- e) Familjet e të cilëve deklarojnë se janë në krizë të rëndë sociale për shkak se prindërit janë të divorcuar ose janë rimartuar;
- ë) Prindërit e të cilëve shtrohen në spital ose dërgohen për kurim jashtë shtetit dhe deklarojnë me vullnet të lirë sistemimin e fëmijëve në institucionet e përkujdesjes shoqërore deri sa njëri ose të dy prindërit janë fizikisht të aftë për t'u kujdesur për fëmijët;
- f) Fëmijë që nuk mbikëqyren më ose janë larguar nga prindi apo kujdestari, deri në momentin e identifikimit dhe gjetjes së prindit apo kujdestarit të tyre.

56. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

- a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- b) Fotografitë e fëmijës (2 copë);
- c) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- ç) Certifikatën e vdekjes së prindërve, sipas rastit, nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;
- d) Vendimin e gjykatës për heqjen e së drejtës prindërore ose kopje të noterizuar të tij, sipas rastit;
- dh) Deklaratën e noterizuar të nënës ose, në pamundësi, deklaratën zyrtare të drejtorit të institucionit shëndetësor ku është braktisur fëmija, në rastet e braktisjes së fëmijës në maternitet, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 8, të ligjit nr. 18/2017, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;
- e) Epikrizën shëndetësore, kartelën mjekësore ose fotokopjen e saj, me të dhënat laboratorike dhe për vaksinimin;
- ë) Procesverbalin e lindjes së fëmijës në rastin kur fëmija është braktisur në maternitet;
- f) Procesverbalin dhe urdhrin e mëparshëm të pranimit/transferimit të fëmijës me vendim komisioni, në rastin e lëvizjes së tij nga një institucion në tjetrin, për shkak të moshës;
- g) Fotokopje të kartës së identitetit të prindërve;
- gj) Dokumentin e shkollës që ka ndjekur fëmija;
- h) Deklaratën noteriale për dhënien e pëlqimit të të dy prindërve ose të kujdestarit/kujdestarëve për vendosjen e tij në institucion;
- i) Verifikimin e gjendjes social-ekonomike të familjes të kryer nga administratori shoqëror sipas formularit të posaçëm të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;
- j) Dokumentet e noterizuara të pronësisë së banesës, si dhe dokumente të tjera për të drejtat pasurore, kur fëmija është trashëgimtar i drejtpërdrejtë, për rastet kur prindërit kanë vdekur ose kur, me vendim gjykatë, u është hequr e drejta prindërore;
- k) Të dhëna nga struktura policore të interesuara sipas rastit, komisariati i policisë që mbulon territorin ku banon.

57. Periudha e sistemimit të fëmijëve nga materniteti në shtëpinë e foshnjës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e lindjes së fëmijës, por mund të zgjatet në varësi të gjendjes shëndetësore të fëmijës.

58. Shërbimi në strehëza për të moshuarit, sipas përcaktimit të pikës 11/c/iii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kritere:

- a) Përfituesit e shërbimit kanë mbushur moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi;
- b) Përfitojnë pension social ose pension minimal në përputhje me legjislacionin përkatës;
- c) Nuk zotërojnë banesë apo llogari bankare;

ç) Janë të vetmuar dhe të braktisur sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit.

59. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

- a) Certifikatën personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- c) Fotografinë e individit (2 copë);
- ç) Raportin mjekësor që përcakton gjendjen shëndetësore;
- d) Vërtetimin nga sigurimet shoqërore me masën dhe llojin e pensionit që përfiton, nga sistemi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- dh) Verifikimin e gjendjes social-ekonomike të familjes të kryer nga administratori shoqëror sipas formularit të posaçëm të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;
- e) Vërtetimin nga ZRPP-ja dhe ALUIZNI për pronat që ka në zotërim;
- ë) Verifikimin nga sistemi bankar të burimeve financiare të individit, i marrë me autorizimin përkatës të individit.

60. Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese, sipas përcaktimit të pikës 12/a, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohen nga persona me aftësi të kufizuara, të vlerësuar nga komisioni përgjegjës i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, kur mjeku specialist i referon për shërbime rehabilituese, duke specifikuar qartësisht shërbimin e nevojshëm.

61. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- b) Vendimin e komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;
- c) Referencën nga mjeku specialist;
- ç) Referimin në shërbimin rehabilitues nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit.

62. Shërbimet rezidenciale për viktimat e dhunës në familje, sipas përcaktimit të pikës 12/c, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohen nga individët që plotësojnë këto kritere:

a) Fëmijët 0–18 vjeç të dhunuar në familje, të shoqëruar nga nëna ose të pashoqëruar nga prindërit, të identifikuar nga strukturat përgjegjëse si viktima të dhunës në familje. Për djemtë mbi 13 vjeç, pas kryerjes së vlerësimit psikosocial;

b) Vajza dhe gra, viktima të dhunës në familje, të pajisur me urdhër mbrojtjeje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.

63. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Urdhrin e mbrojtjes/urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes;
- b) Procesverbalet e referimit nga punonjësi i Policisë së Shtetit;
- c) Procesverbalet nga punonjësit socialë të sektorit të dhunës në njësitë e qeverisjes vendore;
- ç) Raportin mjekoligjor;
- d) Vendimin e gjykatës për vendosje në shërbim rezidencial.

64. Shërbimet rezidenciale për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit, sipas përcaktimit të pikës 12/ç, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohen nga fëmija, personi mbi 18 vjeç, shtetas shqiptar apo i huaj që, në bazë të intervistës formale të zhvilluar sipas procedurave standarde, vlerësohet si viktima e mundshme ose viktima trafiki.

65. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Deklaratën e pranimit të marrjes së shërbimit rezidencial, e firmosur nga përfituesi;
- b) Deklaratën e konfidencialitetit për përkthyesit (kur viktimat/viktima e mundshme të trafikimit është shtetas/e i/e huaj);
- c) Lejen e informuar për intervistën formale;
- ç) Formatin e konkludimit të intervistës formale;
- d) Formatin e konkludimit pa intervistë formale (për viktimat e mundshme të trafikimit);
- dh) Deklaratën e vendimit të informuar për ndihmë;
- e) Kërkesën për vlerësimin social-ekonomik dhe të sigurisë së parakthimit vullnetar (për viktimat /viktimat e mundshme të riatdhesuara);
- ë) Raportin për vlerësimin e situatës familjare para kthimit vullnetar të asistuar;
- f) Procesverbalet e referimit nga punonjësi social i zyrave rajonale dhe nga punonjësi i antitrafikut;
- g) Autorizimin e prindërve/kujdestarit për kthim të asistuar të të miturit/miturës;
- gj) Autorizimin e prindërve/kujdestarit për udhëtimin e të miturit/miturës.

66. Shërbimi i rehabilitimit rezidencial për personat me varësi nga droga, sipas përcaktimit të pikës 12/d, të kreut II të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kritere:

- a) Janë përdorues të drogës që kanë të nevojshëm shërbimin e rehabilitimit nga droga larg nga mjedisi që ka nxitur përdorimin e drogave;
- b) Përdorues i drogës që pranon të përfshihet në shërbimin e rehabilitimit.

67. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

- a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;
- b) Epikrizën shëndetësore të përgatitur nga mjeku toksikolog;
- c) Fotografinë e individit (2 copë);
- ç) Vlerësimin e kryer nga psikologu klinik;
- d) Raportin mbi shërbimet komunitare të ofruara ndaj individit në kushtet komunitare i përgatitur nga punonjësi social i njësisë vendore që ka menaxhuar rastin;
- dh) Deklaratën me shkrim, të noterizuar, për dhënien e pëlqimit të prindit ose të kujdestarit për pranimin e personit në institucion kur ky i fundit është minoren.

V. MASA E SHUMËS PËR SHPENZIME PERSONALE DHE NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME PËR PËRFITUESIT E SHËRBIMIT REZI-DENCIAL E KOMUNITAR

68. Subjekteve përfituese të shërbimit rezidencial publik, sipas përcaktimit të këtij vendimi, u jepet, për shpenzime personale, një shumë parash, si më poshtë vijon:

- a) Personave të moshuar që nuk kanë të ardhura, që janë të vendosur në shërbimin rezidencial për të moshuarit, 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj;
- b) Fëmijëve të moshës 2–5 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 300 (treqind) lekë në muaj;
- c) Fëmijëve të moshës 6–15 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 000 (një mijë) lekë në muaj;
- ç) Fëmijëve të moshës 16–18 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në muaj;
- d) Personave, që marrin shërbime në qendrat e zhvillimit, 1 000 (një mijë) lekë në muaj;
- dh) Viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë në muaj;

e) Viktimave të trafikimit/viktimave të mundshme të trafikimit, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.

69. Procedurat e shpërndarjes së shumës së parave që u jepet kategorive të përcaktuara në pikën 67 të këtij vendimi, për shpenzime personale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale.

70. Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare miratohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Nivelet e kuotave të shpenzimeve në institucionet private nuk mund të jenë më të ulëta se ato në institucionet publike.

71. Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare indeksohen çdo vit sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

72. Ngarkohen strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkive dhe qarqeve dhe njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje dhe me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre.

73. Kreu I, i vendimit nr. 113, datë 31.1.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 425, datë 27.6.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar, shfuqizohen.

74. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 578, datë 3.10.2018

**PËR PROCEDURAT E REFERIMIT E TË MENAXHIMIT TË RASTIT, HARTIMIN
DHE PËRMBAJTJEN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES, FINANCIMIN E
SHPENZIMEVE PËR ZBATIMIN E TIJ, SI DHE ZBATIMIN E MASAVE TË
MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 54, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave të referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes, sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor, sipas pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 34, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**PROCEDURAT E REFERIMIT E TË MENAXHIMIT TË RASTIT;
HARTIMI DHE PËRMBAJTJA E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES;
FINANCIMI I SHPENZIMEVE PËR ZBATIMIN E TIJ, SI DHE ZBATIMI I MASAVE TË
MBROJTJES**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë rregullat dhe procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, mënyrën e hartimit dhe përmbajtjen e Planit Individual të Mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Përcaktimet e këtij vendimi janë të detyrueshme për të gjitha autoritetet shtetërore, mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, institucionet publike apo private, organizatat jofitimprurëse dhe të gjithë personat e tjerë, të cilët kanë për detyrë funksionale, profesionale, kontraktuale apo ligjore të kryejnë referim, menaxhim, koordinim apo të ofrojnë një shërbim, në kuadër të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Neni 3
Parimet udhëheqëse në menaxhimin e rastit

Procedura për identifikimin dhe menaxhimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje, hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes, financimi i shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes bazohet në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, të respektimit të nderit, dinjitetit e personalitetit të fëmijës, konfidencialitetin, promovimin e së drejtës së fëmijës për mbrojtje dhe përkujdesje, respektimin e së drejtës për t'u dëgjuar, informuar, në lirinë e shprehjes, mosdiskriminimin, partneritetin e bashkëpunimin, si dhe në respektimin e përgjegjësive.

Neni 4
Përkufizime

Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi, për referencë do të përdoren përkufizimet dhe shkurtime si më poshtë vijojnë:

1. “Agjencia”, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
2. “NJMF” Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës;
3. “PMF”, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve pranë njësisë së mbrojtjes së fëmijëve ose pranë njësisë administrative;
4. “PIM”, Plani Individual i Mbrojtjes;
5. “GTN”, Grupi Teknik Ndërsektorial;
6. “NJVRN”, Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave;
7. “Rrezik i menjëhershëm”, situata në të cilën gjendet fëmija, i cili, në momentin e identifikimit nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe, nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë, mund të abuzohet seksualisht, të trafikohet apo të jetë pre e keqtrajtimit të tjera, të konsideruara vepër penale, sipas Kodit Penal. Ndërhyrja, në këtë rast, duhet të jetë urgjente dhe të sigurojë largimin e fëmijës nga situata e rrezikut.
8. “Rrezik i lartë”, situata në të cilën gjendet fëmija, i cili, për shkak të faktorëve të ndryshëm rrezikon që të dëmtohet rëndë, të jetë subjekt i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme apo të dëmtohet në mënyrë të tillë që të vuajë nga paaftësi të përhershme ose t’i rrezikohet seriozisht mirëqenia, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur atë.
9. “Rrezik i mesëm”, situata në të cilën gjendet fëmija, për të cilin nuk ka të dhëna që të jetë në rrezik për të pësuar dëmtime të rënda apo të ketë pësuar dëmtime të rënda, por ekziston mundësia që të dëmtohet apo të abuzohet nëse nuk merren masa për ta mbrojtur atë. Ndërhyrja për të mbrojtur fëmijën dhe për të ofruar shërbime është e domosdoshme.
10. “Rrezik i ulët”, situata në të cilën gjendet fëmija, i cili është relativisht i sigurt, nuk vuan nga dëmtime që kanë ardhur si rrjedhojë e abuzimit dhe ka aftësi për të mbrojtur veten. Vlerësohet se ka prezencë të faktorëve të rrezikut dhe se fëmija mund të bëhet pre e abuzimit, dhunës, neglizhimit apo shfrytëzimit nëse nuk realizohen ndërhyrje për t’i ofruar respektimin dhe aksesin në të drejta apo nëse nuk i ofrohen shërbimet, për të cilat fëmija ka nevojë.
11. “Menaxhimi i rastit”, metodologjia që siguron, hap pas hapi, ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për fëmijën në nevojë për mbrojtje dhe që synon të promovojë e të nxisë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e tij.
12. “Plan individual i mbrojtjes”, plani me veprime të caktuara, me qëllim mbrojtjen e fëmijës dhe parandalimin e cenimit të integritetit të tij, garantimin e të drejtave, mirëqenies, shëndetit dhe zhvillimit të tij, duke mbështetur familjen e fëmijës në realizimin e këtij plani, kur kjo është në interesin me të lartë të fëmijës.

KREU II
PROCEDURAT E REFERIMIT DHE TË MENAXHIMIT TË RASTIT

Neni 5
Hapat e menaxhimit të rastit

Procesi i menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm:

1. Identifikimin;
2. Raportimin;
3. Vlerësimin fillestar;
4. Vlerësimin e plotë;
5. Hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes;
6. Zbatimin, ndjekjen dhe monitorimin e PIM-it;
7. Mbylljen e rastit.

Neni 6
Identifikimi

1. Identifikimi i një fëmijë në nevojë për mbrojtje bëhet nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, mësuesit, ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor, strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Azilin dhe Antitrafikimin, Qendra

Kombëtare e Pritjes për Azilkërkuesit, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, si dhe vetë fëmijët.

2. NJMF-të dhe PMF-të kanë për detyrë të kryejnë identifikim proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet planifikimit të punës në terren, verifikimit të njoftimit të marrë nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijën, si dhe verifikimit të informacionit për rastet që vijnë në dijeni nëpërmjet medias së shkruar, elektronike apo medias sociale. (Formulari i identifikimit proaktiv - aneksi nr. 1.)

Neni 7

Raportimi

1. Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit.

2. Çdo mësues, ofruer i shërbimit psikosocial shkollor, punonjës i institucioneve shëndetësore apo i përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë njësisë arsimore vendore, drejtorit të institucionit, organeve të Policisë së Shtetit, strukturave për mbrojtjen e fëmijës.

3. Raportimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje bëhet me çdo mjet komunikimi, me telefon, *e-mail*, me postë, në formë shkresore, duke kontaktuar punonjësin e strukturave të Policisë së Shtetit apo të strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës.

4. Profesionistët e përmendur në pikat 1 e 2 të këtij neni, ose struktura përgjegjëse pranë institucionit/ve raportojnë menjëherë, me çdo mjet komunikimi, rastet që identifikohen si në rrezik të menjëhershëm apo të lartë, ndërsa, rastet e tjera të rrezikut, të mesëm apo të ulët, raportohen brenda 24 orëve nga identifikimi. Raportimi bëhet nëpërmjet formularit të raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje (aneksi nr. 2).

5. Formulari i plotësuar dërgohet në mënyrë elektronike apo me postë te punonjësi/njësia përgjegjëse e mbrojtjes së fëmijëve. Në formular hidhet i gjithë informacioni dhe të gjitha detajet e ditura nga personi/personat, të cilët janë në dijeni dhe kanë raportuar rastin.

6. Rasti raportohet te PMF-ja përgjegjëse për territorin ku është bërë identifikimi. Në rast se është e pamundur të kontaktohen këto struktura, njoftohet Agjencia, e cila merr masa për ndjekjen e rastit nga ana e strukturave vendore të mbrojtjes.

7. Me marrjen e raportimit, NJMF-ja/PMF-ja ka detyrimin të ndërmarrë të gjitha masat e veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të dhënë dhe fillimin ose jo të vlerësimit fillestar të rastit.

8. Procedurat për raportimin e rasteve rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës, sipas pikës 7, të nenit 67, të ligjit.

Neni 8

Vlerësimi fillestar

1. Vlerësimi fillestar është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut, bazuar në informacionin e disponueshëm nga identifikimi ose raportimi, si dhe nga informacioni që mund të merret nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën.

2. Vlerësimi fillestar kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe, maksimalisht, brenda 48 orëve pas raportimit.

3. PMF-ja, gjatë vlerësimit fillestar, vlerëson:

a) Nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër, duke mbajtur në konsideratë sigurinë, mbrojtjen fizike, shëndetin e fëmijës dhe nevojën për masë emergjente të mbrojtjes;

b) Nevojat bazë, për sa u përket ushqimit, higjienës, strehimit dhe kujdesit shëndetësor;

c) Shërbimet e domosdoshme, me qëllim përmbushjen e nevojave të identifikuara në kushtet e emergjencës.

4. Vlerësimi fillestar bëhet nga PMF-ja/NJMF-ja në territorin ku gjendet fëmija. Pas intervistimit fillestar të fëmijës apo verifikimit të gjendjes së tij, nëse fëmija nuk është në gjendje të flasë apo të intervistohet, të dhënat e marra nga PMF-ja dokumentohen menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 orë, në vlerësimin fillestar (aneksi nr. 3).

5. Nëse pas vlerësimit fillestar rezulton se fëmija nuk është në nevojë për mbrojtje, atëherë PMF-ja nuk hap dosje, por e referon atë pranë institucioneve përgjegjëse për ndjekje të situatës apo ofrimin e

shërbimit të nevojshëm. PMF-ja mban një regjistër të posaçëm për veprimet e kryera për këto raste.

6. Nëse pas vlerësimit fillestar PMF-ja konstaton ekzistencën e rrezikut edhe pasi i ka siguruar fëmijës shërbimet e nevojshme, për shkak të kushteve të emergjencës, ajo hap një dosje specifike (në letër dhe në format elektronik) për fëmijën.

7. Fëmijës i caktohet një numër, i cili do të jetë numri identifikues për të gjatë gjithë procesit të menaxhimit. Ky numër do të përdoret gjatë të gjitha komunikimeve, përveç rastit kur është e nevojshme të përdoret emri i fëmijës, për efekt të referimit apo ndërhyrjeve për mbrojtjen e tij.

8. Drejtuesi i NJMF-së cakton një nga PMF-të e kësaj njësie si menaxher rasti për secilin fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë përkatëse. Drejtuesi i NJMF-së, kur përcakton një PMF si menaxher rasti, merr parasysh ngarkesën e punës të secilës PMF dhe faktin nëse PMF-ja është përfshirë aktivisht në identifikimin apo kontaktin paraprak me fëmijën.

9. Në njësitë administrative ku ka vetëm një PMF, ajo shërben si menaxher rasti për të gjithë fëmijët në nevojë për mbrojtje. Në rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në nivel rreziku të lartë ose të menjëhershëm, PMF-ja e njësisë administrative, në menaxhimin e këtyre rasteve, do të mbështetet nga PMF-ja e bashkisë, i cila do të caktohet nga drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki.

Neni 9

Vlerësimi i plotë

1. Vlerësimi i plotë kryhet për çdo rast të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes.

2. PMF-ja, gjatë vlerësimit të plotë, vlerëson:

a) Nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, si dhe faktorët e rrezikut;

b) Nevojat e fëmijës në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij/saj dhe nevojat e familjes;

c) Faktorët mbrojtës, në veçanti pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e fëmijës, të familjes, nëse është e nevojshme edhe të familjes së gjerë;

ç) Në rastet kur për fëmijën është marrë një masë emergjente mbrojtjeje, vlerësimi përfshin edhe rezultatin e procesit të konfirmimit të masës nga gjykata, vlerësimin e kushteve të institucionit, të personit apo familjes kujdestare pranë të cilit është vendosur fëmija, në kuadër të masës.

3. Për realizimin e vlerësimit të plotë, PMF-ja duhet të kryejë, të paktën:

a) Një vizitë në shtëpinë e fëmijës dhe të dhënat/informacionin e marrë gjatë vizitës i hedh në formularin për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime (aneksi nr. 4);

b) Një intervistë me fëmijën, motrat/ vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, siç tregohet në formularin e intervistimit (aneksi nr. 5).

4. Për realizimin e vizitave në familje, në rastet kur është e nevojshme për arsye sigurie apo kur prindi nuk është bashkëpunues dhe nuk lejon vizitën apo takimin e PMF-së me fëmijën/fëmijët e tjerë të familjes, PMF-ja kërkon që gjatë kryerjes së vizitës në familje të shoqërohet nga strukturat e Policisë së Shtetit.

5. Pas mbledhjes së informacioneve për rastin, PMF-ja plotëson formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6).

6. Vlerësimi i plotë kryhet brenda 20 ditëve pune nga vlerësimi fillestar. Gjatë kësaj periudhe PMF-ja ka detyrimin të mbledhë GTN-në, në rastet kur fëmija në nevojë për mbrojtje është në nivel rreziku të mesëm dhe të lartë. Në rastet e rrezikut të ulët, PMF-ja mbledh GTN-në vetëm nëse e vlerëson të nevojshme.

7. Vlerësimi i plotë për rastet e rrezikut të menjëhershëm kryhet nga PMF-ja brenda 5 ditëve, nga miratimi i masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i sektorit të shërbimeve shoqërore në bashki. Vendimi për masën e mbrojtjes dhe vlerësimi i plotë i kalojnë për miratim gjykatës.

Neni 10

Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes

1. Pas plotësimit të formularit të vlerësimit dhe analizës së rrezikut, PMF-ja harton Projektplanin Individual të Mbrojtjes, sipas formularit të PIM-it (aneksi nr. 7).

2. Projektplanin Individual të Mbrojtjes hartohet mbi bazën e nevojave të identifikuara të rastit dhe përmban veprimet, ndërhyrjet dhe shërbimet e nevojshme për të ulur nivelin e rrezikut. PIM-i përmban:

a) Listën e nevojave të fëmijës dhe familjes;

- b) Veprimet apo ndërhyrjet konkrete për aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijës;
- c) Shërbimet e nevojshme për të përmbushur nevojat;
- ç) Vendimin për masën e mbrojtjes;
- d) Autoritetet dhe aktorët përgjegjës;
- dh) Afatet kohore;
- e) Ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike.

3. PMF-ja ose drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki u dërgon anëtarëve të GTN-së formularin e PIM-it, projektin e PIM-it, formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut, së bashku me kërkesën për mbledhjen e GTN-së. Në këtë mbledhje anëtarët e GTN-së:

a) Finalizojnë vlerësimin e plotë, duke shqyrtuar e plotësuar, sipas rastit, informacionin e hedhur në formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6);

b) Shqyrtojnë projektin e PIM-it dhe bëjnë rekomandimet përkatëse për ndërhyrjet apo shërbimet e nevojshme për rastin, duke caktuar detyrat për secilin anëtar të GTN-së, me afatet përkatëse, si dhe cilat shërbime apo ndërhyrje kanë nevojë të mbulohen me shpenzime nga ana e bashkisë.

4. Brenda dy ditëve pune nga mbledhja e GTN-së, PMF-ja reflekton në formularin e vlerësimit, analizën e rrezikut dhe në PIM ndryshimet, për të cilat bien dakord anëtarët e GTN-së.

5. PMF-ja i paraqet për miratim drejtorit të strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki PIM-in, së bashku me formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6) dhe rekomandimet e GTN-së.

6. Drejtori i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki, brenda dy ditëve pune, miraton PIM-in, bazuar në propozimin e bërë nga PMF-ja e GTN-ja dhe merr masat për prokurimin e shërbimeve, shpenzimet e të cilave rezultojnë të pambuluara në PIM-in e propozuar nga PMF-ja.

Një kopje e PIM-it duhet të mbahet në dosjen individuale të fëmijës. Nëse drejtori i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki nuk e miraton PIM-in e propozuar, rasti i njoftohet Agjencisë, e cila merr masat e nevojshme, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

7. Pas miratimit nga drejtori, PMF-ja ndan zyrtarisht, me të gjithë anëtarët e GTN-së, PIM-in përfundimtar.

8. Në rastin kur ka më shumë se një fëmijë në familje, hartohet një plan individual për secilin fëmijë, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre individuale.

9. PMF-ja bën të gjitha përpjekjet për të siguruar bashkëpunimin e familjes e të fëmijës në realizimin e PIM-it dhe diskuton e u shpjegon fëmijës dhe anëtarëve të familjes përmbajtjen e PIM-it.

10. Kur fëmija është mbi 14 vjeç, PMF-ja merr, në çdo rast, miratimin e fëmijës për masat e mbrojtjes të përfshira në PIM, kur kjo nuk prek interesin më të lartë të fëmijës.

11. Punonjësit të tjerë të NJMF-së, NJVNR-së apo të ofruesve të shërbimeve shoqërore publike e private bashkëpunojnë dhe mbështesin PMF-në, nëse fëmija dhe/ose anëtarët e familjes së tij paraqesin vështirësi në të kuptuarin, shprehjen apo ndërveprimin e nevojshëm për zbatimin e PIM-it.

Neni 11

Zbatimi, monitorimi dhe rishqyrtimi i PIM-it

1. Çdo institucion, autoritet apo ofrues shërbimi i përcaktuar në PIM është përgjegjës për realizimin e aktiviteteve, të veprimeve, ndërhyrjeve apo ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në PIM për fëmijën, prindërit apo anëtarët e familjes së tij.

2. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës:

a) Referon zyrtarisht, me shkresë, te shërbimet e përcaktuara në PIM, rastin kur autoriteti përgjegjës nuk ishte prezent në mbledhjen e GTN-së;

b) Kërkon informacion, sipas afateve të përcaktuara në PIM, për realizimin e ndërhyrjeve, të shërbimeve e detyrave të tjera të anëtarëve të GTN-së dhe autoriteteve të tjera, te të cilat është referuar rasti;

c) Njofton drejtorin e strukturës përgjegjëse, në nivel vendor, në rastet kur koordinimi dhe ndërveprimi institucional në nivel vendor është i vështirë;

ç) Referon te Agjencia rastet kur autoritetet shtetërore nuk bashkëpunojnë e ndihmojnë në aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, me qëllim zbatimin e sanksioneve të parashikuara në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";

d) Kryen rishqyrtimin formal të PIM-it, jo më vonë se 6 javë pas hartimit të PIM-it të parë dhe, më pas, çdo 3 muaj, por sipas nevojave të rastit ose kërkesës së njërit prej anëtarëve të GTN-së. Rishqyrtimi mund të bëhet më shpesh;

dh) Kryen vizita të rregullta në familje ose, në kuadër të masës së mbrojtjes, pranë institucionit, kujdestarit apo te personi pranë të cilit është vendosur fëmija, me qëllimin për të vlerësuar ecurinë dhe efikasitetin e ndërhyrjeve, të masave dhe shërbimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës.

3. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës merr informacion, në lidhje me:

- a) Fëmijën dhe marrëdhëniet e tij me familjen e origjinës, vëllezërit, motrat;
- b) Zbatimin e veprimeve dhe të detyrave të PIM-it dhe sa efektive kanë qenë ato;
- c) Rivlerësimin e nivelit të rrezikut dhe të nevojave të fëmijës dhe familjes;
- ç) Hartimin e PIM-it të rishikuar.

4. PIM-i i rishikuar diskutohet në mbledhjen e radhës së GTN-së, e cila zhvillohet në të njëjtën mënyrë si mbledhja e parë. Anëtarët e GTN-së raportojnë lidhur me ofrimin e shërbimeve apo të ndërhyrjeve sipas PIM-it. PMF-ja, për rastet me rrezikshmëri të lartë, ka të drejtë të thërrasë GTN-në në takim të jashtëzakonshëm, pavarësisht takimit periodik të radhës.

5. PMF-ja përditëson të dhënat, në lidhje me rastin në formularin e shqyrtimit të progresit (aneksi nr. 8) dhe bën ndryshimet përkatëse në Planin Individual për Mbrojtjen e Fëmijës.

6. Plani Individual i Mbrojtjes së Fëmijës, i rishikuar, miratohet brenda 2 ditëve pune nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. PIM-i i rishikuar i dërgohet drejtorit, së bashku me formularin e shqyrtimit të progresit.

Neni 12

Monitorimi i PMF-i për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes

1. Drejtuesi i NJMF-së është përgjegjës për monitorimin e punës së PMF-së, në lidhje me zbatimin e PIM-it, përfshirë PMF-në pranë NJMF-së apo PMF-në pranë njësisë administrative.

2. Drejtuesi i NJMF-së, i mbështetur nga PMF-ja përgjegjëse për ecurinë e PIM-it, realizon vizita monitoruese për të verifikuar situatën e fëmijës dhe të familjes së tij, me qëllim verifikimin e progresit në zbatimin e PIM-it.

Neni 13

Bashkëpunimi në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje

1. Bashkëpunimi në menaxhimin e rastit të një fëmije në nevojë për mbrojtje kryhet kur është i nevojshëm koordinimi i veprimeve, ndërhyrjeve dhe ofrimi i shërbimeve në territorin e më shumë se një bashkie apo njësie administrative, për shkak të lëvizjes së vazhdueshme të fëmijës ose kur vendbanimi dhe vendqëndrimi i fëmijës janë të ndryshëm.

2. Nëse, gjatë procesit të vlerësimit fillestar, rezulton se fëmija apo familja e fëmijës banon në një bashki apo njësi administrative tjetër, të ndryshme nga ajo ku është identifikuar fëmija, atëherë PMF-ja, në rastet e rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm, ndërmerret të gjithë hapat për ofrimin e shërbimit të emergjencës e të vendosjes së masës emergjente të mbrojtjes dhe më pas referon rastin në bashkinë apo njësinë administrative ku ka vendbanimin fëmija, duke i dërguar edhe gjithë dokumentacionin e rastit, të administruar deri në atë kohë. PMF-ja e bashkisë apo njësisë administrative ku ka vendbanimin fëmija do të shërbejë më tej si menaxher rasti për fëmijën në nevojë për mbrojtje.

3. PMF-ja/NJMF-ja bëjnë referimin e rastit te PMF-ja/NJMF-ja përkatëse, ku do të ketë vendqëndrimin fëmija kur, gjatë procesit të identifikimit, vlerësimit të plotë dhe marrjes së një mase mbrojtjeje fëmija vendoset në përkujdesje alternative në një institucion, të afërm apo person, të cilët ndodhen në një territor të ndryshëm nga ai i bashkisë apo njësisë administrative nga ajo ku është identifikuar fëmija.

Në çdo rast, së bashku me referimin e rastit, PMF-ja dërgon edhe një kopje të dokumentacionit përkatës të vlerësimit fillestar dhe të identifikimit. PMF-ja e bashkisë apo njësisë administrative ku ka vendqëndrimin fëmija do të shërbejë, më tej, si menaxher rasti për fëmijën në nevojë për mbrojtje.

4. Pas referimit të rasteve të përmendura në pikat 2 e 3, PMF-ja/NJMF-ja, e cila shërben si menaxher rasti, merr masat e duhura për vazhdimin e procesit për mbrojtjen e fëmijës, sipas këtij vendimi, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga PMF-ja/NJMF-ja referuese. Në çdo rast, PMF-ja kontakton fëmijën brenda 5 ditëve, pas referimit të rastit nga PMF-ja/NJMF-ja referuese.

5. PMF-ja/NJMF-ja referuese bashkëpunon me PMF-në/NJMF-në ku ka vendbanimin apo vendqëndrimin fëmija, në lidhje me ndjekjen e procedurave gjyqësore për konfirmimin e masës së mbrojtjes apo të vendosjes në kujdestari, si edhe për çdo informacion apo dokumentacion që kërkohet nga PMF-ja/NJMF-ja, e cila menaxhon rastin pas referimit.

6. Nëse, për arsye të ndryshme, fëmija kalon një pjesë të kohës ose kryen aktivitete të ndryshme në territorin e bashkisë apo të njësisë administrative ku është identifikuar ose në një bashki apo njësi administrative tjetër, atëherë PMF-ja/NJMF-ja e bashkisë/njësisë administrative ku ka vendbanimin apo vendqëndrimin fëmija, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, bashkëpunon me PMF-në/NJMF-në përkatëse për të realizuar një Plan Individual Mbrojtjeje të përbashkët.

Në këto raste, PMF-ja/NJMF-ja fton në mbledhjen e GTN-së edhe PMF-në/NJMF-në e bashkisë apo njësisë administrative tjetër, me qëllim koordinimin dhe ndarjen e detyrave për zbatimin e PIM-it.

Neni 14

Transferimi i rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje

1. PMF-të/NJMF-të transferojnë rastin të PMF-të/NJMF-të e një bashkie apo njësie administrative tjetër kur prezumohet se fëmija do të zhvendoset apo është zhvendosur me vendbanim apo vendqëndrim në territorin e një bashkie apo njësie administrative të ndryshme nga ajo që ka bërë identifikimin e rastit dhe ekzistojnë premiset që fëmija të qëndrojë në mënyrë të përhershme apo për një kohë relativisht të gjatë në të. Në këto raste PMF-ja/NJMF-ja referuese dërgon kopje të dosjes së fëmijës të PMF-ja/NJMF-ja pritëse dhe e konsideron rastin të mbyllur.

2. Në çdo rast, nëse fëmija kthehet përsëri në bashkinë apo njësinë administrative të mëparshme, atëherë PMF-ja/NJMF-ja pritëse referon rastin sërish për transferim ose kërkon bashkëpunim në menaxhim në bashkinë/njësinë administrative ku ndodhet fëmija, duke përcjellë edhe dosjen e dokumentacionin e administruar për fëmijën.

Neni 15

Mbyllja e rastit

1. PMF-ja raporton të GTN-ja për mbylljen e rastit nëse, pas rishqyrtimit të PIM-it, rezulton se:

- a) Veprimet, ndërhyrjet e ndërmarra dhe shërbimet e ofruara sipas planit janë kryer, fëmija është jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera për fëmijën;
- b) Individët kanë mbushur moshën 18 vjeç. Nëse PMF-ja vlerëson se fëmija, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç, ka ende nevojë për shërbime, rasti do të referohet për marrjen e shërbimeve të përshtatshme të strukturat që mbulojnë shërbime për këtë grup-moshë dhe në përputhje me nevojat e individit;
- c) Fëmija vdes;
- ç) Fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqëndrim dhe dosja e tij është transferuar.

2. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki miraton mbylljen e rasteve të mësipërme, bazuar në rekomandimin përkatës të PMF-së.

3. PMF-ja, në çdo rast, plotëson formularin për mbylljen e rastit (aneksi nr. 9), i cili bëhet pjesë e dosjes individuale të rastit.

Neni 16

Mbajtja dhe raportimi i të dhënave

1. Të gjitha të dhënat, informacioni, veprimet, ndërhyrjet e ndërmarra, shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura gjatë procesit të menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje dokumentohen nga strukturat përkatëse në nivel vendor dhe qendror.

Të gjitha të dhënat dhe informacioni i përfutur ruhen, përpunohen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve nënligjore përkatëse, duke zbatuar detyrat dhe procedurat e parashikuara në këtë vendim.

Detyrimi për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale shtrihet për të gjithë personat dhe institucionet e përfshira në procesin e menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje.

2. PMF-ja u shpjegon fëmijës dhe anëtarëve të familjes që informacioni që ajo merr, lidhur me identifikimin dhe trajtimin e rastit, nuk mbahet sekret, por regjistrohet në dosjen individuale të fëmijës. Informacioni i marrë përdoret për ndërmarrjen e veprimeve, të ndërhyrjeve dhe dhënien e shërbimeve për fëmijën në nevojë dhe për anëtarët e familjes, duke ruajtur konfidencialitetin ndaj personave të tjerë dhe ndaj publikut në përgjithësi, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. PMF-ja u shpjegon atyre se informacioni do të ndahet vetëm kur dhe në masën që është e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës dhe pasi të jetë informuar fëmija dhe familja.

3. Çdo anëtar i GTN-së, i përfshirë në menaxhimin e rastit, nënshkruan një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit në mbledhjen e parë të GTN-së.

4. PMF-ja krijon, për të gjitha rastet në menaxhim, dosjen individuale të fëmijës, e cila mbahet, administrohet dhe ruhet në dosjen individuale:

a) Të fëmijës, e cila është në format letre dhe përmban nënshkrimet origjinale në dokumentet përkatëse;
b) Në format elektronik, e cila përmban të dhëna dhe informacion të përditësuar në formularët elektronikë (Regjistrin Elektronik të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror), sipas formularëve të përcaktuar në këtë vendim, si dhe dokumentet me nënshkrime origjinale të skanuara.

5. PMF-ja do të hapë dhe do të administrojë dosjen individuale të fëmijës për të gjitha rastet kur fëmija rezulton në nevojë për mbrojtje dhe është në rrezik të mesëm, të lartë apo të menjëhershëm.

6. PMF-ja nuk do të hapë dosje individuale të fëmijës në rast se, pas vlerësimit fillestar, rezulton se fëmija nuk është në nevojë për mbrojtje. Në këto raste, PMF-ja do të marrë masa për referimin e fëmijës pranë institucioneve përgjegjëse për ndjekje të situatës apo ofrimin e shërbimit të nevojshëm. Informacioni dhe të dhënat e rastit do të hidhen në regjistrin elektronik të posaçëm.

7. NJMF-ja merr masa dhe mbikëqyr PMF-në, në lidhje me hedhjen e të dhënave dhe të informacionit për fëmijët në nevojë për mbrojtje në dosjet individuale përkatëse.

8. NJMF-ja i raporton dy herë në vit, më 30 maj dhe 30 nëntor, drejtorit të strukturës së shërbimeve shoqërore, në lidhje me të dhënat statistikore për situatën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, bazuar në rezultatet e nxjerra nga regjistri elektronik për fëmijët në nevojë për mbrojtje. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki i paraqet këto rezultate në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, ku diskutohet buxheti dhe kërkon përditësimin e fondit për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës, nëse kjo është e nevojshme.

Neni 17

Dosja individuale e fëmijës

1. Dosjes individuale të fëmijës në nevojë për mbrojtje i caktohet numri individual, i cili është numri identifikues i fëmijës përgjatë gjithë procesit të menaxhimit të rastit.

2. Dosja individuale përmban:

- Aneksin 1. Formulari për identifikimin proaktiv;
- Aneksin 2. Formulari i raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- Aneksin 3. Formulari i vlerësimit fillestar;
- Aneksin 4. Formulari për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime;
- Aneksin 5. Formulari i intervistimit;
- Aneksin 6. Formulari i vlerësimit dhe analiza e rrezikut;
- Aneksin 7. Formulari i PIM-it;
- Aneksin 8. Formulari i shqyrtimit të progresit dhe PIM-i i rishikuar;
- Aneksin 9. Formulari i mbylljes së rastit;
- Aneksin 10. Procesverbali për marrjen e fëmijës në mbrojtje të menjëhershme;
- Aneksin 11. Formulari i miratimit për ndarjen e informacionit;
- Aneksin 12. Formulari “Fletë të ditarit”, në të cilin pasqyrohen në mënyrë të detajuar datat dhe orët e të gjitha kontakteve me familjen/ fëmijën ose me anëtarët e GTN-së, përfshirë përmbledhjet e diskutimeve, të takimeve dhe vizitave në shtëpi;
- Informacione të tjera të rëndësishme, si certifikata e lindjes, vendimet gjyqësore etj.;
- Procesverbale të shërbimeve, procesverbale të marrjes në mbrojtje dhe kthimit të fëmijës në familje.

3. Të dhënat në format letre ruhen në një mjedis të sigurt, të aksesueshëm vetëm nga PMF-ja. Të gjithë formularët e plotësuar me dorë duhet të plotësohen me stilolaps dhe jo me laps, duke përdorur shkrim të qartë e të kuptueshëm për një lexues tjetër.

4. PMF-ja merr masa të plotësojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë, dosjen individuale të fëmijës.

KREU III

ZBATIMI I MASAVE TË MBROJTJES

Neni 18

Masa emergjente e mbrojtjes

1. PMF-ja njofton menjëherë drejtorin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, inicion procesin për mbrojtjen e menjëhershme të fëmijës dhe vendosjen e masës emergjente të mbrojtjes nëse, pas referimit apo gjatë vlerësimit fillestar, rezulton se fëmija është:

a) Në situatë të rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo forme tjetër dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së

Shtetit apo të prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku qëndron fëmija nuk është i sigurt për të;

b) Braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;

c) Pa përkujdesje prindëror, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situata të tilla, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

2. Në rastet kur përmbushen kushtet e pikës 1, PMF-ja, fillimisht, merr masa për garantimin e sigurisë fizike të fëmijës dhe vendosjen e tij në përkujdesje alternative. Për këtë, PMF-ja vlerëson, së pari, mundësinë për vendosjen e fëmijës pranë një të afërmi ose një familjeje kujdestare dhe, nëse kjo nuk është e mundur, identifikon e njofton shërbimin e strehimit emergjent më të përshtatshëm për fëmijën.

3. PMF-ja merr masa për të shoqëruar fëmijën te personi i afërm, familja kujdestare apo shërbimi i strehimit emergjent për fëmijë. Në çdo rast, PMF-ja dhe personi apo përfaqësuesi i institucionit ku vendoset fëmija nënshkruajnë procesverbalin për marrjen e fëmijës në mbrojtje të menjëhershme (aneksi nr. 10), i cili përmban arsyet për marrjen e këtij vendimi. PMF-ja i shpjegon personit/institucionit detyrat që ai ka për të garantuar sigurinë dhe përkujdesjen për mirëqenien e fëmijës. Në rastet kur vlerësohet e nevojshme dhe rrethanat e rastit e kërkojnë për shkak të kushteve të emergjencës, PMF-ja shoqërohet nga punonjësi i policisë.

4. PMF-ja, pasi ka garantuar fillimisht sigurinë fizike të fëmijës, i propozon drejtorit të strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki marrjen e masës emergjente të mbrojtjes. PMF-ja bazohet në të dhënat e administruara në formularin e referimit për mbrojtjen e fëmijës, intervistën e kryer me fëmijën dhe/ose persona të tjerë, të cilët kanë dijeni për ngjarjen, procesverbalin për marrjen në mbrojtje të fëmijës në rrezik të menjëhershëm dhe dërgon kopje të këtyre dokumenteve bashkëngjitur propozimit për marrjen e masës emergjente të mbrojtjes. Në rast se fëmija është mbi 14 vjeç, PMF-ja dërgon edhe miratimin me shkrim të fëmijës, sipas aneksit nr. 10, për masën emergjente të mbrojtjes. Në rastet kur fëmija nuk është në gjendje të shkruajë, për shkak të aftësisë së kufizuar apo nivelit arsimor, atëherë miratimi i fëmijës bëhet nëpërmjet regjistrimit audio.

5. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore miraton masën emergjente të mbrojtjes brenda 24 orëve nga identifikimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje. Drejtori nuk e miraton masën emergjente nëse gjatë kësaj kohe janë verifikuar kushtet për rikthimin e fëmijës në familje dhe rrethanat që çuan në vlerësimin e rrezikut emergjent nuk janë më të vlefshme.

6. PMF-ja lajmëron prindin apo kujdestarin, në lidhje me vendimin për marrjen e masës emergjente të mbrojtjes dhe pasojën e saj për mosushtimin e përgjegjësisë prindërore nga ana e tyre, për sa kohë zgjat masa e mbrojtjes. PMF-ja nuk i tregon prindit vendndodhjen e fëmijës.

PMF-ja informon fëmijën, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm për të drejtën e tyre për të paraqitur ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës së mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore.

7. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës:

a) Merr masa për thirrjen e GTN-së në një mbledhje të jashtëzakonshme, brenda 5 ditëve pune nga marrja e masës emergjente të mbrojtjes, me qëllim realizimin e vlerësimit të plotë të rastit dhe hartimin e PIM-it;

b) Viziton dhe bisedon me fëmijën të paktën 1 herë, brenda 5 ditëve të para pasi është vendosur te personi apo institucioni i përcaktuar në masën emergjente të mbrojtjes;

c) Interviston, gjithashtu, personin, të cilit i është besuar fëmija, me qëllim marrjen e informacionit për fëmijën dhe hedh të dhënat e mbledhura në formularin e shqyrtimit të progresit (aneksi nr. 8);

ç) Harton dhe depoziton në gjykatën e rrethit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit për masën, kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, në të cilën përfshin edhe kërkimin për vendosjen e fëmijës në kujdestari, bazuar në vlerësimin e plotë. PMF-ja i bashkëngjit kërkesës të gjitha dokumentet e administruara deri atëherë për rastin, përfshirë edhe dokumente të marra nga strukturat e Policisë së Shtetit.

8. Në çdo rast, nëse PMF-ja nuk i disponon këto dokumente, i përshkruan ato dhe vë në dijeni gjykatën se ato mund të vihen në dispozicion nga strukturat e policisë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nëse fëmija është vendosur pranë një personi të afërm apo një personi të përfshirë në listën e familjeve kujdestare, atëherë PMF-ja i bashkëngjit kërkesës edhe të dhënat që disponon për këta persona. PMF-ja bashkëngjit, në çdo rast, procesverbalin e marrjes në përkujdesje të fëmijës, të nënshkruar nga personi apo institucioni pranë të cilit qëndron fëmija dhe kopje të masës së mbrojtjes, të miratuar nga drejtori.

9. PMF-ja merr pjesë dhe ndjek të gjitha seancat gjyqësore, në lidhje me konfirmimin e masës emergjente të mbrojtjes dhe vendosjen e fëmijës në kujdestari, si dhe përgatit dokumentet e kërkuara nga gjykata në

procesin gjyqësor.

10. PMF-ja lehtëson zbatimin e vendimit përfundimtar të gjykatës, në lidhje me masën e mbrojtjes dhe vendosjen në kujdestari të fëmijës, nën drejtimin e drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. Strukturat e shërbimit social shtetëror, rajonal, kanë detyrimin të ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë zbatimin e këtij vendimi.

11. Nëse gjykata e vendos fëmijën në kujdestari të një personi apo institucioni të ndryshëm nga ai i caktuar në masën emergjente të mbrojtjes, drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore/Shërbimi Social Shtetëror marrin masa për zbatimin e vendimit të gjykatës.

12. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes, të konfirmuar nga gjykata, PMF-ja vazhdon të monitorojë e të marrë masa për zbatimin e PIM-it për fëmijën.

13. PMF-ja, bazuar në ecurinë e rastit, vlerësimin e rrezikut dhe rishqyrtimin e PIM-it, i propozon GTN-së mbylljen e rastit, bazuar në të dhënat e hedhura dhe të administruara në formularin për mbylljen e rastit (aneksi nr. 9). Nëse GTN-ja e miraton propozimin për mbylljen e rastit, PMF-ja i paraqet propozimin drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, të cilit i bashkëngjit formularin për mbylljen e rastit dhe dokumentacionin që tregon se prindërit janë në gjendje të kujdesen vetë për fëmijën.

14. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, nëse e miraton propozimin, pajis me autorizim PMF-në për të paraqitur në Gjykatën e Rrethit kërkesën për heqjen e masës së mbrojtjes, nëse kanë pushuar shkaqet e vendosjes së saj. Gjykata shprehet në të njëjtin vendim edhe në lidhje me kthimin e fëmijës pranë prindërve, duke sjellë si pasojë përfundimin e kujdestarisë.

Neni 19

Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative

1. PMF-ja, bazuar në vlerësimin e plotë të rastit, harton projektin e PIM-it për fëmijën në nevojë për mbrojtje, i cili përfshin edhe propozimin për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative.

2. Projekti i PIM-it dhe masa e propozuar e mbrojtjes diskutohet dhe miratohet nga anëtarët e GTN-së. Masa e mbrojtjes, e propozuar, përcakton, si personin, ashtu edhe institucionin pranë të cilit do të vendoset fëmija, duke ndjekur radhën e përcaktuar në pikën 1, të nenit 57, të ligjit nr. 18/2017.

3. PMF-ja shoqëron propozimin për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative me informacionin nëse është e mundur vendosja dhe strehimi i fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij dhe kjo nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës. PMF-ja rekomandon, në rastin kur kjo nuk është e mundur, vendosjen e fëmijës te një nga personat e përfshirë në listën e familjeve kujdestare, i cili rezulton i përshtatshëm për fëmijën.

PMF-ja propozon si alternativë të fundit vendosjen e fëmijës në institucion të përkujdesjes për fëmijë.

4. Projekti i PIM-it përfshin edhe ndërhyrjet apo shërbimet që duhet të ndërmerren për të riaftësuar familjen, me qëllim kthimin e fëmijës në familje brenda një periudhe sa më të shkurtër të mundshme, si dhe rekomandimin për kalendarin e takimeve të fëmijës me prindin apo të afërm të tjerë gjatë periudhës së masës së mbrojtjes.

5. PMF-ja i propozon drejtorit të strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, nëse konstatohet se, megjithë ndërhyrjet dhe shërbimet e ofruara në kuadër të PIM-it, niveli i rrezikut nuk është ulur dhe vlerësohet se është në interesin më të lartë të fëmijës të largohet nga mjedisi familjar.

6. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki miraton masën e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative brenda 24 orëve.

7. PMF-ja harton dhe depoziton në gjykatën e rrethit gjyqësor kërkesën për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative. PMF-ja i bashkëngjit kërkesës të gjitha dokumentet e administruara deri në atë moment për rastin. Kërkesës, nëse ka, i bashkëlidhen edhe dokumente të marra nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Neni 20

Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar

1. Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar vendoset për fëmijën, i cili:

a) Ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes;

b) Mund të qëndrojë me njërin nga prindërit, i cili ka aftësinë dhe mundësitë për t'u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë nga veprimet e prindit tjetër, që dyshohet ose provohet se e ka dhunuar, abuzuar,

shfrytëzuar apo neglizhuar fëmijën. Prindi nuk banon apo, për shkak të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje apo urdhri mbrojtjeje, nuk lejohet të frekuentojë të njëjtën banesë apo mjedis familjar me atë ku ndodhet fëmija në nevojë për mbrojtje;

c) Dyshohet ose ka kryer veprë penale dhe është nën moshën e përgjegjësisë penale.

2. PMF-ja, në çdo rast, vlerëson nëse rrethanat e lejojnë që fëmija të trajtohet dhe të mbrohet pranë familjes.

3. PMF-ja, gjatë vlerësimit të plotë lidhur me vendosjen e masës së mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar, merr parasysh, por pa u kufizuar në, informacionin për:

a) Situatën, për të cilën kërkohet dhe është e nevojshme marrja në mbrojtje e fëmijës;

b) Marrëdhënien prindërore;

c) Qasjen e prindërve ndaj fëmijës;

ç) Aftësinë e tyre për të marrë përgjegjësi dhe për të ofruar kujdesin e duhur për fëmijën;

d) Sigurinë e fëmijës, nëse familja përbën rrezik për fëmijën.

4. MASA e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar përfshin:

a) Objektiva konkretë që duhet të përmbushin familja dhe fëmija gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj mase;

b) Aktivitete specifike apo shërbime që duhet të kryejë apo marrë fëmija dhe familja, me qëllim arritjen e këtyre objektivave;

c) Caktimin e personave përgjegjës, që do të mbikëqyrin fëmijën bashkë me PMF-në.

5. PMF-ja i propozon GTN-së marrjen e masës së mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar, si pjesë e PIM-it, duke përcaktuar edhe anëtarët e GTN-së që do të mbështesin PMF-në në zbatimin e tij. Masa i dërgohet për miratim drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, së bashku me projektin e PIM-it, i cili merr vendim brenda 24 orëve për këtë masë.

6. PMF-ja njofton fëmijën dhe prindin, në lidhje me masën e mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar dhe detyrimet gjatë kohës së vlefshmërisë së kësaj mase.

PMF-ja nënshkruan me prindërit/prindin e fëmijës apo kujdestarin ligjor dhënien e miratimit për caktimin e kësaj mase sipas formularit X. Nëse prindi nuk jep miratimin për këtë masë, PMF-ja merr në konsideratë propozimin e një mase tjetër mbrojtjeje në kuadër të PIM-it.

7. PMF-ja, e shoqëruar nga një punonjës tjetër i NJMF-së/NJVNR-së/drejtorisë përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki ose një anëtar i GTN-së, viziton në mënyrë periodike dhe sporadike, me ose pa njoftim dhe në orare të ndryshme gjatë ditës fëmijën e vendosur në masën e mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar. Të dhënat e mbledhura gjatë vizitave në familje hidhen në fletët e ditarit, pjesë e dosjes individuale të fëmijës.

8. PMF-ja e bën më të lehtë dhe monitoron zbatimin e PIM-it për fëmijën lidhur me këtë masë mbrojtjeje.

9. PMF-ja raporton për ecurinë e PIM-it të fëmijës te GTN-ja dhe, nëse nuk ekzistojnë më shkaqet, të cilat çuan në vendosjen e kësaj mase, i propozon drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore marrjen e vendimit për përfundimin e masës së mbrojtjes.

KREU IV

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE E TË STRUKTURAVE PËR MENAXHIMIN E RASTIT

Neni 21

Roli dhe përgjegjësitë e PMF-së në menaxhimin e rastit

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka këto përgjegjësi:

a) Bën identifikim proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo si rrjedhojë e raportimeve / referimeve të marra nga institucionet e tjera, OJF-të, anëtarët e komunitetit, publiku, vetë fëmijës/ëve dhe medias;

b) Bashkëpunon me policinë, Shërbimin Social Shtetëror dhe aktorë të tjerë të nevojshëm në menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

c) Inicion dhe kryen vlerësimin fillestar për të gjithë rastet e fëmijëve të referuar në NJMF-të, në nivel bashkie apo te PMF-të, në nivel njësie administrative;

ç) Organizon dhe koordinon takimet e GTN-së për vlerësimin e plotë të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe bën ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve për menaxhimin e tij;

d) Harton projektplanet individuale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe ia paraqet ato për diskutim GTN-së;

dh) Bën denoncimin në polici të rasteve të abuzimit, të ndodhura apo të dyshuara, që përbëjnë veprë

penale, me qëllim parandalimin dhe garantimin e një mbrojtjeje sa më efektive;

e) Përgatit dhe zbaton një plan për të punuar drejtpërdrejt me fëmijët dhe familjet;

ë) Ofron këshillim psikosocial dhe mbështetje për fëmijët dhe familjet, duke vlerësuar rrethanat e nevojat e rastit;

f) Vepron si menaxher i rastit dhe është përgjegjës për zbatimin e monitorimin e Planit Individual të Mbrojtjes, shërben si person kontakti për fëmijën, për të cilin është dhënë një masë mbrojtjeje, pavarësisht nëse fëmija është lënë në përkujdesje të prindit apo është vendosur në përkujdesje alternative;

g) Ndërmerr dhe ndjek procedurat ligjore për konfirmimin e masës emergjente apo të masës së mbrojtjes në gjykatën kompetente;

gj) Kryen detyrat e lëna nga gjykata, lidhur me vendosjen e fëmijës në kujdestari pas konfirmimit të masës emergjente apo të masës së mbrojtjes;

h) Harton dhe paraqet në gjykatë kërkesën për lëshimin e “Urdhrit të mbrojtjes” nga dhuna në familje, në situata kur kjo është e nevojshme për fëmijën apo për njërin prind;

i) Merr masa dhe kërkon nga strukturat përgjegjëse caktimin e përfaqësuesit procedural për fëmijët viktima dhe dëshmitarë të përfshirë në një proces penal;

j) Administron të dhëna të sakta dhe faktike për të gjitha rastet e menaxhuara e të referuara të fëmijëve pranë NJMF-së në bashki ose pranë PMF-së në njësinë administrative.

Neni 22

Roli dhe përgjegjësitë e strukturave të Policisë së Shtetit

Punonjësi i strukturave të policisë ka këto përgjegjësi:

a) Bën identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative;

b) Merr masa, në rastet e fëmijëve në rrezik të menjëhershëm, për mbrojtjen e fëmijëve dhe referimin e tyre pranë NJMF-së ose PMF-së;

c) Bashkëpunon me NJMF-në ose PMF-në për plotësimin e kërkesëpadisë, për lëshimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes nga dhuna në familje, kur fëmijët janë në rrezik të lartë ose të menjëhershëm, pavarësisht marrjes së masës emergjente të mbrojtjes nga ana e drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

ç) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet zhvillimin e zbatimin e PIM-it për fëmijën;

d) Bashkëpunon me PMF-në, sipas nevojave të rastit, e shoqëron PMF-në gjatë kryerjes së vizitave në familje, si dhe gjatë identifikimit të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik të lartë ose të menjëhershëm;

dh) Mbështet dhe bashkëpunon me PMF-në për zhvillimin e aktiviteteve informuese, me qëllim parandalimin e dhunës dhe/ose abuzimin ndaj fëmijëve;

e) Cakton personin përgjegjës, i cili do të asistojë punonjësit e institucionit për raportimin e rasteve të identifikuar dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.

Neni 23

Roli dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë, Drejtorisë së Antitrafikut dhe Migracionit dhe Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit

Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit dhe Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit kanë këto përgjegjësi:

a) U kushtojnë vëmendje të veçantë identifikimit të fëmijëve refugjatë ose azilkërkues, që janë në nevojë për mbrojtje;

b) Njoftojnë menjëherë Policinë e Shtetit dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor në rast identifikimi të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

c) Veçojnë fëmijën nga abuzuesi apo nga abuzuesi i mundshëm, duke lejuar hyrjen në mjediset ku mbahet fëmija vetëm të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe mundësuar atyre që të takohen me fëmijën;

ç) Bashkëpunojnë me NJMF-në/PMF-në dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës gjatë gjithë procesit të menaxhimit dhe marrjes në mbrojtje të fëmijës;

d) Ofronjë mbështetje të drejtpërdrejtë për këtë kategori fëmijësh, duke përfshirë koordinimin me agjenci/institucione publike dhe /ose private.

Roli dhe përgjegjësitë e Shërbimit Social Shtetëror Rajonal

1. Shërbimi Social Shtetëror Rajonal ka përgjegjësitë, si më poshtë vijojnë:
 - a) Bën identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë;
 - b) U kërkon institucioneve të përkujdesjes për fëmijë të pranojnë e të ofrojnë përkujdesje alternative për fëmijët, për të cilët është dhënë masa emergjente e mbrojtjes apo masa e mbrojtjes për vendosjen në përkujdesje alternative.
2. Drejtuesi i Shërbimit Social Shtetëror Rajonal cakton personin përgjegjës që do të asistojë punonjësit e institucionit për raportimin e rasteve të identifikuarra dhe do të bëjë koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit, si dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.
3. Personi përgjegjës, i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, ka këto detyra:
 - a) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet për zhvillimin dhe zbatimin e PIM-it për fëmijën;
 - b) Merr masa për koordinimin dhe bashkëpunimin e PMF-së e të institucioneve të përkujdesjes për të siguruar pranimin në kohë dhe pa vonesa të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
 - c) Asiston, në bashkëpunim me policinë dhe aktorë të tjerë të nevojshëm, PMF-në në menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve, edhe jashtë orarit zyrtar të punës.

Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore

1. Punonjësit e institucioneve arsimore, çdo mësues dhe çdo ofruer i shërbimit psikosocial në shkolla, bëjnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë.
2. Drejtuesi i institucionit arsimor cakton personin përgjegjës që do të asistojë punonjësit e institucionit, për raportimin e rasteve të identifikuarra dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.
3. Personi përfaqësues i institucionit arsimor, i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni:
 - a) Është përgjegjës për lehtësimin dhe mbështetjen e zbatimit e PIM-it, i cili parashikon ndjekjen e shkollës nga fëmijët në nevojë për mbrojtje;
 - b) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet zhvillimin e zbatimit e PIM-it për fëmijën;
 - c) Merr masa që fëmijës në nevojë për mbrojtje t'i sigurohen tekste dhe mjete shkollore falas.

Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve shëndetësore, publike dhe private

1. Punonjësit e institucioneve shëndetësore, publike apo private, kanë këto përgjegjësi:
 - a) Bëjnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë;
 - b) Përgatisin raportin mjekësor mbi gjendjen shëndetësore të fëmijës, në rastin e identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
 - c) Marrin masa për ofrimin e ndihmës mjekësore, duke përfshirë kontrollet mjekësore, analizat e zhvillimit të fëmijës, ofrimin e barnave falas.
2. Drejtuesi i institucionit shëndetësor cakton personin përgjegjës, që do të asistojë punonjësit e institucionit për raportimin e rasteve të identifikuarra dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.
3. Personi përgjegjës, i caktuar sipas pikës 2, të këtij neni:
 - a) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet zhvillimin dhe zbatimin e PIM-it për fëmijën;
 - b) Mbështetet dhe bashkëpunon me NJMF-në për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme informuese, me qëllim parandalimin e dhunës dhe/ ose abuzimin ndaj fëmijëve.

Roli dhe përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve për fëmijë, publike dhe private

1. Punonjësit e ofruesit të shërbimeve për fëmijë, publike ose private, bëjnë identifikimin e fëmijëve

në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë.

2. Drejtuesi i ofruesit të shërbimeve cakton personin përgjegjës, që do të asistojë punonjësit e institucionit për raportimin e rasteve të identifikuara dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.

3. Personi përgjegjës, i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni:

a) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet për zhvillimin e zbatimit të PIM-it për fëmijën, si dhe në ofrimin e shërbimeve për fëmijën dhe familjen;

b) Mban kontakte të vazhdueshme me PMF-në, i cili shërben si menaxher rasti për fëmijën, ndaj të cilit ofrohen shërbimet në kuadër të PIM-it, si dhe njofton PMF-në në lidhje me çdo situatë që ndikon në mirëqenien, zhvillimin apo rrezikon sigurinë e fëmijës.

Neni 28

Roli dhe përgjegjësitë e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve është përgjegjëse për:

a) Koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim garantimin e mbrojtjes së fëmijëve;

b) Marrjen në konsideratë të çdo rasti fëmije në nevojë për mbrojtje, si dhe vlerësimin e çdo indicieje, që përbën dyshim të bazuar, për të verifikuar e shqyrtuar çdo rrethanë apo situatë të caktuar, e cila mund të jetë apo të ekspozojë fëmijën në një rrezik për mbrojtjen e tij;

c) Ofrimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, në lidhje me menaxhimin e rasteve të caktuara, si dhe ofrimin e asistencës në menaxhimin e trajtimin e këtyre rasteve, përfshirë koordinimin me agjenci të tjera publike ose private, si dhe/ose ofrues të shërbimeve.

KREU V

FINANCIMI I SHPENZIMEVE PËR ZBATIMIN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES

Neni 29

Financimi i shpenzimeve

1. Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në njësitë e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për hartimin e kërkesës buxhetore për fondin për mbrojtjen e fëmijëve, i cili është i nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

2. Parashikimi dhe krijimi i këtij fondi është pjesë e buxhetit dhe e programit buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe merr në konsideratë:

a) Fondin e shpenzuar për trajtimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të menaxhuara nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës apo PMF-ja, në njësitë administrative, në vitin paraardhës;

b) Parashikimin për fondin e nevojshëm për menaxhimin e rasteve të reja që mund të identifikohej, të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

c) Fondin e nevojshëm për ofrimin e shërbimit të emergjencës.

3. Këshilli Bashkiak miraton fondin për mbrojtjen e fëmijëve, bazuar në propozimin e ardhur nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

4. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki është përgjegjës për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të emergjencës, i cili organizohet me personel dhe struktura (qendra) të vetë bashkisë ose duke i kërkuar kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore prokurimin e këtij shërbimi dhe kontraktimin e OJF-ve apo entitete të tjera private, në kuadër të zbatimit të linjës buxhetore të fondit të mbrojtjes së fëmijëve.

Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki vë në dijeni, zyrtarisht, strukturat e Policisë së Shtetit për shërbimin e emergjencës për mbrojtjen e fëmijëve, duke u komunikuar edhe kontaktet dhe listën e personelit përkatës.

5. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki, në rast se shërbimi i emergjencës nuk mbulon trajtimin dhe mbulimin e shpenzimeve për zbatimin e PIM-it, i dërgon strukturës përkatëse në bashki kërkesën për prokurimin e shërbimeve për rastet individuale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në kuadër të zbatimit të PIM-it dhe mbulimin e këtyre shpenzimeve nga fondi i mbrojtjes së fëmijës.

6. Struktura përkatëse në bashki, në varësi të situatës, mund të bëjë prokurim për raste individuale (*ad-hoc*) ose prokurim për trajtim të një numri të caktuar rastesh gjatë një viti kalendarik, duke kontraktuar një OJF ose entitet privat, i cili do të shërbejë si lehtësues i zbatimit të PIM-it, duke mbuluar shpenzimet për shërbimet dhe ndërhyrjet e nevojshme për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe/ose për familjen e tyre.

7. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki merr masa, së bashku me NJMF-në dhe PMF-në, të monitorojnë ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e PIM-it nga OJF-të apo ofruesit privatë të kontraktuar për dhënien e shërbimit të emergjencës apo të trajtimit të rasteve të tjera të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

ANEKSET

ANEKSI 1

FORMULARI PËR IDENTIFIKIMIN PROAKTIV

Formulari për identifikimin proaktiv		
DATA:	ORA:	PUNONJËSI I NJMF-së:
<ul style="list-style-type: none">▪ Njësia Bashkiake nr. _____▪ Bashkia/qyteti: _____		
VENDNDODHJA:		
FORMA PËRMES SË CILËS ËSHTË BËRË IDENTIFIKIMI:		
<ul style="list-style-type: none"><input type="checkbox"/> Vizita në terren (data dhe anëtarët e skuadrës së terrenit): _____<input type="checkbox"/> Njoftim nga:<ul style="list-style-type: none"><input type="checkbox"/> person fizik ose juridik<input type="checkbox"/> punonjës i institucioneve publike dhe private<input type="checkbox"/> medias së shkruar, elektronike apo medias sociale		
EMRI I FËMIJËS/I PRINDËRVE/I KUJDESTARËVE/I SHOQËRUESVE		
MOSHA E FËMIJËS _____	FËMIJË TË TJERË (që ndodhen me fëmijën)	
GJINIA E FËMIJËS _____		
TË DHËNA PARAPRAKE MBI SITUATËN NË TË CILËN GJENDET FËMIJA, NEVOJA PËR MBROJTJE DHE MASAT QË DUHET TË MERREN		

--

ANEKSI 2

FORMULARI I RAPORTIMIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

FORMULARI I RAPORTIMIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJEN

Emri /identiteti i fëmijës:	Data e lindjes:	Gjinia
Emri dhe adresa e prindit/e kujdestarit:		Vendndodhja e fëmijës/adresa ku po qëndron fëmija:
Shenjat e abuzimit/neglizhimit/dhunës së mundshme <i>(shenja fizike, sjellja e fëmijës, informacione të tjera mbi gjendjen e fëmijës):</i>		Lloji i abuzimit i dyshuar/konstatuar: <ul style="list-style-type: none"><input type="checkbox"/> dhunë fizike<input type="checkbox"/> dhunë seksuale<input type="checkbox"/> dhunë psikologjike<input type="checkbox"/> shfrytëzim ekonomik<input type="checkbox"/> trafikim<input type="checkbox"/> fëmijën në situatë rruge<input type="checkbox"/> neglizhim

Të dhëna të tjera mbi situatën e fëmijës:

Përmbledh informacione të tjera që sugjerojnë se fëmija është në situatë rreziku dhe burimin e rrezikut.

Arsyet për raportim: Shqetësimi për mbrojtjen e fëmijës:

Emri dhe detajet e kontaktit të personit që ka bërë identifikimin:	Emri dhe detajet e kontaktit të personit që bën raportimin:	
Firma	Emri dhe kontaktet e personit/institucionit, të cilit i dërgohet formulari:	Formulari është dërguar: <i>- Email: nga adresa</i>

		<hr/> - Postë: Data:
--	--	---

ANEKSI 3
FORMULARI I VLERËSIMIT FILLESTAR

Formulari i vlerësimit fillestar	
Emri i fëmijës:	Nr. i regjistrimit (kodi):
Mosha/data e lindjes:	Gjinia:
Data kur është bërë raportimi i rastit:	Vlerësimi është bërë nga:
Personi fizik juridik që ka bërë raportimin:	
Arsyeja përse është bërë raportimi:	
Shërbimet/strukturat në kontakt me fëmijën:	Shkolla:

ARSYEJA PËRSE ËSHITË BËRË REFERIMI

Sfondi Familjar /përmbledhje e historive të fundit/ngjarje kritike:

Vlerësimi i nivelit të rrezikut:

Rrezik i menjëhershëm

Shpjegim. Në rrezik të menjëhershëm konsiderohet situata në të cilën gjendet fëmija, i cili në momentin e identifikimit, nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe nëse libet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë, të abuzohet seksualisht, trafikohet apo të jetë pre e keqtrajtimit të tjera të konsideruara veprë penale sipas Kodit Penal. Ndërhyrja në këtë rast duhet të jetë urgjente dhe të sigurojë largimin e fëmijës nga situata e rrezikut.

Rrezik i lartë

Shpjegim. Është situata në të cilën gjendet fëmija, i cili për shkak të faktorëve të ndryshëm, *rrezikon që të dëmtohet rëndë, të jetë subjekt i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme apo të dëmtohet në mënyrë të tillë që të vuajë nga paaftësi të përhershme apo t'i rrezikohet seriozisht mirëqenia nëse nuk merren masa për të mbrojtur fëmijën.*

Rrezik i mesëm

Shpjegim. Është situata në të cilën gjendet fëmija, për të cilin nuk ka të dhëna që të jetë në rrezik për të pësuar dëmtime të rënda apo të ketë pësuar dëmtime të rënda, por ekziston mundësia që fëmija të dëmtohet apo të abuzohet, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur atë. Ndërhyrja për të mbrojtur fëmijën dhe për të ofruar shërbime është e domosdoshme.

Rrezik i ulët

Shpjegim. Është situata në të cilën gjendet fëmija, i cili është relativisht i sigurt, nuk vuan nga dëmtime që kanë ardhur si rrjedhojë e abuzimit dhe ka aftësi për të mbrojtur veten. Megjithatë, vlerësohet se ka prezencë të faktorëve të rrezikut dhe se fëmija mund të bëhet pre e abuzimit, dhunës, neglizhimit apo shfrytëzimit, nëse nuk realizohen ndërhyrje për t'i ofruar respektimin dhe aksesin në të drejta apo nëse nuk i ofrohen shërbimet për të cilat fëmija ka nevojë

MASAT E MBROJTJES NË VARËSI TË NIVELIT TË RREZIKUT

<input type="checkbox"/> Masa emergjente e mbrojtjes	<input type="checkbox"/> Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative
<input type="checkbox"/> Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në ambientin familjar	
Firma e PMF-së	Firma e drejtorit të shërbimeve shoqërore në bashki

Data:	Data:
--------------	--------------

ANEKSI 4
FORMULARIN PËR VIZITAT NË SHTËPI DHE VËZHGIME

Formulari për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime		
DATA/ORA:	MBIEMRI I FAMILJES:	PUNONJËSI
Kush është i pranishëm:		

	Nuk ka shqetësim	Ka pak shqetësim	Ka shumë shqetësime	Komente/ shënime
Mjedisi fizik				
<i>A është e përshtatshme shtëpia? Për shembull, ka hapësira të mjaftueshme? A ka ujë pa ndërprerje/ tualet? A është mjaftueshëm e ngrohtë?</i>				
<i>A është shtëpia e pastër dhe e rregullt? A ka ndonjë tregues që mund të ketë rreziqe për shëndetin e fëmijës?</i>				
<i>A ka një vend të përshtatshëm për fëmijën ku të flejë?</i>				
<i>A ka rreziqe fizike të dukshme? Për shembull, xhama, thika dhe objekte të mprehta që gjenden rrotull ose pranë një rrugë të ngarkuar?</i>				

<i>A ka lodra të disponueshme që përshtaten me moshën e fëmijës?</i>				
--	--	--	--	--

Vëzhgimi dhe sjellja e fëmijës

<i>A është i veshur fëmija në mënyrën e duhur?</i>			
<i>A është i pastër fëmija?</i>			
<i>Duke mbajtur parasysh moshën e fëmijës, a i përmbushin ata etapat e një zhvillimi normal?</i>			
<i>A është ndërveprimi i fëmijës me ju i përshtatshëm, duke mbajtur parasysh moshën e tyre?</i>			
<i>A është e folura dhe gjuba në përputhje me moshën e tyre?</i>			
<i>A luan fëmija/ a e mbush kohën e tij/ saj në mënyrën e duhur?</i>			
<i>A i ndjek fëmija udhëzimet/ kërkesat?</i>			
<i>A ka shenja abuzimi, si p.sh., ka nxirje ose dëmtime të pashpjegueshme?</i>			
<i>A ka ndonjë sjellje e cila mund të përbëjë shqetësim ose e cila mund të mos duket “normale”?</i>			

Ndërveprimi prind–fëmijë

<i>A ka ndonjë veprim fizik/ të përçemërt ndërmjet prindit dhe fëmijës?</i>			
<i>A bën prindi komente pozitive për fëmijën në prani të fëmijës?</i>			
<i>A është ndërveprimi prind–fëmijë udhëzues (kontrollues) apo ata i lënë fëmijës mundësi zgjedhjeje?</i>			
<i>A shihet prindi dhe fëmija në sy?</i>			

<i>A duket se ka një marrëdhënie të ngrohtë dhe të natyrsbme ndërmjet prindit dhe fëmijës (apo fëmija duket i frikësuar/ i kujdesur)?</i>			
<i>A duket i lumtur fëmija?</i>			
<i>A duket se ka një dallim të dukshëm në sjellje ose qëndrim ndaj fëmijëve të ndryshëm në familje?</i>			
<i>Nëse ka fëmijë të tjerë në shtëpi, a duket se marrëdhëniet mes fëmijëve është e përshtatshme? Ndonjëri nga fëmijët a po dominon ose po ushtron bullizëm ndaj të tjerëve?</i>			
Prezantimi i prindërve/adultëve			
<i>A paraqet prindi pritshmëri jorealiste për fëmijën / sjelljen e tyre?</i>			
<i>A flet prindi me negativitet për fëmijën/ duket shumë kritik?</i>			
<i>A duket sikur prindi kontrollon tërësisht sjelljen e tyre ose a duken ata sikur janë nën ndikimin e drogës, alkoolit etj.?</i>			
<i>A ka ndonjë shenjë të dhunës në familje brenda familjes?</i>			
<i>A ka ndonjë shenjë ose a përmendet ndonjë vështirësi në marrëdhëniet ndërmjet adultëve në shtëpi?</i>			
<i>A përmend prindi ndonjë sjellje për kujdesin e fëmijës që mund të jetë shkak për një shqetësim? Për shembull, ndëshkimi trupor.</i>			
<i>A ka ndonjë gjë të “çuditshme”, ose shqetësuese mbi sjelljen e prindërve që mund të sugjerojë praninë e problematikave të rëndësishme, si p.sh., probleme me shëndetin mendor?</i>			

<i>A ishte prindi agresiv/ mbrojtës gjatë vizitës?</i>			
PAS VIZITËS/Vëzhgime			

Cilat ishin dinamikat gjatë vizitës?

A patët mundësi të flisnit me fëmijën në mënyrë individuale? Nëse po, a keni ndonjë element që do të donit ta trajtonit?

A ka ndonjë çështje/problematikë që ka nevojë të ndiqet?

Duke menduar për vizitën në shtëpi, a jeni të shqetësuar për mirëqenien/sigurinë e fëmijës? A mendoni që ata janë përballë ndonjë risku? Nëse po, atëherë ju lutem përmendi përse.

ANEKSI 5
FORMULARI I INTERVISTIMIT

<p>Formulari i intervistimit për fëmijët ose personat e tjerë të familjes</p> <p><i>Formulari përdoret në intervistat individuale me fëmijën ose personat e tjerë të familjes</i></p>		
Data/ora:	Mbiemri i familjes:	Punonjësi:
Personi/at e pranishëm gjatë intervistës:		
Arsyeja e intervistës me anëtarin/ët e familjes:		
Marrëdhënia e të intervistuarit me fëmijën:		

Përshkrimi i të dhënave të marra gjatë intervistës:

Identifikimi i problemeve/çështjeve për adresim nga intervista:

ANEKSI 6
FORMULARI I VLERËSIMIT DHE ANALIZA E RREZIKUT

Formulari i vlerësimit dhe analiza e rrezikut

Emri i fëmijës:

Nr. i regjistrimit (kodi):

Sfondi familjar/përmbledhje e historive të fundit/ngjarje kritike:

Zhvillimi dhe mirëqenia e fëmijës (fizike, emocionale, njohëse, shpirtërore etj. dhe çdo nevojë tjetër e veçantë, p.sh., aftësia e kufizuar):

Prezantimi dhe marrëdhënia e fëmijës me të tjerët (përfshirë familjen dhe miqtë):

Arsimimi:

Kapaciteti i prindërimit dhe aftësia për ta përballuar:

Funksionet familjare (marrëdhëniet dhe dinamikat):

Kushtet e jetesës dhe situata ekonomike/e punësimit:

Mbështetje nga familja/komuniteti i gjerë:

Histori të mëparshme abuzimi:

RISQET DHE RREZIQE PËR FËMIJËN:

Opinionet e prindërve/kujdestarëve:

Këndvështrimet/dëshirat e fëmijës:

Burime shtesë/mbështetja e disponueshme:

Pikat e forta të fëmijës dhe familjes:

Faktorët e identifikuar të rrezikut			
FËMIJA			
ABUZIMI/DHUNA			
Fizike	i dyshuar	abuzim i konfirmuar	në rrezik
	i dokumentuar	në familje	nga i huaj
	në institucion		
Seksuale	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
	i dokumentuar	në familje	nga i huaj
	në institucion		
Psikologjike/ emocionale	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
	i dokumentuar	në familje	nga i huaj
	në institucion		
Neglizhimi	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
	i dokumentuar	në familje	nga i huaj

	në institucion		
Situata shoqërore	punë joformale	e dëmshme	në rrezik shfrytëzimi
	punon në biznesin e familjes_____	shëgert	numri i orëve të punës në javë
Arsimimi	shkon rregullisht	frekuentim i çrregullt	mungesa të shpeshta
	nuk ka shkuar asnjëherë në shkollë	e ka lënë shkollën	analfabet
	pjesërisht analfabet	arsimimi në distancë	mungesa e mësuesit ndihmës për fëmijët me AK
Mbarëvajtja në shkollë	arritje të mira akademike	arritje mesatare	nivel i dobët arritjesh
	përparim i çrregullt		
Trajnimi profesional	skemë e qeverisë	kurs nga OJF-të	pret për një vend
	nuk ka kurse të përshtatshme ekzistuese		
Trafikimi	i dyshuar	në rrezik	i trafikuar më parë
	i kthyer në familje më parë	anëtarët e përfshirë të familjes	palët e treta të angazhuara
	hetim nga policia		
Të miturit e pashoqëruar	nga jashtë	brenda Shqipërisë	
Migrimi	nga jashtë	brenda Shqipërisë	i pajisur në vendndodhjen aktuale
Abuzimi i alkoolit/ drogës ose substancave	çfarë substance	i dyshuar	përdorues i konfirmuar
	shpeshtësi apo nivel përdorimi		

SHËNDETI			
Fizik	i shëndetshëm	të prera, të nxira të dukshme	gjymtyrë ose kocka të thyera
	probleme me zemrën	diabet	azëm
	gjendje kronike	merr ilaçe rregullisht	i paekzaminuar
Mendor	nuk ka probleme	i paekzaminuar	çrregullim i shëndetit mendor: gjendja, lloji
Aftësitë e kufizuara	fizike	probleme dëgjimi	probleme shikimi
	aftësitë në të nxënë: lloji	lëvizshmëri: e pavarur	Lëvizshmëri: ka nevojë për ndihmë me nevojat e përditshme të jetesës
ÇËSHTJET PSIKOLOGJIKE			
Sjellja	agresive	i tërhequr	hiperaktive
	largohet nga shtëpia ose shkolla	i shkakton dëm vetes	
Emocionale	ankth	ka frikë (nga çfarë)	xheloz
	mungesë vlerësimi për veten	i trishtuar/me depresion	lag ose ndot shtratin
	çrregullime në ngrënie	çrregullime gjumi	përqendrim i dobët apo i kufizuar
Trauma	pikëllim nga humbja	aksident madhor	fatkeqësi natyrore
Faktorë të tjerë zhvillimi	zhvillim në shkallë mesatare për moshën	vonesë në të folur	vonesë në zhvillimin fizik
	vonesë në zhvillimin emocional		

Marrëdhëniet mësues–nxënës	të mira	fushat e konfliktit: llojet	diskriminim
	dhunë fizike	abuzim emocional	
Marrëdhëniet shokë me shokë	i detyruar nga “të fortët”	dhunë fizike	kërcënime si fizike ashtu dhe/ose psikologjike
	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
FAMILJA			
Prindërit/ kujdestarët	të martuar dhe jetojnë bashkë	të ndarë	duke u divorcuar
	të divorcuar	[prind] i vetëm	i/e ve
	një nga prindërit ka vdekur	të dy prindërit kanë vdekur	mama dhe njerë
	baba dhe njerë	kushërinj të tjerë: marrëdhënia	
Motrat dhe vëllezërit	fëmijë i vetëm	fëmija më i madh	fëmija më i vogël
	vëllezër, sa?	motra, sa?	fëmijë të tjerë që jetojnë në familje: marrëdhënia
	të adoptuar	të birësuar	
Shëndeti	prindërit kanë sëmundje mendore	të dy apo njëri nga prindërit kanë një aftësi të kufizuar fizike ose të mësuarit	të dy apo njëri nga prindërit kanë një problem me alkoolin ose drogat
Dhuna në familje	i dyshuar	nivel dhe shpeshtësi e lartë	raporte të policisë
	trajtimit spitalor	raportimi i dhunës i tërhequr	në pritje akuze
Të ardhurat	varfëri ekstreme	varfëri afatgjate kronike	marrin vetëm ndihmë ekonomike

	mbështetur nga OJF-të	lutet	të ardhura nga familjarët jashtë vendit
	mbajnë kafshë dhe rrisin kafshë		
Punësimi	i rregullt	i pjesshëm	rastësor/joformal
	asnjë	i rrituri ka një aftësi të kufizuar dhe nuk mund të punojë	merr pension ose pension paaftësie
Strehimi	shtëpi e sigurt	me qira	pa shtëpi
	jeton në rrugë	strehim i papërshtatshëm ose i pasigurt	godinë me shumë njerëz
Hakmarrje gjakësie	i ekspozuar ndaj gjakmarrjes	i ngjuar	të afërm të familjes së zgjeruar të përfshirë në gjakmarrje
	fëmijë që nuk shkojnë në shkollë dhe nuk marrin kujdes shëndetësor		
Diskriminimi (etnik, gjinor, aftësitë e kufizuara)	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
	shumë i shpeshtë	i kufizuar	
BURIMET MJEDISORE OSE KOMUNITARE			
Aktivitetet e kohës së lirë	pranë shtëpisë së familjes	jo të pranishme në komunitet	prani e kufizuar
	salla bilardoje	kafene	bibliotekë
	fusha sportive	qendra kulturore	kinema
Rrjetet e besimit ose rrjetet e mbështetjes	asnjë	OJF	kishë
	xhami	shoqata grash	grupe të rinjsh

ANEKSI 7
FORMULARI I PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES

Formulari i planit individual të mbrojtjes

Nr. i regjistrimit (kodi): _____

Data e miratimit të Planit Individual të Mbrojtjes: _____

Data e rishikimit të Planit Individual të Mbrojtjes: _____

Veprimet e nevojshme	Nevojat për mbrojtje që adresojnë këto veprime	Personi përgjegjës	Afati kohor	Komente mbi progresin e arritur (datat)

Persona të përfshirë në hartimin e PIM-it (firmat)

Personat të cilët nuk bien dakord me PIM-in dhe arsyet pse:

Rishikimi dhe aprovimi nga drejtori i strukturës së shërbimeve sociale në bashki:

ANEKSI 8
FORMULARI I SHQYRTIMIT TË PROGRESIT/PLANIT INDIVIDUAL PËR MBROJTJEN
E FËMIJËS

FORMULARI I SHQYRTIMIT TË PROGRESIT/PLANIT INDIVIDUAL PËR MBROJTJEN E FËMIJËS		
Nr. i regjistrimit (kodi):	Data kur është bërë plani:	Data e shqyrtimit të radhës të progresit:

Ju lutemi konfirmoni nëse prindërit/fëmija ishte i pranishëm (nëse jo si u morën në konsideratë mendimet e tyre gjatë hartimit të planit?).

Datat e shqyrtimeve të mëparshme:

Dimensionet: nevojat e veçanta janë të identifikuar	Shërbimet e nevojshme për të përmbushur nevojat	Institucioni/struktura përgjegjëse dhe afati kohor	Përditësim gjatë shqyrtimit/ndryshim i planit
Nevojat për siguri:			
Strehimi/akomodimi dhe nevojat bazë:			
Shëndeti dhe nevoja për zhvillim (duke përfshirë nevojat fizike, emocionale dhe psikologjike):			
Arsimi dhe aftësitë e jetës:			

Marrëdhëniet sociale:			
Marrëdhëniet Familjare (përfshirë si do të mbahen kontaktet nëse fëmija do të shkëputet nga familja):			
Kulturor/identiteti:			
Nevojat për aktivitete shlodhëse:			
Çdo lloj tjetër i veçantë nevoje (p.sh., konsultime etj. për të ndihmuar në përmirësimin e situatës):			
Persona të përfshirë në rishqyrtimin e PIM-it (firmat)			
Personat të cilët nuk bien dakord rishqyrtimin e PIM-it dhe arsyet pse:			
Rishikimi dhe aprovimi nga drejtori i strukturës së shërbimeve sociale në bashki:			

--

ANEKSI 9
MBYLLJA E RASTIT

MBYLLJA E RASTIT	
Datë:	Nr. i regjistrimit (kodi)

Arsyet për referimin e parë dhe data e referimit:

Përse po mbyllet rasti? Si ka ndryshuar situata (jepni specifikat):

Këndvështrimet e fëmijës/prindërit lidhur me mbylljen:

Emrat e anëtarëve të grupit teknik ndërsektorial që morën pjesë në vendimin për mbylljen e rastit (firmë):

Data e mbylljes së rastit:

Firma e PMF-it: _____

Firma e drejtuesit të strukturës së shërbimeve sociale në bashki

ANEKSI 10
PROCESVERBALI PËR MARRJEN E FËMIJËS NË MBROJTJE TË MENJËHERSHME

Vendi: _____, datë ____ . ____ . ____ ,

Të dhënat e fëmijës: (emër/mbiemër) _____, gjinia: _____, data e lindjes (mosha): _____

Vendbanimi _____, nr. i dokumentit identifikues (nëse ka) _____

Emër i prindërit/i kujdestarit nëse dihet: _____

Përshkrim i shkurtër i arsyeve/i shkaqeve që çojnë në nevojën për marrje në mbrojtje të menjëhershme:

Vendi ku vendoset fëmija i marrë në mbrojtje të menjëhershme:

a) *I afërm i fëmijës:* _____

b) *Familje kujdestare:* _____

c) *Institucioni i përkujdesjes/shërbimi i emergjencës:* _____

Punonjësi i Policisë

(emër/mbiemër/firmë)

(emër/mbiemër/firmë)

Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës

I afërm i fëmijës/familja kujdestare/personi përgjegjës pranë institucionit ose shërbimit të emergjencës

(emër, mbiemër, firmë)

ANEKSI 11
FORMULAR MIRATIMI PËR NDARJEN E INFORMACIONIT

Miratimi për ndarjen e informacionit

..... është përgjegjëse për sigurimin e mirëqenies dhe të drejtave të të gjithë fëmijëve që janë të regjistruar në këtë zonë.

Për të garantuar se çdo fëmije i ofrohet shërbimi i përshtatshëm është shpesh e nevojshme të ndahet informacion personal i mbledhur nga fëmija dhe pjesëtarët e familjes me autoritete/organizata të tjera.

Kjo formë kërkon miratimin tuaj, për ndarjen e informacionit thelbësor të mbledhur nga punonjësi/ja e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, së cilës i është caktuar rasti i fëmijës suaj, me specialistë të cilët mund të jenë në gjendje të ndihmojnë në punën për Mbrojtjen e Fëmijës.

Unë..... (emri mbiemri i fëmijës dhe/ose prindit/i kujdestarit) bie dakord që punonjësi/ja e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, e caktuar në, mund të ndajë informacionin thelbësor, në lidhje me(emri mbiemri i fëmijës), me autoritetet e administratës publike, policinë ose organizatat jofitimprurëse, siç konsiderohet e nevojshme, për të mbrojtur mirëqenien dhe të drejtat e fëmijës së përmendur.

Firma:

Fëmija/prindi/kujdestari/kujdestari

Firma:

Punonjësja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve

Data:

ANEKSI 12
FLETA E DITARIT

Ky formular duhet të përdoret për të regjistruar TË GJITHA veprimet dhe kontaktet që bëhen në lidhje me një rast dhe mbahet në dosjen e fëmijës. Kur përdoret një bllok shënimesh, informacioni nga blloku i shënimeve DUHET të pasqyrohet në këtë formular.

FLETA E DITARIT				
Nr. i regjistrimit (kodi)	Data/ ora	Metoda e komunikimit (p.sh., përmes telefonit, vizitës, takimit)	Përmbledhje e kontaktit	Veprime të ndërmarra ose të sugjeruara

--	--	--	--	--

VENDIM
Nr.597, datë 4.9.2019

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE PËRDORIMIT TË FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, pikat 1, 4, e 5, 16, pika 2, dhe 21 të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. SUBJEKTET, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE

1. Ndihma ekonomike shpërndahet sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.
2. Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:
 - a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;
 - b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
 - c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
 - ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;
 - d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.
3. Ndihma ekonomike për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, është një pagesë që jepet në formën e një shpërblymimi mujor në lekë, e cila kufizohet në kohë për një periudhë jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike nuk aplikohet për:
 - a) familjet, anëtarët e së cilës janë mbi moshë pune;
 - b) familjet me kryefamiljare gra, me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë.
4. Për të përfutur ndihmë ekonomike, subjektet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 4.1.Për familjet në nevojë, kryetari i familjes/njëri nga anëtarët madhorë, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kërkojnë të aplikojnë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative, ku kanë vendbanimin, duke paraqitur, si më poshtë vijon:
 - a) Kopjen e kartës së identitetit të aplikantëve.
 - b) Certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës /vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende.
 - c) Për rastet që janë në proces zgjidhjeje martese dhe ende nuk ka një vendim gjykatë të formës së prerë, dokumentacioni i përcaktuar në pikën 4.1, të këtij kreu paraqitet i ndarë nga secili bashkëshort. Krahas këtij dokumentacioni paraqitet edhe vërtetimi i gjykatës që bashkëshortët janë në proces zgjidhjeje martese.
 - ç) Për familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuara, që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, krahas dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4.1, të këtij kreu paraqesin edhe kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

d) Për fëmijët e familjeve në nevojë, që ndjekin arsimin bazë, paraqesin edhe vërtetimin për ndjekjen e shkollës të lëshuar nga shkolla, i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor, për të përfituar pagesën shtesë.

dh) Për fëmijët e familjeve në nevojë që vaksinohen, paraqesin edhe fotokopje nga libri i shëndetit të fëmijës për vaksinën e kryer, sipas kalendarit të detyrueshëm për grupmoshat e fëmijëve, për të përfituar pagesën shtesë.

e) Për familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë anëtarë në moshë aktive pune, që ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, krahas dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4.1, paraqesin edhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni arsimor, i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar një herë brenda një viti shkollor.

4.2. Jetimët, të cilët nuk janë në institucione të përkujdesjes shoqërore, paraqesin pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative:

a) kopjen e kartës së identitetit;

b) kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për statusin e jetimit, të ndryshuar;

c) për jetimët që ndjekin arsimin bazë, paraqesin edhe vërtetimin për ndjekjen e shkollës, të lëshuar nga shkolla, i cili paraqitet 2 (dy) herë brenda vitit akademik, për të përfituar pagesën shtesë;

ç) për jetimët që vaksinohen paraqesin edhe fotokopje nga libri i shëndetit të fëmijës për vaksinën e kryer, sipas kalendarit të detyrueshëm për grupmoshat e fëmijëve për të përfituar pagesën shtesë.

4.3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë, plotësojnë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4.1, të këtij kreu. Dokumentacioni duhet të përfshijë edhe vlerësimin e situatës social-ekonomike të kryer nga administratori shoqëror që vërtetoon se është familje në nevojë.

4.4. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre, paraqesin:

a) kopjen e kartës së identitetit;

b) vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve të fundit.

4.5. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, paraqesin:

a) kopjen e kartës së identitetit;

b) urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, për rastet e parashikuara në shkronjën "d", të pikës 2, të këtij kreu.

II. PROCEDURA E APLIKIMIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE

1. Administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, të dhënat e mëposhtme:

a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, dhe që përmbledh informacionin për:

i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin;

ii) llojin e banesës;

iii) pasuritë/asetet familjare;

iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera.

2. Administratori shoqëror, pasi verifikon situatën social ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren, brenda muajit të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike,

hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat sipas formularit në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Administratori shoqëror paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike;

4. Anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet e situatës social-ekonomike të familjes, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përfitimin e ndihmës ekonomike.

5. Administratorët shoqërorë janë të detyruar që dokumentet e përcaktuara në pikën 4, të kreut I, dhe në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të kreut II, të këtij vendimi, t'i ruajnë ato sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e dokumentacionit.

6. Ndryshimi i vendbanimit të përfituesve të ndihmës ekonomike shoqërohet me transferimin e dokumentacionit pranë bashkisë/njësisë administrative të vendbanimit të ri.

7. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki dërgon, në formë shkresore dhe elektronike, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë nën juridiksionin e bashkisë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për trajtim me ndihmë ekonomike, brenda datës 15 të çdo muaji, sipas formatit në shtojcën 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, për realizimin e procesit të vendimmarrjes për përfituesit e ndihmës ekonomike, ka këto përgjegjësi:

a) verifikon të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar si dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe në bazë të aplikimit të formulës së pikëzuar për familjet në nevojë;

b) merr vendime për caktimin e familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, masën e përfitimit të tyre si edhe refuzon kërkesën për dhënien e përfitimit të ndihmës ekonomike të shoqëruar me arsyet e refuzimit, sipas formatit në shtojcën 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) ia dërgon vendimin kryetarit të bashkisë:

i. për të njoftuar kërkuar për përfitimin e ndihmës ekonomike;

ii. për të kryer veprimet financiare për pagesën për përfituesit e ndihmës ekonomike.

9. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror realizon procesin e vendimmarrjes brenda muajit të aplikimit të qytetarëve për ndihmë ekonomike.

10. Strukturat e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, mjeku i familjes dhe administratori shoqëror koordinojnë procesin e dhënies së ndihmës ekonomike, duke bërë të mundur dhënien e informacionit për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë, për personat e grupmohës 35–70 vjeç. Administratori shoqëror ka detyrimin të njoftojë 3 (tri) muaj rresht, para muajit të lindjes, personat e grupmohës 35–70 vjeç që përfitojnë ndihmë ekonomike për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë, në një nga ditët e muajit të lindjes. Personi i njoftuar është i detyruar të paraqitet në muajin pasardhës të muajit të lindjes me një vërtetim nga qendra shëndetësore që ka kryer kontrollin mjekësor bazë. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendrike, nëpërmjet strukturave rajonale të tij, dërgon informacionin e nevojshëm pranë administratorit shoqëror.

11. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë gjashtëmuajore, familjet të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes që jetojnë në të njëjtën strehë, kur nuk krijohet një kurorë e re, me përjashtim të rastit vajzë-nënë;

b) Nuk tërheq ndihmën ekonomike brenda afateve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si shëndetësore apo fatkeqësi;

c) Refuzon verifikimin e situatës social-ekonomike në familje;

ç) Fsheh informacionin apo kryen deklaram të rremë;

d) Nuk paraqiten për deklaram dhe/ose nuk deklarojnë ndryshimet e situatës social-ekonomike çdo tre muaj pranë administratorit shoqëror, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si shëndetësore apo fatkeqësi, dhe të anëtarëve të familjes, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara, invalidë pune ose të moshuar, të cilët janë në pamundësi lëvizjeje;

dh) Refuzojnë përfshirjen në kurset e formimit profesional për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

e) Kanë anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim dhe banojnë në fshat;

ë) Anëtarët në moshë aktive pune, të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të familjeve që kanë anëtarë, që ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, por jo më shumë se deri në moshën 25 vjeç.

12. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë njëvjeçare familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre qoftë edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Është në moshë aktive pune dhe refuzon ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

b) Punësohen dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, me përjashtim të rasteve kur zgjidhja e kontratës bëhet nga ana e punëdhënësit;

c) Ka kryer më shumë se një deklaram të rremë;

ç) Ato familje, të cilat rezultojnë me të ardhura dhe kushte të mira social-ekonomike.

13. Pagesat e ndihmës ekonomike, në masën e përcaktuar në kreun III, të këtij vendimi, paguhën nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë bashkive/njësive administrative ku ka vendbanimin përfituesi. Bashkia merr masa që këto pagesa të merren të plota nga përfituesit dhe të mos tarifohen/komisionohen.

14. Njësia administrative, me kërkesë të qytetarit, e pajis atë me dokument që vërteton se trajtohet me ndihmë ekonomike, duke përcaktuar masën e përfitimit dhe periudhën e trajtimit.

III. MASA E NDIHMËS EKONOMIKE

1. Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndihmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe individët e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të këtij vendimi.

2. Masa e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë përcaktohet sipas strukturës së familjes dhe shkon deri në 150 për qind e masës së pensionit social dhe e indeksuar. Masa e ndihmës ekonomike indeksohet nga Shërbimi Social Shtetëror sa herë indeksohet pensioni social dhe në bazë të këtij indeksi.

3. Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzime për mënyrën e përlllogaritjes së masës së ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.

4. Kur në përbërjen e strukturës së familjes, për efekt të llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike, mbetet vetëm një anëtar, masa e ndihmës ekonomike për këtë të fundit është ajo e llogaritur për këtë anëtar.

5. Për bashkëshortët në proces zgjidhjeje martese, kur ende nuk ka një vendim gjyqate të formës së prerë, masa e ndihmës ekonomike për secilin bashkëshort do të jetë e përlllogaritur në bazë të strukturës së familjes, sipas pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi.

6. Masa e ndihmës ekonomike, në muaj, për prindërit e fëmijëve të lindur është, si më poshtë vijon:

a) Trinjakë 3 000 (tre mijë) lekë, për çdo fëmijë;

b) Katërnjakë 4 000 (katër mijë) lekë, për çdo fëmijë;

c) Pesënjakë 5 000 (pesë mijë) lekë, për çdo fëmijë.

Kjo ndihmë ekonomike përfitohet deri në mbarimin e arsimit bazë, por jo më shumë se 18 vjeç.

7. Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre.

8. Masa e ndihmës ekonomike për çdo viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare që nuk trajtohet në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të përcaktuar në urdhrin e mbrojtjes apo urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet gjatë periudhës së vlefshmërisë të urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

9. Masa e ndihmës ekonomike për çdo jetim është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet nga jetimët që nuk janë në institucione deri në çastin e punësimit të tyre.

10. Anëtarët e familjes, fëmijë/jetimët që nuk janë në institucione për të cilët vërtetohet që ndjekin arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç, marrin një shtesë në masën 300 (treqind) lekë në muaj gjatë vitit shkollor.

11. Anëtarët e familjes, fëmijë/jetimët që nuk janë në institucione për të cilët vërtetohet se janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinimit, marrin një shtesë në masën 100 (njëqind) lekë, për çdo vaksinë të kryer.

12. Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune apo individ, përfitues i ndihmës ekonomike, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

13. Anëtarit të familjes në nevojë, që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuan dënimin me heqje lirie ose që trajtohet me mjekim të detyruar me vendim gjykate, në institucionet mjekësore të posaçme, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

14. Të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike për familjet në nevojë e ka bashkëshortja e kryefamiljarit. Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, të drejtën e tërheqjes e ka kryetari i familjes.

IV.PËRDORIMI I FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE

1. Këshilli bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

2. Këshilli bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, duke përdorur fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

3. Fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike është 6 për qind e këtij fondi dhe mbi këtë fond mund të shtohen ose jo edhe fonde të buxhetit vendor.

4. Akordimi i fondit deri në 6 për qind do t'i shtohet çeljes faktike të çdo 2-mujori që transferohet për përfituesit e ndihmës ekonomike të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit.

5. Familjet në nevojë, në momentin që do të përzgjidhen nga lista e familjeve, duhet të kenë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar për ndihmë ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.

6. Familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, do të miratohen me vendim të këshillit bashkiak.

7. Për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social-ekonomik në familje nga administratori shoqëror, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Administratori shoqëror, gjatë periudhës së trajtimit me fondin deri në 6 për qind, nëse verifikon që ka ndryshime të situatën social ekonomike, referon familjen për të aplikuar në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike apo ndërpret periudhën e përfitimit në rast të punësimit të anëtarëve të familjes.

9. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki harton projektvendimin për familjet në nevojë nën juridiksionin e bashkisë, në bazë të propozimeve dhe të vlerësimeve social-ekonomike të ardhura nga administratori shoqëror, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

10. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki përllogarit fondin për mbulimin e familjeve në nevojë që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike dhe e dërgon për miratim në këshillin bashkiak.

11. Masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese nga ky fond llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përllogaritjes së masës së strukturës së familjes, për familjet përfituese të ndihmës ekonomike.

12. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki grumbullon dhe përgatit informacione, statistika për numrin e familjeve përfituese të trajtuara nga ky fond dhe fondin e realizuar të cilat i dërgojnë pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

13. Nuk mund të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike:

a) familjet të cilat nuk kanë aplikuar për ndihmë ekonomike nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar;

b) familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike sipas kërreve I, II dhe III, të këtij vendimi.

V. PROCEDURA E ANKIMIMIT ADMINISTRATIV

1. Aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykojnë se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njesisë administrative, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr.955, datë 7.12.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale të nxjerrë udhëzimet në zbatim të vendimit.

3. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



FORMULAR APLIKIMI
PËR NDIHMË EKONOMIKE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Email: info@shendetesia.gov.al Tel: +355 4 2376 178 Web: www.shendetesia.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Shtetësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/> <i>(Ju lutem specifikoni rrugën, bllokun, nr. e banesës/ apartamentit)</i>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Rajoni:	<input type="checkbox"/> Bregdetar <input type="checkbox"/> Qendror <input type="checkbox"/> Malor <input type="checkbox"/> Tirana	13. Zona:	<input type="checkbox"/> Urbane <input type="checkbox"/> Rurale
14. Kodi Postar	<input type="text"/>	15. E-mail	<input type="text"/>
16. Nr. Celular	<input type="text"/>	17. Nr. Tel. Fiks	<input type="text"/>

SEKSIONI A2: INFORMACION SPECIFIK MBI ADMINISTRATORIN SOCIAL

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>		

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

1. Grupi etnik:	<input type="checkbox"/> Shqiptar <input type="checkbox"/> Grek <input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Maqedonas <input type="checkbox"/> Malazeze <input type="checkbox"/> Vllahe <input type="checkbox"/> Tjetër <i>(specifiko)</i> <input type="text"/>
2. Gjuha në të cilën do të dëshironi të merrni informacion të mëtejshëm në lidhje me aplikimin tuaj:	<input type="text"/>
3. A përfiton pagesë të aftësisë së kufizuar/pension invaliditeti ndonjë nga anëtarët e familjes?	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo

Certifikatë familjare:

<p>Listoni emrat e të gjithë anëtarëve të familjes:</p>	<p>NID (Nr. i identifikimit personal) Shënoni N/A nëse nuk keni asnjë pjesëtar</p>	<p>Seksi: 1= M 2= F</p>	<p>Datëlindja (data/muaji/viti)</p>	<p>Mosha:</p>	<p>Marrëdhënia me kryefamiljarin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Kryefamiljari <input type="checkbox"/> Bashkëshortja/ Partneri <input type="checkbox"/> Fëmija/ fëmija i adoptuar <input type="checkbox"/> Nipër <input type="checkbox"/> Mbesa <input type="checkbox"/> Baba/ mama <input type="checkbox"/> Motër/ vëlla <input type="checkbox"/> Dhëndër/ nuse <input type="checkbox"/> Kunatë/ kunata <input type="checkbox"/> Gjysh/ gjyshe <input type="checkbox"/> Vjehërr/ vjehërra <input type="checkbox"/> Të afërm të tjerë <input type="checkbox"/> Jo të afërm 	<p>Gjendja civile:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> I martuar <input type="checkbox"/> Divorcuar/ Ndarë <input type="checkbox"/> J etojnë së bashku <input type="checkbox"/> I ve/vejushë <input type="checkbox"/> Beqar 	<p>A përfiton [EMR] pagesë të aftësisë së kufizuar/ pension invaliditeti/ ndihmë ekonomike si individ ?</p> <p>1=Po 2=Jo</p>	<p>Kryerja e vaksinimit sipas kalendarit të detyrueshëm për grup moshat e fëmijëve</p> <p>1=Po 2=Jo</p>
---	--	---------------------------------	-------------------------------------	---------------	---	--	--	---

ARSIMI DHE PUNËSIMI

4. Arsimi më i lartë i arritur:

- | | |
|---|---|
| <input type="checkbox"/> Asnjë | <input type="checkbox"/> Arsimit profesional 4-5 vjet |
| <input type="checkbox"/> Arsimit fillor 4-vjeçar | <input type="checkbox"/> Pasuniversitar në Shqipëri |
| <input type="checkbox"/> Përfundimtar 8/9 vite arsim fillor | <input type="checkbox"/> Përfunduar universitetin në Shqipëri |
| <input type="checkbox"/> Arsimit mesëm i përgjithshëm | <input type="checkbox"/> Përfunduar universitetin jashtë Shqipërisë |
| <input type="checkbox"/> Arsimit profesional 2-3 vjet | <input type="checkbox"/> Pasuniversitar jashtë Shqipërisë |

PËR TË GJITHË PERSONAT NË FAMILJE QË JANË 16 VJEÇ E LART

Nr	A jeni duke ndjekur arsimin e mesëm apo të lartë? Niveli bachelor? Niveli Master? Doktoraturë?	A keni punuar në 4 javët e fundit? Përfshirë punën e papaguar në një fermë apo biznes familjar apo edhe disa orë punë si e rastësishme?	Nëse ju nuk keni punuar, a keni pasur një punë nga e cila keni munguar përkohësisht?	Në këtë punë ju jeni: 1 = Një punonjës i dikujt i cili nuk është anëtar i familjes; 2 = Punëtor me pagesë në një fermë familjare apo biznes tjetër; 3 = Punëdhënës; 4 = Punëtor me llogari më vete (i vetë-punësuar); 5 = Punëtor i papaguar në fermë/ biznes familjar 6 = Të tjera__	A keni të drejtë të përfitoni nga skema e sigurimeve shoqërore në këtë punë?	Sa ishte pagesa juaj e fundit apo fitimet NETO? (Nëse i intervistuari ende nuk është paguar, PYETET: Çfarë pagese presin?) Cilën periudhë kohore mbulon kjo pagesë / apo fitim?	Sa është pagesa/ fitimi juaj i zakonshëm NETO? Çfarë periudhe kohore mbulon kjo pagesë? (merr parasysh kohën e 12 muajve të fundit, nëse ju keni filluar punë më pak se 12 muaj më parë, merr në konsideratë mesataren qysh nga fillimi)	Njësia në kohë		Njësia kohore	
								Muaj	1	Muaj	1
1											
2								15 ditë	2	15 ditë	2
3								javore	3	javore	3
4								ditore	4	ditore	4
5								Lekë	Njësia kohore	Lekë	Njësia kohore
6											
7											
8											
9											
10											

BANESA, UJË/DRITA/GAZ DHE MALLRA TË QËNDRUESHËM

5. Tipi i banesës:

- Shtëpi private
 Apartament
 Të tjera (specifiko)

6. Numri i dhomave që ka familja

(përfshijto kuzhinën, ballkonin, korridoret dhe banjat)

7. Gjendja e njësisë së banimit:

- Gjendje shumë e mirë
 E përshtatshme për jetesë
 E papërshtatshme për jetesë
 Në ndërtim

8. Lloji i banjës që ka banesa:

- Tualet brenda shtëpisë Tualete jashtë me kanalizim
 2 ose më shumë tualete brenda shtëpisë Tualete jashtë pa kanalizim
 Të tjera (specifiko)

9. Të tjera:

- Kuzhinë të ndarë Papafingo
 Dush/vaskë të ndarë Garazh
 Ballkon ose tarracë Ashensor
 Aneks gatimi

10. Statusi i pronësisë së ndërtesës:

- Pronar
 Pronar me një hua hipotekore për ndërtesën
 E marrë me qira nga një individ privat
 E marrë me qira nga shteti
 Jetoj falas/pa pagesë
 Të tjera (specifiko)

11. Distanca më e afërt e banesës nga _____ (matësi: në minuta):

Stacion Autobusi/
Furgoni Ambulancë/
doktor
Shkollë fillore

12. Burimi kryesor i ujit të përdorur në këtë familje:

- Ujë i rrjedhshëm brenda banesës Autobot me ujë
 Ujë i rrjedhshëm jashtë banesës Burim ose pus
 Lum, liqen, pellg ujqor ose diçka e tillë Çezmë publike
 Të tjera (specifiko)

13. Burimi i ngrohjes që përdoret në familje:

- Energji elektrike Qymyr
 Dru zjarri Ngrohje qendrore
 Gaz Naftë/vajguri
 Të tjera (specifiko)

14. Matësi i energjisë elektrike:

- Të përbashkët Individual
 Nuk ka matës

15. A përdor familja juaj gaz? Po Jo

16. Qëllimi i përdorimit të gazit:

- Ndryçim Gatim
 Ngrohje Aparate të tjera elektrike

ASETET FAMILJARE

17. Për çdo artikull të listuar më poshtë, ju lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron ato apo jo:

Artikulli	Për cdo artikull të listuar më poshtë, J u lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron apo jo?:
TV me ngjyra	
Tv pa ngjyra	
Video/DVD player	
Magnetofon/CD player	
Kamera/video kamera	
Frigorifer	
Frigorifer ftohës (ngrirës)	
Makinë larëse	
Pjatararëse	
Sobë me gaz/energji elektrike	
Sobë me vajguri	
Sobë me dru zjarri	
Kalorifer	
Gjenerator	
Makinë qepëse/thurëse	
Kondicioner	
Boiler	
Komputer	
Aparat marrës satelitor/aparat marrës kabllor	
Biçikletë	
Motoçikletë/ Motor me kubik të vogël	
Makinë/veturë	
Kamion	
Makinë Dumdum	
Mikrovalë	
Furnelë/ rezistencë	

18. A zotëron tokë familja juaj? Po Jo

19. A jep tokë me qera familja juaj? Po Jo

20. Cila është sipërfaqja e tokës ?

(në metra katror)

Sipërfaqja e zotëruar:

Sipërfaqja me qera:

21. A ka dikush në familjen tuaj ndonjë gjë të gjallë, shpezë, zgjua bletësh ose që angazhohet në akuakulturë?
(Nëse po, shënoni numrin e tyre)

Tipi	Numri
Lopë	
Derra	
Dele/dhi	
Shpezë	
Kuaj	
Gomar, Mushkë	
Dem	
Zgjuja bletësh	
Lepuj	
Peshk (akuakulturë)	

MBROJTJA SOCIALE

22. Në 12 muajt e fundit, a ka marrë ndonjë anëtar i familjes tuaj ndonjë pagesë nga burimet e mëposhtme?
(Plotëso tabelën më poshtë për të gjitha burimet)

Burimi	1 = Po; 2=Jo	Shuma e pagesës së fundit të familjes suaj (Lekë)	Numri i muajve që iu referohet kjo pagesë (Muaj)
Ndihma ekonomike			
Pagesa për aftësinë e kufizuar			
Pension pleqërie - Urban			
Pension pleqërie -Rural			
Pension suplementar			
Pension invaliditeti - Urban			
Pension invaliditeti- Rural			
Pension për merita të veçanta			
Pension për të mbijetuar - Urban			
Pension për të mbijetuar - Rural			
Asistencë papunësie			
Përfitimë për veteranë të luftës			
Pagesa për barrë lindje (përfshin pagesat e marra gjatë lejes së lindjes)			
Kujdesi social/ shërbimet për të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuar			
Pagesa të lejes së sëmundjes (1-6 muaj)			
Të tjera (specifik)			
Total të gjitha programet			

TË ARDHURA TË TJERA

23. Në 12 muajt e fundit a keni marrë pagesë nga burimet e mëposhtme (para në dorë apo formë tjetër pagesë) ju apo ndonjë anëtar tjetër i familjes tuaj? (Plotëso tabelën më poshtë për të gjitha burimet)

Nr	Burimi	1 = Po; 2=Jo	Shuma në total që ka marrë familja juaj në 12 muajt e fundit nga [BURIMI], përfshirë vlerën e ndonjë dhurate ose pagese në formë mallrash(Lekë)
1	Përfitim nga mbrojtja sociale (All SP)		
Remitanca/ dërgesa në të holla/ dhurata			
2	Remitanca/ dhurata nga të afërm jashtë shtetit		
3	Dhurata nga të afërm në Shqipëri		
4	Dhurata nga të afërm të tjerë (përfshirë dhurata për një ceremoni)		
5	Dhurata/ asistencë nga institucione		
Të ardhura nga qiratë			
6	Qira nga toka /por jo tokë bujqësore		
7	Qira nga apartamentet/shtëpia		
8	Qira nga dyqani, dyqanet etj		
9	Qira nga makina, kamioni apo automjete të tjera		
Të ardhura nga shitjet e aseteve			
10	Shitje e pronës së patundshme shtëpi, tokë, etj		
11	Shitje e mallrave të qendrueshëm të familjes		
12	Shitje e aseteve të tjera		
Të ardhura të tjera			
13	Nga ndonjë trashëgimi		
14	Fitime nga lotaritë apo bixhozi/kumari		
15	Të ardhura të tjera		
Të ardhura bujqësore			
16	Prodhime bujqësore të shitura /bimë bujqësore		
17	Produkte të shitura bujqësore si mjaltë, pije alkoolike (raki, verë), ushqim të përpunuar, etj		
18	Gjë e gjallë e shitur /shtazore		
19	Nënprodukte shtazore të shitura (vezë, qumësht, djath, lesh, lëkurë bagëtitish, etj		
20	Të ardhura në lekë në dorë ose kontribut në natyrë nga kooperativat bujqësore apo shoqata të tilla		

24. Të ardhurat neto mujore në total të familjes
(Shuma në total e të ardhurave të anëtarëve të familjes nga pagat / rrogat, mbrojtja sociale, pensionet, asistencë)

25. Shpenzimet totale mujore të familjes

26. Tjetër

(diçka që aplikanti dëshiron të thotë)

27. Emri i kryefamiljarit/bashkëshortes që do të administrojë shumën e ndihmës

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Autorizoj Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të dhënat konfidenciale të aplikantit:

Emri i Administratorit Social

Nr. i identitetit kombëtar të Administratorit Social

Emri i personit që hedh të dhënat

Vendi i intervistës

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.

Nënshkrimi i aplikantit

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Data Muaji Viti



FORMULAR APLIKIMI

VERIFIKIMI I SITUATËS SOCIAL-EKONOMIKE

SHËRBIMI SOCIAL SHETËTOR
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Email: info@shendetesia.gov.al Tel: +355 4 2376 178 Web: www.shendetesia.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/>
7. Vendlindja	<input type="text"/>		<i>Data Muaji Viti</i>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. E-mail	<input type="text"/>
14. Nr. Tel. Celular	<input type="text"/>	15. Nr. Tel. Fiks	<input type="text"/>

SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI ADMINISTRATORIN SOCIAL

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>		

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

DEMOGRAFIA E FAMILJES						
Nr.	Emër, Mbiemër	ID	A është i saktë informacioni rreth anëtarëve të familjes?	A është deklaruar saktë paaftësia?	A është deklaruar saktë statusi i të punësuarit?	A është deklaruar saktë arsimimi?
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						

BANESA, UJË/DRITA/GAZ DHE MALLRA TË QËNDRUESHËM

1. Tipi i banesës

2. Numri i dhomave që ka familja

(përfshijto kuzhinën, ballkonin, korridoret dhe banjat)

3. Cila është gjendja e njësisë së banimit?

4. A ka banesa juaj:

- Kuzhinë të ndarë
 Dush/vaskë të ndarë
 Ballkon ose tarracë
 Aneks gatimi
 Papafingo
 Garazh
 Ashensor

5. Cili është statusi i pronësisë së kësaj banese?

6. Çfarë burimi ngrohjeje përdorni kryesisht në familje?

7. A ka banesa matësin e vet të energjisë elektrike?

- Po Jo

8. A përdor familja juaj gaz?

- Po Jo

Cili është qëllimi i përdorimit të gazit?

- Ndrichim
 Ngrrohje
 Gatim
 Aparate të tjera elektrike

ASETET FAMILJARE

9. Për çdo artikull të listuar më poshtë, ju lutem tregoni nëse familja juaj i zotëron ato apo jo

Artikulli	Kodi	Kontrollo nëse asetet janë raportuar saktë
TV	101	
Frigorifer	106	
Makinë larëse	108	
Pjatararëse	109	
Sobë me gaz/energji elektrike	110	
Sobë me vajguri	111	
Sobë me dru zjarri	112	
Mikrovalë	125	
Kalorifer	113	
Makinë qepëse/thurëse	115	
Boiler	117	
Aparat marrës satelitor/aparat marrës kabllor	119	
Biçikletë	120	
Motoçikletë/motor me kubik të vogël	121	
Autoveturë (specifiko)	122	

10. A ka dikush në familjen tuaj ndonjë gjë të gjallë?

Asete, gjë e gjallë	Sasia/Njësia
<input type="checkbox"/> Lopë	
<input type="checkbox"/> Derra	
<input type="checkbox"/> Dele/dhi	
<input type="checkbox"/> Shpezë	
<input type="checkbox"/> Kuaj	
<input type="checkbox"/> Gomar, Mushkë	
<input type="checkbox"/> Dem	
<input type="checkbox"/> Zgjuar bletësh	
<input type="checkbox"/> Lepuj	
<input type="checkbox"/> Peshk (<i>akuakulturë</i>)	
<input type="checkbox"/> Tjetër (<i>specifiko</i>)	

11. Përshkrim i shkurtër i nivelit të jetesës së aplikantit

A përputhet niveli i jetesës me të ardhurat/konsumin e deklaruar? Të ardhurat janë deklaruar më pak apo më shumë?

Nënshkrimi i anëtarit të familjes

Data		Muaji		Viti			

Nënshkrimi i anëtarit të familjes

Data		Muaji		Viti			

Nënshkrimi i administratorit social

Data		Muaji		Viti			

Nënshkrimi i administratorit social

Data		Muaji		Viti			

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.

Nënshkrimi i aplikantit

Data		Muaji		Viti			

DEKLARATË E PARAQITJES ÇDO 3-MUAJ TË FAMILJES

Anëtarët madhore të familjes kërkuese për ndihme ekonomike paraqitet nga data 1 deri 10 çdo 3-muaj pranë administratoreve shoqëror në bazë të ligjit nr. 57 datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në RSH”.

Kryefamiljari _____

Adresa e Banimit _____

PËRBËRJA DHE GJENDJA E FAMILJEVE

Muaji _____

Nr.	Emri Mbiemri	Datëlindja Ditë muaj vit	Lidhja me kryefamiljarin	Gjendja aktuale
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				

Emri Mbiemri i personit që do të administroj paratë _____

Shënim: Te kolona Gjendja Aktuale të shkruhet shënimi përkatës për çdo anëtar të familjes. I punësuar, i vetpunësuar, i papunë, pensionist, nxënës, student, fëmijë, ushtar, në spital, jashtë shtetit, në institucione etj.

Keni ndryshim në deklaratën e Gjendjes Ekonomike dhe Sociale të familjes.

Po _____, JO _____ .Në rast se Po _____ shkruani ndryshimet përkatëse

Firmat

Emri Mbiemri

Datë _____ u marr në dorëzim nga Administratori Shoqëror

Firma _____

Logoja e Bashkisë

Prefektura _____

Bashkia _____

LISTË

Nr. ____ datë _____

**“E FAMILJEVE/INDIVIDËVE NË NEVOJË PËR TRAJTIM ME NDIHMË
EKONOMIKE PËR PERIUDHËN _____**

Duke u mbështetur në nenin 22/a të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në RSH”, struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki i dërgon Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror _____ listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë për trajtim me ndihmë ekonomike.

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera konkludojmë dhe propozojmë se:

1. Kanë aplikuar për ndihmë ekonomike _____ familje, lista bashkëlidhur.
2. Individë me statusin e Jetimit _____ persona, lista bashkëlidhur
3. Individë viktime të trafikimit _____ persona, lista bashkëlidhur
4. Individë viktime të dhunës në familje _____, lista bashkëlidhur
5. Prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh:
 - a) Trinjakë _____ familje, lista bashkëlidhur
 - b) Katernjakë _____ familje, lista bashkëlidhur
 - c) Pesënjakë e më shumë njëherësh _____ familje, lista bashkëlidhur
6. Fëmijë të vendosur në familje kujdestare1 _____ aplikime, lista bashkëlidhur
7. Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare2 _____ aplikime, lista bashkëlidhur

STRUKTURA PËRGJEGJËSE

Personi përgjegjës për ndihmën ekonomike

Titullari / Personi i autorizuar

Emri, Mbiemri firma

Emri, Mbiemri firma

Prefektura _____

Bashkia _____

Lista e plotë e familjeve të propozuara në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar.

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Dosje	Nr. anëtarëve	Lloji ndihmës

¹ Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, neni 24, pika 5

² Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, neni 24, pika 5

DREJTORIA RAJONALE _____

VENDIM

Nr. ____ datë _____

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUDHËN _____

Duke u mbështetur në nenin 20, pika 4 të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në RSH”, dhe në bazë të listës së plotë të plotë të familjeve/individëve në nevojë për trajtim me ndihmë ekonomike të Bashkisë _____, Drejtoria Rajonale _____.

Vendosi:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike pas aplikimit _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur.
2. Individë me statusin e Jetimit _____ persona, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
3. Individë viktime të trafikimit _____ persona, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
4. Individë viktime të dhunës në familje _____, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
5. Prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh:
 - a) Trinjakë _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
 - b) Katërnjakë _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
 - c) Pesënjakë e më shumë njëherësh _____ familje, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
6. Fëmijë të vendosur në familje kujdestare³ _____ aplikime, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
7. Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare⁴ _____ aplikime, me një fond _____ lekë, lista bashkëlidhur
8. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike _____ familjet e mëposhtme, për arsyet e renditura përbri.

Emri Atësia Mbiemri i kryefamiljarit

Arsyet e daljes nga skema

1. _____

2. _____

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Përgjegjësi i Dixhitalizimit
Shtetëror**

Drejtori Rajonal i Shërbimit Social

VULA

³ Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, neni 24, pika 5

⁴ Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, neni 24, pika 5

VENDIM
Nr. 182, datë 26.2.2020

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE E DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, SI DHE TË NDIHMËSIT PERSONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 17, pika 1, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRITERET E PËRFITIMIT TË PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar personat e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

2. Personat me aftësi të kufizuar, që nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilët me vendim të komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë një ndihmës personal me pagesë.

3. Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, bëhet nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP) të nivelit të parë, të Shërbimit Social Shtetëror.

4. Përfitojnë, sipas këtij vendimi, personat me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, të cilët në 5 vitet e fundit para lindjes të së drejtës nuk kanë, së paku, 12 muaj sigurim shoqëror dhe nuk kanë qenë përfitues të pensionit të plotë, të pjesshëm apo të reduktuar të invaliditetit nga skema e sigurimeve shoqërore para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

II. VLERËSIMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Pranë Shërbimit Social Shtetëror do të ngrihen dhe do të funksionojnë 5 (pesë) KMCAP-e të nivelit të parë, që do të vlerësojnë në nivel kombëtar dosjet e personave të përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, me këtë përbërje:

a) 2 (dy) KMCAP të shëndetit mendor, që do të kenë në përbërje psikopediater dhe psikiater;

b) 1 (një) KMCAP i kirurgjisë, onkologjisë, ortopedisë dhe reumatologjisë, që do të ketë në përbërje ortoped, onkolog dhe reumatolog;

c) 1 (një) KMCAP për paraplegjinë, tetraplegjinë dhe neurologjinë, që do të ketë në përbërje neurolog;

ç) 1 (një) KMCAP për sëmundje interne (nefrologji, kardiologji, gastroepatologji, endokrinologji, hematologji, pneumoalergologji), që do të ketë në përbërje internist, kardiolog, nefrolog dhe pneumoalergolog.

2. KMCAP-ja e nivelit të parë përbëhen nga pesë anëtarë, të cilët përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e shëndetësisë.

3. Në përbërje të çdo KMCAP-je të nivelit të parë mer pjesë, si anëtar me të drejtë vote, edhe një mjek, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror.

4. Shpenzimet për pagesën e anëtarëve të KMCAP-së të nivelit të parë përballohen nga buxheti i Shërbimit Social Shtetëror.

5. KMCAP-të e nivelit të parë marrin vendim për grupin e përfitimit, përfitimet dhe afatet e përfitimit për secilin grup, sipas anekseve nr. 1 e nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

6. Kundër vendimit të KMCAP-së të nivelit të parë personi mund të bëjë ankim në Komisionin Epror Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (Komisioni Epror).

7. Pranë Shërbimit Social Shtetëror ngrihen 4 (katër) komisione epnore, të cilat përbëhen nga 5 anëtarë për çdo komision dhe që zgjidhen në detyrë nga ministri përgjegjës për çështjet shëndetësore dhe sociale. Komisionet epnore të shërbimit social shtetëror janë:

- a) Komisioni Epror për Sëmundje të Përgjithshme;
- b) Komisioni Epror për Sëmundje të Shëndetit Mendor;
- c) Komisioni Epror për Paraplegjinë dhe Tetraplegjinë;
- ç) Komisioni Epror për Verbërinë.

8. Kryetari dhe anëtarët e komisionit epror janë mjekë me përvojë profesionale në fushën e ekspertizës dhe mjeku relator i Shërbimit Social Shtetëror. Anëtari i pestë i komisionit epror është me profesion jurist, me përvojë në fushën e aftësisë së kufizuar dhe përfaqësues i ministrisë që ka në fushën e përgjegjësisë shtetërore çështjet e aftësisë së kufizuar. Anëtarët e komisionit duhet të kenë një figurë të pastër morale dhe të mos jenë të dënuar penalisht. Mandati i anëtarit të komisionit epror është 4-vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje.

9. Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve të nivelit të parë dhe të komisioneve epnore përcaktohen në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

10. Shpenzimet për pagesën e anëtarëve të komisioneve epnore përballohen nga buxheti i Shërbimit Social Shtetëror.

11. Masa e shpërblimit mujor të anëtarëve të komisioneve të nivelit të parë dhe komisioneve epnore bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjsteve të qeverisjes qendrore.

12. Anëtarët e komisioneve nuk angazhohen në detyrat e përditshme të ushtrimit të profesionit të tyre dhe punojnë me kohë të plotë gjatë ditëve që janë të mbledhur në komision.

13. Personat me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikën 1, të kreut I, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen në rregulloren e Shërbimit Social Shtetëror.

14. Kriteret mjekësore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, përcaktohen në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe çështjet sociale.

III. MASA E PËRFITIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Masa e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar, e përcaktuar sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, është 10 653 (dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj. Të njëjtën masë pagese përfiton edhe ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuar, i përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar dhe pagesa e ndihmësit personal indeksohet çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

2. Personat me aftësi të kufizuar, që ndjekin një kurs kualifikimi të licencuar ose të akredituar, dhe nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuar gjatë kohës që ndjekin kursin e kualifikimit/vitit shkollor vetëm për një dhe gjatë një kursi kualifikimi/viti shkollor, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e kursit të kualifikimit/vitit shkollor.

3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si person me aftësi të kufizuar gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit. E njëjta masë pagese zbatohet për personat që ndjekin programin e studimit të ciklit të tretë. Për personat që ndjekin studimet e doktoratës dhe për personat që ndjekin procedurat për fitimin e një titulli akademik, kjo pagesë përfitohet në mënyrë të përhershme, mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente për fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.

4. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin, njëkohësisht, arsimin e mesëm të lartë apo arsimin e lartë dhe një kurs kualifikimi, përfitojnë vetëm njërin nga pagesat.

5. Personat e përcaktuar sipas pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, me plotësimin e moshës dhe të kushteve për përfitim pensioni, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore, ndërpresin pagesat që përfitojnë sipas këtij vendimi.

6. PAGESA E NDIHMËSIT PERSONAL TË PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, sipas shkronjës “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, është në masën 11 190 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj. Kjo pagesë indeksohet çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

7. Përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

8. Periudha e shërbimit si ndihmës personal për personat e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë siguri, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindjeje, aksidenti në punë, sëmundjeje profesionale dhe siguri shëndetësor. Kontributet paguhen në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohen nga buxheti i shtetit.

9. Ndihmësit personale, që ofrojnë shërbim për më shumë se një përfitues, marrin një shtesë prej 50% të shumave përkatëse për çdo përfitues të shtuar.

10. Përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar nuk llogaritet në të ardhurat e familjes, për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike.

11. PAGESA PËR PERSONAT QË PËRFITOJNË NGA KY VENDIM DHE E NDIHMËSIT PERSONAL BËHET NË HERË NË MUAJ, nëpërmjet shërbimit bankar ose Postës Shqiptare, pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.

12. Personave me aftësi të kufizuara, sipas pikës 1, të kreut I, të cilët vlerësohen për herë të parë në KMCAP, u lind e drejta e përfitimit të pagesës në muajin pasardhës, nga data e marrjes së vendimit nga ky komision.

113 Përfitimi i pagesës nga personat me aftësi të kufizuar ndërpritet:

- a) kur personi refuzon të kryejë ekzaminimet e kërkuara;
- b) kur dokumentacioni për rivlerësim nuk paraqitet sipas afateve të përcaktuara në rregulloret e organizimit, të të drejtave, detyrave dhe funksionimit të komisioneve të vlerësimit;
- c) kur personi nuk paraqitet në komisionin e pror dy herë radhazi dhe refuzon të kryejë ekzaminimet e kërkuara/mjekimin e rekomanduar/ marrjen e shërbimit të rekomanduar;
- ç) kur vërtetohet që personi nuk është rezident në Shqipëri;
- d) kur personi ka qëndruar për më shumë se tre muaj jashtë Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për arsye shëndetësore;
- dh) për personat e përcaktuar në nenin 11, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI PËR VLERËSIM DHE PËRFITIM PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Personat, që vlerësohen me aftësi të kufizuar, pajisen nga institucioni i kujdesit shëndetësor, i specializuar me shtretër, me fletën e drejtimit për në KMCAP. Personat, që rivlerësohen për aftësinë e kufizuar, pajisen nga mjeku specialist me epikrizë, në bazë të rekomandimit të mjekut të familjes. Dokumentacioni për vlerësimin/rivlerësimin e aftësisë së kufizuar, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve nga institucioni shëndetësor pranë njësisë administrative ku individi ka vendbanimin.

2. Për personat me aftësi të kufizuar, për të cilët me vendim të komisionit mjekësor është përcaktuar se kanë nevojë për përkujdesje, plotësohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve dokumentacioni për ndihmësin personal, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal.

3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë,

paraqesin çdo fillim të vitit ri shkollor/akademik dokumentet e mëposhtme:

a) Vërtetimin, të nënshkruar nga titullari dhe sekretari i institucionit arsimor të mesëm të lartë dhe të lartë, ku të shënohen emri dhe mbiemri i personit, niveli i arsimit që ndjek, viti shkollor/akademik dhe kohëzgjatja. Për të vërtetuar frekuentimin e procesit mësimor, vërtetimi lëshohet çdo tre muaj. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të çdo sezoni lëshohet vetëm për personat që ndjekin arsimin e lartë;

b) Kopjen e noterizuar të dëftesës së çdo viti dhe kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së mesme të lartë apo të lartë, si dhe/ose kopje të dëshmisë së kursit të kualifikimit.

4. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët kanë fituar gradë shkencore/titull akademik, paraqesin kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.

5. Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror ose rajonal ka të drejtë të verifikojë, me strukturat përgjegjëse për çështjet e arsimit, vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar nga ana e institucioneve arsimore.

6. Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor, e dërgon atë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, me procesverbal, pranë mjekut të drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror, dhe listën emërore të personave që do të vlerësohen apo do të rivlerësohen, pranë KMCAP-së. Mjeku verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMCAP. Mjeku mban regjistrin e personave me aftësi të kufizuar, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.

7. Në rastet e rivlerësimit, administratori shoqëror njofton personin 2 (dy) muaj para përfundimit të afatit të vlerësimit për pajisjen me epikrizën përcjellëse.

8. Personat, të cilëve u ndryshon gjendja shëndetësore brenda afatit të përfitimit, i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit me fletëdrejtimi të re.

9. Drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror, në përfundim të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për personat aplikues, hedhin në arkivin elektronik, brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e vlerësimit/rivlerësimit, dokumentacionin që përmban dosja e përfituesit dhe e dërgojnë atë pranë njësisë administrative, të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person.

10. Administratori shoqëror, në bazë të vendimeve të komisionit, përgatit listën e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar, të shoqëruar me masën e përfitimit për çdo përfitues, përfshirë edhe përfitimet shtesë, të bazuara në dokumentacionin përkatës, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo listë i dërgohet çdo muaj strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki për të kryer pagesat.

11. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki përgatit listën e plotë dhe masat e përfitimit për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar nën juridiksionin e saj dhe mundëson ekzekutimin e pagesave brenda afateve ligjore.

V. PROCEDURA E ANKIMIMIT NË KOMISIONIN EPROR

1. Kundër vendimit të KMCAP-së së nivelit të parë personi mund të bëjë ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve në komisionin epror. Procedura e ankimit kryhet, si më poshtë vijon:

a) Ankimi në komisionin epror bëhet me shkrim dhe dorëzohet pranë drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror;

b) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror dërgon në Shërbimin Social Shtetëror dosjen e ankimuesit, së bashku me një relacion të hollësishëm, ku argumentohet vendimi i marrë nga KMCAP-ja e nivelit të parë;

c) Shërbimi Social Shtetëror njofton anëtarët e KMCAP-së eprore dhe ankimuesit 7 (shtatë) ditë përpara zhvillimit të seancës së komisionit epror.

2. Mjeku pranë Shërbimit Social Shtetëror, në rolin e relatorit, studion dokumentacionin e dosjes, procedurat e zbatuara në KMCAP-në e nivelit të parë, dokumentacionin e vlerësuar nga ky komision, pretendimet e parashtruara nga ankimuesi dhe përgatit një relacion, ku, ndër të tjera, shprehet edhe për referencën e gjendjes shëndetësore të ankimuesit, sipas kriterëve mjekësore orientuese për përcaktimin e aftësisë së kufizuar.

3. Seancat e mbledhjes së komisionit janë të përmuajshme dhe zhvillohen brenda një muaji, nga data e paraqitjes së dokumenteve në Shërbimin Social Shtetëror. Seanca zhvillohet në ditët e caktuara nga komisioni epror, i cili tërhiqet për të marrë vendimin pa praninë e personit. Komisioni epror mblidhet jo më pak se dy herë në muaj dhe kur janë mbledhur jo më pak se 20 dosje.

4. Vendimet e komisionit epror merren me shumicë të thjeshtë votash. Mbledhja mund të zhvillohet edhe në mungesë të njërit prej anëtarëve, por asnjëherë në mungesë të kryetarit. Në rastet kur ka barazi votash, në fund vendos vota e kryetarit të komisionit.

5. Anëtarët e komisionit epror kanë të drejtë të argumentojnë votën e tyre pro ose kundër. Vendimi i komisionit epror plotësohet sipas formatit nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Vendimi i komisionit epror arkivohet në dosjen përkatëse dhe i njoftohet me shkrim edhe ankimuesit, brenda një afati 8-ditor.

7. Nëse ankimuesit nuk paraqiten para komisionit 2 herë radhazi dhe refuzojnë të kryejnë ekzaminimet e kërkuara apo mjekimin e rekomanduar, komisioni epror merr vendim “pa aftësi të kufizuar”, dhe dosja i kthehet drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror. Në këtë rast, dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura si për rastet që paraqiten para komisionit për herë të parë.

8. Komisioni epror nuk mund të marrë në rishqyrtim rastet për të cilat ai është shprehur një herë, në rastet kur ankimuesi ka të njëjtën gjendje shëndetësore, për të cilën pretendohet aftësi e kufizuar.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit për përfitim si kategori e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me përcaktimet në këtë vendim, individët, të cilët janë kategori përfituese e pagesave të aftësisë së kufizuar sipas vlerësimit biopsikosocial, të përcaktuar në vendimin nr. 722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”.

2. Vendimi nr. 618, datë 7.9.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të gjitha organet e administratës shtetërore shëndetësore e sociale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



KMCAP NIVELI PARË PËR _____

VENDIM Nr. _____

Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, i mbledhur më datë ____/____/_____, pasi shqyrtoi kërkesën dhe dokumentat e aplikuesit _____, konstatoi se:

Kuadri klinik sipas dokumentacionit mjekësor:

Përshkrimi i analizave dhe i ekzaminimeve bazë: _____

Diagnoza: _____

Kodi i sëmundjes: _____

Mbështetur në dokumentat, diagnozën, ekzaminimet, si dhe kriteret mjekësore:

VENDOSI:

Të caktojë _____, se _____ Person me Aftësi të Kufizuar, grupi _____, prej datës ____/____/_____ deri më ____/____/_____, sipas ligjit 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij: _____

Z/Znj _____, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Afati i rikontrollit në KMCAP: _____

Shënim: _____

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

KRYETARI I KOMISIONIT

(_____)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
KMCAPI NIVELI PARË PARAPLEGJI-TETRAPLEGJI

VENDIM Nr. _____

Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, në rrethin e Tiranës, i mbledhur më datë ____/____/_____, pasi shqyrtoi kërkesën dhe dokumentat e aplikuesit _____, konstatoi se:

Kuadri klinik sipas dokumentacionit mjekësor: _____

Përshkrimi i analizave dhe i ekzaminimeve bazë: _____

Diagnoza: _____

Kodi i sëmundjes: _____

Mbështetur në dokumentat, diagnozën, ekzaminimet, si dhe kriteret mjekësore:

VENDOSI:

Të caktojë _____, _____ përfitues i statusit para-tetraplegjisë, grupi _____, prej datës ____/____/_____ deri më ____/____/_____.

Sipas ligjit nr. 8626 datë 22/06/2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", ligjit 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

Z/Znj _____, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Z/Znj _____, ka nevojë për paketë të veçantë higjieno-sanitare, sipas VKM nr. 78 datë 07/02/2007, të ndryshuar.

Afati i rikontrollit në KMCAPI: _____

Shënim: _____

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

KRYETARI I KOMISIONIT

(_____)

Divergjencë: _____

Mjeku: _____

Datë: _____

Divergjencë: _____

Mjeku: _____

Datë: _____

SHËNIM I AUDITIT

U kontrollua më datë ___ / ___ / _____, nga mjeku i Auditit _____ dhe rezultoi se:

Mjeku i Auditit

(_____)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
KMCAP EPROR PËR _____

VENDIM Nr. _____

Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, Epror, i mbledhur më datë _____, pasi dëgjoi relacionin e përgatitur nga z/znj. _____, mjek pranë ShSSH, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentat e Z/Znj. _____, që me vendim nr. _____, datë _____ KMCAP të nivelit të parë _____, është deklaruar _____, pasi vuan nga sëmundja:

KMCAP Epror, pasi e vizitoi të sëmurën/ të sëmurin, konstatoi se vuan nga sëmundja:

Mbështetur në dokumentat, diagnozën si dhe kriteret mjekësore:

VENDOSI:

Të caktojë se z/znj _____, _____ përfiton grupi _____ prej datës _____/_____/_____ deri më datën _____/_____/_____ sipas ligjit nr. 57 datë 18.07.2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim: _____.

Z/Znj _____, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Rikontroll në KMCAP EPROR: _____ në muajin _____

Këshilla mjekësore për riaftësim: _____

Shënim: _____

Relatori
(_____)

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

(_____) (_____) (_____) (_____)

KRYETARI I KOMISIONIT

(_____)